

KDU 3:1(05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

# STUDIME SHOQËRORE

7

KDU 3:1(05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

# STUDIME SHOQËRORE

7

KDU 3:1(05)

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SECTION OF SOCIAL SCIENCES

# SOCIAL STUDIES

7

Editorial board

Muhamedin Kullashi, editor-in-chief

Frashër Demaj, secretary

Oliver Schmitt, member

Justina Shiroka Pula, member

Gjyljeta Mushkolaj, member



PRISHTINA  
2020

KDU 3:1(05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

# STUDIME SHOQËRORE

## 7

Këshilli redaktues

Muhamedin Kullashi, kryeredaktor

Frashër Demaj, sekretar

Oliver Schmitt, anëtar

Justina Shiroka Pula, anëtare

Gjyljeta Mushkolaj, anëtare



PRISHTINË

2020

Copyright © ASHAK

Adresa / Address:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës  
Redaksia e revistës “*Studime shoqërore*”  
Rr. Agim Ramadani, nr. 305  
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel. + 381 38 249 303  
E-mail: [ashak@ashak.org](mailto:ashak@ashak.org)

## PËRMBAJTJA

<b>HIVZI ISLAMI: KOSOVA PËRBALLË HEGJEMONIZMIN SERB</b> .....	7
<b>MUHAMEDIN KULLASHI: HEIDEGGERI MBI VULLNETIN PËR FUQI SI ART</b> .....	33
<b>EDI SHUKRIU: SI E SIGURONIN DARDANËT KRIPËN JETIKE?</b> .....	77
<b>SUSANA VILLAVICENCIO: SARMIENTO ET L'EMERGENCE DE LA NATION CIVIQUE EN ARGENTINE</b> .....	95
<b>HAQIF MULLIQI: ZONJUSHA GJULIA – NATYRALIZMI SI QËLLIM FILOZOFIK I STRINDBERGUT</b> .....	115
<b>ARSIM BAJRAMI &amp; FLORENT MUCAJ: ASPEKTE KUSHTETUESE TË DIALOGUT KOSOVË - SERBI</b> .....	149
<b>STÉPHANE DOUAILLER: VIOLENCES ET AMOURS POLITIQUES : LE DROIT AU SEIN DE LEUR DECHAINEMENT</b> .....	181
<b>FRASHËR DEMAJ: BURIME BRITANIKE PËR ARRESTIMIN DHE INTERNIMIN E GRAVE DHE FAMILJEVE SHQIPTARE QË NGRITËN KRYE KUNDËR PUSHTETIT OSMAN 1910-1912</b> .....	191
<b>RREZE KRYEZIU-BREZNICA: KOMPOZITORËT E MUZIKËS ARTISTIKE NË KOSOVË - NDARJA HISTORIKE SIPAS MUZIKOLOGJISË KOSOVARE</b> .....	207
<b>HIVZI ISLAMI: DËSHMI (MEMORIE) - “FRONTI I JUGUT” - RRËFIM PAS TRI DEKADAVE</b> .....	231
<b>GEORGES NAVET: LES DIFFICULTÉS D'UNE LECTURE STRAUSSIENNE DE VICO</b> .....	241
<b>SHPRESË SIQECA: MARTESAT DHE DASMAT TRADICIONALE PRIZRENASE</b> .....	257

<b>DARIO CANINO: SOCIAL CONTEXT OF ROMAN PUBLIC AREAS: THE RELATIONSHIP BETWEEN BUILDING PHASES OF THE FORA AND LEGAL STATUS OF THE ROMAN CITIES.....</b>	<b>271</b>
---	------------

## RECENSIONE

<b>EQREM BASHA: MUHAMEDIN KULLASHI, KTHESA E DRAMËS MODERNE (SHEK. XIX - XX) Dramaturgjia e Ibsenit dhe e Strindbergut .....</b>	<b>349</b>
<b>DAUT DAUTI: NOEL MALCOLM USEFUL ENEMIES – ISLAM AND THE OTTOMAN EMPIRE IN WESTERN POLITICAL THOUGHT 1450-1750 (ARMIQTË E DOBISHËM – ISLAMI DHE PERANDORIA OTOMANE NË MENDIMIN POLITIK TË PERËNDIMIT 1450-1750).....</b>	<b>353</b>
<b>HIVZI ISLAMI: BRANISLAV KRSTIĆ, KOSOVO IZMEĐU ISTORIJSKOG I ETNIČKOG PRAVA, KUĆA VID, BEOGRAD, 1994, FF. 1-318.....</b>	<b>359</b>
<b>SHPRESË MULLIQI: CHARLES LUDWIG, THE QUEEN OF THE REFORMATION (MBRETËRESHA E REFORMACIONIT, BOTUAR NGA OPERATION MOBILISATION GREATER EUROPE .....</b>	<b>375</b>
<b>JEAN-PIERRE MARCOS: PARATHËNIE PËR LIBRIN E MUHAMEDIN KULLASHIT FOUCAULT ET LEFORT : REGARDS CROISÉS SUR LA MODERNITÉ (FOUCAULT DHE LEFORT: SHIKIME TË KRYQËZUARA MBI MODERNITETIN), L’HARMATTAN, PARIS, 2020. ....</b>	<b>387</b>
<b>RREZE KRYEZIU BREZNICA: MUZIKA ARTISTIKE NË KOSOVË: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI LITERATURËN EKZISTUESE.....</b>	<b>393</b>

Hivzi Islami, Prishtinë

## KOSOVA PËRBALLË HEGJEMONIZMIT SERB

### Abstrakt

Në këtë artikull shqyrtohen aspiratat hegjemoniste dhe ekspansioniste serbe me qëllim të formimit të Serbisë së Madhe; spastrimi etnik i territoreve shqiptare etj.; roli i Evropës në çështjet brendaballkanike dhe shqiptarët si viktima më e madhe; historiku i konfliktit serbo-shqiptar dhe fillimi i krizës së ish-shtetit përmes dhunës në Kosovë në vitin 1981; projektet recente serbe për copëtimin, ndarjen e Kosovës, shkëmbimin e territoreve dhe të popullatave dhe dëbimin e shqiptarëve; hegjemonizmi serb si burim i destabilizimit afatgjatë në Ballkan; krijimi i një Mini-Shengeni Ballkanik si ide e Serbisë zyrtare me qëllim të krijimit të një Jugosllavie të Vogël, që do t'i përngjante unioneve dhe marrëveshjeve të viteve 1946-1948 midis Josip B. Titos dhe Enver Hoxhës për nënshtrimin e Shqipërisë nga ish-Jugosllavia në planin ekonomik, tregtar, politik e ushtarak, ndërsa Kosovën e sotme do ta shndërronte në një qark të Serbisë etj.

*Fjalët çelës:* Projektet hegjemoniste serbe, spastrim etnik, shqiptarët si viktima më e madhe në Ballkan, konflikti serbo-shqiptar, copëtimi i Kosovës, shkëmbimi i territoreve dhe popullatave, mini-Shengeni ballkanik.

### IDETË DHE PROJEKTET SERBOMËDHA

Po mbushen gati dy shekuj që kur Serbia ka hartuar shumë projekte me qëllim të realizimit të aspiratave hegjemoniste e ekspansioniste dhe rrjedhimisht të krijimit të Serbisë së Madhe ose të një shteti të sllavëve të jugut ku do të dominonin dhe sundonin serbët (Serbia, BeH, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, Sllavonia, Sremi, Banati, Baçka, pjesa më e madhe e Kroacisë së sotme). Projekti i parë, si dokument sekret i Qeverisë së Serbisë së atëhershme, me sa dihet është “Naçertanije” e Ilija Garashaninit i vitit 1844, si “Program i politikës së jashtme dhe i politikës nacionale të Serbisë në mbarim të vitit 1844”. Në fillim të projektit theksohet se “themeli i politikës serbe” është që Serbia “nuk mund të ngushtohet në kufijtë e sotëm,



veçse ajo synon t'i afrojë e bashkojë të gjithë serbët që e rrethojnë”.<sup>1</sup> Në hartimin e “Naçertanjes” rol të madh kanë luajtur njerëzit e migracionit polak me orientime pansllaviste, në krye me knjazin dhe diplomatën Adam Çartorijski (1770-1861), që i formoi misionet e tij në disa qendra evropiane. Në Serbi e dërgoi agjentin e tij, çekun Frantishek Zah (1807-1892), i cili kishte bërë një plan për politikën sllave të Serbisë, si qendër e sllavizmit, e që duhej t'ia paraqiste Ilija Garashaninit, ndër njerëzit më të rëndësishëm të administratës shtetërore dhe të diplomacisë në Serbinë e atëhershme. Në bazë të këtij plani të Zahut (afër 90% të tij) u vërtetua se Garashanini e hartoi “programin e politikës së brendshme dhe të jashtme të Serbisë” të përmbledhur në projektin “Naçertanije”.<sup>2</sup>

Që nga mesi i shek. XIX e deri në përfundim të shek. XX shteti serb nuk ka prajtur së vepruari me të gjitha institucionet e tij, ushtarake e policore, kishtarë, shkencore dhe kulturore për hartimin e projekteve për krijimin e Serbisë së Madhe dhe daljen e saj në detin Egje dhe detin Adriatik, sikundër dhe për ndërmarrjet konkrete kriminale e gjenocidale ndaj popujve të tjerë, veçanërisht ndaj shqiptarëve dhe tokave të tyre. Një nga idetë megalomane të tij nga fillimi i pjesës së dytë të shek. XIX dhe fillimi i shek. XX ishte dalja e Serbisë në detin Egje përmes ndërtimit të kanalit Moravë-Vardar, për çka shprehën interesim disa kompani të huaja të kohës (dy franceze, një gjermane, një angleze dhe një amerikane). Terreni i komplikuar,<sup>3</sup> kostoja shumë e lartë e ndërtimit dhe ndërhyrja e Rusisë ishin pengesat kryesore që projekti nuk u realizua. Por ideja e ndërtimit të këtij kanali u aktualizua edhe në pjesën e dytë të shek. XX, madje

<sup>1</sup> Shih: *Izvori velikosrpske agresije*, Rasprave-dokumenti, (Red. B. Čović), A. Cesarec-Školska knjiga, Zagreb, 1991, f. 65-77. Projekti është botuar për herë të parë në vitin 1906. Shih M. Vučković, *Program spoljne politike Ilije Garašanina na koncu 1844 godine*, Delo XXXVIII, Beograd, 1906, f. 321-336 dhe D. Stranjaković, *Kako je postalo Garašaninovo “Načertanije”*, Spomenik SKA, XCI, Beograd, 1939, f. 76-102. Teksti i plotë në gjuhën shqipe është botuar në librin: Hivzi Islami, *Spastrimet etnike*, Dukagjini, Pejë, 2003, ff. 95.111 (E përktheu Idriz Ajeti).

<sup>2</sup> Më gjerë: Mirko Valentić, “Prva programska formulacija velikosrpske ideje”, në *Izvori velikosrpske agresije*, Rasprave-dokumenti, (Red. B. Čović), A. Cesarec-Š. knjiga, Zagreb, 1991, ff. 41-63).

<sup>3</sup> Në rrugën lundruese Moravë-Vardar, sipas vlerësimeve të kohës, duhej të ngrihej një sistem i tërë kaskadash e kanalesh për t'i eliminuar dallimet hipsometrike prej 461.6 metrash (krrusja midis Preshevës dhe Kumanovës) dhe vetëm nga qyteti i Smederevës e deri te porti i Selanikut në Greqi parashihej ndërtimi i 65 kaskadave!

edhe sot e gjithë ditën udhëheqja e Partisë Përparimtare Serbe (ish-Partia Radikale Serbe e V. Sheshelit) dhe Qeveria e bërë prej tyre, me ministrat e saj, ekspertët dhe analistët e të tjerët angazhohet për ringjalljen e idesë për realizimin e këtij projekti; një konzorcium i madh kinez ka përgatitur edhe studimin e fizibilitetit dhe projekti është bërë pjesë e synimeve planifikuese e strategjike të Serbisë.<sup>4</sup>

Në fillim të dekadës së dytë të shek. XX,<sup>5</sup> pas tërheqjes së Perandorisë Osmane dhe pavarësisë së Shqipërisë (1912), një shkencëtar i njohur serb i kohës, Jovan Cvijiç (1865-1927), i cili i kishte vënë bazat e ekspansionizmit serb në Ballkan, kishte dalë më projektin e njohur me titull “Dalja e Serbisë në detin Adriatik”,<sup>6</sup> ku e arsyeton nevojën e Serbisë për dalje në detin Adriatik për motive ekonomike, por e përdor edhe “argumentin” e ndërlidhjes historike midis Shqipërisë Veriore dhe Serbisë së Vjetër (lexo Kosovës). Nën pretekstin e rritjes demografike të serbëve dhe nevojës së tyre për “hapësirë jetësore”, Serbia “për shkak të pavarësisë së saj ekonomike duhet patjetër të del në detin Adriatik dhe në një pjesë të bregdetit

<sup>4</sup> Shih më gjerë në: H. Islami - A. Ejupi, “Aspiratat shekullore serbe për dalje në det”, *Studime shoqërore*, 6, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2019, ff. 7-40.

<sup>5</sup> Ndër projektet serbomëdha dhe veprimet e organizuara të bandave çetnike kundër popujve joserbë duhet përmendur edhe organizatën “Crna ruka” (“Dora e zezë”), e cila për nga idetë, qëllimet dhe metodat e veprimit ishte padyshim terroriste dhe kriminele që ishte formuar qysh në vitin 1903 nga strukturat militante dhe kriminele të ushtrisë serbe. Pas një përçarjeje të brendshme, në vitin 1911 “Crna ruka” e ndërron emrin dhe shndërrohet në organizatën “Bashkim ose vdekje”. Mirëpo për nga orientimi nuk ndërron asgjë, mbetet *organizatë sekrete që merrej me komplete, atentate dhe veprime terroriste çetnike*, e cila ka vrarë shumë shqiptarë, veçanërisht në Maqedoni. “Është organizatë komplotiste serbe të cilën e përbënin kryesisht oficerët pjesëmarrës të përmbysjes së oborrit në vitin 1903; pas ndarjes së saj një pjesë formoi organizatën sekrete nacionaliste me emrin “Ujedinjenje ili smrt” (“Bashkim ose vdekje”) ose “Crna ruka” (Dora e zezë), si e kanë quajtur pastaj, ndërkaq pjesën tjetër e quanin “Bela ruka” (Dora e bardhë). Qëllimi i “Dorës së zezë” ishte që të gjithë serbët t’i bashkojë në Mbretërinë Serbe si piemont të serbizmit; forca kryesore e realizimit të qëllimit do të ishte Mbretëria Serbe, ndërsa organizatat e ndryshme komplotiste ndër serbë jashtë Serbisë do ta ndihmonin me propagandë, atentate dhe veprime çetnike. Organizata ka konsideruar se këtë detyrë mund ta realizojë vetëm nëse vetë e merr udhëheqjen dhe të gjitha forcat e Mbretërisë së Serbisë dhe lëvizjet e serbëve jashtë Serbisë i orienton në drejtim të krijimit të Serbisë së Madhe” (*Mala enciklopedija “Prosveta”*, Treće izdanje, 3, R-Š, Prosveta, Beograd, 1978, f. 644).

<sup>6</sup> J. Cvijiç, “Izlazak Srbije na Jadransko more”, *Glasnik srpskog geografskog društva*, god. 1, br. 2, Beograd, 1912, ff. 192-204.

shqiptar qoftë me uzurpimin e territorit, qoftë përmes sigurimit të të drejtave ekonomike dhe komunikative për këtë hapësirë” – theksonte ai! Angazhimi i Cvijiqit për zgjerimin e “hapësirës jetësore” të serbëve është identik me qëllimet gjeopolitike të qarqeve naciste hitleriane midis Dy Luftërave Botërore.

Jugosllavia e Versajës (1919), si katurë artificiale, që nga ditët e para të krijimit të saj në mënyra të ndryshme bëri përpjekje ta zvogëlojë numrin e shqiptarëve, ta shkatërrojë tërësinë kompakte hapësinore etnike të tyre dhe, përmes politikës së reformave agrare dhe kolonizimit ta krijojë territorin e pastër etnik në rajonet e banuara nga shqiptarët. Për këto qëllime shteti nxori një varg ligjesh, dekretesh, rregulloresh, udhëzimesh, urdhërash, instruksionesh e vendimesh, madje u formuan edhe banka të veçanta agrare<sup>7</sup> mbi bazë të të cilave ndërmoi një varg masash drastike të natyrës ekonomike, sociale, juridike e politike, masa për shpërnguljen e dhunshme në Turqi, Shqipëri e në vende të tjera, për asimilim, pastaj ushtroi tortura fizike policore e deri te përpjekjet për shfarosje fizike. Në fakt këto masa ishin vazhdim i atyre nga viti 1912, kur Serbia e okupoj Kosovën, duke bërë krime të mëdha në popullatën shqiptare.<sup>8</sup>

Fundi i viteve të 30-ta shquhet me nxjerrjen e shumë elaboreteve dhe projekteve me karakter fashistoid dhe gjenocidal të paraqitur në Klubin Kulturor Serb në Beograd më 7 mars 1937, çfarë ishin ai i prof. Vasa Çubrilloviqit<sup>9</sup> dhe i nobelistit Ivo Andriq (1892-1975) i vitit 1939,<sup>10</sup> i cili angazhohej për daljen e Serbisë në detin Adriatik, madje edhe me hekurudhë, sikurse Cvijiqi më 1912, duke okupuar territorin e Shqipërisë, por edhe duke i shpërngulur dhe asimiluar shqiptarët në të dy anët e kufirit. Pas planeve dhe elaboreteve të

<sup>7</sup> J. Osmani, "Zakonski propisi o agrarnoj reformi i kolonizaciji na Kosovu između dva svetska rata", *Vjetar - Godišnjak*, XX, Prishtinë, 1985, ff. 169-189.

<sup>8</sup> Shih më gjerë punimet e autorit H. Hoxha: "Elemente të presionit ekonomik ndaj shqiptarëve në Jugosllavinë e vjetër", *Përparimi*, nr. 4, Prishtinë 1970; "Politika e eliminimit të shqiptarëve nga trualli i Jugosllavisë së vjetër", *Përparimi*, nr. 5, 1970; "Proces nacionalne afirmacije albanske narodnosti u Jugoslaviji", *Časopis za kritiko znanosti*, 51 - 52, Ljubljana, 1982, f. 244-318.

<sup>9</sup> *Iseljavanje Arnauta*, Predavanje održano u Srpskom kulturnom klubu od dr. Vase Čubrilovića, 7. marta 1937. godine, Vojnoistorijski institut, Arhiv bivše jugoslovenske vojske, br.2, fasc. 4, kutija 69 (në shtojcë: një hartë, dy tabela dhe dy grafikone; teksti ka 19 faqe makine, i shkruar me alfabet cirilik, në origjinal është i nënshkruar me dorë; fotokopja e elaboratit gjendet te autori i këtij botimi (nënvizoi H. I.).

<sup>10</sup> B. Krizman, "Elaborat dr Ive Andrića o Albaniji", *Časopis za suvremenu povijest*, II, Zagreb, 1977, f. 81-89 (E përktheu Vehap Shita).

prezantuara në “Klubin Kulturor Serb” më 1937 ishte përgatitur terreni për arritjen e marrëveshjes midis Turqisë dhe Jugosllavisë (Konventa)<sup>11</sup> për shpërnguljen e 40.000 familjeve shqiptare me një numër të madh të anëtarëve për një familje, gjë që i përgjigjej qeverisë jugosllave, meqë pagesa bëhej sipas numrit të familjeve.<sup>12</sup>

Pas projektit të parë të V. Çubrilloviqit, të prezantuar në “Klubin Kulturor Serb” në mars të vitit 1937, edhe kryetari i këtij Klubi, Stevan Moleviqi, një ndër ideologët e lëvizjes çetnike të D. Mihajllloviqit, më 30 qershor 1941 e hartoi një plan me titull “Serbia homogjene”,<sup>13</sup> si dokument programor i kësaj lëvizjeje, ku parashihej krijimi i Serbisë së Madhe dhe dominimi i serbëve në Ballkan. “*Serbët duhet ta kenë patjetër hegjemoninë në Ballkan, e për ta pasur hegjemoninë në Ballkan duhet ta kenë më parë hegjemoninë në Jugosllavi*”, thoshte Moleviqi. Viktima e parë e planit të Moleviqit do të ishin shqiptarët. Projekte me përmbajtje plotësisht identike hartuan edhe vetë çetnikët e Drazha Mihajllloviqit në vitin 1941 e më vonë.<sup>14</sup> Në prag të përfundimit të Luftës II Botërore, prof. Vasa Cubrilloviqi sërish e hartoi një elaborat tjetër me titull “Problemi i pakicave në Jugosllavinë e Re”, të cilin gjatë hulumtimeve shkencore në një arkiv të Beogradit, në fillim të viteve të 80-ta të shek. XX, e gjeti dr. Seit Lipa. Projekti ishte hartuar menjëherë pas çlirimit të Beogradit, përkatësisht më 3.XI.1944.<sup>15</sup> Duke u udhëhequr nga pikëpamjet e

<sup>11</sup> “Konventa jugosllavo-turke e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve”, *Gjurmime albanologjike. Seria e shkencave historike, XII*, Prishtinë, 1982, ff. 243-271. Shih tekstin e plotë të Konventës në: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve)*, “Dukagjini”, Pejë, 2003, ff. 251-259 (E përktheu Eqrem Basha).

<sup>12</sup> Kjo Konventë nuk u ratifikua në Parlament nga frika se nuk do të miratohej pa debat të ashpër ashtu çfarë ishte ajo dhe nuk u zbatua për disa arsye të kohës, para së gjithash për shkak të shpërthimit të Luftës II Botërore, mungesës së mjeteve financiare, vdekjes së Atatürkut, rënies së qeverisë së Stojadinoviqit etj.

<sup>13</sup> S. Molević, “Homogena Srbija”, *Zbornik dokumenata i podataka o narodno-oslobodilačkom ratu naroda Jugoslavije, XIV*, knjiga 1, Dokumenti četničkog pokreta Draže Mihailovića 1941-1942, Vojnoistorijski institut, Beograd, 1981, ff. 1-10; *Izvori velikosrpske agresije*, Rasprave - dokumenti, (Red. B. Čović), A. Cesarec - Školska knjiga, Zagreb, 1991. Teksti i plotë i këtij plani u botua në: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve)*, “Dukagjini”, Pejë, 2003, ff. 273-280.

<sup>14</sup> Shih: *Dokument br. 37 od 20.XII.1941. godine*, Arhiv Vojnoistorijskog instituta, Beograd (me nënshkrimin e kryeçetnikut Drazha Mihajllloviq).

<sup>15</sup> “*Manjinski problem u novoj Jugoslaviji*”. Elaborati i ka 11 faqe (tekst i dendur makine) të alfabetit cirilik. Në shtojcë ka një tabelë (Broj Arnauta u Staroj Srbiji, Makedoniji i Crnoj Gori po srezovima od 31. marta 1931. godine”) dhe

teorikëve nacionalsocialistë gjermanë dhe tashmë si njeri me eksperiencë në përpilimin e planeve të etnisë së pastër dhe duke u thirrur në eksperiencat e Bashkimit Sovjetik me rastin e përzënies së shumë popujve, siç janë koreanët, kinezët, gjermanët e Besarabisë, polakët etj., gjatë viteve të 30-ta e të 40-ta të shek. XX -, në këtë elaborat në mënyrë edhe më brutale dhe më fashistoide se në vitin 1937 kërkon dëbimin e miliona njerëzve, pjesëtarë të bashkësive etnike joslave (shqiptarëve, hungarezëve, italianëve, rumunëve etj.), me shtetet amë të cilave rrethohej ish-Jugosllavia. Qëllimi kryesor i Elaboratit të tij ishte që Jugosllavia të bëhej një *shtet etnikisht i pastër, i populluar vetëm me popullatë sllave apo jugosllave*.

Deri tash nuk dihet se me iniciativë të kujt Çubrilloviqi e hartoi këtë elaborat pas çlirimit të Beogradit, me nismë të vetën apo dikush ia porositi, sikurse në Elaboratin e vitit 1937, kur e përpiloi me kërkesë të Shtatmadhorisë dhe të Qeverisë. Gjithashtu nuk na është e njohur kujt ia ka dërguar këtë elaborat. Mirëpo duke pasur parasysh faktin se për realizimin e tij Çubrilloviqi mbështetet në Ushtrinë Nacionalçlirimtare dhe Këshillat Nacionalçlirimtare, nuk ka dyshim se elaborati iu dërgua Mareshalit Tito. Janë disa dëshmi se vetë Titoja ka marrë pjesë në bisedimet me përfaqësuesit e Qeverisë së Turqisë për marrëveshjen e përtërirë të shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi në vitin 1953 në Bled, gjë që nuk është dokumentuar me material arkivor, sikundër që mbetet të ndriçohet pse ky projekt i Çubrilloviqit nuk u realizua menjëherë kur ende po zhvillohej Lufta e Dytë Botërore. Projekti “Problemi i pakicave në Jugosllavinë e Re” për shpërnguljen e të gjithë shqiptarëve përmes forcës ushtarake priste zbatimin dhe në bazë të një marrëveshjeje të fshehtë jugosllavo-turke të përtëritur në fillim të viteve të 50-ta në Split apo në Bled, ku ka marrë pjesë edhe vetë Titoja, nisi vala e shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi.<sup>16</sup>

---

një hartë (Broj Arnauta i Rumuna na sto stanovnika”). Në origjinal është i nënshkruar me dorë. V. Çubrilloviqi, anëtar i Akademisë Serbe të Shkencave dhe profesor në Universitetin e Beogradit, në Jugosllavinë e Re (të Titos), u emërua ministër i disa resorëve, por nuk ishte gjë e rastit që si historian ishte ministër i bujqësisë dhe i pylltarisë. Duhej ta organizonte kolonizimin në Vojvodinë dhe në Kosovë dhe, paralelisht me këtë, edhe shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi. Me këtë bëhet i qartë qëndrimi i Jugosllavisë së Re ndaj shqiptarëve! Shih gjithashtu: Rastoder, Šerbo, "Jedan manje poznat elaborat Vasa Čubrilovića o rješavanju manjinskog problema u novoj Jugoslaviji od 3. nov. 1944", *Crnogorski anali*, 5-6, Cetinje, 2014, pristupljeno 6. svibnja 2019.

<sup>16</sup> “Formalni rezultat bile su Konvencija o iseljavanju ‘neslovenskog elementa’ (200.000 ljudi) iz 1938. i tzv. Džentlmenski sporazum između Tita i turskog

Pas vdekjes së liderit jugosllav, J. B. Titos (1892-1980), Serbia dhe regjimi i Millosheviqit vazhduan me hartimin e projekteve për shkatërrimin e ish-shtetit dhe krijimin e Serbisë së Madhe mbi bazë të forcës ushtarake (JNA-APJ). Një ndër ta ishte Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve (1986),<sup>17</sup> për të cilin do të bëjmë fjalë më vonë, pastaj projekti i Partisë Radikale Serbe të Vojislav Sheshelit në vitin 1993<sup>18</sup> etj.

## ROLI I EVROPËS NË ÇËSHTJET BRENDABALLKANIKE DHE SHQIPTARËT SI VIKTIMA MË E MADHE

Është tashmë i njohur fakti se Evropa dhe bota në tërësi sikur janë tashmë të lodhur me Ballkanin dhe mentalitetin e tij. Sir W. Churchill (1874-1965) kishte theksuar në kujtimet e tij se “Ballkani prodhon më shumë probleme sesa që mund t’i absorbojë”. Por gjithashtu qëndron e vërteta se Evropa për një kohë të gjatë është drejtpërdrejt përgjegjëse për konfliktet midis shteteve dhe popujve të Ballkanit. Në përpjekjet për dominim këto 150 vjetët e fundit Evropa (Anglia, Franca, Austro-Hungaria, Italia, Gjermania) vazhdimisht e ka nxitur destabilizimin e përgjithshëm të Ballkanit dhe më tepër Rusia për shkak të interesave të saj pansllaviste në këtë rajon; roli i Turqisë deri në vitin 1912 është çështje në vete. Urrejtja midis etnive në Ballkan, konfliktet dhe interesat për territore dhe gllabërimi i tyre nga vetë vendet “e fuqishme” ballkanike në dëm të të tjerave, në radhë të parë ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve kanë një histori të gjatë dhe

---

šefa diplomatije Keprilija (Fuad Kyprili, ministër i Punëve të Jashtme të Turqisë – H. I.) iz 1953, koji je trebalo da „oživi“ prethodnu konvenciju kroz formu „spajanja porodica“ (“Rezultati formal ishte Konventa për shpërnguljen e ‘elementit joslav’ (200.000 njerëz) nga viti 1938 dhe e ashtuquajtura Marrëveshje xhentëlmene midis Titos dhe shefit të diplomacisë turke Keprilit (Fuad Keprili, ministër Punëve të Jashtme të Turqisë – H. I.) nga viti 1953, e cila duhej ta “ringjallë” konventën e mëparshme nëpërmjet formës së “bashkimit të familjeve”) (Vladan Jovanović, bashkëpunëtor i lartë shkencor në Institutin për Histori të Re të Serbisë: “Zašto su srpska i jugoslovenska država bile neuspešne u kolonizaciji Kosova”, në radioemisionin *Peščanik*, Beograd, 29.03.2013).

<sup>17</sup> “Memorandum” SANU (grupa akademika Srpske akademije nauka i umetnosti o aktuelnim društvenim pitanjima u našoj zemlji). Teksti i këtij “Memorandumi” merret nga revista “*Naše teme*”, 33 (1-2), Zagreb, 1989, ff. 128-163. (E përktheu Hivzi Islami).

<sup>18</sup> Shih tekstin e plotë në: Hivzi Islami, *Spastrimet etnike – Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve*, “Dukagjini”, Pejë, 2003, ff. 374-383.

komplekse.<sup>19</sup> Të gjitha këto kanë ndodhur nga animet e hapta të shteteve e fuqishme evropiane në favor të kombeve të privileguara brenda Ballkanit, të cilët për hir të paqes në Evropë i bënë kurban shqiptarët.<sup>20</sup> Politikat zyrtare, angleze dhe franceze mbajtën qëndrim antiboshnjak dhe proserb gjatë luftës në BeH në vitet e 90-ta të shek. XX. Srebrenica si zonë e mbrojtur e Kombeve të Bashkuara, ku u masakruan më se 8.300 burra boshnjakë në gusht të vitit 1995, ishte turpi më i madh i Evropës, i NATO-s dhe i Kombeve të Bashkuara.

As pas përfundimit të luftës së ftoftë në fund të shek. XX Evropa nuk e kuptoi realitetin politik dhe mbi të gjitha nuk u tregua e aftë t'i zgjidhë problemet në truallin e vet, përfshirë këtu në veçanti Ballkanin. Kjo u dëshmuar në rastin e ish-Jugosllavisë kur neo-hegjemionizmi serb me forcë ushtarake donte t'i nënshtonte dhe biologjikisht t'i zhdukte popujt joserbë, veçanërisht shqiptarët. Ruajtja me çdo kusht e Jugosllavisë së Titos ishte një gabim i rëndë i vendeve evropatlantike, sikundër që pati përpjekje të ruhej Jugosllavia e tretë, e ashtuquajtur e Zhablakut (Serbia dhe Mali i Zi),<sup>21</sup> dhe pati pastaj insistime që të gjallëronte edhe Unioni Serbi-Mali i Zi, disproporcional në madhësi territoriale dhe demografike, deri te disfunkcionalizimi dhe rrjedhimisht dekompozimi i tij. Kur Mali i Zi vendosi të del nga Unioni me Serbinë dhe të pavarësohet në vitin 2006 përmes referendumit, BE-ja i vuri kusht që duhet mbështetja jo e standardit 50+1, por validitetin e rezultatit e çoi në 55% të numrit të përgjithshëm të votuesve (!); referendumi ishte i suksesshëm, ngase

<sup>19</sup> "Dje 'fuçi baruti e Europës', sot një përzierje shtetesh të vogla të cilat pas një gjysmë shekulli që kanë qenë – përveç Greqisë – në 'kampin socialist', me sa duket po rizbulojnë për të ripohuar identitetet e tyre kombëtare duke i shprehur në grindje ndëretnike dhe në rivendikime arkaike kufijsh" (G. Castellan, *Histori e Ballkanit*, Libra për një shoqëri të hapur, "Çabej", Tiranë, 1991, f. 11).

<sup>20</sup> Kryetari i Konferencës së Ambasadorëve dhe ministër i Punëve të Jashtme të Anglisë Eduard Grey, më 12 gusht 1913, në Dhomën e Komunave deklaroi: "Unë e di fare mirë se kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo (zgjidhje) në shumë pika do të japë shkas për kritika të mëdha nga kushdo që e njeh vendin dhe që e gjykon çështjen nga një pikëpamje e ngushtë lokale. Duhet të mos harrohet se gjatë përpjekjeve për të gjetur një zgjidhje të tillë, qëllimi kryesor ka qenë që të ruhej marrëveshja midis vetë Fuqive të Mëdha dhe, në qoftë se vendimi për Shqipërinë e ka siguruar këtë, atëherë ai e ka bërë punën më të rëndësishme në të mirë të paqes së Europës" (*Historia e popullit shqiptar, III*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2000, f. 26).

<sup>21</sup> "Jugosllavia e Tretë" (Serbia dhe Mali i Zi), e njohur si Republika Federative e Jugosllavisë, u themelua më 27.4.1992 dhe Unioni Serbi-Mali i Zi më 4. 2. 2003, ndërsa më 21. 5. 2006 Mali i Zi del nga ky Union dhe bëhet shtet i pavarur dhe sovran.

votuan pro 55,4%, ku roli i boshnjakëve dhe i shqiptarëve ishte vendimtar. BE-ja donte me çdo kusht ta pengonte shkëputjen e Malit të Zi nga Unioni edhe për shkak se nuk dëshironte që Kosova të pavarësohej.

Edhe mosgatishmëria e BE-së sot që të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor të integrohen në të është një gabim i rëndë i radhës, sepse vetëm me integrimin e tij në këtë bashkësi do të evitoheshin mundësitë e konflikteve etnike-shtetërore. Integrimi i Ballkanit Perëndimor në tërësi në BE është në dobi të Evropës dhe në funksion të pengimit të çarjes së mëtejshme të UE-së, veçanërisht me largimin e Britanisë së Madhe. Pengimi i përfshirjes së vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, kryesisht nga Franca, dhe dështimi i negociatave për pranim në BE të Shqipërisë dhe Maqedonisë në tetor 2019 (me ndërhyrjen e ashpër të kryetarit francez Macron) dhe bllokimi i liberalizimit të vizave për Kosovën është një dëshmi se BE-ja me sjelljet e saj po e largon Ballkanin nga gjiri i vet më shumë se para vitit 2015 dhe po e thellon krizën brenda vetvetes! Vendi i fundit që u anëtarësua në BE në vitin 2013 ishte Kroacia dhe nga ky vit u ndal procesi i zgjerimit të Unionit nga vendet e Ballkanit P. Franca, duke dashur të marrë një rol të ri në BE dhe të merr primatin mbi Gjermaninë dhe A. Merkelin që nga hapja e Procesit të Berlinit në vitin 2014 po bëhet pengesë serioze në shumë drejtime. Ballkani historikisht si "fuçi baruti" mund të shpërthejë sërish ose së paku të orientohet nga Lindja, para së gjithash nga Rusia dhe Turqia! Ka sa kohë që këto dy vendet e fundit po orvaten në mënyra të ndryshme të rikthehen dhe të involvohen në proceset aktuale politike dhe ekonomike në Ballkan, duke mos nënçmuar as infiltrimin ekonomik dhe politik të Kinës në këtë rajon.

Pa ndërhyrjen e SHBA-së, që po ashtu i ka interesat e veta strategjike në Evropën JL, nuk do të ishin ndalur luftërat dhe krimet e regjimit të Millosheviqit në Kroaci, BeH dhe në Kosovë. Pa amerikanët as në Maqedoni e as në Serbi të Jugut Evropa nuk do të kishte sukses në parandalimin e konflikteve shqiptare-maqedonase (AKSH) dhe shqiptare-serbe (UÇPMB). Pse Evropa me shumë vështirësi po arrin sukses në zgjidhjen e problemeve në Ballkan, ose në shumë raste nuk po ka asnjë sukses, shkaqet sigurisht duhet kërkuar në diversitetin e saj në shumë baza, në kontradiktat e saj të brendshme apo rivalitetet brendapërbrenda saj dhe oportunitizmin, por arsye kryesore në këto vitet e fundit duket se është rivaliteti me SHBA-në, sepse, duke u përpjekur ta largojë ndikimin amerikan nga rajoni, po i



komplikon çështjet edhe më shumë. Një hap që ndërmori Evropa para disa viteve, p. sh. për formimin e një force të përbashkët për intervenime të shpejta, më tepër u bë për ta mënjanuar ndikimin amerikan në Ballkan sesa për të zgjidhur situata të krizave. Nga eksperiencat e hidhura me evropianët, shqiptarët kudo në Ballkan kanë më tepër besim te amerikanët. Edhe sot, mjerisht, qarqe të caktuara politike dhe intelektuale, por edhe vende evropiane nuk e kanë ndërruar qëndrimin ndaj disa çështjeve në Ballkan. Angazhimi amerikan në Afganistan, në Irak etj. dhe në luftë kundër terrorizmit global sikur i kurajon këto qarqe evropiane, veçanërisht Rusinë dhe Francën. Por SHBA kanë investuar shumë në Kosovë dhe në Maqedoni për arsye edhe gjeopolitike, prandaj është vështirë të heqin dorë nga këto.

Shqiptarët nga rilindasit e deri më sot gjithnjë si synim e kishin hyrjen në Evropë dhe thuhej se “për shqiptarët dielli lind në perëndim”. Por Evropa nuk u tregua e gatshme që t’u hapë rrugën. Qëndrimi i saj më tepër se një shekull nuk evoluoi pozitivisht ndaj çështjes shqiptare. Përkundrazi, Evropa u rreshtua në anën e hegjemonizmit serb dhe të fuqive të tjera antishqiptare, duke i ndarë edhe territorialisht, kështu që sot e gjithë ditën ndjehen pasojat në shumë rrafshë. Kosova, një hapësirë relativisht e vogël (10.905 km<sup>2</sup>), sa Departamenti i Gironde-s (Zhirondës) në Francë, me pozitë të ndërlikuar gjeopolitike, me shumë histori, kontradikta, tensione latente e të hapura interetnike dhe konfrontime deri në luftëra të hapta, e shtrirë midis dy civilizimeve, vend shumë i pasur dhe në të njëjtën kohë shumë i varfër - gjithnjë paraqiste një nyje të rëndësishme në Ballkan dhe në kontinentin e vjetër dhe një problem më neuralgjik e më kompleks në hapësirat e ish-Jugosllavisë dhe në Evropën JL. Vetëm në fund të shek. XX, me bombardimet e NATO-s mbi forcat serbe, Kosova bëhet një problem i madh edhe në shkallë evropiane dhe botërore.

## HISTORIKU I KONFLIKTIT SERBO-SHQIPTAR DHE FILLIMI I KRIZËS SË ISH-SHTETIT PËRMES DHUNËS NË KOSOVË NË VITIN 1981

Kontesti rreth Kosovës dhe për Kosovën, që zhvillohet midis shqiptarëve dhe serbëve, ka një histori shekullore. Kontesti deri në ditët tona zhvillohet mbi bazë të argumenteve të ndryshme për palët e konfrontuara, që janë të karakterit historik dhe etnikodemografik.

Serbët gjithnjë kishin aspirata që Kosovën ta fusnin nën juridiksionin e tyre me arsyetim se edhe në mesjetë i përkiste shtetit serb dhe se Kosova paraqet “zemrën dhe shpirtin serb”. “Babai” i kombit serb D. Qosiq, pas mënjanimit të A. Rankoviçit nga pushteti shtetëror në korrik të vitit 1966 deklaroi: “Kosova është vend i shenjtë serb, që do të mbrohet, nëse është nevoja, edhe me pushkë...”.<sup>22</sup> Ndërkaq, për shqiptarët Kosova është pjesë e pandashme e tërësisë etnike dhe, më vonë, e shtetit shqiptar, me argumentimin se është popull shumë më i vjetër se serbët dhe sllavët në Ballkan, se shumica absolute e popullatës është shqiptare dhe se lëvizja shqiptare për çlirim e pavarësi ishte pikërisht më e forta në Kosovë. Mirëpo me vendimet e padrejta të Konferencës së Londrës (1913) dhe me vonë të Versajës (1919) dhe të Parisit (1945), përkundër vullnetit të popullit shumicë, Kosova mbeti nën Serbi/Jugosllavi.

Në truallin gjeoetnik të shqiptarëve u bë edhe prerja e kulturave, perëndimore dhe lindore, që la pasoja të shumënduarshme, ndërsa tragjeditë më të mëdha nacionale, ekonomike, politike, sociale, familjare etj. shqiptarëve u kanë sjellë injorimi i vullnetit politik dhe ndarjet e njëpasnjëshme të imponuara e të dhunshme të cilat vetëm në shek. XX u përsëritën disa herë: deri më 1912 vilajetet, formimi i shtetit të cinguar shqiptar më 1913, midis Dy Luftërave Botërore banovinat, gjatë Luftës II Botërore zonat okupuese dhe në kohën e Jugosllavisë komuniste shqiptarët u ndanë në një krahinë autonome (Autonomna oblast) dhe afër 30% të tjerë mbetën në tri republika (Maqedonia, Serbia, Mali i Zi). Pasojat e copëtimit të territorit etnik shqiptar po ndjehen edhe sot e gjithë ditën. Të gjitha regjimet serbe dhe jugosllave u përpoqën që çështjen e Kosovës ta zgjidhnin me shpërnguljen masive të shqiptarëve dhe kolonizimin e serbëve. Këto regjime e dëshironin edhe Kosovën e pazhvilluar dhe me nivel të ulët të natalitetit të tipit evropian, edhe Kosovën e kolonizuar dhe joshëse për serbët dhe privilegjet e tyre, qëllime këto që në asnjë mënyrë nuk shkonin së bashku.

Rreth gjysma e shqiptarëve sot jeton jashtë shtetit shqiptar me të cilin kufizohet. Janë raste shumë të rralla në botë, ku rreth dy të tretat e popullsisë, që i përket një kombi, të mos jetojë në një shtet të vetëm. Nuk është identik as rasti i irlandezëve, të cilët, së bashku me pasardhës, ndonëse disa herë janë më shumë jashtë shtetit të tyre kombëtar, megjithatë kjo ndarje është pasojë e eksodit përtej oqeanit.

<sup>22</sup> I. Supek, *Krivovjernik na ljevici*, Globus nakladni zavod, Zagreb, 1992, f. 164.

Irlandezë në hapësirën kompakte etnike, por jashtë Irlandës si shtet amë (Alsteri që është në përbërje territoriale të Irlandës Veriore dhe pjesë e Anglisë), ka shumëfish më pak. Numri kaq i madh i shqiptarëve jashtë kufijve të shtetit kombëtar është në radhë të parë rezultat i ndarjes me kufij artificialë; natyrisht që ka edhe shpërngulje jo të vogla nga trualli gjeoetnik i tyre dhe ngulitje larg territorit të pakëputur etnik, në Evropë dhe përtej oqeanit. Prandaj si dje ashtu edhe sot, në kuptimin demografik, por jo vetëm demografik, është vështirë të thuhet se Shqipëria është amë, ndërsa Kosova dhe trojet e tjera etnike përreth saj degë.

Juristi ynë i njohur, akademik prof. Gazmend Zajmi, në kontekstin e përkufizimit të kategorisë "ama kombëtare", pa u bërë ende Kosova shtet, fliste për "policentrizmin subjektor" me qendrat Tirana, Prishtina, Shkupi e Tetova, Presheva, Ulqini etj.,<sup>23</sup> të cilat, sot, në pikëpamje demografike dhe politike, janë baraz me "amën" si kategori komuniste. Vetë konceptimi dhe përkufizimi i kategorisë "ama kombëtare" është konfuz, ku, pas shembjes së sistemit komunist dhe pavarësisë së Kosovës, duket se është në tejkalim e sipër. Shqipëria, me gjithë kufijtë e saj ndërkombëtarisht të pranuar, nuk mundet më të konsiderohet "amë" në kuptimin e deridjeshëm. Nocioni "ama kombëtare" i përkiste regjimit komunist. Në të gjitha kushtetutat e ish-Jugosllavisë, p. sh. nën ombrellën e "amës kombëtare", pakicat kombëtare deri në vitin 1963 (kur u nxorr Kushtetuta e tretë), apo më vonë kombësitë (nacionalitetet), ku hynin edhe shqiptarët, konsideroheshin kategori e rendit të dytë, sepse i kishin shtetet e tyre kombëtare me të njëjtin emër jashtë Jugosllavisë: shqiptarët Shqipërinë, hungarezët Hungarinë, italianët Italinë etj.

<sup>23</sup> Akademik Gazmend Zajmi, në kuadër të zgjidhjes së çështjes shqiptare, në vitet e 90-ta të shek. XX elaboronte tezën e policentrizmit subjektor, që do të thoshte se "kudo ku pjesëtarët e kombit shqiptar gjenden në pozitë të shumicës etnike territoriale në makroproporcione, ngrihen në nivel të subjektit politik territorial. Është fjala për një zgjidhje politike sintetike të kohës, që shton forcën akomoduese të kombit shqiptar si ndaj rrethanave ndërkombëtare të kohës, ashtu edhe ndaj të gjitha parimeve themelore të Programit kombëtar. Këtu qëndrojnë edhe vlerat konkret ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Programit kombëtar shqiptar. Policentrizmi subjektor i kombit shqiptar në Ballkan në këtë stad të rrjedhave në Evropë nuk është faktor i ndarjes kombëtare, por përkundrazi, në kushte të trashëguara të ndarjeve gjeopolitike të kombit është faktor i ngritjes së subjektivitetit kombëtar, i integriteteve kombëtare dhe i proceseve të bashkimit kombëtar" (G. Zajmi, *Vepra, I*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 1997, f. 158).

Në vitin 1981 kriza e sistemit jugosllav nisi në Kosovë në formë të konfrontimit të shtetit serb me shqiptarët. Krizën në Kosovë duhet parë në kuadër të krizës së përgjithshme në Jugosllavinë komuniste, që rezultoi nga kundërthëniet dhe konfliktet e brendshme, të akumuluar gjatë gjithë periudhës së ekzistimit të këtij shteti, e këto janë moszgjidhja e çështjes nacionale dhe mungesa e demokratizimit të shoqërisë. Por në këto hapësira ballkanike konfliktet e brendshme dhe antagonizmat ndëretnike ishin më të mëdha se çdokund tjetër. Jugosllavia e Versajës (1919-1941), ashtu siç u krijua mbi bazë të forcës ushtarake dhe të politikës hegjemoniste serbe, ashtu edhe u shkatërrua nga veprimi i konceptit të shtetit unitarist. Edhe shkatërrimin e Jugosllavisë komuniste duhet parë në aspiratat e hegjemonizmit serbomad. Titoja (1892-1980), me reformën e Federatës dhe formimin e udhëheqjes kolektive federative, donte ta pengonte vendosjen e çfarëdo hegjemonie pas tij. Mirëpo trashëgimtarët e tij nuk u treguan të aftë ta zgjidhnin krizën si ekonomike, ashtu edhe politike dhe t'u kundërviheshin tendencave të hegjemonizmit serb; mungesën e autoritetit suprem politik të gjitha qarqet serbe nisën ta shfrytëzonin si përgatitje për dominim, që në fund shpjeu në shpërbërjen e Jugosllavisë përmes rrugës së përgjakshme.<sup>24</sup>

Ushtria mbeti pa komandant suprem, ndërsa në këtë fazë elitës ushtarake i përgjigjej një njeri i tipit të Millosheviqit, i cili angazhohej për ruajtjen e Jugosllavisë njëpartiake, unitare dhe autoritare ku do të sundonin serbët. “Kur u themelua Jugosllavia pas Luftës I Botërore, interesi kryesor i Serbisë ishte që të gjithë serbët të jetonin në një shtet të vetëm. Para Titos Serbia e kishte dominuar këtë shtet. Tashti pas Titos Millosheviqi kërkonte të rivendoste këtë dominim. Në fund të viteve 1980 pengesa e tij kryesore ishte Sllovenia, ironikisht e vetmja republikë që nuk kishte një numër të madh serbësh. Sllovenët ishin të parët që i bënë sfidë unitetit të Jugosllavisë”, thoshte ambasadori amerikan në Beograd, W. Zimmermann.<sup>25</sup> Mirëpo pas vdekjes së Titos dhe sidomos pas shkatërrimit të LKJ-së (1990), Armata Jugosllave, e cila dominohej nga serbët, bënte politikën shtetërore.<sup>26</sup>

<sup>24</sup> Sh. Maliqi, *Nyja e Kosovës (As Vllasi, as Millosheviqi)*, Knjižna zbirka KRT, Ljubljana, 1994, ff. 283-289.

<sup>25</sup> W. Zimmermann, *Burimet e një katastrofe*, Besa (Libra për një shoqëri të hapur), Tiranë, 1996, f. 27.

<sup>26</sup> M. Hadžić, “Srpski kraj jugoslovenske armije”, në *Srbija između prošlosti i budućnosti*, Beograd, 1995, ff. 281-299; D. Janjić, “Srbija između krize identiteta i izazova modernizacije”, në *Srbija između prošlosti i budućnosti*, f. 24.

Kosova që ballafaqohet me probleme të mëdha politike, ekonomike, sociale e nacionale në krizën e sistemit federativ ishte hallka më e dobët. Pas vdekjes së Titos, forcat hegjemoniste e shfrytëzuan Kosovën për hapjen e çështjes serbe në Jugosllavi nga pozitat nacionaliste dhe shtetomëdha, duke propaguar tezën se Serbia nuk është e barabartë me republikat e tjera, ndërsa serbët si popull më i madh gjithkund janë të shtypur: në Kosovë, në Kroaci, në BeH etj. Së pari në Kosovë u zbulua "populli i keq", "armiqtë e serbëve", "kundërevolucionarët", "separatistët", "irredentistët", "rrënuesit e Jugosllavisë" etj. Shqiptarofobia dhe shovenizmi serb u shtrinë gjerësisht në të gjitha shtresat e shoqërisë serbe, duke shpikur teza që hynë në modelin gjenocidial të të menduarit dhe të sjelljes. U nxorën disa dokumente partiako-shtetërore me përmbajtje neomaltusianiste dhe raciste për pengimin e natalitetit të shqiptarëve; një shkrimtar i njohur serb, me rastin e një vizite në Izrael, kishte deklaruar: "Më vjen shumë keq që nuk kam marrë me vete një kafaz me një shqiptar që të shihni se çfarë majmunash janë" (M. Bečković)! Por "zbulimi" më i madh që bënë forcat neohegjemoniste serbe ishte se barazia e shqiptarëve me serbët mbi bazë të Kushtetutës së vitit 1974 dhe statusi politik i Kosovës ishin burim i problemit në Serbi dhe Jugosllavi, prandaj, sipas tyre, duhej "demontuar" strukturën juridike-konstitucionale të Kosovës!

Terrori shtetëror dhe aparteidi i regjimit serb ndaj shqiptarëve mori përmasa të gjera. Por si reagim ndaj këtij veprimi dhe suprimimit me dhunë të gjendjes kushtetuese dhe vendosjes së gjendjes okupuese e koloniale, si dhe ngjarjeve në krejt Jugosllavinë (referendumet për pavarësi), Parlamenti i Kosovës më 2 korrik 1990 shpalli Deklaratën e Pavarësisë, më 7 shtator 1990 shpalli Kushtetutën e Republikës së Kosovës, prej 26-30 shtator 1991 mbajti Referendumin për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, ndërsa më 24 maj 1992 dhe 8 mars 1998 u mbajtën zgjedhjet parlamentare e presidenciale. Projekti i lëvizjes politike shqiptare ishte që problemi i Kosovës të zgjidhej me mjete paqësore dhe me dialog. Duke pasur kujdes që të mos i fusin në luftë 7 milion shqiptarë dhe të mos e destabilizojnë rajonin, por edhe duke u udhëhequr nga parimet e proklamuar të bashkësisë ndërkombëtare se të gjitha problemet e hapura duhet të zgjidhen me rrugë demokratike dhe me bisedime, shqiptarët duruan një represion kaq brutal të Serbisë. Mirëpo këto sakrificat e tyre nuk u shpërblyen nga bashkësia ndërkombëtare deri në mars të vitit 1999. Të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe OKB-ja, pas vitit 1990, në një anë e dënonin

shkeljen e të drejtave njerëzore dhe civile të shqiptarëve, por në anën tjetër e toleronin këtë shkelje. Kjo gjendje zgjati deri më 10 qershor 1999, kur u dorëzua regjimi i Millosheviqit para fuqisë më të madhe në botë, NATO-s.

Megjithatë, Kosova nuk ishte problem i të drejtave të njeriut, ndonëse ato shkileshin nga regjimi serb në mënyrën më brutale, e as problem i pakicave. Kosova ishte çështje e dekolonizimit dhe e pavarësisë në bazë të së drejtës për vetëvendosje të popullit shumicë, si dhe çështje politike ndërkombëtare. Bashkësia evropiane dhe bashkësia ndërkombëtare përgjithësisht, me konferencat mbi ish-Jugosllavinë, që nga Brukseli (1990) e Haga (1991) dhe Komisioni i Badinterit e deri te Dejtoni (1995) bëri gabime me pasoja të mëdha kur Kosovën nuk e trajtoi të barabartë me njësitë e tjera të ish-Federatës, element konstitutiv i së cilës ishte sipas Kushtetutës së vitit 1974 dhe me të drejtë të vetos në të gjitha nivelet politike në ish-Jugosllavi, por u nis nga gjendja e krijuar pas vitit 1989, e vënë me mjete policore dhe ushtarake. Me indiferencën ndaj dhunës në Kosovë deri më 1991 dhe me pranimin e gjendjes faktike, të krijuar pas suprimimit të autonomisë federale, Evropa dhe bashkësia ndërkombëtare e pranonin politikën e aktit të kryer, që e kurajonte Serbinë për sjellje edhe më agresive ndaj shqiptarëve. Nga fajtori kryesor i tragjeditve njerëzore, i shkatërrimit të qyteteve dhe fshatrave të tëra në ish-Jugosllavi, kjo bashkësi e pranonte Millosheviqin si një njeri të paqes dhe, duke i bërë koncesione të vazhdueshme deri në fillim të vitit 1999, e largonte Serbinë nga dialogu serioz me shqiptarët në praninë e faktorit të jashtëm. Çështja e Kosovës nuk qe e përfshirë as në Marrëveshjen e Dejtonit më 1995. “Diplomacia perëndimore ishte shndërrua në njëfarë teatri cinik” dhe “diplomacia pa forcën ishte bërë një armë e zbrazët, e pafuqishme dhe qesharake”, shkruante ambasadori i fundit (1992) i SHBA-së në Beograd, Zimmermann.<sup>27</sup>

## PROJEKTET RECENTE SERBE PËR COPËTIMIN E KOSOVËS DHE DËBIMIN E SHQIPTARËVE

Serbia zyrtare dhe qarqet e ndryshme serbomëdha sa i përket çështjes së Kosovës nga fundi i viteve të 60-ta të shekullit të kaluar e deri në intervenimin e NATO-s (mars 1999) kishin pasur disa variantat të zgjidhjes së saj, por gjithnjë në dëm të shqiptarëve. Statusi

<sup>27</sup> W. Zimmermann, *Po aty*, ff. 230-231.

konstitucional-politik i Kosovës me Kushtetutën e vitit 1974 bënte përjashtim, sepse ishte arritur pa vullnetin e Serbisë. Përveç mbetjes së Kosovës brenda sistemit juridik-politik të Serbisë, variantet me shumë ose me pak përkrahje, varësisht nga evolucioni i pozitës së përgjithshme të Serbisë në ish-Jugosllavi dhe më gjerë, ishin edhe rikolonizimi, ridefinimi territorial i Kosovës, enklavizimi, ndarja e saj në dy entitete apo edhe përkufizimi hapësinor midis shqiptarëve dhe serbëve, që e mbështeste “babai” i kombit serb dhe inspiruesi i të gjitha tragjediave njerëzore dhe materiale në ish-Jugosllavi, Dobrica Qosiqi. Me tezën për ndarjen e Kosovës qysh nga fundi i viteve të 60-ta kishte dalë “babai” Qosiq.<sup>28</sup> Kur u bë kryetar i të ashtuquajturës Jugosllavi e Zhablakut (1992-1993), si zgjidhje definitive të problemit të Kosovës dhe, më konkretisht, të çështjes shqiptare-serbe, siç thoshte ai, projektin për ndarjen e Kosovës në fillim të vitit 1993 (60:40% në favor të serbëve) ia paraqiti edhe bashkëkryetarëve të Konferencës së Gjenevës për ish-Jugosllavi Sajrus Vens (Cyrus Vance) dhe Robert Oven (Robert Owen) në selinë e OKB-së në Gjenevë. Mirëpo, me sa dihet, këta dy diplomatë të rangut të lartë këtë projekt e hodhën poshtë pa diskutim nga frika se efektet do të ishin zinxhirore, para së gjithash në BeH dhe në Maqedoni.

Planin për ndarjen e Kosovës sipas versionit të Qosiqit e kishte edhe kryeministri i vrarë (2003) Z. Gjingjiri, i cili derisa ishte gjallë

<sup>28</sup> I vetmi shqiptar, që e ka mbështetur tezën e Qosiqit, është “babai” i kombit, Rexhep Qosja. Ai shkon edhe më larg dhe në një seri prononcimesh në gazeta, televizione dhe portale në Kosovë dhe në Shqipëri pas luftës flet për “lëkundjen e kufirit mes Kosovës dhe Serbisë dhe zhvendosjen humane të popullsisë”(!), të fokusuar pikërisht të shqiptarët e Veriut të Kosovës dhe shqiptarët e serbët e Luginës, duke kërkuar të bëhet shkëmbimi i Luginës së Preshevës me Veriun e Kosovës, pa pasur njohuri elementare për kontekstin gjeohapësinor dhe gjeoetnik të dy territoreve. Ky njeri nuk la çështje për të cilën nuk foli, përveç Plavës dhe Gucisë, por as për pozitën e rëndë të shqiptarëve në Mal të Zi?! “Zhvendosja humane e popullsisë” ndodhi përmes spastrimit etnik si veprim më i shëmtuar në luftërat në ish-Jugosllavi në fund të viteve të 90-ta të shek. XX; në vitet 1998-1999 regjimi i Millosheviqit deportoi rreth një milion shqiptarë të Kosovës dhe miliona njerëz të tjerë në ish-Jugosllavi në vitet e 90-ta. Në kuadër të krimeve kundër njerëzimit, shpërngulja e qëllimshme, e planifikuar dhe e dhunshme e popullsisë në sistemet juridike të shumë vendeve, përfshirë edhe ato që vetë ushtrojnë gjenocid, dhe nga vetë OKB-ja konsiderohet krim gjenocidial.<sup>28</sup> Vetëm të tillët pa ndjenja njerëzore, populistët dhe paranojakët sot e mbështesin “zhvendosjen humane të popullsisë”! (Shih: R. Qosja, Intervistë në “Epoka e re”, 30-31 dhjetor 2005 dhe 1-2 janar 2006 në “Zëri”, në TV 21 (emisioni „Sy me sy“), si dhe në “Shekulli”, në KTV (emisioni „Rubikon“), në „Klan Kosova“ etj.

thoshte publikisht se çështjen e Kosovës e zgjidhim jo me Rugovën, por me Hashim Thaçin! Aktualizimi i ndarjes së Kosovës sërish vjen këto vitet e fundit nga Beogradi zyrtar i Presidentit Vuçiq, bashkë me Tiranën zyrtare të Kryeministrit Edi Rama dhe Presidentin e Kosovës Hashim Thaçi nën parullën e “korrigjimit të kufirit Kosovë-Serbi dhe bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën!” “Bashkimet” që i dikton Serbia janë fatale për Kosovën, Luginën dhe të gjithë shqiptarët, sikundër që është tragjik “bashkimi” i Kosovës me Shqipërinë përmes modelit konfederativ të Edi Ramës dhe Hashim Thaçit! Ky i fundit si i vetëshpallur “bërës” i shtetit të Kosovës, po bëhen gradualisht edhe “zhbërës” i këtij shteti të pavarur dhe sovran, sikundër që copëtimi i Luginës do ta fshinte atë si entitet territorial-politik. Me shkatërrimin e sovranitetit shtetëror dhe territorial të Kosovës hapet mundësia për rinegocijimin e pavarësisë së Kosovës dhe tërheqjes së njohjeve nga disa vende me të cilat Serbia ka raporte tradicionale të bashkëpunimit. Projektin e treshes famëkeqe Vuçiq-Rama-Thaçi për ndarjen e Kosovës gjithnjë e mbështeste edhe shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, e cila gjithë dialogun Kosovë-Serbi e shndërroi në përpjekjet për ndarjen e saj dhe zhbërjen e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran!<sup>29</sup>

Milloseviqi dhe regjimi i tij vazhdonin ta shihnin Kosovën vetëm si pjesë integrale të Serbisë, Kosovën me numër të reduktuar të shqiptarëve (600.000 deri 800.000) ose madje pa shqiptarë në sajë të zbatimit të politikës së spastrimit etnik etj. Këtë fakt dhe këtë strategji të reduktimit të numrit të shqiptarëve e dëshmuan në procesin gjyqësor kundër Milloseviqit në Hagë edhe shumë dëshmitarë të kombësisë serbe, të afërt me Milloseviqin dhe partinë e tij në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar. Dëshmitari i partisë “Nova demokratija” kundër S. Milloseviqit në Tribunalin e Hagës (2002) Ratomir Taniq, disa herë në koalicion qeveritar me Partinë Socialiste të Milloseviqit, përveç tjerash, theksoi se politika e reduktimit të numrit të shqiptarëve në Kosovë përmes spastrimit etnik ishte qëllim dhe strategji e regjimit të Milloseviqit.

Në vazhdën e ideve dhe projekteve të shumta të qarqeve e institucioneve shkencore, kulturore dhe kishtarë serbe, si dhe të të gjitha regjimeve serbe për pastrime etnike, krime e veprime gjenocidale me qëllime ekspansioniste e shtetomëdha nga Naçertanija

<sup>29</sup> H. Islami - A. Ejupi, “Korrigjimi” i kufirit Kosovë-Serbi dhe “bashkimi” i Luginës së Preshevës me Kosovën”, *Studime*, 5, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2019, ff. 11-12.



e Ilija Garashaninit (1812-1874) e vitit 1844, duhet veçuar Memorandumin e Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve (1986), të inicuar jo nga një grup akademikësh, siç thuhej në fillim, por nga organet më të larta të këtij institucioni në gjysmën e viteve të 80-ta të shekullit të kaluar, kur edhe doli në opinion me emrin “Memorandumi”. Në hartimin e tij morën pjesë emra të njohur të shkencës dhe të kulturës serbe, të cilët, pas ngjarjeve të vitit 1981 në Kosovë ishin angazhuar në përpilimin e suazave shkencore, politike dhe legale në zbatimin e dhunës, të migrimëve “humane” dhe të gjenocidit ndaj popujve joserbë. Akademikët dhe intelektualët serbë kishin vënë bazat ideologjike dhe shkencore për dëbimin dhe shfarosjen biologjike të shqiptarëve edhe midis Dy Luftërave Botërore dhe menjëherë pas saj, siç bënë akademiku Çubrilloviq dhe nobelisti Ivo Andriq etj.

Qëllimi i “Memorandumit” ishte pa dyshim krijimi i Serbisë së Madhe ose më shumë dominimi serb në gjithë Jugosllavinë komuniste, që duhej të arrihej me përdorimin e forcës ushtarake (APJ-së) përmes ndërrimit të dhunshëm të Kushtetutës së vitit 1974, zbatimit të represionit, luftës dhe krimeve masive e gjenocidit ndaj shqiptarëve, kroatëve dhe boshnjakëve, gjë që edhe ndodhi midis viteve 1990 dhe 1999 derisa nuk u mposht definitivisht makineria ushtarako-policore serbe me intervenimin e forcave të NATO-s nga 24 marsi deri më 10 qershor 1999, kur kapitulloi regjimi kriminal i Millosheviqit. “Memorandumi” i paraqitte shqiptarët si armik shekullor, të cilët, njëherë biologjikisht e pastaj edhe politikisht kinse po e rrezikonin popullin serb, hapësirën e tij jetësore dhe prosperitetin gjeodemografik, kombëtar dhe ekonomik të sllavëve të jugut, veçanërisht të serbëve. Aty madje shqiptarët akuzohen edhe për raste perverse, çfarë ishte rasti Martinoviq, kur një serb i sëmurë nga Gjilani, në maj të vitit 1985, për motive vetëkënaqësie kishte futur një shishe në prapnicë!

Krimi dhe gjenocidi ishin të paramenduar dhe të planifikuar nga strukturat politike, shtetërore dhe ushtarake të Serbisë, ndërsa arsytimin dhe legjitimimin e tyre e bënë intelektualët, shkencëtarët, shkrimtarët serbë, mediat serbe dhe kisha ortodokse serbe. Intelektualët serbë ishin pikërisht ata të cilët në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar inicuan idenë dhe projektin e “pacifikimit” të Kosovës sipas modelit izraelit. Këtë e bëri me dije sociologu i njohur slloven Rudi Rizman në simpoziumin “Kosovo-Serbiya-Jugoslavia” në fillim të vitit 1989: “Kam menduar se është ky një konstruksion utopik, por më duhet të them se nga shokët e mi serbë, intelektualët,

kam marrë një kundërgargument që flet për mundësinë e pacifikimit, duke pasur parasysh atë që ka ndodhur në Izrael, pacifikimi madje në një funksion civilizues. Kjo ide është e mundur të shpjegohet dhe kuptohet racionalisht në atë mënyrë që plotësisht pajtohem me rrezikun e imitimit të një modeli, të një paradigme që në përmasa jugosllave do të ishte e trishtueshme dhe e cila do të kishte efekte fatale, më shumë se që kishte kthimi i hebrenjve në Palestinë”.<sup>30</sup>

Në këtë funksion ishte pikërisht projekti i përmendur i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, i shkruar dhe i arsyetuar “shkencërisht”. Për ta arritur këtë objektiv duhej të shkatërrohej Jugosllavia dhe atë jo me rrugë paqësore, por përmes krimeve dhe gjakderdhjeve masive. Që në fillim të “Memorandumit” parashihej se kriza e shtetit të atëhershëm nuk “përrjashton përfundimin edhe ashtu katastrofik, çfarë është rrënimi i bashkësisë shtetërore jugosllave”. Për regjimin e Millosheviqit ky projekt ishte platforma kryesore e veprimit për 15 vjet rresht, por “Millosheviqi nuk e prodhoi Memorandumin; atë e krijoi atmosfera që e krijoi Memorandumi”.<sup>31</sup> “Memorandumi” ishte një lloj *in memoriam* për Jugosllavinë komuniste. Historianët serbe dhe udhëheqësja e dikurshme e Serbisë komuniste Llatinka Perović ishte ndër autorët e rrallë që theksonte se objektivat militariste të Serbisë ishin “revidimi i kufijve të brendshëm, këmbimi i popullatave dhe ristrukturimi i hapësirës politike ballkanike”.<sup>32</sup> “Memorandumit i praprinë trazirat e vitit 1981 në Kosovë, pastaj lëvizja e serbëve, të cilën e kishte nxitur dhe organizuar Dobrica Qosiqi, i cili e përforcoi rolin e ‘babait’ të kombit”.<sup>33</sup> Analizën më meritore për përmbajtjen dhe porosinë e “Memorandumit” e ka bërë akademik Fehmi Agani.<sup>34</sup>

Millosheviqi në shënimin e 600-vjetorit të Betejës së Kosovës në Gazimestan (1989), ku u mbloodhën, siç thonin një milion serbë nga e gjithë ish-Jugosllavia, paralajmëroi luftën si mjet për arritjen e

<sup>30</sup> R. Rizman, në *Zbornik Kosovo-Srbija-Jugoslavija*, KRT, Ljubljana, 1989, ff. 66-67.

<sup>31</sup> L. Perović, *Dominantna i neželjena elita (Beleške o intelektualnoj i političkoj eliti u Srbiji – XX-XXI vek)*, II izdanje, Beograd, 2016, f. 46.

<sup>32</sup> L. Perović, L. Perović, “Yugoslavia was defeated from inside”, in S. Biserko (éd.), *Yugoslavia: Collaps, War, crimes, Center for Antiwar Action*, Belgrade, 1993, p. 63; sipas V. Pešić, “La guerre pour les États nationaux”, në *Radiologie d’un nationalisme. Les crimes serbes du conflit yougoslave* (Sous la direction de N. Popov), Les Editions de l’Atelier (Editions Ouvrières), Paris, 1998, p. 51.

<sup>33</sup> L. Perović, *Dominantna i neželjena elita (Beleške o intelektualnoj i političkoj eliti u Srbiji – XX-XXI vek)*, II izdanje, Beograd, 2016, f. 45.

<sup>34</sup> F. Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, “Dukagjini”, Pejë, 1994, ff. 139-152.

qëllimit kryesor – “zgjidhjen e çështjes serbe”! Në tubim mori pjesë e gjithë udhëheqja e Jugosllavisë së atëhershme, kreu i APJ-së, kreu i Kishës Ortodokse Serbe<sup>35</sup> dhe shumë diplomatë të huaj, përveç ambasadorit amerikan në Beograd W. Zimmermann. Fjalimi luftënxitës i tij e kurajoi edhe më tepër homogenizimin serb dhe populizmin histerik se ideja për formimin e Serbisë së Madhe në kufijtë Viroviticë-Karlovac-Karlobag është vetëm çështje e ditës! Pas këtij fjalimi të Millosheviqit e gjithë energjia nacionale e serbëve orientohet nga serbët jashtë Serbisë dhe drejt konfliktit serbo-kroat. Populizmi histerik arrin kulminacionin pas vitit 1991. Deri në vitin 1994 ideja mbi Serbinë e Madhe në kufijtë e përmendur, sikurse mit u zgjerua në Serbi dhe te populli serb, si bindje se *bashkimi i të gjithë serbëve në një shtet të vetëm është vetëm çështje e ditës*, pa llogaritur se çka do të thotë bashkësia ndërkombëtare. Në këtë ide, bashkë me regjimin, ishte edhe opozita nacionaliste e Serbisë, e cila herë pas here gjendej edhe në pushtet.<sup>36</sup> Teza e kahershme e shkrimtarit serb D.

<sup>35</sup> Është i njohur fati se kriminelit dhe vrasësi masiv Zhelko Raznjatović – Arkan ka thënë: Komandanti im suprem është patriarku Pavle, për të cilën gjë ai nuk është distancuar. Arkan me njerëzit e tij të armatosur hynte në manastiret ortodokse dhe në Patriarkanë. Patriarku Pavle kurrë nuk i ka dënuar krimet, të cilat formacionet e armatosura serbe i kishin kryer në Kroaci, Bosnjë dhe në Kosovë” (D. Todorović, “Populizmi i ri serb”, “Koha ditore”, 26 dhjetor 2009, f. 11).

Me rastin e vdekjes së tij, me ditë të tëra serbët prisnin me rreshta kilometrike që t’i bënin nderimin e fundit. Në varrimin e tij në vjeshtë të vitit 2009 foli presidenti i Serbisë B. Tadiq. Patriarku Pavle “nuk është deklaruar fare kur janë shkatërruar xhamitë dhe objektet tjera fetare të muslimanëve në Bosnje, në mesin e të cilave edhe përmendoret historike të hyra në listën e monumenteve të mbrojtura historike, të xhamive të famshme Alaxha (e ndërtuar më 1549) në Foçë dhe të asaj Ferhadija (e ndërtuar më 1579) në Banjallukë. Disa xhami janë restauruar në kisha ortodokse, si ajo në fshatin Diviq në Zvornik . Episkopët e caktuar dhe priftërinjtë e Kishës ortodokse serbe (SPC) i bekonin kriminelët e luftës para apo pas krimeve të kryera. Patriarku Pavle nënshkroi personalisht peticionet në dobi të Radovan Karaxhiqit, i akuzuar për gjenocid nga Tribunali i Hagës. Gjatë luftës në hapësirat e ish-Jugosllavisë, SPC-ja, për shkak të rolit të vet në këtë luftë, rrezikonte përjashtimin nga aleanca e botërore e kishave. Ndoshta për këtë arsye në varrimin e patriarkut Pavle, nga 14 patriarkët ortodoksë në botë, kanë ardhur vetëm dy” (D. Todorović, *Po aty*).

<sup>36</sup> Historianja serbe dhe udhëheqsja e dikurshme e Serbisë, Llatinka Perović, theksonte se objektivat militariste të Serbisë ishin “revidimi i kufijve të brendshëm, këmbimi i popullatave dhe ristrukturimi i hapësirës politike ballkanike” (L. Perović, “Yugoslavia was defeated from inside”, in S. Biserko (éd.), *Yugoslavia: Collaps, War, crimes, Center for Antwar Action*, Belgrade, 1993, p. 63; sipas V. Pešić, “La guerre pour les Etats nationaux”, në *Radiologie d’un nationalisme. Les crimes serbes du conflit yougoslave* (Sous la direction de

Qosiq, i cili atëherë konsiderohej "baba" i kombit, e që do të bëhej kryetar i parë i Jugosllavisë së Tretë "*Serbët fitojnë në luftë, por humbin në paqe*",<sup>37</sup> pothuajse në mënyrë plebishitare gjen përkrahje në Serbi dhe te serbët në përgjithësi dhe tezat se "serbët në luftë e zgjidhin çështjen e tyre nacionale", "serbët janë luftëtarë më të mirë", "kemi ushtrinë më të fortë në Evropë" etj. bëhen nxitje të fuqishme për luftë kundër popujve joserbë.<sup>38</sup>

Përkrahja që i dhanë republikat e tjera Serbisë kundër Kosovës dhe shqiptarëve në vitet 1981-1990 iu kthyen të gjithave bumerang; kriza eskaloj në konfrontim të hapët të Serbisë e të serbëve dhe me komunitetet e tjera etnike me synim të realizim të projektit "Të gjithë serbët në një shtet të vetëm", që nënkuptonte ose Serbinë e Madhe në kufijtë e përmendur ose Jugosllavinë Serbe! Më vonë, pas shpërthimit të luftës në Slloveni, Kroaci dhe BeH, Serbia dhe serbët do të konfrontohen edhe me bashkësinë ndërkombëtare dhe këtë konfrontim do ta shpjegojnë si komplot kundër popullit serb (Vatikani, Gjermania, CIA, Turqia, Xhihadit).<sup>39</sup> Pasi u sollën dëme të mëdha popujve joserbë, në fund e shkatërruan edhe vetë shoqërinë serbe në Serbi dhe jashtë saj, duke u ballafaquar me një krizë serioze ekonomike, politike e morale me pasoja afatgjata.

## HEGJEMONIZMI SERB SI BURIM I DESTABILIZIMIT AFATGJATË TË BALLKANIT

Për ta qetësuar Ballkanin së pari duhet ndryshuar mentalitetin ballkanik, ku logjika e kombit, e shtetit, e kufirit dhe e urrejtjes

---

N. Popov), Les Editions de l'Atelier (Editions Ouvrières), Paris, 1998, p. 51.

<sup>37</sup> "Çfarë populli jemi ne, çfarë njerëz jemi ne, të cilët në luftë aq shumë vdesin për liri, ndërsa me vetë fitoret mbesin pa të? Si është e mundur që dikush midis nesh, dikush në shtëpinë tonë, të na i grabitë atë që nuk ka mundur të na i grabitë në luftë armiku shumëfish më i fortë? Si është e mundur që njerëzit aq shumë dinjitozë, që mburren, janë trima në luftë, pranojnë që në paqe të jenë të përlulur, të nënshtruar? (...) dhe është tragjike të jesh pasardhës i atyre që janë të detyruar të kenë më shumë forcë për luftë sesa për paqe, të cilët pas fitores më të rëndë dhe më të madhe të luftës në historinë serbe, kanë mbetur pa fuqi që ta verifikojnë në paqe" (D. Ćosić, *Stvarno i moguće. Članci i ogledi*, O. Keršovani, Rijeka, 1982, ff. 171-172).

<sup>38</sup> "Babai" Qosiq, për serbët thoshte: "Gënjeshtra është formë e patriotizmit tonë dhe dëshmi e inteligjencisë sonë natyrore. Ne gënjëjmë në mënyrë krijuese, fantastike, inventive" (Nga romani i D. Qosiqit "Deobe"; sipas: *Velika Epohina enciklopedija aforizama*, Zagreb, 1968, f. 264).

<sup>39</sup> D. Janjić, *Po aty*, f. 34.

interetnike është ende e fortë. Me këtë logjikë është vështirë të vendoset një paqe e qëndrueshme dhe të krijohet një shoqëri civile dhe demokratike. Kjo logjikë ende çon nga mbyllja dhe konfliktet midis shteteve dhe konfliktet midis etnive brenda vendeve ballkanike; ndërhyrjet evropiane nuk po premtojnë zgjidhje të pranueshme të problemeve, veçanërisht midis Kosovës dhe Serbisë. Transformimi i këtij mentaliteti është një proces afatgjatë. Së dyti, ekziston mentaliteti komunist, ku përveç Greqisë, të gjitha shtetet ballkanike ishin komuniste. Ky mentalitet ka krijuar një sistem të tërë të sjelljeve autoritare, me të cilin nuk mund të ketë progres as në planin e të drejtave të njeriut, as në vendosjen e demokracisë, të ekonomisë së tregut, të mirëqenies sociale dhe të paqes. Së treti, hegjemonizmi serb është burim kryesor i destabilizimit të Ballkanit. Është gabim të mendohet se kjo ideologji është mposhtur me rënien e Millosheviqit; ajo do të ekzistojë një kohë të gjatë. Makineria ushtarake serbe, e trashëguar nga epoka e Titos, ende nuk është asgjësuar. Nga bombardimet e NATO-s më 1999 shumë pak ka pësuar. Serbia dhe serbët, pos forcës ushtarake, kalkuloni edhe me faktorin demografik si një forcë dominuese (rreth 8,5 milion), ndonëse në Ballkan ekziston një ekuilibër demografik (rreth 9 milion grekë, 8,5 bullgarë, 7 milion shqiptarë). Regjimi i Millosheviqit ishte bërë “zemërgjerë”, duke u ofruar shqiptarëve “të gjitha” të drejtat, por me kusht që të respektohej realiteti i ri demografiko-etnik i Kosovës, ku nuk “dominonin” më shqiptarët. Fushata fantastike e zvogëlimit të numrit të shqiptarëve dhe e rritjes së numrit të të tjerëve, veçanërisht të serbëve bëhet më transparente në prag dhe gjatë Konferencës së Rambujesë në fillim të vitit 1999 nga ana e përfaqësuesve të Serbisë.<sup>40</sup>

Megjithatë, hegjemonizmi më i rrezikshëm në Serbi dhe te serbët mbetet *sistemi i të menduarit hegjemonist*. Pjesa dërmuese e serbëve mendon se duhet të dominojë mbi popujt e tjerë të Ballkanit. Shumica e serbëve e përkrahën politikën e Millosheviqit dhe luftërat në Kroaci, në BeH dhe në Kosovë. Serbia e viteve të 80-ta dhe të 90-ta të shekullit të kaluar nuk ishte produkt i Millosheviqit, por Millosheviqi ishte produkt i Serbisë, i shoqërisë serbe, i institucioneve të saj politike, shkencore e kishtare dhe pikërisht i këtij sistemi të të menduarit neohegjemonist. Njëri nga liderët kryesor në Serbi në gjysmën e parë të viteve të 80-ta, Ivan Stambolliqi, qëllimet serbomëdha në Kosovë dhe në gjithë ish-

<sup>40</sup> Kryetari i Serbisë M. Millutinoviç, p. sh. theksonte se në Kosovë shqiptarët nuk janë shumicë, por janë nën 50% e madje nën 40%, duke i abstrahuar vlerësimet e vetë institucioneve përkatëse të Beogradit se shqiptarët më 1991 përbënin 82,2% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës.

Jugosllavinë donte t'i arrinte me mjete të tjera, siç thoshte “me marrëveshje dhe luftë politike”, duke e ndërsyer tërë ish-shtetin kundër Kosovës dhe shqiptarëve. Pasi qarqet hegjemoniste, nacionalshoviniste dhe neofashiste serbe në luftë për pushtet e mënjanuan atë nga skena politike në vitin 1987 e në fund edhe e vranë në vitin 2000, pas heshtjes disavjeçare foli në vitin 1995 për inspiratorët dhe organizatorët e “kryengritjeve serbe” në Kosovë në vitet e 80-ta, për angazhimet e tij politike për “Serbinë unike dhe të barabartë” dhe për politikën shkatërrimtare të Millosheviqit, të cilin vetë e kishte sjellë në pushtet, por dhe të qarqeve militariste serbomëdha. Me zgjedhjen e Millosheviqit për kryetar të Serbisë me 104% të votave (!) dhe me tërë atë që i ka ndodhur dhe po i ndodh popullit serb, hegjemoni Stambolliq nuk e fshihte zhgënjimin edhe në vetë popullin hegjemon serb.<sup>41</sup>

Sjellja e strukturave pushtetore, e opozitës dhe e institucioneve kyçe të shoqërisë serbe, si dhe e serbëve si qytetarë ndaj Kosovës pas rënies së Millosheviqit (2000) e dëshmon pikërisht këtë. Është krejtësisht e sigurt se duhet të kalojë shumë kohë që nga klasa politike në Serbi të dalë një personalitet me kurajo i tipit të Charles de Gaulle-it, i cili do t'i thoshte opinionit dhe popullit serb: Kosova është barrë e madhe politike, ekonomike dhe ushtarake për Serbinë dhe një popull prej më se 2 milion banorëve ka bërë një luftë që të del jashtë Serbisë, prandaj duhet të pavarësohet. Për ta ndërruar këtë sistem të të menduarit hegjemonist serb nevojitet ende kohë, por duhen edhe qasje të reja evropatlantike ndaj Serbisë dhe politikës serbe, në përputhje me realitetet faktike në terren. Tash për tash nuk shihet në horizont një marrëveshje midis Kosovës dhe Serbisë, ku Serbia do ta pranojë Kosovën shtet të pavarur dhe sovran në kufijtë aktualë, në sipërfaqe prej 10.905 km<sup>2</sup>. Sepse, përveç tjerash, në pushtet gjenden trashëgimtarët e drejtpërdrejtë të Millosheviqit, kryetari aktual i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, atëherë Ministër i Informatave (si një Gebels i vogël, i cili në luftën e Bosnjës thoshte: ”Za jednog Srbina, sto Muslimana” - “Për një serb, njëqindë myslimanë”!), dhe Nënkryetari aktual i Qeverisë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë Ivica Daçiq në kohën e regjimit të S. Millosheviqit zëdhënës i Partisë Socialiste të Millosheviqit; kur bisedohej me Hashim Thaçin

<sup>41</sup> I. Stambolić, *Put u bespuće*, Radio B – 92, Beograd, 1995.

Hegjemonin Ivan Stambolliq, pasi forcat neofashiste të Millosheviqit, në luftë për pushtet, e mënjanuan nga skena politike në vitin 1987, në gusht të vitit 2000 e eliminuan edhe fizikisht: u gjet i varrosur në një gropë speciale, të bërë nga gëlqerja, në Frushka Gorë, më se 200 km larg Beogradit!

dhe Edi Ramën për ndarjen e Kosovës në vitin 2018, Vuçiqi erdhi në Kosovë dhe i thuri lavde Millosheviqit, ndërsa në dhjetor të vitit 2019 e mohoi krimin dhe gjenocidin në Reçak! Tekefundit, edhe po të arrihej ndonjë marrëveshje e brishtë, Serbia nuk do ta respektonte atë. Serbia e Millosheviqit në vitet e 90-ta kishte nënshkruar rreth 80 marrëveshje ndërkombëtare lidhur me rrjedhat e luftërave me Kroacinë dhe BeH-në, por asnjë nuk e kishte respektuar!

Pas dështimit të Unionit Serbi-Mal i Zi, Serbia po përpiqet që përmes një mini-Shengeni Ballkanik të krijojë një Jugosllavi të Vogël, ku ajo do të përfitonte si ekonomikisht, ashtu edhe politikisht dhe do të zhbëhej Kosova si shtet, që Serbia e konsideron si territor brenda Kushtetutës së vet. Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi të vetmin hap produktiv që e bëri në raport me Serbinë këto vitet e fundit është bojkotimi i këtij Unioni. Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama u bë mbështetësi kryesor i kësaj krijese, sikundër që luftoi për copëtimin e Kosovës dhe shkatërrimin e sovranitetit shtetëror dhe territorial të saj! Edhe kjo krijesë është dizajnuar të çojë në ndarjen e Kosovës! Rama ishte edhe kundër ndërtimit të “Rrugës së Kombit” dhe kur projekti u realizua në kohën e Berishës, shqiptarëve të Kosovës u vëri taksën! Ky në kontakte me Vuçiqin do ta anashkalojë Kosovën, çfarë e donte Qosiqi nga viti 1969. Prononcimi i tij, bashkë me Vuçiqin në Nish në tetor 2016 për ndërtimin e rrugës Nish–Merdare–Kukës–Durrës, pa çarë kokën se ajo kalon nëpër Kosovë është në këtë frymë. Por në anën tjetër vazhdon me demagogjitë dhe skandalet e tij kur në 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës thotë; “Shqipëria dhe Kosova mund ta kenë një president dhe një politikë të jashtme”, apo skandali tjetër populist që arriti kulminacionin me deklaratën në Pejë (në mbledhjen e dy Qeverive më 26.11.2018), “se do të bashkohemi deri në vitin 2025” (!). “Bashkimi kombëtar” dhe zhbërja e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur nuk shkojnë bashkë!

Mini-Shengeni i vitit 2019 na përkujton pak a shumë unionet dhe marrëveshjet e viteve 1946-1948 midis Titos dhe Enverit për nënshtrimin e Shqipërisë nga ish-Jugosllavia në planin ekonomik, politik e ushtarak, ndërsa Kosovën e sotme kjo krijesë e shndërron në një qark të Serbisë! Në vitet 1946-1948 në çdo cep të Shqipërisë shkruhej parulla dhe këndohej kënga “Ide drug Tito preko Albanije”; me Ramën në pushtet duket se shpejt do ta dëgjojmë këngën “Ide gospodin Vučić preko Albanije”! Anash sjelljet e një njeriu të çekuilibruar si Edi Rama, që po i përfaqëson politikisht shumicën shqiptare dhe frymën e metodat enverhoxhiste, pyetja që shtrohet është:

Ku është Shqipëria "sovrane-demokratike", "kombëtare-prokosovare", "akademike-intelektuale", "racionale" dhe "vizionare"?! Po ku është "papagalli" i Edi Ramës, kosovari dhe ministri i jashtëm i Shqipërisë Gent Cakaj?! Të paktën të jepte dorëheqje! Ku mbetën dhjetra marrëveshje të nënshkruara midis dy qeverive, të Kosovës dhe të Shqipërisë për fusha të ndryshme? Asnjë nuk gjeti zbatim në jetën praktike! Mbetën vetëm taksa për shqiptarët e Kosovës prej 10 eurove për hyrje-dalje në Shqipëri për veturat, kurse për kamioner e mjetet e rënda shumë më të larta dhe fyerjet e sharjet e Edi Ramës në llogari të udhëheqjes së Kosovës: "Lopët që japin qumësht, por me një shkelm e derdhn kovën", "Kush e shanë H. Thaçin është gomar", Kryeministri "Haradinaj si gjelat mbi majen e plehut" dhe banalitetet tjera që fare s'i kanë hije një asnjë diplomati e udhëheqësi të asnjë shteti në botë.

Hivzi Islami

## KOSOVA FACING SERBIAN HEGEMONISM

### Summary

The article examines Serbian hegemonic and expansionist aspirations revolving around the establishment of a Greater Serbia; ethnic cleansing of Albanian territories, etc.; Europe's role in internal Balkan affairs, and Albanians as the biggest victims; the history of the Serbo-Albanian conflict and how the crisis that resulted in the breakup of Yugoslavia began with the violence perpetrated in Kosova in 1981; recent Serbian projects for the breakup and partition of Kosova, exchange of territories and populations, and expulsion of Albanians; Serbian hegemony as a source of long-term destabilization in the Balkans; the rise of a Balkan Mini-Schengen as an idea of official Belgrade driving for the creation of a Little Yugoslavia, which would resemble the 1946-1948 union and agreements between Josip B. Tito and Enver Hoxha that subjugated Albania to Yugoslavia in economic, trade, political and military terms, while today's Kosova would be transformed into a region of Serbia, etc.

*Keywords:* Serbian hegemonic projects, ethnic cleansing, Albanians as the biggest victims in the Balkans, Serbo-Albanian conflict, partition of Kosova, exchange of territories and populations, Balkan mini-Schengen.





Muhamedin Kullashi, Prishtinë

## HEIDEGGERI MBI VULLNETIN PËR FUQI SI ART

### Abstrakt

Analizat e Heideggerit mbi filozofinë e Nietzsches e në veçanti ato në veprën e tij të papërfunduar Vullneti për fuqi do të shënojnë kthesën (Kehre) e mendimit të tij në vitet 30 dhe 40 të shekullit të kaluar. Në këtë artikull ne kemi ekzaminuar interpretimin të cilin Heidegger-i e shpalos në në kaptinën e katërt të Vullnetit për fuqi me titullin Vullneti për fuqi si art.

Duke ndriçuar linja kryesore të konceptcionit niçean mbi artin, ai mëton të vë në dukje „përse një interpretim i embrionit të Vullnetit për fuqi duhet të fillojë pikërisht me temën e artit“. Çështja drejtuese e filozofisë perëndimore, ajo që pyet se ç'është qenia, për Heidegger-in, i paraprinë çështjes themelore e cila do të duhet të çilej ndaj pyetjes së qeniesimit. Në këtë kontekst, arti për Heidegger-in, në një kuptim më të gjerë, emërton forcën krijuese e cila përbën veçorinë themelore të qenies.

Për këtë qëllim Heideggeri saktëson se interpretimi i tij synon të zërthejë pyetjen se ç'është qenia si çështje të cilën filozofia në Perëndim e ka konsideruar si „çështje kapitale“, kurse Heidegger-i e quan atë „çështje drejtuese“. Për të në fakt kjo çështje është e parafundit, kurse çështjen e fundit ai e formulon kështu: Ç'është vetë qeniesimi? Këtë çështje, e cila duhet të zhvillohet dhe themelohet, Heidegger-i e konsideron si çështje themelore të filozofisë, ngase pikërisht „brenda saj filozofia e bën çështje para së gjithash themelin e qenies si themel i filozofisë, e njëherazi ajo pyet për vetë themelin e saj dhe kështu themelohet“.

Arti në kuptimin më të gjerë, sipas interpretimit të Heidegger-it mbi mendimin e Nietzsches, është forcë krijuese që përbën veçorinë themelore të qenies. Ndërkaq në një kuptim më të ngushtë arti është «aktiviteti brenda të cilit forca krijuese i shpaloset vetes me tejdukshmërinë më të madhe jo vetëm si një strukturë midis të tjerave, por si struktura më e lartë e vullnetit për fuqi». Synimi i Nietzsches për rivlerësimin e të gjitha vlerave do të gjejë te Vullneti për fuqi themelin kryesor, edhe ngase struktura më e lartë e këtij është arti. Arti do të bëhet, ndryshe nga religjioni, morali dhe filozofia tradicionale, referencë për rivlerësimin e vlerave të moçme.

Në pjesën e parë të vëllimit të parë të librit të tij *Nietzsche* (1936-1940), Heideggeri (Hajdegeri) trajton temën e *Vullnetit për fuqi*

si art te Nietzsche (Niçe)<sup>1</sup>. Shqyrtimi i kësaj vepre na bën të mundur të shohim si shpaloset dialogu filozofik midis Heidegger-it, njërit nga mendimtarët më të mëdhenj jo vetëm të shekullit XX dhe Nietzsche-s si mendje më e thellë e më origjinale e filozofisë së shekullit XIX - mendje kjo që hapi shtigje të reja në bashkëkohësi për të menduarit filozofik.

Të përkujtojmë së pari se është pikërisht hulumtimi i mendimit të Nietzsches ai që e shtyri Heidegger-in të kalojë nga pikëpamja mbi kërkimin e themeleve të metafizikës, duke gjurmuar përgjatë historisë deri te fillet e saj në filozofinë greke antike, kah tejkalimi i saj. Kësodore kthesën (*Kehre*) e shquar brenda të menduarit të tij në vitet 30 dhe 40 të shekullit të kaluar Heidegger-i e realizon me gjurmimet e mendimeve të Nietzsche-s, të cilat do ta shpiejnë te çështja e *kapërcimit të metafizikës*. Këto gjurmime Heidegger-i i zhvilloi në tekstet e tij të ndara në dy vëllime *Nietzsche I* (1936-1940) dhe *Nietzsche II* (1940-1946), çdonjeri prej të cilëve ka më se 500 faqe. Për filozofinë e Nietzsche-s mbi historinë Heidegger-i zhvillin kërkime në: *Interpretim i shqyrtimit të dytë jobashkëkohor i Nietzsche-s*, 1938-19389.

Të shkruash për këtë dialog të dy mendimtarëve nga më të mëdhenjt në historinë e filozofisë është punë sfiduese, por është edhe e rëndësishme që në gjuhën shqipe të merren në shqyrtim konceptonet e këtyre filozofëve mbi filozofinë dhe artin.<sup>2</sup>

Termi i Nietzsche-s «vullneti për fuqi» është titull i veprës së tij të papërfunduar, të cilën Heidegger-i e konsideron si vepër “kapitale”.

<sup>1</sup> Martine Heidegger, *Nietzsche*, I, Gallimard, Paris, 1971 (512 f.) Të dy vëllimet e kësaj vepre i ka përkthyer në gjuhën frengje Pierre Klossovski.

<sup>2</sup> Për filozofinë e Nietzsche-s kam shkruar në librin *Vetpërkufizimi i njeriut* (“Rilindja”, Prishtinë, 1997), artikullin «Nietzsche mbi historinë» si dhe në librin *Kah metafizikë*, që përmban një version të shkurtër të disertacionit tim të doktorantës, ku kam zhvilluar një analizë të interpretimit të filozofit francez Henri Lefebvre mbi metafizikë. Në takimin e parë që kam pasur me të në Paris në vitin 1982, e kam pyetur në veçanti për qasjen e tij ndaj Nietzsche-s dhe raportet e tij me Hegelin dhe Marx-in. Në numrin 6 të revistës «Studime shoqërore» kam shkruar për kritikën e etikës së Kantit nga Nietzsche. Për disa koncepte të Nietzsche-s kam shkruar edhe në librat *Pushteti dhe dija te Michel Foucault* (2008) dhe *Dy gjenealogji të modernitetit* (2016), si dhe në librat *Humanisme et haine* (Paris, 2008) dhe në *Foucault et Lefort: regards croisés sur la modernité* (Paris, 2020). Njëherazi të përkujtoj se në Universitetin Parisi 8 kam mbajtur ligjëratat gjatë katër viteve (2014-2017) mbi konceptonet etike të Nietzsche-s.

(“Vullneti për fuqi” emërton karakterin themelor të çdo qenieje (gj.*Seiende*, fr. *l'étant*).<sup>3</sup>

Vlerësimin e filozofisë së Nietzsche-s Heidegger-i e paralajmëron këtu duke cekur se Nietzsche «gjendet në udhën e persiatjes filozofike perëndimore», e kjo don të thotë se «ai e dinte se ç'është filozofia». Këtë dije Heidegger-i e konsideron si dije *të rrallë*. “Vetëm mendimtarët e mëdhenj e kanë atë”, saktëson Heidegger-i. Këtë vlerësim Heidegger-i e forcon edhe më shumë duke thënë se meqë në «formën e tij tradicionale të menduarit perëndimor përqendrohet dhe përkryhet në mënyrë vendimtare brenda të menduarit të Nietzsche-s, të shpjegohemi me Nietzsche-n don të thotë të shpjegohemi me të menduarit perëndimor».<sup>4</sup>

Ky shpjegim nënkupton një «kritikë autentike» si «mënyrë e vetme dhe e lartë për ta vlerësuar në mënyrë të mirëfilltë një mendimtar”. Zhvillimin e të rimenduarit të filozofisë së Nietzsche-s, Heideggeri e orienton me ndriçimin në rradhë të parë të “forcës së tij vepruese”, krahas vërejtjeve kritike.<sup>5</sup>

Shpjegimin me Nietzsche-n Heidegger-i e kupton si synim «që të bëhemi të lirë për ta mbështetur përpjekjen më të lartë të të menduarit».

Përgjigja në pyetjen ç'është qenia (gjermanisht, *Seiende*)<sup>6</sup>, nënkupton të eksplorohet qeniesimi i qenies.<sup>7</sup> Për Nietzsche-n çdo

<sup>3</sup> Po aty, f. 14.

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Po aty, f.15.

<sup>6</sup> Qenia (*Seiende*) si particip i prezentit të thjeshtë të foljes «me qenë» emërton «gjërat» reale që ekzistojnë në metafizikë. Te Heidegger-i «qenie» nuk janë vetëm gjësendet e natyrës, por edhe objektet artificiale, po ashtu edhe zotat, mitet, besimet, idetë, njerëzit, të pranishëm apo ata që nuk janë aty të pranishëm, pa i harruar edhe qeniet e kalura dhe ato të ardhshme. Heidegger-i shkruan: «Njerëzit po ashtu, sikurse edhe gjërat e prodhuara nga njerëzit, sikurse edhe efektet dhe rrethanat që dalin si rrjedhojë e aktivitetit njerëzor, të gjitha këto bëjnë pjesë në qenia. Bën pjesë edhe e mundshmja, ndonëse ende-jo-reale. Por e mundshmja është, siç cek Heidegger-i në librin *Hollzwege* (në frëngjisht *Chemins qui ne mènent nulle part*).

<sup>7</sup> Që të mendohet *Qeniesimi* (gj.*Sein*), thotë Heidegger-i, nevojitet të braktiset pikëpamja mbi qeniesimin si themel i qenies. Midis qenies, e cila është aty e pranishme dhe qeniesimit (në kuptimin foljor), ka një dallim themelor të cilin e ka harruar tradita filozofike -, e kjo është për Heideggerin *diferenca ontologjike*. Pas kthesës të cilën e realizon gjatë gjurmimeve mbi mendimin e Nietzsche-s, Heidegger-i e ndryshon grafinë *Sein* në *Seyn* për ta shprehur një orientim të ri në persaitjen e vet e cila, duke kërcyer përtej dallimit ontologjik, i drejtohet drejtpërsëdrejti qeniesimit si e vërteta. Në tekstin *Letër mbi humanizmin* ai

qeniesim është të ndodhurit (gj.*werden*, fr.*devenir*) i cili cilësohet me veprimin dhe aktivitetin e vullnetit. Ndërkaq vullneti, për të, është thelbësisht vullnet për fuqi.<sup>8</sup>

## VULLNETI SI VULLNET PËR FUQI

Për ta kapur paraprakisht atë që është vendimtare në të kuptuarit e vullnetit për fuqi te Nietzsche, Heideggeri i formulon dy pyetje: Çka don të thotë vullneti? Dhe çka don të thotë vullneti për fuqi? Mirëpo ai shton menjëherë se për Nietzsche-n në fakt është këtu vetëm një pyetje, sepse vullneti s'është për të veçse *Vullnet për fuqi*, kurse fuqia s'është asgjë tjetër veçse esenca e vullnetit.<sup>9</sup> Nga kjo Heidegger-i nxjerr konstatimin se vullneti për fuqi s'është veçse „vullnet i vullnetit, do të thotë se të dëshirosh (fr.*vouloir*) është të dëshirosh vet-veten“. Tani Heideggeri e sheh të nevojshme ta sqarojë këtë pohim,

---

thekson se të menduarit i cili mendon në drejtim të së vërtetës së Qeniesimit është një mendim historik, i cili është vepër e mendimtarëve të mëdhenj. Heidegger-i shpjegon se filozofët grekë nuk kanë filluar të mësojnë se ç'është “fyzis”(natyra) në saje të njohjes së fenomeneve “natyrore”, por anasjelltas: në saje të një përvoje fundamentale poetike dhe të menduarit filozofik mbi *qeniesimin* (*Sein*) që u hap për ata ajo që quanin “fyzis”. Përktimi i kësaj fjale në gjuhën latine me fjalën “natura”(proceset e gjërave materiale, atomet etj.), sipas Heidegger-it, e *deformoi* kuptimin *burimor* të “fyzisit”. Rrjedhoja e këtij deformimi ka të bëjë me varfërimin e shikimit dhe të njohjes së natyrës në kuptimin burimor, ashtu si u *zbulua* ajo në filozofinë greke. Ajo që u humb me këtë varfërim semantik shkaktoi “humbjen e relacionit autentik ndaj gjërave”. Në kuptimin burimor “fyzis” don të thotë *lulëzim*, bie fjala lulëzimi i trëndafililit ose shpalosja e tij. Lulëzimi dhe shpalosja nënkuptojnë *çeljen* e diçkaje, paraqitjen dhe *qëndrimin* e asaj në këtë çeltësi, por don të thotë edhe ritën, ndonëse jo në kuptimin sasiar. Burimisht, siç cek Heidegger-i, “fyzis” emërton edhe qiellin, edhe tokën, edhe gurin, edhe bimën, kafshën dhe *njeriun*, por edhe veprat e *njerëzve* etj. Të filozofuarit është shprehje e një *arti të veçantë të thurjes* së mendimeve, thurje kjo që implikon gjurmime e gjermime të thella rreth pyetjeve, fjala vjen, që pyesin se ç'është njeriu dhe çfarë raportesh ai sajton me veten, me të tjerët dhe me botën. Me termin dhe konceptin *qeniesimi* Heidegger-i mendon botën, historinë, ngjarjet. (*Le Dictionnaire de Martin Heidegger*, Arjakovski-Fédier, 2013, Cerf, Paris, f. 428-429).

<sup>8</sup> Po aty, f.16. Në *Letër mbi humanizmin* (Gallimard, Paris, 1986, f.206), dërguar filozofit francez Jean Beaufret, Heideggeri thekson se esenca e qenies, është ajo që është e përbashkët për të gjitha qeniet, kurse filozofia është përgjatë tërë historisë së vet problematikë e qeniesimit, në atë masë sa pyetja që ajo shtron dallon që nga filltet prej pyetjeve që shtrohen lidhur me qenien.

<sup>9</sup> Po aty, f. 40.

përkatësisht të përkufizojë konceptet që mëtojnë „të kapin qeniesimin e qenies“. Meqë për Nietzsche-n vullneti për fuqi përbën veçorinë themelore të çdo qenieje, atëherë cek Heidegger-i, „ne nuk mundemi me rastin e përkufizimit të esencës së vullnetit t’i lejojmë vetes që t’i referohemi një qenieje të veçantë, një mënyre të veçantë të qeniesimit për ta shpejguar duke u nisur nga kjo esencën e vullnetit“.<sup>10</sup>

Këtë shpjegim Heidegger-i e sqaron me dy shembuj konkret. Ai përkujton se brenda përfytyrimit të rëndomtë vullneti del si një aftësi e shpirtit. Se ç’është vullneti kjo përcaktohet me esencën e shpirtit, kurse psikologjia merret me trajtimin e shpirtit, i cili është një qenie e veçantë për dallim nga trupi dhe mendja. Prandaj „nëse për Nietzsche-n vullneti përcakton qeniesimin e shumë qenieve, atëherë vullneti nuk është diçka psikike, por shpirti është diçka „e vullnetshme“. Mirëpo për Heideggerin edhe trupi dhe mendja (fryma) janë vullnet në atë masë sa „diçka e ngjashme „është“.

Pikëpamja e dytë e shikon vullnetin si një shkak. Kësisoj thuhet se vullneti prodhon diçka ose përcakton një sukses. Mirëpo, sqaron Heideggeri, meqë *të jetë shkak* është një mënyrë e të qenimit të veçantë, atëherë „Qeniesimi nuk mund të kuptohet si i tillë.“ Mu për këtë arsye Heidegger-i përfundon se vullneti nuk prodhon asnjë efekt, ngase ajo që mbahet rëndom si „efiçiençë, aftësi kjo që shkakton diçka, mbështetet vetë mbi vullnetin.“<sup>11</sup>

Për shkak të këtyre arsyeve, Nietzsche do ta ndjejë të nevojshme që shpesh të jap definicione të përtërira të vullnetit. Kësodore, siç cek Heidegger-i, ai do të thotë se vullneti është „afekt“, se është „pasion“ apo se është „ndjenjë“, apo se është „komandim“.

## VULLNETI DHE FUQIA. ESENCA E FUQISË

Heideggeri tani e bën një rezymë të tipareve që shquajnë vullnetin për fuqi, me qëllim që t’i afrohet një definicioni të vetëm: ai përmend *vullnetin si qeniesim-që zotëron i cili shkon duke u shtrirë përtej vetvetes mbi...;* pastaj vullnetin si afekt (qasje e eksitimit); vullnetin si pasion; vullnetin si *ndjenjë* (dispozicion *për-tu-mbajtur-me-vetveten*) dhe në fund vullnetin për *komandim*. Ai eviton këtu të sajojë një definicion të qartë sa i takon *formës* e cila do t’i tubonte veçoritë e

<sup>10</sup> Po aty, f. 41.

<sup>11</sup> Po aty, f. 41-42.

përmendura. Mirëpo ai e shtyn më tej formulimin e këtij definicioni duke cekur se një „koncept në filozofi nuk është koncept nëse nuk është i bazuar në atë mënyrë që ajo që ai e përmban të mund të bëhet në vete kriter dhe mjet për persiatje, në vend se të jetë i mbuluar me formula të thjeshta“. E meqë koncepti i vullnetit duhet të përmbajë në vete *Qeniesimin*, Heidegger-i konstaton se „tani ende nuk jemi afër atij.“<sup>12</sup>

Nietzsche cek se çdo vullnet (dashje, fr.*le vouloir*, si infinitiv i substantivuar) është një *vullnet-për të qenë-më shumë*, ose *vullnet-për të qenë-gjithnjë-e-më shumë*. Ai saktëson lidhur me këtë: „Atë që njeriu do, atë që dëshiron pjesëza më vogël e një organizmi të gjallë, është që të ketë më shumë fuqi“.<sup>13</sup>

Kur Nietzsche-e thotë se vullneti është *vullnet-për-të qenë-më-i-fortë*, ai mendon, ndryshe nga darvinizmi, se jeta nuk është vetëm impulsion për ta ruajtur (konservuar, mbajtur) veten, por ajo është *afirmim i vetvetes*. Jeta sipas darvinizmit është ruajtje vetëm e asaj që tashmë ekziston, përqendrohet aty dhe madje bëhet e verbër ndaj esencës së vet. Ndërkaq afirmimi i vetes (si të veprosh në saje të vullnetit tënd) nënkupton një kthim të vazhdueshëm kah esenca, një kthim të vazhdueshëm te origjina (*Ursprung*, shpërthimi fillestar). Afirmimi i vetvetes është afirmim burimor i esencës për Nietzsche-n.<sup>14</sup>

Nietzsche e interpreton *Qeniesimin* si vullnet për fuqi, dhe me këtë interpretim të qeniesimit të qenies, siç vë në pah Heideggeri, ai ka depërtuar “në brendinë më të thellë dhe më të gjerë të qarqeve të mendimit perëndimor.“

## ÇËSHTJA FUNDAMENTALE DHE AJO DREJTUESE E FILOZOFISË

Heidegger-i zhvillon analizën e vet të mëtejshme me interpretimin e librit të tretë të *Vullnetit për fuqi*, i cili merret me parimin e një themelimi të ri të vlerave, duke u nisur nga kaptina IV dhe e fundit, që ka për titull *Vullneti për fuqi si art*. Duke ndriçuar linjat kryesore të pikëpamjes së Nietzsche-s mbi artin dhe mënyrën e shtruarjes së kësaj çështjeje, ai synon që vë në dukje „përse një interpretim i bërthamës së *Vullnetit për fuqi* duhet të fillojë pikërisht me artin.“<sup>15</sup> Për këtë qëllim Heidegger-i saktëson se interpretimi i tij

<sup>12</sup> Po aty, f. 60.

<sup>13</sup> Po aty, f. 61.

<sup>14</sup> Po aty, f. 61-62.

<sup>15</sup> Martine Heidegger, *Nietzsche*, I, f. 67.

synon të zbërthejë pyetjen se ç'është qenia si çështje të cilën filozofia në Perëndim e ka konsideruar si „çështje kapitale“, kurse Heidegger-i e quan atë „çështje drejtuese“. Për të në fakt kjo çështje është *e parafundit*, kurse çështjen e fundit ai e formulon kështu: Ç'është vetë qeniesimi? Këtë çështje, e cila duhet të zhvillohet dhe themelohet, Heidegger-i e konsideron si çështje themelore të filozofisë, ngase pikërisht „brenda saj filozofia e bën çështje para së gjithash themelin e qenies *si themel* i filozofisë e njëherazi ajo pyet për vetë themelin e saj dhe kështu themelohet.<sup>16</sup>

Në vijim të persiatjes së vet Heideggeri thekson se nëse çështja drejtuese (Ç'është qenia?) dhe çështja themeluese (Ç'është qeniesimi?) problematizohen, kjo don të thotë të pyesësh: Çka është?...“Hapja e qenies në tërësinë e saj dhe hapja e qeniesimit tregojnë se çka kërkon të menduarit. Qenia duhet të bartet te hapja e vet qeniesimit dhe qeniesimi duhet të bartet te hapja e esencës së tij.“<sup>17</sup> Gjendjen e hapur të qenies Heideggeri e emërton si „ajo që nuk është e errësuar: *aletheia* (gr), e vërteta. Kësodore çështja drejtuese, si ajo që orienton dhe çështja themeluese e filozofisë „pyesin për të ditur se çka janë në të vërtetë qenia dhe qeniesimi.“<sup>18</sup>

Pyetja se ç'është *esenca e qeniesimit* për Heideggerin nënkupton njëherësh pyetjen se *ç'është e vërteta*; pikërisht pse qeniesimi duhet të ndriçohet brenda të vërtetës. Kësisoj, për Heidegger-in, e vërteta dhe qeniesimi gjenden „në hapësirën e çështjes themeluese“. Brenda çështjes themeluese dhe çështjes drejtuese, Heideggeri e problematizon njëherazi edhe esencën e të vërtetës. Këto pyetje e persiatje që i shtron Heidegger-i shkojnë përtej konceptionit të Nietzsche-s. Kjo është e vetmja mënyrë për Heidegger-in „që ta bartë të menduarit në ajrin e pastër dhe për ta bërë të frytshëm; por kjo na bën edhe të sprovovjmë kufirin specifik dhe çka përmban ai tjetër“.

Kësodore Heidegger-i nënvizon se është vullneti për fuqi ai që përcakton „qeniesimin e gjërave si të tilla, që do të thotë brenda të vërtetës së tij.“ Ai mendon se meqë Nietzsche në interpretimin e tij të çdo ngjarjeje si vullnet për fuqi ia rezervon një vend të veçantë artit, atëherë mu për këtë „pyetja e cila ka të bëjë me të vërtetën duhet të ketë një rol të rendit të parë“.<sup>19</sup>

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Po aty, f. 67-68.

<sup>18</sup> Po aty, f. 68.

<sup>19</sup> Po aty.



## TË QENIT ARTIST SI MËNYRË E TË JETUARIT

Në vijim të hulumtimit të vet, Heidegger-i do të marrë në shqyrtim disa propozicione të Nietzsche-s që synojnë të vënë në suprinë esencën e artit sikurse edhe peshën që ato kanë në themelimin e parimit të ri të vlerave. Duke e pasur parasysh fragmentin e Nietzsche-s nga *Vullneti për fuqi* me titull «Fenomeni i «artistit», Heideggeri na bën me dije se ky kërkim na shpie te ndriçimi i qeniesimit «në mënyrën më imediate dhe më të qartë».<sup>20</sup>

Të jesh-artist për Nietzsche-n don të thotë të kesh një *fuqi-për të prodhuar, ose* që të vendosësh diçka që nuk është *ende* brenda qeniesimit. «Brenda prodhimit, shkruan Heidegger-i, ne shofim se si bëhet të ndodhurit (gj. *werden, fr. devenir*) e qenies dhe aty mund ta diktojme esencën e saj të paprishur». Dhe në vijim: «Meqë është fjala për ndriçimin e Vullnetit për fuqi si veçori themelore e qenies, duhet që detyra e tillë të nisë aty ku shtrohet çështja dhe kjo të paraqitet më së qarti, ngase çdo sqarim duhet të kalojë nga e qarta te e errta e asnjëherë anasjelltas».<sup>21</sup>

Për ta vënë në pah perspektivën brenda së cilës fenomeni i jetës duhet të shkoqitet dhe për ta sqaruar domethënien që ka te Nietzsche mendimi se *të jesh artist është një mënyrë e të jetuarit*, Heidegger-i përmend **përkufizimin e jetës në Vullneti për fuqi** si «forma më e njohur për ne e Qeniesimit» (fr. nr. 689). Ai saktëson, në mbështetje të disa thënieve sentencioze se «brenda të qenit-artist ne takojmë mënyrën më të tejdukshme dhe më të njohur të Vullnetit për fuqi». Kësisoj për ta ndriçuar qeniesimin e qenies, refleksioni mbi artin, cekë Heideggeri, ka një *epërsi* vendimtare.<sup>22</sup>

Mirëpo, Nietzsche flet në këto fragmente kryesisht për fenomenin e artistit. Megjithatë Heidegger-i sqaron se «realitetit të artit» i takojnë edhe veprat e artit, ndonëse këto vrojtohen nga pikëshikimi i artistit.<sup>23</sup> Nietzsche i bën vërejtje këtu estetikës se ka favorizuar kryesisht «natyrat receptive të artit, duke e lënë anash artistin si krijues të veprave artistike». Kësisoj për të kuptuar se ç'është arti duhet ndriçuar fenomenin e artistit (fr.797). Nga kjo Heidegger-i i nxjerr dy propozicione: *arti është struktura më*

<sup>20</sup> Po aty, f. 69.

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Po aty, f. 70.

*transparente* dhe më e njohur e vullnetit për fuqi dhe së dyti arti duhet të kuptohet nga pikëpamja e artistit.

Në vazhdim të këtij fragmenti Nietzsche shton: « Duke u nisur nga kjo duhet të vështrohen instiktet themelore të fuqisë, të natyrës, etj.! E njëherazi edhe ato të religjionit dhe moralit!». Këtyre strukturave të vullnetit për fuqi Nietzsche ia shton edhe ato të shoqërisë dhe të individit, të njohjes, të shkencës, të filozofisë. Këto struktura të qenies janë, sipas Heidegger-it «korrespondenca në raport me të qenit artist, me faktin e të qenit të krijuar [*Geschaffensein*]. Qenia, të cilën e përbëjnë struktura të tilla që nuk janë prodhim specifik i artistëve, merr pjesë në mënyrën e të qenit korrespondues ndaj veprës së krijuar nga artisti». Këtë mendim Heidegger-i e gjen të konfirmuar në fragmentin paraprak (796): «Vepra e artit ku ajo duket pa artistin, bie fjala si një trup, si një organizatë (bie fjala si trupi i oficerëve prusian, ose rendi i jezuitëve). Në këtë masë artisti s'është veçse në stadin fillestar. Universi (gjithësia) si një vepër e artit e cila lind nga vetvetja... ». Kësisoj Heidegger-i tani vë në pah se koncepti i artit dhe vepra e artit këtu shtrihen mbi gjithë aftësinë e prodhimit dhe mbi «tërë realitetin thelbësisht të prodhuar». Heidegger-i cek se kjo i përgjigjej njëfarë dore po ashtu edhe mënyrës së të folurit të rëndomtë deri në pragun e shekullit XIX. Ai përkujton se me fjalën «art» emërtohej çfarëdo lloj aftësie e të prodhuarit. Kësisoj mjeshtri i artizanatit, pushtetari, edukatori janë artistë të asaj që prodhojnë. Edhe vetë natyra paraqitet si «artist». Pra, fjala art nuk e nënkupton këtu konceptin në kuptimin e ngusht të «arteve të bukura», si prodhim i të «bukurës» në një vepër. Heidegger-i shpjegon se Nietzsche me «arte të bukura» nënkupton vetëm njërin nga zhanret e arteve midis tjerëve, kurse të gjitha prodhimet i shikon si korrespondenca me arte të bukura dhe me aktivitetin e artistit. Kësisoj artisti në kuptimin e ngushtë, sqaron Heidegger-i, paraqet këtu vetëm një stad preliminar të krijimtarisë. Në saje të këtij vrojtimi Heidegger-i shtron propozicionin e tretë mbi artin: arti, sipas konceptcionit të artistit, është ngjarja fundamentale e qenies, kurse «qenia është, në atë masë sa është, diçka që e krijon vetveten, diçka e prodhuar, e krijuar».<sup>24</sup> Ky saktësim është i rëndësishëm për të kuptuar veçantinë e konceptcionit të Nietzsche-s mbi artin; ky pra nuk reduktohet vetëm në arte të bukura, ngase ka domethënie më të gjerë, duke përfshirë *disa forma të krijimtarisë* që cilësojnë «ngjarjen fundamentale të qenies».

<sup>24</sup> Po aty, f. 71.

Më tutje Heidegger-i thekson se meqë Vullneti për fuqi është thelbësisht krijim dhe shkatërrim, atëherë ngjarja fundamentale e qenies është «art», e kjo don të thotë se ajo është Vullnet për fuqi.<sup>25</sup> Heidegger-i përkujton njëherazi se Nietzsche qysh në veprën e vet të parë *Lindja e tragjedisë duke u nisur nga fryma e muzikës* (186) e shikonte artin si *veçori themelore e qenies*; ndërkaq në veprën e vet të fundit *Vullneti për fuqi* (fr. 853) ai shkruante: «Në parathënien *Lindja e tragjedisë*, e cila e ftonte Wagnerin në një dialog, shpërfaqet kjo bindje, ky evangjil i artistit: arti si detyrë e mirëfilltë e jetës, si aktivitet i saj metafizik... ».

Heidegger-i vë në pah se «jeta» në këtë tekst të Nietzsche-s shikohet jo vetëm në kuptimin e përpiktë të jetës njerëzore, por ajo identifikohet me gjithësinë në kuptimin shopenhauerian, ndonëse, shton Heideggeri, ky propozicion përmban një kritikë të Schopenhauer-it. Arti në kuptimin më të gjerë, sipas Heidegger-it, është forcë krijuese që përbën veçorinë themelore të qenies. Ndërkaq në një kuptim më të ngushtë arti është «aktiviteti brenda të cilit forca krijuese i shpalohe vetes me tejdukshmërinë më të madhe jo vetëm si një strukturë midis të tjerave, por si struktura më e lartë e Vullnetit për fuqi». Synimi i Nietzsche-s për *rivlerësimin e të gjitha vlerave* do të gjejë te Vullneti për fuqi themelin kryesor, edhe ngase struktura më e lartë e këtij është arti. Arti do të bëhet, ndryshe nga religjioni, morali dhe filozofia tradicionale, referencë për *rivlerësimin e vlerave të moçme*.

Heidegger-i e rezymon kritikën e Nietzsche-s mbi parimin më të lartë të moralit, të religjionit të krishterë dhe të filozofisë platoniste kësisoj: «Kjo botë e këtushme nuk vlen asgjë, duhet të ekzistojë një botë «më e mirë» nga kjo e gërshetuar brenda shqisores, duhet të ketë një «botë të vërtetë» përmbi botën tonë, një botë mbishqisore. Bota e shqisave s'është veçse një botë aparente». Nietzsche e konsideron, ndërkaq, këtë botë mbishqisore si një botë *e pavërtetë*, kurse botën shqisore ai e kupton jo si një gënjeshtër, siç e kundronte platonizmi, por *përkundrazi* si një botë e vërtetë. Nietzsche kësodore e bën një *inversion* të vlerave. Dhe meqë shqisorja është element i artit, Nietzsche e afirmon pikërisht artin si *mohues* të botës mbishqisore: «Arti si e vetmja forcë superiore është i kundërt ndaj cilitdo vullnet që mohon jetën, del si element antikrishterë, antibudist, antinihilist *par excellence*» (Nr. 853, II).<sup>26</sup>

<sup>25</sup> Po aty.

<sup>26</sup> Po aty, f. 72-73.

Inversioni i vlerave të cilin Nietzsche e realizon në raport sa ndaj pikëpamjes platoniste, aq edhe ndaj teologjisë së krishterë dhe budizmit mbi botën «mbishqisore», duke e cilësuar të pavërtetë, ngase e mohon jetën tokësore si e vetmja botë e vërtetë. Horizonti brenda të cilat Nietzsche kundron dhe shqyrton jetën, njeriun dhe artin është horizont i cili përjashton botën transcendentë, botën e cila vendoset përtej jetës historike e tokësore; ai e përjashton atë «botë», sepse ajo ka varfëruar dhe shterë forcat krijuese të njeriut. Duke e afirmuar begatinë e botës dhe jetës *shqisore*, Nietzsche nuk përjashton në asnjë mënyrë *mendimin* dhe *frymën* nga ky horizont. Mirëpo «spiritualitetin» e jetës njerëzore dhe tokësore ai e kupton rrënjësisht ndryshe nga platonizmi dhe teologjia monoteiste, siç do të kemi rastin ta shohim në shqyrtimet e mëtejme.

### ARTI SI LËVIZJE E KUNDËRT NDAJ NIHILIZMIT

Në saje të këtyre qëndrimeve të Nietzsche-s, Heidegger-i formulon propozicionin e katërt mbi artin: *Arti përbën në mënyrë të mirëfilltë lëvizjen e kundërt ndaj nihilizmit*. Elementi artistik shfaqet te akti i krijimit dhe strukturimit, ndërkaq aktiviteti metafizik, me veprimin e tij më të lartë si mendim filozofik ka nevojë të përcaktohet nga elementi artistik. Nietzsche kërkon që *filozofit të moralit nihilist, siç del të jetë Schopenhauer-i, t'i kundërvihet «filozofi-artist»*. «Ky filozof, saktëson Heidegger, është artist në atë masë sa ai përbën strukturat e qenies në totalitetin e saj, do të thotë edhe aty ku qenia paraqitet në totalitetin e saj, përkatësisht njeriu». Nietzsche në fragmentin 795 shkruan: «Filozofi-artist. Koncepti superior i artit. A do të mund të merrte njeriu distancë të tillë ndaj njerëzve deri aty sa të arrijë *t'i formësojë ata në strukturën e tyre?*»

Arti në kuptimin e ngushtë, thekson Heideggeri, është së pari pranim i ndijores (shqisores), aparentes dhe gjithë asaj që nuk është «botë e vërtetë» apo, siç thotë Nietzsche shkurtazi, ndaj asaj që nuk është e vërtetë. Brenda artit ndërhyr vendimi, cek Heidegger-i, sa i takon pyetjes se ç'është e vërteta. E kjo për Nietzsche-n don të thotë gjithëherë: se ç'është e «vërteta» është çështje që pyet për qenien në kuptimin e mirëfilltë. Për Heidegger-in kjo ka të bëjë në njërën anë me «lidhjen e domosdoshme midis çështjes drejtuese dhe çështjes që ka

parasysh themelin e filozofisë dhe, në anën tjetër, me pyetjen se ç'është e vërteta. Arti është vullnet i aparencës si ndijimore».<sup>27</sup>

Heidegger-i, në vijim të analizës së vet, citon një fragment (nr.369) nga *Vullneti për fuqi* lidhur me këtë vullnet. Aty thuhet se «vullneti për aparencën, iluzionin dhe mashtrimin, për të ndodhurit dhe për ndryshimin është më i thellë, më «metafizik» se sa vullneti për të vërtetën, realitetin e qeniesimin». Nietzsche e ka fjalën këtu për të vërtetën ashtu si e kupton Platoni, pra si qenie në vete, për idetë që janë mbishqisore. Ndërkaq për Nietzsche-n, siç nënvizon Heidegger-i, vullneti për të ndjeshmen (shqisoren) dhe për begatinë e saj është vullnet i asaj që kërkon «metafizika». Kësisoj, vë në pah Heideggeri, vullneti për shqisoren (të ndjeshmen) është vetvetiu metafizik. E ky vullnet metafizik është në të vërtetë i pranishëm brenda artit.<sup>28</sup>

Tani Heidegger-i i rikapitulon kësisoj të katër propozicionet paraprake: 1. Arti është struktura më e tejdukshme dhe më e njohurë e Vullnetit për fuqi.<sup>29</sup>; 2. Arti duhet të kuptohet duke u nisur nga artisti; 3. Arti, sipas konceptit të zgjeruar të artistit, përbën ngjarjen themelore të çdo qenieje, ndërsa qenia, në atë masë sa është, është diçka që krijohet, diçka e krijuar dhe fundja 4. Arti është lëvizje antinihiliste *par excellence*.<sup>30</sup> Heidegger-i e sheh të arsyeshme që ta rikujtojë njëherazi edhe fragmentin 808 mbi artin ku Nietzsche thekson: «Ne e takojmë atë si stimuluesin më të fuqishëm të jetës». Pra arti del si stimulues e jo si «qetësues» siç e definonte Schopenhauer-i. Heidegger-i nënvizon se kësodore dëshmohet se për Nietzsche-n arti është strukturë e Vullnetit për fuqi dhe se arti si stimulues i jetës është teza kryesore e Nietzsches mbi artin.

Mirëpo Heideggeri nuk ndalet në këtë shkallë të kërkimit të mendimit të Nietzsche-s mbi Vullnetin për fuqi dhe artin. Ai tani i shtron dy pyetje të reja: Çka sjell ky definicion i artit për përcaktimin e Vullnetit për fuqi, e me këtë, edhe të qenies në tërësinë e saj? Çka don të thotë ky interpretim i artit sa i takon njohjes së artit dhe pozicionit ndaj artit? Për të dhënë përgjigje në këto pyetje Heidegger-i do të merr në shqyrtim gjashtë fakte themelore të nxjerra nga estetika. Ai vazhdon shqyrtimin e vet duke e trajtuar pyetjen e dytë në saje të ndriçimit më të themeltë të qasjes së Nietzsche-s në përcaktimin e esencës së artit. Ai njëherësh e shoshit çështjen e vendosjes së kësaj

<sup>27</sup> Po aty, f. 73.

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Po aty, f. 74.

<sup>30</sup> Po aty, f. 75.

qasje brenda tërësisë së orvatjeve më të hershme, nga historia e estetikës, që çojnë te njohja e artit.<sup>31</sup>

Heidegger-i sqaron se të pesë propozicionet e shtruara përkufizojnë vështrimet thelbësore brenda të cilave lëviz persiatja e Nietzsche-s. Ai nënvizon në veçanti se persiatja e Nietzsche-s mbi artin nuk ka për qëllim ta përshkruaj këtë si një fenomen apo si një shprehje e kulturës, ngase synon të provojë në fakt me artin dhe me një karakterizim të esencës së tij se *çka është* Vullneti për fuqi.

Heidegger-i mendon se refleksioni i Nietzsche-s mbi artin zhvillohet në «udhën tradicionale», në atë që definohet me nocionin e estetikës. Ai shpjegon se termi «estetika» është formuar në mënyrë analoge si «logjika» dhe «etika». Logjika si shkencë (gr. *episteme*) e *logosit*, si doktrinë mbi gjykimin i cili është formë themelore e të menduarit, kurse etika (*ethos*) ka të bëjë me qëndrimin e brendshëm të njeriut dhe mënyrën se si ky qëndrim përcakton sjelljen e tij dhe me kategorinë e të Mirës.<sup>32</sup>

Ngjashëm, termi «estetika» është formuar në mënyrë analoge: si shkencë e sjelljes së ndjeshme dhe afektive e njeriut dhe mbi atë që e përcakton. Ajo që përcakton të menduarit, pra logjika ka të bëjë me të vërtetën. Ajo që përcakton ndijimin (*le sentir*) e njeriut, pra estetika ka të bëjë me të bukurën. Kësisoj, thekson Heidegger-i, Estetika merret me shqyrtimin e gjendjes afektive të njeriut në raportin e tij me të Bukurën. Madje e Bukura nuk është asgjë tjetër veçse ajo që me aparcencën e vet e nxit këtë gjendje te njeriu.<sup>33</sup>

Heideggeri në analizën e vet vë në pah se Estetika nga ky fakt është lloj i refleksionit mbi artin i cili merr «normat e veta të përcaktimit dhe të motivimit nga relacioni afektiv i njeriut ndaj së Bukurës e paraqitur brenda artit». Më tutje ai sqaron se relacioni i të ndjeshmes (shqisores) ndaj prodhimeve të artit, si qëllim i refleksionit estetik, mund të jetë sa relacion i aktit të prodhimit, aq edhe relacion i kënaqjes dhe receptivitetit.<sup>34</sup> Vështrimi estetik kësisoj, cek Heidegger-i, e përcakton veprën si e Bukura të cilën e prodhon arti, duke pasur parasysh gjendjen afektive të njeriut. Pra, e Bukura, e cila mund të jetë natyrore dhe artistike, me paraqitjen e vet e nxit këtë gjendje te njeriu. Refleksioni mbi artin, thekson Heidegger, duke e prodhuar të Bukurën

<sup>31</sup> Po aty, f. 75.

<sup>32</sup> Martin Heidegger, *Nietzsche*, I, f. 76.

<sup>33</sup> Po aty, f. 76.

<sup>34</sup> Po aty, f. 77.

në veprat artistike e bën të mundur kësodore zhvillimin e estetikës. Ai përkujton këtu se estetika si refleksion mbi artin dhe të Bukurën nga pikëpamja e atij që prodhon dhe nga pikëpamja e atij që kënaqet (receptivitetit), u paraqit në shekullin XVIII. Kësisoj, estetika si filozofi fillon të reflektojë mbi «esencën e artit dhe të Bukurës». <sup>35</sup> Në këto shqyrtime të Heidegger-it arti konsiderohet si *strukturë* e Vullnetit për fuqi, pra si *strukturë e Qeniesimit* «në kuptimin absolut».

Heideggeri e orienton tani refleksionin e vet kah *esenca* e estetikës me qëllim që të arrijë te të kuptuarit niçean të esencës mbi artin e njëherazi të mund ta ndërtojë një pozicion të dialogut me Nietzsche-n. <sup>36</sup> Për ta cilësuar esencën e estetikës dhe rolin e saj në mendimin perëndimor dhe relacionin e saj ndaj historisë së artit, Heidegger-i i shtron tani «gjashtë fakte themelore», që në mënyrë të dendur shkoqisin disa momente kyçe të kësaj historie.

Fakti i parë ka të bëjë me artin e madh helen nga epoka e lulëzimit të tij. Ky art nuk ka qenë i shoqëruar me refleksione *konceptuale*, ashtu siç do të zhvillohen më vonë brenda estetikës. Mirëpo kjo nuk do thotë, thekson Heidegger-i, se arti i kësaj epoke ka qenë vetëm i «përjetuar», pa njohuri e koncepte mbi të. Ai mendon se grekët e kësaj epoke kishin megjithatë «një dije aq të qartë, burimisht të zhvilluar dhe një pasion të tillë për dijen sa që në këtë kthjelltësi të dijes nuk kishin nevojë për asnjë «estetikë».

Estetika fillon te grekët, shpjegon Heidegger-i, vetëm në çastin kur arti i madh, por edhe filozofia i afrohen fundit. Në epokën e Platonit dhe Aristotelit elaborohen koncepte të cilat do ta përkufizojnë sferën e persatjeve mbi artin. Ai përkujton së pari çiftin e koncepteve materia-forma (*gr.hile-morfe*). Ky dallim buron nga koncepti i Platonit mbi qenien në saje të nocionit të «idesë» (*idos, aidea*). <sup>37</sup> Atëherë kur vepra e artit përjetohet si diçka që shfaqet (*fainomenon* sipas *idos*) me këtë ndërmjetësim, ajo shfaqet si e Bukura. <sup>38</sup> Këtu shqitet një aspekt i mëvetësisë së interpretimit të Heidegger-it mbi estetikën.

Koncepti i dytë i cili do ta orientojë, siç cek Heidegger-i, tërë persiatjen mbi artin është koncepti *tehné*. Grekët e moçëm emërtonin me këtë term sa artin, aq edhe zanatin, e po kështu edhe artistin dhe

<sup>35</sup> Po aty.

<sup>36</sup> Po aty, f. 78.

<sup>37</sup> Po aty, f. 78.

<sup>38</sup> Po aty, f. 78.

zejtarin. Heidegger-i e bën këtu një analizë të domethënies së termit grek «techné», duke dashur të vë në pah mangësitë e disa interpretimeve të mëvonshme lidhur me raportet *techné* dhe arti e vepra artistike. Për ta vënë në pah domethënien e vërtetë të termit burimor «techné», Heidegger-i e sheh të udhës t'ia kundërvë atij konceptin e kundërt të grekët, konceptin e «fyzis-it». Ai thekson se termi me të cilin ne sot e përkthejmë «fyzis» me termin «natyra» nuk është adekuat. Në fakt fjala «fyzis» ishte për grekët emri thelbësor i qenies (gj.*Seyn*) në totalitetin e saj. Qenia për ta ishte «ajo që duke u rritur nga vetvetja», lulëzon dhe prodhohet, «ajo që kthehet brenda vetes dhe zhduket: mbretëria e cila shkon duke lulëzuar dhe duke u tërhequr brenda vetes».<sup>39</sup> Tani njeriu brenda qenies (*fyzis*) kërkon vendin e vet, duke proceduar në një mënyrë apo një tjetër «për ta zotëruar dhe kapërcyer qenien», e ky procedim i tij ndaj qenies është i orientuar me një *dije* e cila ka të bëjë me qenien. Pikërisht *kjo dije* ishte *techné*. Heidegger-i cek se ky term nuk ka emërtuar te ata «të bërit» apo «të prodhuarit», siç do të ndodhë më vonë, por vetëm një *dije* e cila orienton dhe motivon shpjegimin (ose dekompozimin) dhe zotërimin e qenies, e cila është rritur nga vetvetja; tani mbi bazë të kësaj qenie «prodhohet një tjetër qenie në formë të veglave dhe veprave të artit». Mirëpo, insiston Heidegger-i, edhe këtu *techné* nuk don të thotë të bërit artizanal, një mjeshtri artizanale, por emërton «dijen, shpjegimin e qenies si të tillë në zhanrin e një orientimi të vetëdijshëm të të prodhuarit.»<sup>40</sup> Megjithatë, saktëson Heidegger, domethënia helenike «procedimi» nuk nënkupton të *pushtohet* natyra, por të «lejohet që të prodhohet» ajo që tanimë është e pranishme brenda saj. Heidegger-i vë në pah se si esenca e *technés*, sa më shumë që do të imponohet dallimi midis formës dhe përmbajtjes, përjeton një interpretim i cili bën që ajo të dallohet nga domethënia burimore. Me kohë, në atë masë sa *techné* hyn në raport me prodhimin e objekteve të bukura dhe paraqitjen e tyre, refleksioni mbi artin, nëpërmjet përsiatjeve mbi të Bukurën, kalon në fushën e estetikës.<sup>41</sup>

Mirëpo Heidegger-i nuk hyn këtu në ndriçimin e evoluimit gjatë periudhave të gjata, me të cilin çifti *materia* dhe *forma* do të bëhet skema kryesore e të gjitha pyetjeve mbi artin dhe veprat e artit. Ai megjithatë përkujton se dallimi midis materies dhe formës ka dalur nga fusha e fabrikimit të veglave dhe se ajo nuk kishte të bëjë

<sup>39</sup> Po aty, f. 79.

<sup>40</sup> Po aty.

<sup>41</sup> Po aty, f. 80.



burimisht me artet e bukura.<sup>42</sup> Tani Heidegger-i hedh këtu një dyshim të thellë sa i takon cilësisë *për të dalluar* që kanë konceptet *materia-forma* në fushat e arteve dhe të veprave të artit.

Fakti i tretë lidhur me zhvillimin e estetikës ka të bëjë sërish, cek Heidegger-i, me një ngjarje e cila nuk lidhet drejtpërsëdrejti me vetë artin. Ky fakt ka të bëjë me lindjen e Kohës moderne brenda së cilës «njeriu dhe dija e lirë që ai ka mbi veten brenda qenies bëhen tani e tutje vend ku vendoset *mënyra e përjetimit*, ku përcaktohet dhe strukturohet qenia.» Në këtë epokë, saktëson Heidegger-i, raporti i njeriut ndaj qenies dhe ndaj vetes bëhet i tillë që pozicioni i tij i lirë dhe «shija» e tij sajajnë instancat më të larta për të gjykuar mbi qenien. Në rrafshin metafizik ky ndryshim gjen shprehje te fakti se «siguria e çdo qenie dhe e çdo të vërtete do të mbështetet mbi vetëdijen për vete të unit të veçantë: *Ego cogito ergo sum*».<sup>43</sup> Kësisoj Heidegger-i e paraqet pushtimin e pozicionit të ri të filozofisë moderne nga Descarte-si si *tregues* i këtij ndryshimi të thellë, ku «qenia e parë» është Vetja e njeriut dhe raportet e tij ndaj gjendjeve të tij». Madje mu kjo qenie përbën sigurinë - në fushën e njohjes së pari - se diçka është e vërtetë apo e pavërtetë dhe se sipas saj «do të matet» gjithçka tjetër.<sup>44</sup> Pikërisht brenda këtij ndryshimi historik që sjell moderniteti, Heidegger e vë në pah zhvendosjen që e realizon refleksioni mbi të Bukurën në art kah gjendja afektive e njeriut. Tani e tutje Estetika do të themelohet mbi këto baza.

Heidegger-i nxjerr në shesh këtu një proces paralel me elaborimin e estetikës dhe përpjekjet për ndriçimin e *gjendjes estetike*. Së pari ai sqaron rolin që kishin arti i madh dhe veprat e mëdha në zhvillimin e tyre paraprak historik: «Arti dhe vepra e tij, shkruan Heidegger, nuk janë të domosdoshme veçse si rrugë dhe vendbanim [gj. *Auefenthalt*] i njeriut ku e vërteta e qenies në tërësinë e saj, do të thotë e pakushtëzuara ose absoluti, i çilet atij. Arti i madh nuk është i madh vetëm në saje të cilësisë së lartë të veprës së krijuar, por sepse ai përbën një «nevojë absolute».<sup>45</sup> Mirëpo brenda Kohës moderne Heidegger-i, duke i marrë parasysh edhe analizat e Nietzsche-s, dikton «dekadencën e artit të madh në krahasim me tendencën e mëparshme». Kjo dekadencë nuk ka të bëjë me dobësimin e «cilësisë» dhe të stilit, «por me faktin se arti e humb esencën e vet, raportin

<sup>42</sup> Po aty, f. 81-82.

<sup>43</sup> Po ay, f. 81.

<sup>44</sup> Po aty.

<sup>45</sup> Po aty, f. 82.

imediat ndaj detyrës (objektivit) së saj fundamentale për ta paraqitur absolutin, do të thotë për ta vendosur si të tillë në mënyrë normative në fushën e njeriut historial”.<sup>46</sup>

Ky shpjegim ka për qëllim ta ndriçojë faktin fundamental që lidhet me momentin *historial* në të cilin elaborimi i estetikës kërkon shkallën më të lartë të ngritjes dhe fuqisë krijuese. Mu në atë kohë, sipas Heideggerit, mer fund arti i madh. Në vijim të shqyrtimit të vet ai cek se përmbushja e estetikës e gjen madhësinë e vet, ngase e pranon dhe e thekson këtë mbarim të artit të madh. Estetika më e madhe e Perëndimit, nënvizon Heidegger-i, është ajo e Hegelit, ashtu si është zhvilluar në *Ligjëratat mbi estetikën* (1828-1829). Për ta ilustruar këtë qëndrim Heidegger-i citon disa propozicione nga këto *Ligjërata*: «Kësisoj së paku, shkruan Hegeli, nuk ka më asnjë nevojë absolute që materia të bartet te paraqitja me artin»; «Në të gjitha këto relacione arti është dhe mbetet për ne, sa i takon destinimit të tij më të lartë, një realitet i së kaluarës». Dhe propozicioni i tretë ku thuhet se «Ditët e bukura të artit grek, sikurse edhe koha e artë e mesjetës së vonshme, kanë perënduar ». Me këto pohime Hegeli nuk do të thotë se në kohërat e mëvonshme nuk ka pasur vepra të ndryshme që janë prodhuar dhe çmuar, mirëpo ai mëton të theksojë se arti ka humbur fuqinë e vet absolute, ngase tani ato vepra çmohen vetëm në sferën e shijes artistike për disa shtresa sociale.<sup>47</sup>

Tani Heidegger-i e vë në pah paraqitjen nga mesi i shekullit XIX, e një orvatje për krijimin e një *vepre të artit integral* [gj. *Gesamtkunstwerk*], e cila shfaqet brenda dëshirës për t’iu kundërvën

<sup>87</sup> Historiciteti (*Geschichtlichkeit*) të cilin Henri Corbin e përkthen si “historialitet”, term ky që ka për qëllim të theksojë specificitetin e këtij nocioni që lidhet me ekzistencën njerëzore në raport ndaj konceptit tradicional të historisë. Mënyra e qeniesimit e qenies njerëzore nuk është “historike” për Heidegger-in në kuptimin ku ajo të mund të ishte së pari objekt i një studimi historik. Historikja cilëson atë që zë vend në histori si objekt i njohjes, kurse *historialja* cilëson qeniesimin njerëzor si ai që hap një histori. Mendoj se edhe në gjuhën shqipe, së paku në tekstet që kanë të bëjnë me terminologjinë dhe konceptet e Heideggerit, mund të mbahet ky dallim midis “historikes” dhe “historiales”.

Historiciteti cilëson edhe *Dasein* (qeniesimin-atje) në atë që ai ka për të qenë. Njeriun Heidegger-i e shikon si kohësi (temporalitet) si mundësi e pastër. Ai ka gjithnjë aftësinë që të bëhet tjetër nga ajo që është, të bëhet një krijesë e re.

Mendoj po kështu është mire që termin “Dasein” të Heidegger-it, sikurse praktikohet edhe në disa gjuhë të tjera, të mos e përkthejmë me termin shpjegues *qeniesimi-atje*, por ta përdorim në tekstet për mendimin e Heidegger-it thjesht si *Dasein*.

<sup>47</sup> Po aty, f. 82-83.

procesit të «dezertimit të artit nga pikëpamja e esencës së tij».<sup>48</sup> Kjo përpjekje lidhet në rradh të parë me emrin e Richard Wagner-it. Krahas veprave të mëdha muzikore, Wagner shkruan në këtë kohë vepra që përmbajnë refleksione të rëndësishme mbi artin: *Arti dhe revolucioni* (1849); *Vepra e artit e ardhmërisë* (1850); *Opera dhe drama* (1851); *Arti gjerman dhe politika gjermane* (1865). Heideggeri cek se në këtë kohë shfaqej prirja që *prodhimi* i gjendjes estetike dhe efikasiteti i saj të shikohen si *kriter* me të cilin bota soditet dhe vlerësohet.<sup>49</sup>

Meritën e Nietzsche-s Heidegger-i e sheh këtu në faktin se *ai ishte i pari i cili e pa qartazi se mbrapa kësaj fasade, e cilësuar me gjendjen estetike, fshihej nihilizmi*. Ky konstatim tani e çon Heidegger-in te formulimi i faktit të fundit, i cili ka të bëjë me fenomenin të cilin e nxorri në shesh Hegeli: humbjen e fuqisë së artit «për ta strukturuar dhe ruajtur absolutin». Heidegger-i cekë se Nietzsche e kishte diktuar humbjen e kësaj fuqie edhe në «vlerat më të larta» te religjioni, morali, filozofia platoniste». Ai kishte diktuar edhe «mungesën e forcës dhe atë të obligimeve krijuese të cilat mund të themelojnë ekzistencën humano-historiale mbi qenien në tërësinë e saj».<sup>50</sup> Mirëpo Heidegger-i e sheh të udhës që këtu të theksojë një dallim midis Hegelit dhe Nietzsche-s lidhur me këto probleme. Hegeli e kishte parë artin, ndryshe nga religjioni, morali dhe filozofia, të ketë rënë në nihilizëm, pasi ishte bërë «i tejkaluar dhe joreal». Nietzsche ndërkaq do të kërkojë brenda artit «reagimin kundër nihilizmit religjioz, filozofik dhe moral». Heidegger-i mendon se këtu mund të shihet ndikimi i synimit vagnerian kah vepra e artit integral, ndonëse Nietzsche ishte larguar nga konceptcionet e Wagner-it mbi artin dhe botën. Ndryshe nga Hegeli te i cili arti, si i tejkaluar, bëhej objekt i dijes spekulative, kurse estetika hegeliane «lulëzonte në një metafizikë të frymës (mendjes)», refleksioni niçean në këtë fushë bëhej një «fiziologji e artit». Heidegger-i citon këtu Nietzsche-n nga teksti i tij *Nietzsche kundër Wagner-it* (1888): «Estetika nuk është asgjë tjetër veçse një fiziologji e aplikuar» (VIII,187). Kësisoj ajo nuk është më, cek Heidegger-i, madje as psikologji si e shikonin rëndom në shekullin XIX, por një eksplorim shkencor i *gjendjeve dhe proceseve fizike* dhe motiveve që i nxisin ato.<sup>51</sup> Heidegger-i e sheh të nevojshme

<sup>48</sup> Po aty, f. 83.

<sup>49</sup> Po aty, f. 88.

<sup>50</sup> Po aty, f. 88.

<sup>51</sup> Po aty.

që këtë kërkim të Nietzsche-s mbi estetikën ta marrë ashtu si është: në një rën anë arti me destinimin e tij historial si «reaksion kundër nihilizmit», e në anën tjetër nocionin e artit si një fiziologji. Ky nocion tani vendoset në «fushën e shkencave pozitive». Kësisoj, konstaton Heidegger-i, persiatja estetike «shteret deri në konsekuencat e veta të fundit». Gjendja afektive shpjegohet me «ngacmimet nervore, me gjendjet trupore». Heidegger-i vë në pah se pozita themelore e Nietzsche-s ndaj artit përcaktohet si «realitet historial», kurse estetika shikohet si «fiziologji e aplikuar». Njëherazi ai bën të ditur se edhe njëri, edhe tjetri aspekt i këtij pozicioni janë të integruara në «vargun e gjatë të historisë së artit, brenda raportit të artit me nocione të ndryshme të artit që formohen çdo herë».<sup>52</sup>

### DEHJA SI GJENDJE ESTETIKE

Në zhvillimin e mëtejshëm të analizës së vet Heidegger-i thekson se qëllimi i tij i vërtetë është megjithatë ta kuptojë **artin si strukturë, madje si strukturë e mirëfilltë e Vullnetit për fuqi**. Kjo do të thotë se ai mëton, duke u nisur nga koncepti niçean mbi artin dhe nëpërmjet tij, «ta kapë Vullnetin për fuqi në esencën e tij e njëherazi qenien në tërësinë e saj, duke pasur parasysh veçorinë e tij themelore». Mu për këtë arsye Heidegger-i tani e sheh të domosdoshme që ta shkoqisë konceptin niçean mbi artin “si një tërësi koherente”, ndonëse ai cek se ky koncept në shikimin e parë duket absolutisht i kundërtshëm. Ai dikton brenda mendimit të Nietzsche-s synimin që arti të përfaqësojë *lëvizjen antinihiliste*, përkatësisht “bazën e vlerave të reja” dhe në këtë mënyrë “të përgatisë dhe të themelojë masën dhe ligjet e ekzistencës historialisht spirituale”. Por ai vëren te Nietzsche edhe përpjekjen që ta kuptojë e shpjegojë artin nëpërmjet “mjeteve të fiziologjisë.”<sup>53</sup> Heideggeri i konsideron si të sipërfaqshme vërejtjet që disa autorë i kanë bërë këtij pozicioni të Nietzsche-s, duke e cilësuar si “absurd dhe të zhveshur nga kuptimi dhe pra si nihilist”. Ata që e vlerësonin kësisoj pikëpamjen e Nietzsches zhvillonin argumentimin se nëse arti varet nga fiziologjia, atëherë thelbi dhe realiteti i tij do të shthurreshin brenda “gjendjeve nervore dhe qelizave nervore”. Disa të tjerë i bënë vërejtje Nietzsche-s se në ato “lëvizje të

<sup>52</sup> Po aty, f. 89.

<sup>53</sup> Po aty.

verbëta” nuk mund të gjendej ndonjë kuptim apo ndonjë vlerë.<sup>54</sup> Heidegger-i i shoshit implikimet e pohimit të Nietzsche-s që shpiejnë te reduktimi i artit dhe estetikës në fiziologji, pra në shpjegime që lidhen me procese natyrore, me relacionet shkaku-pasojë. Kësisoj ai cek se nëse “arti i dorëzohet fiziologjisë, atëherë arti bie në nivelin e sekrecioneve gastrike“. Më tutje Heidegger-i shtron pyetjen si mundet atëherë «arti i kuptuar kësisoj të përcaktojë themelimin vendimtar të vlerave? Ta përkufizosh artin njëherazi si lëvizje antinihiliste dhe objekt i fiziologjisë, kjo do të thotë të përziejsh ujin me zjarr”. Mirëpo Heidegger-i mendon se nuk duhet kërkuar përgjigjen në këto pyetje brenda këtyre kundërthënieve të Nietzsche-s sa i takon pikëpamjes së tij mbi artin e estetikën, porse këtë duhet kërkuar te “vullneti dhe mendimin më intim i Nietzsches”.<sup>55</sup>

Heidegger-i thekson se brenda disa shqyrtimeve të Nietzsche-s mund të gjenden mospërputhje që shkojnë prej një skajshmërie te tjetra dhe që shkaktojnë huti te lexuesi. Në anën tjetër, shton ai, fakti se Nietzsche ka lënë vrojtme, plane të porealizuara e bën të vështirë ndonjëherë punën e *rikonstruktimit* të një pikëpamje koherente të tij mbi artin. Nga disa plane që Nietzsche i ka lënë për Vullnetin për fuqi, Heidegger-i përmend projektin burimor me titull *Mbi fiziologjinë e artit* (XVI, 432-434), ku figurojn 17 paragrafe përmbajtja e të cilëve nuk është renditur sipas ndonjë parimi të kapshëm e objektivisht të themeluar.

Mirëpo megjithë karakterin fragmentar të këtyre teksteve të Nietzsche-s mbi artin, Heidegger-i dëshiron të formësojë një shikim mbi *tërësinë* e Vullnetit për fuqi, e në anën tjetër mbi argumentet kryesore të estetikës tradicionale.<sup>56</sup> Ai e bën të qartë synimin e tij që të mos mjaftohet këtu me konstatimin e pikëpamjeve doktrimore të Nietzsche-s mbi estetikën, duke synuar të kuptojë se në ç’mënyrë mund të pajtohen elemente në dukje të kundërthënshme brenda pozicionit të tij themelor ndaj artit. Kësisoj ai do të marrë në shqyrtim pikëpamjen e Nietzsches mbi artin si *reaksion kundër nihilizmit* dhe artit si objekt i fiziologjisë. Së këndejmi, sfida e kërkimit të Heidegger-it mbi konceptcionet e Nietzsche-s mbi artin lidhet me gjetjen e një *uniteti* të tyre, i cili do të dilte nga vetë esenca e artit, e nëse arti del si strukturë e Vullnetit për fuqi dhe pasi të jetë ndriçuar “veçoria e pajtueshme e përcaktimeve të kundërthënshme”, atëherë ai

<sup>54</sup> Po aty, f. 89.

<sup>55</sup> Martin Heidegger, *Nietzsche I*, f. 90.

<sup>56</sup> Po aty, f. 92.

mendon se kështu do të arrijmë të një nocion superior i esencës së Vullnetit për fuqi.<sup>57</sup>

Ky është, pra, synimi i Heidegger-it në këtë shqyrtim të teorive kryesore estetike të Nietzsche-s. Ai së pari e cilëson përsiatjen e Nietzsche-s mbi artin si përsiatje *estetike*, ngase përcaktimet e shtruarra më parë tregojnë se arti përjetohet brenda një estetike, se përkufizohet me një *kthim* të gjendja afektive e njeriut nga e cila del prodhimi dhe kënaqja me të Bukurën. Heidegger-i saktëson se Nietzsche vet e përdor shprehjen “gjendje estetike” dhe flet për një “aktivitet dhe një vizion estetik”. Meqë kjo estetikë cilësohet nga Nietzsche si “fiziologji”, kjo nënkupton, sipas Heidegger-it, se duhet kërkuar *burimet* e gjendjeve afektive të kundruara si thjesht psikike brenda “gjendjeve trupore që u përgjigjen”. Kësisoj Heidegger-i vë në pah një pikëshikim mbi tërësinë dhe unitetin e pandashëm fiziko-psikik, pra të trupit dhe shpirtit, përkatësisht “të gjallës e cila del këtu e përkufizuar si fushë e gjendjeve estetike, si “natyrë” e gjallë e njeriut.”<sup>58</sup>

Heidegger-i sqaron se kur Nietzsche flet për fiziologjinë ai dëshiron të theksojë gjendjen *trupore*, mirëpo kjo gjendje është vetvetiu “gjithëherë diçka psikike, që lidhet pra me shpirtin, e kjo ka të bëjë me psikologjinë». Mirëpo Nietzsche, siç cek Heidegger-i, kur thotë “psikologji”, ai gjithëherë e mendon të lidhur me gjendjen fiziologjike të trupit. Njëherësh ai vë në pah se Nietzsche shpesh përdor shprehjen gjendje “artiste” në vend të gjendje “estetike”. Madje me gjendje *artiste* apo *joartiste* ai ka parasysh gjendjet që mbështesin e favorizojnë apo që pengojnë dhe ndalojnë një raport ndaj artit qoftë krijues, qoftë receptiv. Çështja themelore e estetikës si fiziologji e artit, apo fiziologji e artistit, të Nietzsche, siç e shpjegon Heidegger-i, do të ketë për qëllim të vë në dukje ato gjendje që cilësojnë esencën e natyrës fiziko-psikike, do të thotë “të natyrës së gjallë të njeriut në të cilat në veçanti aktiviteti dhe vizioni artistik përmbushet sipas mënyrave dhe operacioneve natyrore”.<sup>59</sup>

Sa i takon përkufizimit të *gjendjes estetike* themelore Heidegger-i këtu do ta merr parasysh një tekst jo nga *Vullneti për fuqi*, por nga *Muzgu i idoleve* (1888, VIII, sq.122): “**Psikologjia e artistit. - Që të ketë art, që të ketë në çfarëdo mënyre një aktivitet dhe një vizion estetik, është i domosdoshëm një kusht fiziologjik: dehja. Së pari duhet që**

<sup>57</sup> Po aty.

<sup>58</sup> Po aty, f. 92.

<sup>59</sup> Po aty, f. 82-93.

**dehja ta ketë intensifikuar ngacmueshmërinë e tërë makinës: para kësaj s'ka fare art** [nënvizimi është i yni]. Të gjitha llojet e dehjes, sado ndryshe-ndryshe të kushtëzuara që të jenë ato kanë të njëjtën cilësi: para së gjithash dehja e ngacmimit seksual, kjo formë nga më të moçmet e më origjinalet e dehjes. Njëherazi, dehja e cila i shoqëron të gjitha lakmitë e mëdha, të gjitha afektet e fuqishme; dehja e festës, e garave, dehja nga një veprim i çmueshëm, dehja e fitores, e cilësdo lëvizje të skajshme, dehja e egërsisë, dehja e shkatërrimit, dehja nga disa atmosfera meteorologjike, bie fjala dehja pranverore, dehja nga një vullnet që gufon nga energjia e akumuluar”.<sup>60</sup> Këto formulime të gjendjes estetike të Nietzsche-s Heidegger-i i përmbledh me këtë propozicion të përgjithshëm: “gjendja estetike themelore është dehja, e cila mund të jetë e kushtëzuar, e liruar dhe e nxitur në mënyra të ndryshme. Këtë pasazh Heidegger-i e ka zgjedhur, ngase ai ofron njërin nga definicionet niçeanë të gjendjes estetike që ka arritur një qartësi dhe koherencë shumë të lartë. Në saje të këtyre qëndrimeve të qarta të Nietzsche-s, Heidegger-i thekson se nuk ka më vend për ta reduktuar doktrinën niçeanë mbi artin në antagonizmin midis dionizianes dhe apollonianes.

Në vijim të analizës së vet Heidegger-i shtron dy pyetje: 1. Cila është esenca universale e dehjes? 2. Në cilin kuptim dehja është e “domosdoshme” “që të ketë art?” Dhe në cilin kuptim dehja është gjendje estetike fundamentale?<sup>61</sup> Një përgjigje të shkurtë në pyetjen e parë Heidegger-i e gjen te një fragment nga *Muzgu i idolëve* (VIII, 123):”Thelbësorja në dehje është ndjesia e forcës së intensifikuar dhe plotnia”. Këtë mendim ai e gjen edhe në fragmentin *Fiziologjia e artit*: ndjesia e forcës dhe plotnia në dehje. ”Ndërkaq më parë, cek Heidegger, ai e quante dehje gjendjen fiziologjike paraprake të artit; kurse tani ndjesia është esenciale, pra “mënyra se si ne e përjetojmë vetveten e njëherazi edhe mënyra si i përjetojmë gjërat, qenien, që ndryshojnë nga vetja jonë”. Heidegger-i mendon se nuk duhet të ndajmë këtu gjendjen trupore nga ndjenja “thujse truporja të ishte vendosur në katin e ulët e ndjenja në katin e lartë. Ndjenja si fakt për ta ndjerë veten përbën pikërisht mënyrën se si ne jemi trupor”. Mirëpo, saktëson Heidegger-i, të jesh trupor nuk do të thotë që një shpirt do ta mbante si një shtojcë një masë të madhe e quajtur trup, por “se fakti ta ndjesh veten nënkupton që më parë trupin që i takon vetes sonë. Kësisoj me praninë e tij në një gjendje apo në një tjetër, “trupi

<sup>60</sup> Po aty, f. 93.

<sup>61</sup> Po aty, f. 95.

është i shpërndarë brenda tërë vetes sonë”. Heidegger-i sqaron pokështu se trupi për Nietzsche-n nuk është një gjësend që do ta mbanim me veti. Ne nuk “kemi” një trup, por ne “jemi” trupor”, saktëson ai.<sup>62</sup>

Heideggeri më tutje sqaron se për Nietzsche-n esencës së trupit i takon aftësia për ta ndjerë veten, i takon ndjenja e cila “bën të mundur ndërhyrjen implikuese të trupit brenda ekzistencës sonë”.<sup>63</sup> Fjala vjen një shqetësim me gastritin shkakton prishjen e disponimit tonë, erësimin e tij. Vullneti mundet deridiku ta pengojë këtë prishje të disponimit, por nuk mundet të krijojë disponim të mirë, ngase “gjendjet e disponimit nuk mund të mposhten dhe të ndryshojnë veçse me gjendje të tjera të disponimit”. Heidegger-i thekson më tutje, se ajo që është thelbësore për ndjenjën është se ajo nuk “ndodh ‘brenda’ nesh, porse ajo është një lloj themelor i ekzistencës sonë në saje të të cilit ne jemi përherë të shtyrë, të bartur përtej vetvetes brenda qenies, e cila në një mënyrë apo tjetër na takon apo nuk na takon në tërësinë e saj”. Kësisoj gjendja e disponimit është lloj themelor sipas të cilit “ne jemi jasht vetvetes sonë.”<sup>64</sup>

Gjendja e trupit brenda këtyre proceseve oscilon, na çon përtej vetes sonë, apo e lë atë të kapërthehet brenda vetes. Heidegger-i saktëson se sipas kësaj pikëpamjeje të Nietzsche-s ne jetojmë pikërisht pse trupi është pjesë inhereente e jona, kësisoj të jetuarit përmban “trupëzimin”(të korporuarit) i cili është diçka thelbësisht tjetër nga posedimi i thjeshtë i një organizmi.<sup>65</sup> Heideggeri vë në pah se kjo pikëpamje e Nietzsche-s mbi trupin dallon nga ato që e shpjegojnë trupin si diçka thjesht *fizike*. Nietzsche zaten shpesh kritikoi në shkrimet e veta edhe mënyrat se si prezantohej, në kërkimet e asokoshme, *lidhja midis psikikes dhe fizikes* te njeriu. Çdo ndjenjë për Nietzschen nënkupton gërshetimin e ngushtë me procesin e “trupëzimit”, e madje në “një kuptim më autentik se sa uniteti “trupëzues” i disponimit që mbretëron aty në mënyrë thelbësore”.<sup>66</sup>

Në *Vullneti për fuqi* Nietzsche do të theksojë dy elemente që cilësojnë dehjen: 1. Ndjenjën e forcës së intensifikuar dhe 2. Ndjenjën e plotnisë. Ndërkaq Heidegger-i, duke u mbështetur në sqarimet paraprake mbi trupin e trupëzimin, thekson se ky intensifikim i forcës

<sup>62</sup> Po aty.

<sup>63</sup> Po aty, f. 95.

<sup>64</sup> Po aty, f. 96.

<sup>65</sup> Po aty, f. 96.

<sup>66</sup> Po aty, f. 97.



duhet kuptuar si aftësi për ta tejkaluar veten, për të shkuar përtej vetvetes, si një relacion ndaj qenies “në të cilën vetë qenia përjetohet si me më shumë qeniesim, me më shumë begati, me më shumë tejdukshmëri, si më esenciale”.<sup>67</sup>

## HEIDEGGER-I MBI TË BUKURËN TE KANTIT

Teoria estetike e Kantit është njëra nga teoritë e mëdha që ka ushtruar ndikim të fuqishëm në debatet mbi çështjet estetike tani e dy shekuj në fusha të ndryshme të arteve. Njëra nga çështjet kryesore të estetikës së tij është ajo që trajton të Bukurën. Fati historik i konceptonit të Kantit mbi të Bukurën është i ngarkuar me keqkuptime e keqinterpretime. Problemi u bë më i ndërlikuar kur në këto keqkuptime patën rol të veçantë emra të mëdhenj të filozofisë së shekullit XIX, si Shopenhauer, Nietzsche e Dilthey (Diltaj). Ndriçimin më të thellë të këtyre keqkuptimeve mendoj se e ka ofruar vetë Martin Heidegger-i .

### C'ËSHTË E BUKURA PËR KANTIN?

Heidegger-i thekson se keqkuptimi me estetikën e Kantit lidhet me një përkufizim të kategorisë së të Bukurës në veprën e tij *Kritika e aftësisë së të gjykuarit*. Aty e Bukura përkufizohet së pari si diçka që na *pëlqen*. Më tej e Bukura cilësohet si një objekt «i kënaqësisë së pastër të soditjes». Është fjala për «kënaqësinë brenda së cilës e Bukura na çilet si e bukur dhe përjetohet, sipas termave të Kantit, «jashtë çfarëdo interesi vetjak», pra në mënyrë tërësisht të *painteres*.<sup>68</sup> Ndërkaq *shijen* në estetikë, siç përkujton Heidegger-i, Kanti e përkufizon kështu: «*Shija* është fuqi për të gjykuar për një objekt apo për një lloj të përfytyrimit me kënaqësinë e pastër apo me pakënaqësinë *jashtë çfarëdo interesi vetjak*. Objekti i një kënaqësie të tillë quhet i bukur». Heidegger-i tani shpjegon se «sjellja estetike, do të thotë sjellja apo raporti ndaj së Bukurës përbën «kënaqësinë jashtë çfarëdo interesi vetjak», pra kënaqësinë e *painteres*». Ai saktëson se për nocionin vulgar «indiferenca ndaj çfarëdo gjëje apo personi» është mungesë e interesit. Sipas këtij nocioni, në raportin që ne kemi ndaj

<sup>67</sup> Po aty.

<sup>68</sup> Martin Heidegger, *Nietzsche I*, f. 102.

një gjëje apo personi ne përjashtojmë *vullnetin* tonë. Tani Heidegger-i e lidh këtë nocion vulgar me pikëpamjen e Shopenhauer-it: mbasi relacioni ndaj së Bukurës, përkatësisht kënaqësia, përkufizohet si «e painteres», atëherë «gjendja estetike do të implikojë një *suspendim* të vullnetit, një pushim i çfarëdo përpjekjeje, i çfarëdo aspirate, pushim i pastër, një *të mos-dëshirosh-asgjë* e pastër, një avullim i pastër brenda mospjesmarrjes». <sup>69</sup>

Më tutje Heidegger-i e fut në skenë të këtij debati Nietzsche-n, përkatësisht pikëpamjen e tij mbi estetikën dhe të bukurën. Së pari ai përkujton përkufizimin e Nietzsche-s mbi «gjendjen estetike si dehje», me qëllim që të vë në suprinë dallimin e tij radikal nga pikëpamja e Kantit për kënaqësinë «e painteres» sa i takon përcaktimit të sjelljes ndaj të Bukurës. Pastaj ai citon një fragment të Nietzsche-s nga vepra e tij *Vullneti për fuqi*: «Që nga Kanti, gjithë ajo që është thënë për artin, për të bukurën, për njohjen, për urtinë është çnatyruar dhe është ndotur me nocionin «jashtë çfarëdo interesi vetjak». <sup>70</sup> Është ky njëri nga gjykimet më të ashpra ndaj pikëpamjes së Kantit mbi artin dhe të bukurën. Mirëpo Heidegger-i në analizën e vet do të vë në pah se ky gjykim negativ është sajuar nga një interpretim *i gabuar* i konceptcionit të Kantit mbi të Bukurën. Këtë interpretim të gabuar të Kantit e ka sajuar Shopenhauer-i, ndërsa Nietzsche e ka përvetësuar gadi pasivisht nga Shopenhauer-i. Këto interpretime të gabuara do të ndikojnë në përhapjen dhe thellimin e keqkuptimit të teorisë estetike të Kantit për një kohë gjatë.

## PIKËTAKIMI I NIETZSCHE-S ME KANTIN RRETH SË BUKURËS

Heidegger-i thekson se Nietzsche ka gabuar pasi që e ka përvetësuar në mënyrë jokritike interpretimin e Shopenhauer-it dhe pse nuk e ka lexuar *Kritikën e aftësisë së të gjykuarit* të Kantit. Në anën tjetër, Heidegger-i gjen te Nietzsche një pikëpamje të ngjashme me atë Kantit. Te ky pikëtakim Heidegger-i arrin pasi ta ketë zberthyer përcaktimin e së Bukurës si objekt i një kënaqësie të painteres te Kanti. Po si të kuptohet ajo të *kesh interes për diçka?* Heidegger-i e shpjegon këtë si diçka që shikohet si mjet i cili do të shërbejë për diçka tjetër. Kanti ndërkaq e shtron pyetjen e cila ka të bëjë me esencën e të Bukurës në këtë mënyrë: «Në saje të çkafit sjellja

<sup>69</sup> Po aty, f. 103.

<sup>70</sup> Po aty.

me të cilën ne zbulojmë diçka si të bukur përcaktohet si e aftë që të na bëjë ta përjetojmë të Bukurën si të bukur? Cila është arsyeja që e përcakton që ne të zbulojmë diçka si të bukur?»<sup>71</sup>

Para se ta ketë zhvilluar pikëpamjen mbi atë se cila është arsyeja përcaktuese e asaj që është e bukur, e me këtë edhe të hap çështjen se ç'është e Bukura si e tillë, Kanti, sipas Heidegger-it, e mënjanon pikërisht «interesin» si diçka që në asnjë mënyrë nuk do të mund të paraqitet si arsye e tillë. Kësisoj, për Kantin gjykimi «Kjo është e bukur» kurrë nuk mund të jetë një interes. Heidegger-i kësodore hap para syve tonë një konceptcion *krejt tjetër* të Kantit mbi esteteikën dhe të Bukurën në veçanti. Krejt tjetër nga shumë studime e shqyrtime qoftë të autorëve të shekullit XIX, qoftë të atyre të shekullit XX. Për Heidegger-in, Kanti na shpjegon se në mënyrë që diçka që kemi takuar rastësisht del për ne e bukur, «ne duhet ta lëmë objektin të prodhohet vetvetiu, në mëvetësinë e vetes së tij, në rangun dhe dinjitetin e tij vetjak»<sup>72</sup> (f.104). E kjo, sipas interpretimit të Heidegger-it, do të thotë se ajo gjë e bukur nuk duhet të jetë në shërbim të diçkaje tjetër, të ndonjë qëllimi a *interesi tjetër*. Kanti e saktëson këtë qëndrim të vetin edhe duke shtuar se sjellja ose relacioni ynë ndaj së Bukurës si e tillë duhet të jetë «favori i lirë» (*freie Kunst*). Kjo do të thotë se ne duhet të çilemi dhe ta pranojmë atë objekt në mëvetësinë e tij, me cilësitë që e bëjnë të bukur.

Mirëpo tani Heidegger-i e shtron pyetjen çfarë është në të vëretë natyra e atij *favori të lirë*, a nënkupton ai *heqjen e vullnetit tonë* apo *indiferencën* kur çilemi ndaj objektit të bukur? Ndryshe nga Shopenhauer-i dhe ata që mbështesin një pikëpamje të tillë, Heidegger-i mendon se me «favorin e lirë» Kanti kupton diçka krejt tjetër: «përpjekjen më të lartë të esencës sonë, çlirimin e vetes sonë në favor të formësimit (*Freigabe*) të asaj që në vete ka dinjitetin e vet». Heidegger-i kësisoj e vë në pah dallimin e theksuar midis pikëpamjes së Kantit mbi relacionin e «painteres» ndaj së Bukurës dhe Shopenhauer-it e vijuesve të shumtë të tij. Se ky relacion në asnjë mënyrë nuk përmban te Kanti ndonjë «ndotje», por përkundrazi e çmon lartë të bukurën, Heideggeri e nxjerr në shesh edhe me ndriçimin e mëtejshëm të keqinterpretimit të konceptcionit të Kantit mbi të bukurën. Ky keqinterpretim mbështetet në një «gabim të dyfishtë». I pari ka të bëjë me interpretimin e përkufizimit të Kantit të asaj «jashtë çfarëdo interesi». Ky formulim, siç vë në pah Heidegger-i, nuk

<sup>71</sup> Po aty.

<sup>72</sup> Po aty, f. 104.

e thotë atë që është thelbësore për relacionin tonë ndaj asaj që është e Bukur, por vetëm e përgaditë udhën për atë relacion, duke përjashtuar «çfarëdo interesi» i cili do të pengonte të kuptuarit dhe përjetimin e asaj që është e Bukura.

Heidegger-i pastaj vë në pah se nga ky keqkuptim i «interesit» del edhe gabimi i dytë sipas të cilit thuhet «eliminimi i interesit do të anulonte çfarëdo raporti real ndaj objektit». Në fakt ndodh e kundërta; pikërisht për shkak të qasjes *painteres* «raporti real hyn në lojë». Heidegger-i nxjerr në shesh të kuptuarit e mirëfilltë të qëndrimit të Kantit, duke theksuar se «pikërisht në këtë mënyrë objekti i pastër bëhet i dukshëm dhe kështu shfaqet e zbulohet e Bukura».<sup>73</sup>

Heidegger-i shpjegon se ajo që e ka bërë të mundur këtë gabim të dyfishtë është *mungesa* e të kuptuarit real të asaj që Kanti e konsideron si themelore për esencën e të Bukurës dhe artit. Kësisoj, Heideggeri vë në pah po kështu se Wilhelm Dilthey, i cili «ka shkruar me pasion për historinë e estetikës», pohonte se «propozicioni i Kantit mbi kënaqësinë e *painteres* është shtruar në një mënyrë veçanërisht të shkëlqyeshme nga Shopenhaueri». Heidegger-i mendon se, në të vërtetë, Dilthey do të duhej të thoshte se Shopenhauer-i «e ka keqinterpretuar në mënyrë veçanërisht të dëmshme» Kantin.

Kurse Nietzsche në një fragment të veprës së cituar thotë: «Për *mua* është e bukur (historikisht) ajo që për njerëzit më të çmuar të një epoke bëhet e dukshme si shprehje e asaj që është më e denja për t'u çmuar». Heidegger-i thekson se pikërisht në këtë formulim e gjejmë pikëtakimin e dy mendimtarëve: «Ajo që në *dukjen* e saj është më e denja për t'u çmuar». Pasi që mu ajo që në *dukjen* e vet është e denjë për t'u çmuar me respekt përbën për Kantin esencën e të Bukurës, ndonëse ky nuk e shtrinë këtë pikëshikim, sikurse që e bën Nietzsche mbi gjithë atë që është e vlefshme dhe e madhe në histori.<sup>74</sup>

## KËNAQËSIA E REFLEKSIONIT DHE NGAZËLLIMI I QENIESIMIT NË BOTË

Tani Heidegger-i e zgjeron analizën e vet, duke mos u kufizuar vetëm te mënjanimi i keqinterpretimit të teorisë estetike të Kantit, por duke synuar të shpjegojë se në ç'mënyrë Nietzsche e kupton të Bukurën,

<sup>73</sup> Po aty, f. 104.

<sup>74</sup> Po aty, f. 105.

në saje të «pozicionit të burimor, brenda një lidhmërie historike». Së pari ai konstaton se edhe Nietzsche e kupton të Bukurën si diçka që na pëlqen, si diçka që ofron kënaqësi. Mirëpo tani shtrohet pyetja se ç'është të pëlqyerit, ajo që na pëlqen. Konceptin e Nietzsche-s mbi të pëlqyerit Heidegger-i e qëmton brenda disa teksteve nga *Vullneti për fuqi*. Kësisoj ai dikton se ajo që pëlqen, që korrespondon varet nga ajo se çka është personi të cilit duhet t'i korrespondojë diçka, duhet t'i pëlqejë. Ndryshe «Ai që është i tillë definohet në saje të asaj që ai kërkon prej vetes së vet». Kjo nënkupton se ajo kërkesë varet se si e kuptojmë atë që jemi, sidomos si e kuptojmë shkallën e aftësisë sonë për të arritur «jetën e fuqishme», atë që na pëlqen, pra ajo «që i përgjigjet asaj që e konsiderojmë se i takon vet-vetes sonë».<sup>75</sup>

Heideggeri më tutje thekson se «E Bukura është ajo që ne nderojmë e çmojmë si prototip i esencës sonë». Mirëpo pikërisht te ky moment i mendimit të Nietzsche-s mbi të Bukurën Heidegger-i citon një fragment tjetër të Nietzsche-s për të na ballafaquar me kritikën dhe distancën që ai dëshiron të marrë nga Kanti: «Çlirimi nga çfarëdo interesi vetjak dhe nga «egoja» s'është veçse një absurditet dhe vrojtim i pasaktë: është fjala më parë për ngazëllimin që jemi tani në botën tonë, që jemi të çliruar nga ankthi përballë asaj që është e huaj për ne!» Këtu Heidegger-i sikur ka zgjedhur një fragment ku shpërfaqet sa keqinterpretimi i Kantit mbi «interesin», por edhe ajo që e bën të afërt Nietzsche-n me Kantin. Kemi të bëjmë këtu, pra, me një operacion të dyfishtë të Heidegger-it.

Sqarimin e dy gabimeve dhe keqinterpretimeve të Kantit e pamë më sipër. Tani ai na ballafaqon me *ngjashmëritë* e pikëpamjeve të këtyre dy mendimtarëve sa i takon të Bukurës. Pikëtakimin e tyre Heidegger-i e tregon te ngjashmëria midis «ngazëllimit që jemi në botën tonë» te Nietzsche me «kënaqësinë e refleksionit» te Kanti. Ky e shpjegon në fakt *kënaqësinë e refleksionit* me sjelljen estetike themelore ndaj së Bukurës. Kësisoj, për të, «favori i lirë» ka të bëjë me «interesin në shkallën më të lartë». Kjo është krejt e kundërta e një qëndrimi indiferent ose të cilësuar me një kalkulim për një interes. Heidegger-i sqaron se interpretimi kantian i sjelljes estetike si kënaqësi e refleksionit «depërton te një gjendje fundamentale e qeniesimit-njeri, brenda të cilit njeriu arrinë të plotnia e cila buron nga esenca e tij».<sup>76</sup>

<sup>75</sup> Po aty, f. 106.

<sup>76</sup> Po aty, f. 107.

Ndërkaq te Nietzsche e Bukura është ajo që përcakton brenda nesh sjelljen tonë dhe fuqinë tonë, plotninë e fuqisë sonë thelbësore; këtu sërish del ngjashmëria e dy mendimtarëve. Ky saktësim, që na ofron Heidegger-i, na ndihmon që më mirë ta kuptojmë konceptin e «dehjes» te Nietzsche: kjo s'ka të bëjë me një gjendje «të marramendjes së ndjenjave dhe zhytjes në ekzistencën e përjetuar, ashtu si e kuptonte Wagner-i». Heideggeri shpjegon se «tonaliteti afektiv i dehjes, si raport ndaj së Bukurës nuk është as vlim e as gjallëri e thjeshtë» e gjendjes estetike. Nietzsche në një fragment tjetër e bën edhe më të qartë se çka mendon me të Bukurën si diçka e denjë për t'u adhuruar (çmuar) si e tillë: «Është fjala për *forcën* (e një individi apo të një populli) e cila e di se në ç'mënyrë dhe ku është i aplikueshëm gjykimi «për të bukurën».

Heidegger-i saktëson se Nietzsche me «forcë» nuk nënkupton forcën thjesht fizike e aq më pak brutalitetin «por aftësinë e ekzistencës historiale e cila është në gjendje të kapë dhe të përmbushë destinimin më të lartë të esencës së tij». Dehja për të cilën e ka fjalën Nietzsche ka të bëjë «me forcën krijuese». Ndërkaq me termin «historial» Heidegger-i mendon, thënë shkurtazi, momentet më të çmueshme e më të begatshme në historinë e njerëzimit.<sup>77</sup>

Të përmendim, së fundi, një ngjashmëri dhe një pikëtakim tjetër të Nietzsche-s me Kantin, këtë herë në fushën e *çështjeve etike*. Duke sqaruar domethënien e një *veprimi të mirëfilltë etik*, Kanti shpjegonte se ky veprim duhet të prodhohet në saje të *parimeve* që kanë një vlerë njerëzore, e cila kapërcen kalkulimet dhe interesat vetjake të individit. Ndërkaq, ky tip i dytë i veprimeve ka të bëjë me *imperativat hipotetike*: kur veprimi sipas këtyre, vlera e veprimit nuk është brenda vetë atij veprimi, por është jashtë, te një qëllim a *interes* tjetër.

Të përmendim së fundi fjalët e Nietzsche-s të cilat Heidegger-i i vë në epigrafin për vëllimin e parë të librit të *Nietzsche*:

*Jeta...më misterioze - duke filluar nga dita ku çliruesja e madhe erdhi mbi mua, mendimi se kishim mundësinë ta shohim në jetë një eksperimentim të njohjes.*

*Dija e gëzuar*, libri IV, 324 (1880). Kjo fjali shpreh, sipas Heidegger-it, përvojën vendimtare të të menduarit të tij.

<sup>77</sup> Po aty, f. 108.

## DISA REFLEKSIONE TË NIETZSCHE-S MBI ARTIN NË TEKSTE TË TJERA

Tani do t'i marrim në shqyrtim disa mendime të Nietzsche-s mbi artin nga disa tekste të tij të tjera nga ato që Heidegger-i i trajton në dy vëllimet e librit të tij mbi Nietzsche-n.

Do cekja në fillim se stili i të menduarit të Nietzsche-s lexohet mirë në tekstet e tij: të menduarit poetik, një lidhmëri e mbrytje e ngushtë e koncepteve me imazhe, me imagjinaren; të menduarit poetik jo thjesht si gërshetim i këtyre të dyjave po edhe në kuptimin burimor të termit «poiesis» krijues; shkrimi letrar dhe shkrimi filozofik; ndryshe nga mendimet filozofike të zhvilluara brenda sistemeve të mëdha filozofike, si ai i Hegelit fjala vjen, Nietzsche e sajon librin e vet kryesisht me fragmente thuajse kishte kërkuar qëllimisht t'i kundërvihet strukturës madhështore sistemike. Mirëpo këto fragmente janë tejet të dendura me mendime të holla e të thelluara, që kapin aspekte të ndryshme të një problemi, anë të ndryshme të temave filozofike. Pastaj, ndryshe nga shkrimi filozofik i Kantit, te shkrimi i Nietzsche-s vështirë mund të bëhet një prerje midis filozofisë, letërsisë e psikologjisë njëkohësisht. Të menduarit e Nietzsche-s është cilësuar shpesh si të menduar poetik jo vetëm pse në shkrimin e tij hasim rregullisht një gërshetim të dendur midis koncepteve thellësisht të elaboruara dhe kritike ndaj konceptioneve tjera, po me imazhe e figura stilistike (metafora, alegori etj.), që janë më karakteristike për shkrimet letrare e poetike në veçanti. Domethënia e poetikes brenda «fragmenteve» filozofike të Nietzsche-s nuk reduktohet në këtë gërshetim e mbrytje të mendimit filozofik me imazhe të begatshme dhe një imagjinare artistike, por edhe me momentin që bashkon filozofinë me letërsinë, domethënia burimore e konceptit *poiesis*: ajo që vjen nga filozofia antike greke. (Në *Metafilozofinë* e Henri Lefebvre-it, *poiesis* dhe lidhjet e tij me praxisin në filozofinë e artin grek; *poiesis* që shpreh dimensionin krijues, prodhimin krijues. Ndarja e moçme e Aristotelit midis filozofisë teorike (çështjet metafizike), filozofisë praktike (etika dhe politika) dhe filozofia *poetike* që merret me krijimtarinë. Disa autorë e theksuan anën poetike të të menduarit të Nietzsche-s kryesisht në veprën e tij *Kështu fliste Zarathoustra*; Heidegger-i ndërkaq mendon se vepra e tij e papërfunduar *Vullneti për fuqi*, si vepër kapitale, është po aq konceptuale sa edhe poetike, dhe jo vetëm në fragmentet ku bëhet fjalë për artin. Ai shton njëherazi se *Kështu fliste Zarathoustra* është sa poetike aq edhe konceptuale. Pra,

Heidegger-in si disa interpret të tjerë të mendimit të Nietzsches kanë cekur lidhmërinë e ngushtë midisi të menduarit konceptual dhe shprehjes poetike e artistike të shkrimeve të tij. Do të përkujtoja lidhur me këtë atë që Goethe thot për stilin e të shkruarit të Diderot-së, mund të vlejë edhe më shumë për atë të Nietzsche-s: «Cfarë koherence në këtë dialog! Gjithçka është e lidhur këtu me një gjerdan të padukshëm e megjithatë real... ; një gjerdan i çelniktë të cilin e mbulon para syve tonë një kurorë lulesh».<sup>78</sup>

Se nocioni i artit te Nietzsche s'ka të bëjë vetëm me artet e bukura shihet edhe nga një fragment i parathënies së tij për librin *Agimi* (1886), ku ai flet për «filologjinë si art i çmuar». Në epigrafin e kësaj parathënie Nietzsche citon një thënie nga «Rigveda» indase: «Ka aq shumë agime që ende nuk kanë lindur». Nietzsche edhe në këtë vepër afirmon një konceptcion që shpjegon njeriun dhe historinë me kategorinë e krijimtarisë së asaj që *ende nuk ekziston*, që *ende nuk është bërë e sajuar*. Këtë libër ai e cilëson si një libër, i cili nga adhuruesit e vet kërkon para së gjithash një gjë: «të bëhen të durueshëm, t'i kushtojnë kohë, - një art ky i argjendarisë dhe një dije prej argjendarisë që i kushtohet *fjalës*, një art që kërkon një punë subtile dhe të kujdesshme dhe i cili nuk arrin asgjë nëse nuk bëhet me ngadalë, *lento*».

Në parathënien e botimit të dytë të veprës së tij *Dija e gëzuar* (1886) shfaqet një aspekt tjetër i nocionit të Nietzsche-s mbi artin. Këtu ai flet për filozofinë si «art i transfigurimit», duke pohuar se filozofi transponon çdo herë «brenda formës më të largët spirituale». Të menduarit filozofik si art transformohet në forma të ndryshme edhe sipas gjendjeve të ndryshme nëpër të cilat kalon filozofi, përfshirë edhe krizat e shëndetit të tij.<sup>79</sup> Për ta cilësuar këtë art të transfigurimit në krijimtarinë filozofike, Nietzsche e sheh të udhës të përkujtojë se ai që e realizon këtë *art të transfigurimit* nuk është qenie e përbërë vetëm nga mendja, fryma e shpirti, por qenie e përbërë nga trupi dhe shpirti, trupi dhe fryma. Mirëpo, ndryshe nga metafizika tradicionale, e sidomos nga platonizmi dhe teologjia, trupi dhe mendja (fryma) nuk janë dy *botëra të ndara* e të kundërvëna, ngase ato gërshetohen ngushtazi. Kësisoj aktet e krijimtarisë nuk mund të kuptohen në mënyrë të mirëfillt nëse nuk e marrin parasysh këtë *ndërlidhje* që merr forma të ndryshme midis trupores dhe shqisores me mendoren. «Ne nuk jemi bretkoca që mendojnë, shkruan Nietzsche këtu, ne nuk jemi

<sup>78</sup> Charly Guyot, *Diderot par lui-même*, Seuil, Paris, 1959, f. 78.

<sup>79</sup> Nietzsche, *Oeuvres*, II, Robert Lafont, Paris, 1993, f. 30.



aparate objektive dhe regjistruet me organe të brendshme në frigorifer...». Pra, të menduarit nuk është një proces «i pastër» që del nga fryma, e cila supozohej të jetë e ndarë nga truporja. Prandaj për Nietzsche akti i të menduarit, akti i prodhimit të mendimeve nuk del nga një «substancë» frymore rrënjësisht e ndryshme nga trupi dhe truporja, ngase «– ne duhet vazhdimisht t'i lindim mendimet tona brenda dhimbjes dhe t'u japim amësisht atë që kemi brenda nesh gjakun, zemrën, afshin, gëzimin, pasionin, shqetësimet (mundimet), vetëdijen, fatin, fatalitetin». Kësodore, në vend të një prerje midis mendimeve dhe trupit të njeriut, Nietzsche cek se mendimet s'mund të lindin nëse ne nuk u japim atyre atë që kemi brenda nesh. E në këtë *brendësi* Nietzsche sheh ngushtësisht të lidhura sa gjakun dhe afshin, po aq edhe gëzimin e pasionin, sikundër edhe vetëdijen. Madje këtë lidhmëri e gërshetim Nietzsche nuk e vë në pah vetëm në krijimtarinë e mendimeve filozofike, por edhe «në të kuptuarit e jetës si me qartësinë zjarrin që ka në vete dhe po kështu gjithë atë që na prekë».<sup>80</sup>

Meqë Nietzsche e cilëson estetikën edhe me nocionin e “fiziologjisë”, kjo nënkupton sipas Heidegger-it, siç teksuam më sipër, se duhet kërkuar *burimet* e gjendjeve afektive, të kundruara si thjesht psikike, brenda “gjendjeve trupore që u përgjigjen”. Kësisoj Heidegger-i vë në pah një pikëshikim mbi tërësinë dhe unitetin e pandashëm fiziko-psikik, pra të trupit dhe shpirtit, përkatësisht “të gjallës e cila del këtu e përkufizuar si fushë e gjendjeve estetike, si “natyrë” e gjallë e njeriut”.<sup>81</sup>

Së këndejmi «arti i transfigurimit» nuk është vetëm një prirje krijuese e veçantë, por ai cilëson jetën si «transformim i përhershëm i gjithë asaj që ne jemi». Megjithkëtë, jeta nuk është thjesht një proces natyror e i natyrshëm, prandaj filozofët duhet «të zbresin në thellësitë e tyre të fundit», e kjo nënkupton një aktivitet krijues. Kthimi nga këto humnera pas përvojave zbuluese bën që krijuesi të jetë më i thellë. Ai kritikon ata që nën presionin e dhimbjeve dhe dyshimeve ikin në ndonjë “hiç oriental”, “nirvana”, në rezignimin e heshtur, të ngurtë dhe të shurdhër, në harresën dhe braktisjen e vetes sonë». Këtu ai kritikon sa shtegdaljen që kishte gjetur Shopenhauer-i në budizëm, por aq edhe ata autorë që brenda teologjisë së krishterë kultivojnë heqjen dhe përbuzjen e *vetes*, e cila për këta ishte burim i veseve dhe vetmashtimit.<sup>82</sup> Nietzsche në njërën anë afirmon kompleksitetin e

<sup>80</sup> Po aty.

<sup>81</sup> Po aty, f. 92.

<sup>82</sup> Po aty, f. 31.

çështjes së jetës, duke vënë në pah se «vetë jeta është bërë problem», por nuk e zgjedh udhën e nihilizmit, as atë të Schopenhauer-it e as atë të kulturës orientale, e në anën tjetër kultivon në faqet e kësaj vepre një dashuri të re për jetën dhe një «lumturi të re...»<sup>83</sup>

Nietzsche thekson më tutje se nga përvojat e zbritjes në humnera të thella mund «të kthehemi të ripërtërirë», pastaj se duhet kultivuar të menduarit kritik, “*vullnetin* për të persiatuar tani e tutje mbi çështje të reja, me më shumë thellësi, rreptësi, ashpërsi, me keqdashësi dhe me heshtje”, me «një shije më subtile për gëzimin», shije kjo e ndryshme nga llomotitja e zhurmshme mbi kënaqësitë spirituale boshe për artin, librin dhe muzikën». Ndryshe nga “çrregullimi i artit romantik”, Nietzsche do të vlerësojë dhe kultivojë “një art tjetër, një art ironik, të lehtë, fluid, hyjnisht i qetë, hyjnisht artificial, një art që shpërthen si një flakë e kthjelltë në një qiell pa rre! Para së gjithash një art për artistët, vetëm për artistët».<sup>84</sup> Frymëzimin për këtë botkuptim të artit Nietzsche e sajoi sidomos nga hulumtimet mbi filozofinë dhe artin antik grek: ata grekë që kishin guxim të kultivojnë thellësinë nëpërmjet «sipërfaqësisë» së aparençave që adhuronin «dukjen, format, tingujt, fjalët e gjithë atij Olimpi të aparençës», ndryshe nga bota e përtejme e platonizmit dhe teologjisë së krishterë që përbuzin veten e njeriut dhe vlerat e botës tokësore. «Ata grekë, shton Nietzsche, ishin të sipërfaqshëm – *me thellësinë* që kishin. Dhe a nuk kthehemi ne, theqafët e frymës (mendjes), që jemi ngjitur te maja më e lartë dhe më e rrezikshme e ideve të sotshme, në mënyrë që prej atje të mund të shohim përreth, të shohim *poshtë*? A nuk jemi ne pikërisht për këtë arsye grekë? Adhuresë të formave, të tingujve, të fjalëve? Për këtë arsye – artistë!”<sup>85</sup> Nietzsche zhvillon këtu një koncepton të artit që është i kundërt me pikëpamjen e të vërtetës platoniste e teologjike.

Në fragmentin *Iluzioni i soditësve* (301), në librin *Dija e gëzuar*, Nietzsche problematizon pikëpamjen e cila e kupton *soditjen* e botës, natyrës dhe vetes së njeriut si një veprim *pasiv*. Ai thekson se dallimi midis njerëzve, përkrah aftësitë e tyre, bën që disa «shohin dhe dëgjojnë pafundësisht më tepër, e ata shohin dhe dëgjojnë vetëm duke medituar – e pikërisht kjo e bën të dallohet njeriu nga kafsha dhe kafsha superiore prej asaj inferiore». Së këndejmi, soditja dhe meditimi, ngase nuk janë shprehje e një qëndrimi pasiv ndaj botës dhe

<sup>83</sup> Po aty.

<sup>84</sup> Po aty, f. 32.

<sup>85</sup> Po aty, f. 32.

fenomeneve të saj, të medituarit i bën të mundur që njeriu të shohë dhe të dëgjojë «pafundësisht më tepër» dhe mu këtu, sipas Nietzsche-s, qëndron dallimi jo vetëm midis njeriut dhe kafshës, por edhe midis atyre njerëzve që i ikin meditimit, ngase e shikojnë si djerrim, pra si humbje kohe, dhe atyre që e kultivojnë meditimin ose përsiatjen. Për ta saktësuar pikëpamjen e vet mbi soditjen (meditimin), Nietzsche saktëson se bota bëhet gjithnjë e më e begatshme «për njeriun që ngritet në lartësinë e njerëzisë, interesimi i tij zgjohet nga ngashnjime gjithnjë e më të shpeshta» kurse me rritjen e këtyre ngashnjimeve «rriten në të njëjtën përmasë kategoritë e tij të kënaqësisë dhe ato të pakënaqësisë» sikurse edhe lumturia apo palumturia e tij.

Tani, mu në këtë nivel të analizës së tij, Nietzsche shtron vërejtjen e vet kritike ndaj iluzionit i cili e shoqëron njeriun që sodit ose mediton: «Ai beson se është i vendosur si *shikues* dhe si *dëgjues* përballë një spektakli dhe përballë një koncerti të madh që është jeta» ose si «një mysafir i vendosur *përballë* skenës». Iluzioni i njeriut që soditë, sikurse edhe i atyre që i ikin soditjes, ngase e shikojnë si punë të kotë», për Nietzsche-n qëndron aty se duke e cilësuar natyrën e vet si *soditëse* «ai nuk e dikton se është vetë poet i vërtetë dhe krijues i jetës». Vlerën e soditjes apo meditimit Nietzsche e vë në pah në mënyrë më të theksuar duke ia kundërvënë «të ashtuquajturin njeri i aksionit». Dallimin midis «njeriut soditës» dhe «njeriut të aksionit» Nietzsche e vë në dukje edhe kur thotë se i pari posedon «duke qenë poet, *jetën kontemplative* (*vis contemplativa*) dhe veprimin mbi veprën e vet, por njëherazi dhe para së gjithash, *jetën krijuese* (*vis creativa*) e cila i mungon njeriut të aksionit, pavarësisht nga ajo që thotë opinioni i rëndomtë». Tani Nietzsche e nxjerr në shesh edhe më qartë se çka është në të vërtetë veprimi ose aksioni i mirëfilltë: **«Ne që meditojmë dhe ndjejmë, ne jemi ata që bëjnë realisht dhe pandërprerë diçka që nuk ekziston ende: gjithë kjo botë që shkon duke u rritur, e ngjyrave, e vlerësimeve, e perspektivave, e shkallëve, e pohimeve dhe mohimeve. Kjo poemë e zbuluar prej nesh është vazhdimisht e mësuar, e ushtruar, e përsëritur, e përkthyer në mish dhe në realitet, po edhe në vetë jetën e përditshme, nga vetë aktorët tanë, ata që i quajnë njerëz praktikë. Gjithë ajo që ka ndonjë vlerë në botën aktuale nuk ka vlerë nga vetvetja, sipas natyrës së saj, - natyra është gjithmonë e pavlerë: - një ditë ia kemi dhënë dhe atribuar një vlerë, dhe ne jemi donatorët, atribuesit! Vetëm ne jemi ata që kemi krijuar botën e cila i intereson njeriut!- (nënvizimi është i yni)»**. Nëse krijuesit në fushën e filozofisë ose

arteve të bukura nuk e zhvillojnë qartazi këtë nocion, i cili nxjerr në suprinë veçorinë e të bërit dhe veprimt të mirëfilltë, atëherë ata, shton Nietzsche, kësisoj injorojnë «forcën e tyre më të mirë».<sup>86</sup>

Për dallim nga *paragjykimi* se meditimi shpreh një qëndrim pasiv të njeriut ndaj botës, Nietzsche mendon se duke medituar dhe duke përjetuar e ndjerë njeriu *bën* diçka të re, që nuk ka ekzistuar më parë, ngase sjell në botë nëpërmjet krijimtarisë filozofike apo artistike mënyra të reja të vështrimit dhe përjetimit të vetes, të ngjarjeve dhe dukurive të ndryshme të natyrës. Kjo krijimtari *bën* që bota të «rritet», përkatësisht të *begatohet* me perceptime të reja, me ngjyra të reja («kjo poemë e zbuluar prej nesh»), me vlerësime dhe pohime e mohime të reja mbi fenomene të ndryshme të botës. Nietzsche shpjegon në mënyrë të thellë se gjithë ajo që ka ndonjë *vlerë* në botë dhe në natyrë, e mer këtë vlerë jo natyrshëm, vetvetiu, nga natyra e gjësëndeve faktike, ashtu si ato janë, por nga aktet krijuese të njeriut me të cilat ai *sjell* diçka të re në këtë botë, trajta e ngjyra të reja, mënyra të reja të mendimit dhe përjetimit, pikëshikime dhe raporte të tjera të njeriut ndaj vetes dhe të tjerëve brenda botës e natyrës në të cilën jeton.

Në fragmentin me titull “Koha e krahasimit”, në vëllimin e parë të librit *Njerëzore, tepër njerëzore* Nietzsche vë pah se begatimi i të gjitha stileve të artit, sikurse edhe i llojeve të ndryshme të moralit, të zakoneve të qytetërimit mund të realizohet e zhvillohet nëse krijohen kushte për *krahasimin* dhe ndërveprimin e tyre. Ndryshe nga qytetërimet tradicionale, të cilat sikurse edhe stilet e llojit të tyre artistik ishin të lokalizuara në një kohë dhe vend, më vonë në epokën bashkëkohore, saktëson Nietzsche, në të sotmen është krijuar mundësia e krahasimit dhe ndërveprimt të rrymave të ndryshme artistike, të trajtave të ndryshme të moralit e qytetërimit. Epoka e tashme “nxjerr domethënien e vet nga fakti se brenda saj botkuptime të ndryshme, zakone e qytetërimi mund të krahasohen dhe të përjetohen njëra pran tjetrës; ajo që dikur, përgjatë sundimit gjithëherë të lokalizuar të çdo qytetërimi nuk ishte e mundshme për shkak të

<sup>86</sup> Nietzsche, *Le gai savoir*, f.179-80. Në veprën e shquar të filozofit francez Gilles Deleuze Nietzsche dhe filozofia (*Nietzsche et la philosophie*, Paris, 1962) tematizohen në veçanti anë dhe akte të ndryshme të krijimtarisë, «fusha të forcave dhe vullneteve të polarizuara që cilësojnë mënyrat e të jetuarit dhe të mendurait» të njerëzve. Ndryshe nga autorët që në filozofinë e Nietzsche-s mbi vlerat kanë parë një qëndrim «shkatërrues», Deleuze vë në pah *aspektin krijues të kritikës* së tij të disa fenomeneve në fushën e kulturës dhe artit.

lidhjes së të gjitha llojeve të stilit artistik me një vend dhe një kohë”. Kësodore, sot “një rritje e ndjenjës estetike do të vendosë përfundimisht midis aq shumë formave që i ofrohen krahasimit”. Në këtë kontekst të ballafaqimit dhe ndërveprimit të llojeve të ndryshme të stilit artistik, sikurse edhe formave të ndryshme të koncepcioneve morale, del se do të mund të mbahen ato që kanë në vete më shumë forcë krijuese.<sup>87</sup>

## DEHJA SI GJENDJE ESTETIKE

Dehja si gjendje estetike ku mbinë arti te Nietzsche s’ka të bëjë fare me disa forma të «dehjes» të cilat ai i kritikon në fragmentin «Besimi në dehje»: «Njerëzit që kanë përjetuar çaste të një kënaqësie sublime, dhe të cilët në kohëra të rëndomta, për shkak të kontrastit dhe shpërndarjes së skajshme të forcave të tyre nervore, e ndjejnë veten të mjerueshëm dhe të dëshpëruar thellësisht, i shikojnë ato çaste si manifestim i mirëfilltë i vetes së tyre, i “unit” të tyre, ndërkaq mjerimin dhe dëshpërimin e thellë *si rrjedhojë e “asaj që është e jashtme”*; prandaj ata ushqejnë ndjenja hakmarrëse për rrethin e tyre, epokën e tyre, botën e tyre në tërësi; gjetiu ata i shohin kundërshtarët dhe ata që pengojnë dehjen e çfarëdo lloji që të jetë dehja qoftë spirituale, morale, religjioze apo artistike. Një pjesë e mirë e fatkeqësive të njerëzimit i takon këtyre të dehurve të egzaltuar: mbasi që ata mbjellin përherë barishta të pakënaqësisë ndaj vetes dhe të tjerëve, përhapin përbuzjen e epokës dhe të botës e sidomos raskapitjen e botës. Ndoshta një ferr i tërë i *kriminelëve* nuk do t’ia dilte të prodhojë shumë efekte të tilla të dëmshme, të rëndë dhe ngulfatës që e prishin tokën dhe ajrin dhe që janë tipar i asaj bashkësie të vogël dhe bujare e qenieve të shfrenuara, të çoroditur dhe gjysmë të marrë, të gjenive që nuk dijnë ta përmbajnë veten dhe që nuk arrijnë të përmbushin të gjitha kënaqjet e vetes së tyre veçse nëse humben plotësisht [...]».<sup>88</sup> Ndryshe nga dehja si gjendje estetike si atmosferë brenda së cilës lulëzojnë vepra të çmuara e sublime nga fusha e arteve të bukura apo nga filozofia, dehja e të «dehurve të ekzaltuar» ushqen dhe nxit dëshpërimin dhe pakënaqësinë ndaj vetes, epokës dhe botës në të cilën jetojnë të dehur që në vend se të krijojnë diçka të vlefshme, prodhojnë efekte ngulfatëse, «prishin tokën dhe ajrin».

<sup>87</sup> Nietzsche, *Oeuvres*, I, f. 456.

<sup>88</sup> Nietzsche, *Oeuvres*, I, f. 999-1000.

Në mënyrë të ngjashme ai kritikon në fragmentin “Besimi në frymëzim”(155) edhe prirjen e disa artistëve që t’u besojnë «intuicioneve të befta, të ashtuquajturave frymëzime»: «...thujse ideja e veprës artistike, e poemës, mendimi themelor i një filozofie, bie nga qielli sikur të ishte një rreze hiri. Në fakt imagjinata e një artisti të mirë apo e një mendimtari të mirë prodhon vazhdimisht gjëra të mira, mediokre dhe të këqija, por *gjykimi* i tij jashtzakonisht i mprehur, i ushtruar, hudh, zgjedh, kombinon; kësisoj sot e kuptojmë, në saje të shënimeve të Beethoven-it, se si i ka komponuar pak nga pak meloditë e tij më të mrekullueshme dhe disi i ka përzgjedhur nga skicat e shumëfishta [...] Të gjithë njerëzit e mëdhenj janë punëtorë të mëdhenj, të palodhshëm jo vetëm në zbulim, por edhe kur hedhin, shoshitin, modifikojnë e aranzhojnë”.<sup>89</sup>

Edhe këtu refleksioni i Nietzsche-s mbi artin bashkon krijimtarinë në fushën e arteve të bukura, në poezi me atë në lëmin e filozofisë.

Një shembull tjetër ku gërshetohen ngushtazi refleksionet e Nietzsches mbi etikën me ato mbi artet e bukura, sikurse edhe ato mbi artin e qeverisjes në politikë, e ku njëherazi krijimtaria nuk shpjegohet as me një frymëzim të beftë e as me dehje të ekzaltuar, por me një proces të ndërlikuar që nënkupton kërkime të thella e afatgjata, e gjejmë në një fragment të librit të tij *Përtej së mirës dhe së keqes (fr.188)*, ku ai shkruan: «Ajo që është thelbësore, në çdo moral, ajo që përbën vlerën e saj të paçmueshme qëndron aty se ai është një shtrëngesë me kohëzgjatje të madhe; për ta kuptuar stoicizmin, Port-Royal apo puritanizmin është mirë ta kemi parasysh se gjithmonë pikërisht në saje të shtrëngesës që, fjala vjen, një gjuhë arrin të fitojë lirinë dhe forcën e vet: shtrëngesa metrike, tirania e rimës dhe e ritmit. Sa punë të mundimshe kanë bërë poetët dhe oratorët e të gjitha vendeve! Pa i harruar disa prozatorë veshi i të cilëve është një gjykatës i rreptë. - Gjithë këto «për një absurditet», siç thonë utilitaristët trashanikë, që kanë përshtypje se kështu bëjnë një vërejtje inteligjente; të gjitha këto për hir të «servilitetit ndaj ligjeve arbitrare», siç thonë anarkistët të cilët e mashtrojnë kësisoj veten se janë «të lirë», e madje mendimtarë të lirë. Në fakt sado e çuditshme që kjo mund të duket, gjithë ajo që është dhe gjithë ajo që mbi tokë ka pasur liri, subtilitet, guxim, vallëzim dhe siguri mjeshtërore qoftë në mendimin, në artin e qeverisjes, në të folurit dhe të bindurit, në arte apo në zakone s’është

<sup>89</sup> Nietzsche, *Œuvres*, I, f. 530.

zhvilluar ndryshe veçse në saje të tiranisë së këtyre «ligjeve arbitrare»; dhe thënë me seriozitetin më të madh, sipas të gjitha gjasave, mu aty gjenden «natyra» dhe «e natyrshmja» e jo në formulën «le të shkojë» (*laisser aller*)! Çdo artist e di nga përvoja e vet sa shumë larg është gjendja e tij më e natyrshme nga qëndrimi «le të shkojë» («laisser aller»), atëherë kur, me liri të plotë, në çastet e frymëzimit ai urdhëron, rregullon, ndërton dhe sajton – me çfarë rreptësie të përpiktë ai i nënshtrohet atëherë mijëra ligjeve rebele ndaj çfarëdo definicioni pikërisht për shkak të rigorozitetit dhe saktësisë së tyre (ndërkaq konceptet më të qëndrueshme në krahasim me ato janë diçka e paqartë, komplekse dhe ekuivoke). Thelbësorja, «mbi tokë sikurse edhe në qiell» duket të jetë, ta përsërisim këtë, *të bindem* një kohë të gjatë dhe në një drejtim të vetëm: kjo shpie pas një kohe të gjatë dhe gjithmonë te ajo që bën që jeta të vlejë të jetohet: te virtyti, te arti, muzika, vallëzimi, arsyeja, spiritualiteti, te diçka që transfiguron, te diçka e rafinuar, e çmendur, hyjnore». <sup>90</sup>

Të veçojmë nga ky tekst pikëpamjen e Nietzsche-s se «natyra» dhe e «natyrshmja» e mirëfilltë nuk nënkupton ndonjë spontanitet të lirshëm, që rrjedh vetiu, ngase format e ndryshme të aktiviteteve të njeriut (mendimi, arti i qeverisjes...) bëhen apo formësohen nëpërmjet shtrëngesave («ligjeve arbitrare»), përkatësisht një mundim krijues që ka në vete rregulla të disiplinës. Rima e mirë del nga «një tirani» e kërkimit dhe kjo është rruga nëpër të cilën poeti arrin të fitojë «lirinë dhe forcën e vet». Ajo që në kërkimin e poetit apo muzikantit për utilitaristët trashanik është vetëm *servilitet* ndaj «ligjeve arbitrare» të këtyre «disiplinave», për Nietzsche-n në këtë tekst është veprimtari krijuese sa komplekse, aq edhe e mundimshme; veprimtari e cila *bëhet e natyrshme* për artistin pikërisht përmes një *gjurmimi rigoroz* i cili shpie te të qenmit e lirë të tij. Zbulimi dhe sajimi pas një rrugëtimi të gjatë i gjithë asaj që bën «që jeta vlen të jetohet» (arti, arsyeja, spiritualiteti...) kalon përmes një «rreptësie të përpiktë».

Kjo pikëpamje është shumë e ndryshme nga ajo që Nietzsche zhvillon në shkrimet e hershme të tij mbi vrullin krijues që buron nga *parimi dionisian dhe* nga dehja dionisiane.

Një refleksion tjetër mbi *shtrëngesat* e ashpra që autorët dramatik, por edhe ata në fusha të tjera të arteve (muzikës, fjala vjen) i kanë imponuar vetes, janë dëshmuar si të domosdoshme në krijimtarinë artistike. Edhe ky fragment me titull «Revolucioni në

<sup>90</sup> Nietzsche, *Œuvres*, I, f. 633.

poezi» në librin *Njerëzore, tepër njerëzore I*, si edhe dy të mëparshmit, i takojnë kaptinës «Mbi shpirtin e artistëve dhe shkrimtarëve»:

«Shtrëngesa e ashpër që autorët dramatikë francezë ia impononin vetes në raport ndaj unitetit të aksionit, të vendit dhe të kohës, strukturës së stilit, vargut dhe fjalisë, përzgjedhjes së fjalëve dhe mendimeve ishte një shkollë po aq e rëndësishme sa edhe ajo e kontrapunktit dhe fugës në zhvillimin e muzikës moderne apo se figurat si Gorgias në elokuencën greke. T'i imponosh kësioj vetes shtrëngesa mund të duket absurde; megjithkëtë, nuk ka mënyrë tjetër për të dalur nga natyralizmi veçse të fillosh ta kufizosh veten në mënyrën më të fortë (ndoshta më arbitrare). Kësioj mëson pak nga pak për të ecur me hir madje edhe nëpër udhë të ngushta që kalojnë si ura përbi gremina tmerruese dhe arrinë kësioj të përvetësosh elasticitetin e skajshëm të lëvizjes: këtë e dëshmon historia e muzikës para syve të çdo njeriu bashkëkohor. Mu aty shihet se si hap pas hapi lidhjet bëhen më të shtendosura, përderisa më në fund ato duket se janë flakur në tërësi: kjo *dukje* është rezultati më i lartë i një evolucioni të domosdoshëm në art. »<sup>91</sup>

Me «natyralizëm» Nietzsche nënkupton këtu supozimin se krijimtaria në artin dramatik apo në muzikën moderne zhvillohet disi «natyrshëm», vetvetiu, ose me frymëzime të çastit. Së këndejmi, e vetmja rrugëdalje nga kjo qasje naive për Nietzsche-n çilet në saje të «shtrëngesave» të cilat nuk janë absurde, ngase bëjnë që krijuesi në këto arte të mësojë si të ecën «me hir edhe nëpër udhë të ngushta që kalojnë si ura përbi gremina tmerruese, dhe arrinë kësioj të përvetësojë elasticitetin e skajshëm të lëvizjes». Me këto imazhe Nietzsche vijëzon sa rigorozitetin, aq edhe ndërlikueshmërinë e procesit krijues, sa në artin dramatik edhe në atë të muzikës se si rigoroziteti i aktit krijues shpie te *shtendosja* e lidhjeve shtrënguese brenda veprës artistike, shtendosje kjo që bën që vepra e realizuar të mos mbajë më «dukjen» e karakterit detyrues, duke përvetësuar «elasticitetin e skajshëm të lëvizjes».

Në një fragment të librit *Njerëzore, tepër njerëzore I*, «Libri pothuajse si njeri», Nietzsche shkruan për *trajektorët* që kalon një libër në hapësirë dhe kohë pasi autori i tij ta ketë përfunduar punën në sajimin e tij. Ai libër do «të përnde të ekzistencën» e lexuesve të vet, do «të jetojë» në rrugëtimin e tij si «një qenie e pajisur me mendje dhe

<sup>91</sup> Nietzsche, *Oeuvres*, I, f. 555.



me shpirt». Rigoroziteti i mendimit të zhvilluar shoqërohet këtu me një imagjinare të begatshme të Nietzsche-s për udhëtimin e librit, i cili në atë udhëtim do të nxisë te lexuesit emocione e ide, do t'i cysë ata në veprime.

«Për çdo autor është si një befasi gjithëherë e re që libri i tij, porsa të jetë ndarë prej tij, vazhdon të jetojë vetë me jetën e vet të veçantë; ai ka përshtypjen të cilën do ta kishte edhe një insekt, një pjesë e të cilit është shkëputur për të shkuar tani e tutje rrugës së vet. Ai ndoshta do ta harrojë tërësisht atë, ndoshta do të ngritet përmbi konceptonet që i ka zhvilluar aty, ndoshta ai nuk do ta kuptojë më atë dhe ndoshta do t'i humbasë krahët e vet me të cilët kishte fluturuar duke e koncipuar këtë libër: megjithatë libri do të kërkojë lexues, do të përdezhë ekzistencën e tyre, do të japë lumturi, frikë, do të nxisë shkrimin e veprave të reja te të tjerët, do të bëhet shpirt i parimeve dhe aksioneve – shkurt: ai jeton, e megjithkëtë ai nuk është njeri».<sup>92</sup>

Ndërkaq, autori i librit nxjerr megjithatë shpërblimin «më të lumtur» kur bëhet i moshuar, ngase vazhdon ta vështrojë në atë libër «gjithë idetë dhe ndjenjat krijuese që i kishte në vete, përforcuese, që strukturojnë e ndriçojnë, jetojnë ende brenda atyre veprave të veta dhe ndonëse ai më nuk është veçse hi i përhimtë, përderisa zjarri është ruajtur dhe përhapur gjithandej». Shikimi i Nietzsche-s në vazhdim të këtij fragmenti zgjerohet jo vetëm te efektet që prodhon një libër mbi imagjinatën dhe të menduarit e lexuesve, por edhe mbi lëvizjet të cilat pasi të jenë aktivizuar një herë, vazhdojnë të jenë «të pranishme në një rrjetë totale të gjithë qeniesimit, sikurse një insekt në qelibar, i mbyllur dhe i përjetësuar». Në fragmentin vijues me titull «Gëzimi në pleqëri» Nietzsche përvijon një refleksion mbi raportin e mendimtarit apo artistit ndaj veprave të veta: “Mendimtari e poashtu edhe artisti, i cili i ka vënë në siguri pjesën më të mirë të vetvetes në veprat e veta, e ndjen një kënaqësi gati malinje kur e sheh se si trupi dhe mendja e tij janë thyer nga koha dhe janë shkatërruar dalëngadalë, thuajse shikon nga një skaj hajnin i cili e hallakat kasafortën, duke e ditur ai se kasaforta është e zbrazët dhe se të gjithë thesaret e tij janë shpëtuar”.<sup>93</sup>

Në fund të përmendim fragmentin «Njeriu komedian i gjithësisë» nga libri *Njerëzore, tepër njerëzore II*, ku Nietzsche zhvillon një kritikë të antropocentrizmit, i cili e shikon njeriun si strumbullar i gjithçkaje, duke harruar se ai është pjesë e një gjithësie

<sup>92</sup> Nietzsche, I, *Oeuvres*, 1993, f. 548.

<sup>93</sup> Po aty, f. 549.

të pafundme. Ndonëse Nietzsche afirmoi veçantinë dhe specificitetin e njeriut, të aftësive dhe të arteve të tij në mënyrë të thellë e origjinale si rrallë ndonjë filozof tjetër, ai *njëherazi* e kundronte njeriun dhe botën njerëzore brenda një horizonti të gjerë mbi universin e shumëllojshëm dhe të pakufishëm. Në fragmentin *Njeriu komedian i gjithësisë*, Nietzsche me një ironi subtile e vë në pah kufizimin e pikëshikimit antropocentrik dhe iluzionet e tij, si fjala vjen pretendimi se ai është «qëllim i fundit i gjithësisë»<sup>94</sup> Këtu mund të diktojmë pikëvrojtimin te i cili Nietzsche ngritet duke vrotuar njeriun si njera nga qeniet e shumta brenda gjithësisë së paskajshme si në kohë po ashtu edhe në hapësirë:

«Do të duhej të kishte qenie më spirituale se ç'është njeriu, veç sa për të shijuar thellë humorin i cili shfaqet në pikëshikimin që ka njeriu për veten si qëllim i fundit i gjithësisë, dhe se njerëzimi deklaroi me seriozitet se nuk kënaqet me më pak se perspektiva e një misoni universal. Nëse një Zot e ka krijuar botën, ai e ka krijuar njeriun që të jetë *majmuni i Zotit*, si një temë e përhershme e zbatimjes së tij përgjatë përjetësive të tij ndopak shumë të gjata. Muzika e sferave<sup>95</sup> rreth tokës do të mund të ishte atëherë të qeshurit tallës i të gjitha krijesave përrreth njeriut. Dhimbja i *shërben* atij të përjetshmit që mërzhitet për ta xigluar kafshën e tij të preferuar, që të kënaqet me qëndrimet e tij tragjike përplot krenari dhe shpjegimeve që i frymëzojnë vuajtjet e tij, sidomos inventiviteti intelektual i njërës nga krijesat e tij më të kota – si zbulues i këtij zbuluesi. Sepse ai që e imagjinoi njeriun sa për t'u tallur me të kishte më shumë frymë se vetë njeriu, e gjithashtu edhe kënaqësi më të madhe të frymës...»<sup>96</sup>

Të cekim se brenda pikëpamjeve filozofike të Nietzsche-s nuk ka vend për realitetin e «zotit» veçse si përfytyrim antropomorf i besimtarëve; kësaj ironia e fjalive të para shoqërohet me një sarkazëm të fortë për iluzionet që i ka prodhuar njeriu si «zbulues i zbuluesit» (përkatesisht zotit). Sarkazmi godet pretendimin se njeriu është imazh i zotit, si qenie e plotfuqishme, por thellohet me pohimin se njeriu është «majmuni i zotit», majmun me të cilin tallet qenia të cilën ai vetë e ka shpikur. Sarkazmi thellohet edhe më tej kur Nietzsche përkujton se «muzika e sferave rreth Tokës», si harmoni e

<sup>94</sup> Po aty, f. 835.

<sup>95</sup> Po at, f. 1282. Është kjo një teori me origjinë pitagoriane sipas së cilës planetet, duke u zhvendosur në distanca të ndryshme nga Toka bëjnë një muzikë të harmonishme, të cilën s'mund ta diktojë veshi njerëzor.

<sup>96</sup> Po aty.

supozuar, s'është veçse «të qeshurit tallës i të gjitha krijesave përrreth njeriut». Të qeshurin tallës e të gjitha krijesave e nxit vaniteti përplot mbufatje e njeriut «si qëllim i fundit i gjithësisë» që sikur ka «një mision universal». Kritika sarkastike e përfytyrimeve përplot mbufatje e njeriut do të gjejë mbështetje te një pikëshikim së paku realist i astronomëve që vënë në pah se «pika e jetës» në kohë është e «parëndësishme për karakterin e tërsishëm të oqeanit të pakufishëm të të ndodhurit»: «Por madje edhe kur njerëzimi ynë dëshiron ta përbuzë veten me dëshirë, vaniteti na luan edhe një dredhi, duke na shtyrë të besojmë se ne njerëzit qenkemi, së paku përmes këtij vaniteti, diçka e pakrahasueshme dhe e mrekullueshme. Ne unik në botë! Ah! gjë kjo shumë e pabesueshme! Astronomët, që shohin ndonjëherë një horizont larg tokës, lënë të kuptohet se pika e *jetës* në botë është e parëndësishme për karakterin e tërsishëm të oqeanit të pakufishëm të të ndodhurit, të lindjes dhe zhdukjes, se yjet e panumërta paraqesin kushte analoge me ato të tokës për prodhimin e jetës, se janë pra të shumtë, por ç'është e vërteta mezi një grusht në krahasim me ato të pakufishmet që kurrë nuk kanë pasur pikë të jetës ose ajo është zhdukur që moti; se jeta mbi çdonjërin nga yjet, në krahasim me kohëzgjatjen e ekzistencës së tij, ka qenë një moment, një shkëndijë e shoqëruar me periudha shumë të gjata kohore – kësaj ajo nuk është fare caku dhe qëllimi i fundit i ekzistencës së tyre».<sup>97</sup> Nga pikëvrotimi i lartë te i cili është ngritur, Nietzsche thekson, në saje të njohurive astronomike, se brenda yjeve të panumërta, ndonëse kanë «kushte analoge» me ato të tokës që kanë në vete jetë, vetëm në shumë pak prej tyre ka pasur një pikë jete ose ajo është zhdukur te ato qysh moti. Krahas ballafaqimit me pakufishmërinë *hapësinore* të gjithësisë Nietzsche sugjeron para shikimit tonë edhe pafundësinë kohore brenda së cilës fenomeni i jetës, shumë i rrallë, ka qenë vetëm një moment apo një shkëndijë e shkurtër. Duke hapur para syve tanë mundësinë që ta mendojmë e përfytyrojmë sa *paskajshmërinë hapësinore*, aq edhe atë *kohore* të trupave qiellorë, krahas rrallësisë së madhe të pikave të jetës në to, Nietzsche na shtyn të hetojmë pretenciozitetin që ka kultivuar njeriu si qëllim i parë dhe i fundit i gjithësisë. Këtë pretenciozitet ai e krahason me imagjinatën e bubreçit: «Ndoshta bubreçi në pyll imagjionon se ai është caku dhe qëllimi i ekzistencës së pyllit, sikurse që ne bëjmë kur në imagjinatën tonë i lidhim gati padashur shkatërrimin e njerëzimit me shkatërrimin e Tokës: madje në këtë rast jemi modest nuk ndalemi te Toka dhe nuk

<sup>97</sup> Po aty, f. 836.

sajojmë përfytyrimin se për të festuar varrimin e të vdekshmit të fundit e një muzgu të përgjithshëm të botës dhe zotave. Astronomi madje edhe më i çliruari nga paragjykimet nuk mund ta përfytyrojë Tokën e pajetë ndryshe veçse si një varrezë e ndriçuar dhe lundruese e njerëzimit”.<sup>98</sup> Në fjalinë e fundit shohim se prirja e njeriut për ta parë tokën me qasje antropocentrike - njeriu si qendër e gjithësisë - diktohet edhe te astronomi (shkencëtari) më i çliruar nga paragjykimet.

Muhamedin Kullashi

## HEIDEGGER SUR LA VOLONTÉ DE PUISSANCE EN TANT QU'ART

### Resume

Les analyses de Heidegger sur la philosophie de Nietzsche et notamment de son ouvrage inachevé de Nietzsche *La Volonté de puissance* vont marquer le tournant (*Kehre*) de sa pensée, dans les années 30 et 40 du siècle dernier. Nous nous sommes attaché dans cet article à examiner l'interprétation que déploie Heidegger sur le quatrième chapitre de la *Volonté de puissance* intitulé *La volonté de puissance en tant qu'art*.

En éclairant les lignes principales de la conception nietzschéenne sur l'art il vise à montrer „pourquoi une interprétation de l'embriion de la *Volonté de puissance* doit commencer justement par le thème de l'art. “La question conductrice“ de la philosophie occidentale, celle qui questionne ce que c'est que l'étant, pour Heidegger, précède la question fondamentale qui devrait s'ouvrir vers la question de l'Etre. Dans ce contexte, l'art pour Heidegger, dans un sens plus large, désigne la force créatrice qui constitue le caractère fondamental de l'étant.

Cependant que l'art dans un sens plus étroit concerne „l'activité au sein de laquelle la force créatrice se déploie à elle-même, dans sa transparence, non seulement comme une *structure* parmi d'autres mais comme la structure la plus haute de la *Volonté de puissance*“. La visée de Nietzsche vers une ré-évaluation de toutes les valeurs trouvera dans *La volonté de puissance* son fondement principal, car sa structure la plus haute est l'art. Art deviendra, à la différence de la religion, de la morale et de la philosophie traditionnelle, une référence pour la réévaluation des anciennes valeurs.

---

<sup>98</sup> Po aty, f. 836.

En interprétant la conception de Nietzsche sur l'art, Heidegger souligne notamment que l'Art constitue un mouvement authentique contre le nihilisme. Si l'élément artistique se manifeste dans l'acte de la création et de la structuration, l'activité métaphysique, d'autre part a besoin d'être déterminé par l'élément artistique.

Edi Shukriu, Prishtinë

## SI E SIGURONIN DARDANËT KRIPËN JETIKE?

### Abstrakt

Ky studim mëton ta konstatojë ekzistencën apo jo të burimeve të kripës në territorin dardan dhe rrugët e mundshme për sigurimin e kësaj substance jetike, aq më tepër që çështja e kripës dhe e sigurimit të saj nga dardanët nuk ka qenë temë e veçantë e trajtimit deri më sot. Si prodhim bazik për qëndrueshmërinë e organizmit të njeriut, të bagëtisë dhe të bimëve siguri i kripës ka qenë çështje qenësore gjatë gjithë historisë së njerëzimit, sidomos me nismën e ekonomisë bujqësore-blegtorale që nga epoka e neolitit.

Studimi sjell përfundimin se në territorin dardan nuk kishte burime të kripës dhe se dardanët ishin të detyruar ta importonin kripën, atë të detit/ujit dhe të gurit. Një prej drejtimeve kryesore të furnizimit me kripë ishte nga detit Egje, si drejtim më i volitshëm edhe në aspektin gjeomorfologjik, por dhe i dëshmuar në aspektin arkeologjik përmes prezencës së qeramikës neolitike starçeviane të Ballkanit Qendror në Greqinë e sotme. Trajtohen dhe mundësitë e furnizimit me kripë edhe përmes autariatëve në perëndim, nga Trakia në lindje dhe Dakia në verilindje. Si mjet këmbimi për kripën jetike kanë mundur të jenë burimet natyrore dhe prodhimet dardane, siç ishin rathët dardan, ari, hekuri, plumbi, mishi i derrit, djathi dardan, cinabari dardan apo klamidat dardane: *Chlamys Dardanica duplex optima* (Klamida Dardane e dyfishtë më e mirë) dhe *Chlamys Dardanica simplex optima* (Klamida Dardane e thjeshtë më e mirë).

*Fjalët çelës:* kripa, dardanët, burimet e kripës, kripa e gurit, kripa e detit.

Çështja e përdorimit të kripës dhe e sigurimit të saj nga dardanët nuk ka qenë temë e veçantë e trajtimit deri më sot, ndonëse siguri i kësaj substance ka qenë tejet jetike. Në përgjithësi siguri i kripës ka qenë çështje qenësore gjatë gjithë historisë së njerëzimit, pasi që ishte prodhimi më bazik për qëndrueshmërinë e organizmit të njeriut, të bagëtisë dhe të bimëve.<sup>1</sup> Kripa (kloruri i natriumit) përmban minerale natyrore të gjithë ujrave të trupit dhe është burim kryesor i joneve, të cilat luajnë rol kyç në proceset fiziologjike që nga rregullimi i shtypjes së gjakut e deri te veprimi i përbërjes nervore. Është kjo arsye pse

---

<sup>1</sup> Harding, A. (2013) pp. 11-13.

mendohet se fjala latine për shëndetin “salus” rrjedh nga fjala “sal” (shqip kripë).

Kripa përfitohet nga disa burime: 1. Nga uji i detit, 2. Nga ujërat e kripur natyror dhe 3. Nga depozitet e kripës së gurit. Teknikat për nxjerrjen e kripës janë: 1. Avullimi i shëllirë (Foto 1, 2) dhe 2. Nxjerrja nga minierat e kripës së gurit (Foto 3-5).<sup>2</sup>

Për nxjerren e kripës së detit nga vjeshta në pranverë bëhet riparimi i pritave prej argjile dhe kanaleve për t’i përgatitur pellgjet ku kristalizohet kripa, ndërsa veprimet e kombinuara të diellit dhe të erës i kthejnë kënetat në kripore.<sup>3</sup> Kripa e gurit nxirret nga formacionet nëntokësore dhe njihet edhe me emrin halit (greq. ἅλς).<sup>4</sup> Thuhet se kripërat më të njohura deri më sot janë kripa kelte dhe kripa e Himalajeve, sidomos ajo rozë e Himalajës, e cila njihet dhe si “ari i bardhë”.<sup>5</sup>



**Foto 1.** Kripa e detit - ujit (Fot. Chritophe Amouriaux)

<sup>2</sup> Urem-Kotsou, D. (2016) p. 128.

<sup>3</sup> U qas më 13.02.2020 në <https://wol.jw.org/am/wol/d/r41/lp-al/1020030>.

<sup>4</sup> Oilfield Glossary, U qas më 13.10. 2019 në Glossary.oilfield.slb.com.

<sup>5</sup> ENCIAN d.o.o., U qas më 7.10.2019 në <https://encian.hr/blog/nutricionisticki-kutak/5-razloga-zasto-je-himalajska-solbolja-od-kuhinjske-soli-20980>.



Foto 2. Kriporja në Pag, Kroaci<sup>6</sup>




Foto 3. Kripa e gurit<sup>7</sup> Foto 4. Kripa e gurit<sup>8</sup>

<sup>6</sup> Solana na Pagu, U qas më 6.03.2020 në <https://croatia.hr/hr-HR/Solana-na-Pagu>.





**Foto 5.** Miniera e kripës së gurit në Gjermani<sup>9</sup>

Etrurët qysh herët krijuan kriporet e tyre, ndërsa në shek. VI p.K. banorët e qytetit të Vejës luftuan kundër romakëve që të mos ua përvetësonin kriporen rreth Ostisë (Livius I 33). Përmes lumit Tibër, pas pushtimeve romake, nga toponimi i ruajtur edhe sot si *Salara vecchia* nën Aventin niste rruga më e njohur romake, që kishte për bazë transportin e kripës: *Via Salaria* (Rruga e Kripës).<sup>10</sup> Kjo rrugë dhe kriporet në Romë sipas Plutarkut kanë ekzistuar që në kohën e Romulit (Plutarch 25).

Romakët e vjetër e kanë shfrytëzuar për një kohë të gjatë kripën si mjet pagese, që kishte vlerë të njëjtë me atë të arit, siç bëhej dhe me pagën e ushtarëve (*salarium argentum*). Kështu, Plini i Vjetër pohon se në Romë rroga e ushtarëve paguhej me kripë dhe se nga kjo u krijua fjala latine *salarium* - rrogë (Plinius XXXI).<sup>11</sup>

<sup>7</sup> Rock salt, u qas më 10.10.2018 në [www.Dreamstime.com](http://www.Dreamstime.com).

<sup>8</sup> Rock salt, u qas më 9.11.2018 në [www.wieliczka-saltmine.com](http://www.wieliczka-saltmine.com).

<sup>9</sup> Rock salt in Germani, u qas më 09.11.2018 në <https://commons.wikimedia.org>.

<sup>10</sup> Zaninović, M. (2005) pp. 125-126; Harding, A. (2013) p. 38.

<sup>11</sup> Plinius, u qas më 10.01.2018 në [Penelope.uchicago.edu](http://Penelope.uchicago.edu).

Ka mendime se kripa është shfrytëzuar nga epoka e paleolitit, por është konstatuar se tregtimi me të nis tek me paraqitjen e ekonomisë bujqësore dhe blegtorale gjatë epokës së neolitit.<sup>12</sup> Në gjendjen e tanishme të studimeve mbi kripën gjithnjë duhet pasur parasysh dhe faktin se marrja e kripës është bërë dhe përmes vetë natyrës kur kihet parasysh se gati të gjitha ujërat përmbajnë kripëra të tretura të cilat mbeten në tokë dhe akumulohen. Natyrisht, kjo masë e kripës nuk ishte aq e madhe sa për t'i përmbushur nevojat e shtuara të përgjithshme të periudhave të mëvonshme.

Që nga bujqit dhe blegtorët e hershëm burimet e kripës apo sigurimi i saj kanë qenë çështje të mirëqenies së përgjithshme dhe kjo ka imponuar edhe kontakte të ndërsjella tregtare, kulturore e të tjera.<sup>13</sup> Më vonë, falë minierave të kripës së gurit në Hallstat të Austrisë, u zhvillua njëra ndër kulturat më të rëndësishme të epokës së hekurit: Kultura e Halshtatit (shek. XII-V p.K.). Këto miniera të kripës krijuan prosperitet të gjithëmbarshtëm për banorët dhe lidhje ekonomike e kulturore me rajone shumë më të gjera,<sup>14</sup> siç ishin dhe territoret ilire, ku u përhap kultura e Hallshtatit.

Ndonëse nevojat për kripën u rritën nga epoka e neolitit, studimet për burimet e kripës ende janë në shkallën e nevojshme se sa i është kushtuar kujdes nevojave gjatë epokës së neolitit për burimet dhe përdorimin e obsidianit, cinabarit, bitumenit, strallit apo sqqfurit.<sup>15</sup> Interesimi për përdorimin dhe prodhimin e kripës nga parahistoria dhe trajtesa të veçanta për këtë jomineral të rëndësishëm për jetën paraqiten sidomos nga viti 1999 dhe këto kryesisht lidhen me epokën e neolitit. Inspiruese për vazhdim të hulumtimeve ishin botimet për këtë temë të O. Weller (Paris).<sup>16</sup> Libër i veçantë për kripën u botua në vitin 1961 nga J. Nenquin, ndërsa tek në vitin 1992 ai i autorit S. Adshead.<sup>17</sup> Studimet mbi kripën në territorin ilir i bëri arkeologu kroat M. Zaninović, përmes trajtimit të portës detare Parentia dhe Nesakciumit të Istrës dhe sidomos punimit mbi kripën në bregun lindor të Adriatikut.<sup>18</sup>

<sup>12</sup> Chapman et al. (2001) pp. 10–20; Urem-Kotsou, D. (2016) p. 127.

<sup>13</sup> Harding, A. (2013) p. 91.

<sup>14</sup> Harding, A. (2013) pp. 18, 62, 71.

<sup>15</sup> Dušanić, S. (2003) p. 248, f.n. 11; Tringham, R. (2003) pp. 81–126; Milić, M. (2014) pp. 285–296.

<sup>16</sup> Harding, A. (2013) pp. 9–10.

<sup>17</sup> Nenquin, J. (1961); Adshead, S.A.M. (1992).

<sup>18</sup> Zaninović, M. (1991) 255–264; Zaninović, M. (2005) pp. 125–127.

Në përgjithësi roli i kripës është lënë anash dhe me këtë edhe shpjegimi i lidhjeve midis burimeve të kripës dhe vendbanimeve rreth tyre apo dhe konstatimi i tregtisë së kripës dhe të rrugëve të furnizimit me kripë. Kjo ka ngjarë deri vonë gjatë studimeve të kulturave neolitike, por dhe të atyre më të vona.

Në territoret ilire kishte burime të shumta të kripës gjatë bregdetit Adriatik dhe në brendi. Për këto burime janë zhvilluar edhe konflikte, siç ishin ato midis ardiejve dhe autariatëve. Straboni dhe Pseudo Aristoteli përmendin kodrën nga e cila vrujon burimi i ujit të njelmët, që jep kripë të shkëlqyer për bagëtinë, andaj dhe të gjithë e përdornin (Strabo VII 5 11; Pseudo Aristoteles 138).<sup>19</sup> Pseudo Aristoteli thekson se bagëtia ushqehet dy herë në vit dhe nëse kjo nuk bëhet u ngordhte gati e gjithë bagëtia (Pseudo Aristoteles 138). Sipas Strabonit, ardiejtë dhe autariatët binin shpesh në konflikt, sepse nuk e respektonin marrëveshjen për përdorimin e burimit të kripës (Strabo VII 5 11).<sup>20</sup> Ky burim mendohet të jetë te lokaliteti me toponimin “Slana vrela” (shq. Burime të Njelmëta), jo larg vendbanimit kodrinor ilir të Orahovicës (2 km nga Konjica e Bosnjes) dhe të tilla, siç pohon M. Zaninović, kishte nga Kopri e Pirana e Sllovenisë e deri në Shqipëri.<sup>21</sup>

Studime të veçanta për burimet dhe prodhimin e kripës gjatë antikitetit në Shqipëri nuk janë bërë, por nënkuptohet se është prodhuar kripa e detit Adriatik në rajonin e Shkodrës, të Durrësit dhe të Vlorës. Duket se është përdorur dhe kripa e gurit, pasi që rezerva të mëdha kripe guri gjenden ende në zonën e Dumresë, në Dhrovjan, në Kardhiq dhe në Kolonjë.<sup>22</sup> Në rajonin e Vlorës gjenden dhe të ashtuquajturat “Kriporet e Nartës”, pranë të cilave shtrihet liqeni i kriposur ngjyrë rozë, ku mbetet kripa kur thahet uji (Foto 6).

Është e kuptueshme se edhe dardanët gjatë ecurive parahistorike, antike dhe më pas kishin nevojë për kripën, sa për nevojat blegtorale e bujqësore aq edhe për veten e tyre. Lidhur me këtë shtrohet pyetja thelbësore: A kishin dardanët burime natyrore të kripës apo kishin nevojë që këtë ta sillnin nga territoret fqinje a ato më të largëta?

<sup>19</sup> Zaninović, M. (2005) p. 126.

<sup>20</sup> Zaninović, M. (2005) p. 126.

<sup>21</sup> Zaninović, M. (2005) pp. 125-127.

<sup>22</sup> Minaeralet e Shqipërisë: Miliardat në thellësi të tokës... U qas më 20.3.2020 në <http://energija.al/2011/12/12/mineralet-e-shqiperise-miliardat-ne-thellesi-te-tokes-kompanite-kerkuese-dhe-spekulimet-ne-burse>.



**Foto 6.** Kriporet e Nartës – Liqeni Rozë, Vlorë (Shqipëri: [www.dritare.net](http://www.dritare.net))

Për mineralet e shfrytëzuara gjatë periudhës romake në territorin e Dardanisë ka të dhëna dhe janë bërë disa studime, sidomos për arin, argjendin e hekurin, por studimet mungojnë për mineralet jometalurgjike, siç është kripa apo cinabari, siç është konstatuar edhe më parë.<sup>23</sup>

Nxitje e kahershme për ta analizuar çështjen e kripës tek dardanët ishte e dhëna e autorit antik Tit Livit se romakët iu lejuan dardanëve tregtinë me kripë, të cilën duhej ta merrnin në Stobi. Për këtë përfaqësuesi romak Emil Pauli i urdhëroi Meridës III Maqedone që ta sillnin kripën në Stobi për dardanët dhe e caktoi çmimin e saj (Livius XLV 29 13). Leja për tregtinë me kripë nga viti 168 p.K. (*salis commercium*) ishte e vetmja gjë që dardanët në krye me mbretin Bato e fituan nga koalicioni me romakët, të cilët u bënë fqinj jugor të tyre pasi që mposhtën shtetin e Maqedonisë.

Me këtë rast do të trajtohen vetëm rrugët e mundshme të furnizimit të dardanëve me kripë, por jo dhe ku është vendosur kripa në kohë të ndryshme dhe cilat kanë qenë mjetet e transportit, në çfarë objekte dhe enë është vendosur kripa pas arritjes në Dardani, si dhe mënyra e shpërndarjes së saj për përdorim dhe shumë aspekte të tjera të cilat duhen të jenë objekt i studimeve të mëtejme.

<sup>23</sup> Dušanić, S. (1995) pp. 27-34. Për cinabarin dardan shih: Shukriu, E.- Buçinca, A. (2018) ff. 207-228.

Sipas njohurive të deritanishme, si burim më i hershëm i shkruar lidhur me kripën është e dhëna e autorit antik Livit, ndonëse është e dhënë që flet vetëm për Stobin, pra për vendin ku dardanët mund ta merrnin kripën e grumbulluar dhe të lejuar për ta. Megjithëkëtë, kjo e dhënë duket mjaft e rëndësishme për të nxjerrë përfundimet vijuese dhe të cilat duhet të kihet parasysh kur trajtohet historia dhe zhvillimi dardan se:

1. Dardanët nuk kishin burime kripe në territorin e tyre,
2. Dardanët ishin të detyruar ta importonin kripën.

Lidhur me posedimin apo jo të kripës në territorin e njohur dardan ose me tregtinë për të ende nuk janë bërë studime të veçanta, andaj shpresoj se kjo trajtesë mund të shërbejë për të vazhduar thellimin e njohurive rreth këtij problemi. Studimet kanë nisur kohëve të fundit për burimet dhe përdorimin e kripës gjatë epokës së neolitit dhe në to konstatohet se burime të kripës nuk kishte në Ballkanin Qendror, pra as në territorin e shtrirjes së kulturës së Starçevës,<sup>24</sup> në një rën pjesë të së cilës u krijua më pas dhe popullata e Dardanisë.

Il tendra donc à montrer ce qui fut singulier et étranger à la nature de la révolution et qu'elle a pourtant elle-même suscité au cœur des *pampas* argentines. La figure d'Artigas sert d'archétype pour son récit. Sarmiento le décrit comme un célèbre chef, élevé par les autorités civiles de Buenos Aires comme *commandant de campagne* après les avoir combattues, et qui s'était joint, avec "quelques milliers de *gauchos*"\*, au Général Rondeau qui dirigeait le siège de Montevideo<sup>20</sup>. Mais très vite, explique-t-il, Artigas s'en sépare et commence une guerre contre lui. Sarmiento ne donne aucune explication du motif de cette rupture, ni ne veut donner à cet acte un nom consacré en politique. Son écriture n'est pas ici, et comme dans la plupart des cas, une reconstruction historique mais une interprétation du sens du politique ; Artigas est bien plus, pour lui, un exemple de ce défaut qui surgit entre nous, qui détourne le caractère naturel des révolutions. En effet, il établit ce qu'il considère comme "naturel" quand les peuples entrent en révolution, puis signale l'existence de deux intérêts opposés qui luttent entre eux : le *conservateur* et le *révolutionnaire*, dans le cas de l'Argentine, "les patriotes" et "les réalistes". Il est aussi "naturel" que, après la victoire, le parti vainqueur se divise en factions, entre modérés et exaltés, les uns voulant pousser les choses jusqu'aux extrêmes, alors que les autres chercheraient à les maintenir dans le cadre de leurs propres limites. De même c'est propre aux révolutions que les vaincus se réorganisent et puissent triompher, en profitant de la division des vainqueurs. Mais l'action d'Artigas montrait autre chose, c'était une force qui s'isolait et formait une troisième entité, "hostiles aux combattants des deux bords", révélant sa condition "hétérogène" et "inconnue" aux yeux de la société à laquelle il appartenait<sup>21</sup>. Il ne s'agissait plus, alors, d'une lutte entre les factions opposées des conservateurs et des révolutionnaires, pas plus que d'une lutte sur des principes comme pouvait s'expliquer la lutte entre la noblesse et le Tiers Etat pendant la

\* *paysans des pampas argentines [ndt]*

<sup>20</sup> *Facundo* est une œuvre programmatique, écrit dans des circonstances historiques précises, mais n'est pas un traité d'histoire. Le siège de Montevideo et les différentes forces qui y interviennent, sert à Sarmiento à montrer le conflit existant entre les forces en jeu : Rondeau et Artigas seront d'autres figures du combat de la liberté contre le despotisme.

<sup>21</sup> *Facundo*, op. cit, p.87.

Révolution Française, mais bien d'un combat entre des forces qui représentaient des "états différents de l'humanité", selon Sarmiento, où s'affrontaient des instances hétérogènes et irréconciliables.

On passe donc de la révolution à la guerre. L'interprétation qu'il donne dans *Facundo* est bien connue et insiste sur cette confrontation entre des éléments irréconciliables : "la guerre de la révolution argentine a été double : 1° guerre des villes, initiée dans la culture européenne, contre les Espagnols, afin d'étendre cette culture ; 2° guerre des chefs de campagne contre les villes, afin de se libérer de tout assujettissement civil, de recouvrer leur caractère et leur haine de la civilisation. Les villes triomphent des Espagnols et les campagnes des villes. J'ai ici expliqué l'énigme de la révolution argentine, dont le premier coup a été tiré en 1810, et le dernier ne s'est toujours pas fait entendre"<sup>22</sup>.

## CIVILISATION ET BARBARIE

Quel sens a alors l'opposition *civilisation* et *barbarie* ? Quelle relation suppose-t-elle entre le présent de la révolution et le passé colonial ? Une première réponse consisterait à mettre au jour l'interprétation historique qui la parcourt et la place décisive qu'y tenait la philosophie.

Pourtant, au moment d'écrire cette œuvre, Sarmiento n'était qu'un journaliste exilé et un éducateur autodidacte. Il n'était pas un professeur d'histoire ou de philosophie comme Guizot ou Cousin qui donnèrent des cours à la Sorbonne en 1828, et il n'avait pas non plus la prétention d'écrire une histoire de la révolution argentine comme Michelet l'a fait en écrivant son *Histoire de la Révolution française* en 1847. *Facundo* est une œuvre de combat et son recours à l'histoire est en dépendance directe avec la politique. Son travail n'est plus alors celui d'un historien ; Sarmiento ne se contente pas de vérifier les faits qu'il raconte et qu'il a recueillis de plusieurs sources, mais il se sert de l'histoire pour interpréter la politique dans laquelle il doit agir. La figure du *caudillo* Facundo Quiroga lui sert à comprendre les luttes civiles, « l'énigme » de la révolution argentine, et inscrire la singularité de la situation argentine dans la marche générale de l'histoire universelle. Ainsi, contre d'autres interprétations, qui considèrent que le *caudillo* était la plus authentique représentation du

---

<sup>22</sup> Ibid, p.90.

présent américain, Sarmiento proclame qu'il n'y a qu'une seule histoire, celle de l'humanité et de son progrès vers la civilisation. Il n'y a pas de "faits isolés", mais ceux-ci révèlent bien plutôt la marche de l'esprit humain. Le présent de la nation ne peut donc se penser sans cette référence à l'histoire générale de l'humanité.

Cependant, s'il est vrai que sa pensée est au service de l'action, et qu'il n'ait été un lecteur systématique des philosophes français auxquelles il fait référence dans ses textes – Tocqueville, Guizot, Cousin, Jouffroy, Leroux, Michelet, Montesquieu et, par leur intermédiaire, les Allemands Herder, Humboldt et Hegel, - *Facundo* est imprégné des idées et des catégories de la philosophie de son époque qui lui étaient parvenu par ses lectures, directement ou en seconde main, faites dans les bibliothèques de son ami Quiroga Rosa à San Juan<sup>23</sup>, ou dans les échanges de lettres avec ses amis de l'Association de Mai. La paternité de cette philosophie de l'histoire se retrouve dans les concepts qu'il utilise, les citations qui ouvrent plusieurs chapitres ou celles présentes dans le texte même, ainsi que dans les expressions reprises directement du français avec lesquelles il construit une scène inédite en Argentine qui représente la confrontation des principes irréconciliables de "civilisation" et "barbarie".

La formule que Sarmiento a forgée pour présenter une première matrice explicative des maux politiques qu'il s'était proposé d'interpréter se déploie dans une série de figures – la "ville" et la "campagne pastorale", les traditions "rétrogrades" et "barbares" léguées par la domination coloniale, et la vie en société, la "civilisation", dans laquelle il projette sa vision du passé, du présent et du futur à partir des principes de la raison qui se déploient dans l'histoire.

## TERMINER LA RÉVOLUTION

Terminer la Révolution c'est la tâche de la "nouvelle génération" dans laquelle Sarmiento se sent appelé à occuper la place de

---

<sup>23</sup> "En 1838, Manuel Quiroga Rosas vint à San Juan [...] possesseur d'une bibliothèque choisie d'auteurs modernes. Villemain et Schlegel en littérature, Jouffroy, Lerminier, Guizot, Cousin en philosophie et en Histoire, Tocqueville, Pierre Leroux en démocratie, la *Revue Encyclopédique*, comme synthèse de toutes les doctrines, Charles Didier et cent autres noms jusqu'alors inconnus pour moi alimentèrent pendant longtemps ma soif des connaissances. » *Souvenirs de Provence*, op. cit., p. 210

« leader ». "Terminer la révolution", comme nous le savons, fut le programme de Guizot sous la Restauration, et que réalisera finalement la IIIème République<sup>24</sup>. Nous pourrions dire que ce fut même la consigne de la philosophie politique du XIXème siècle, commune à la droite et à la gauche, à Guizot et à Saint-Simon : terminer la Révolution c'était l'instituer positivement. Nous pouvons interpréter avec cette clé le projet que Sarmiento expose dans *Facundo*. Pour lui, construire un ordre politique stable, et fonder un régime garant des libertés seront également les objectifs liés à la tâche de terminer la révolution ; tâche qui est indissolublement intellectuelle et politique, et qui, dans ce moment particulier, prend la forme de la lutte contre la politique de la campagne, contre la politique du despotisme incarnée par le gouvernement de Rosas. Ainsi, comprendre "l'énigme" de la révolution argentine était le premier pas à accomplir pour la rendre durable, pour la stabiliser.

En accord avec Guizot, Sarmiento distingue la révolution comme mouvement de civilisation et la révolution comme événement. Il développe alors un second sujet où les événements révolutionnaires du 1810 et les erreurs qui en dérivent des groupes *Unitaires*, qui avaient voulu appliquer directement les principes appris dans les cieux abstraits des Lumières, avaient ouvert la porte à l'anarchie et au despotisme. L'effet de cette politique erronée était plus proche du paradoxe que de la contradiction : les porteurs des Lumières de la raison ont contribué à son éclipse. Lorsqu'il fait référence aux Unitaires, Sarmiento les considère comme une génération - de laquelle il veut se différencier- "qui use de la raison et de la déduction" mais qui a manqué au plus haut point de sens pratique. La figure de l'*Unitaire* apparaît dans *Facundo* comme un *personnage* qui joue son rôle dans le drame historique: "L' Unitaire typique marche droit, la tête haute, il ne dévie pas de son chemin, quand même il entendrait s'écrouler un édifice; il parle avec fierté; il achève l'expression par des mines dédaigneuses et des gestes catégoriques; il a des idées fixes, invariables, et, à la veille d'une bataille, il discutera encore dans les formes un règlement, ou s'occupera d'établir une nouvelle formule égale, car les formules légales sont le culte extérieur qu'il rend à ses idoles: la Constitution, les garanties individuelles"<sup>25</sup>.

Comment terminer la Révolution ? Pour Guizot, la révolution était "un désordre organisateur", et il reconnaissait en elle deux

<sup>24</sup> Pierre Rosanvallon, *Le moment Guizot*, Paris, Gallimard, 1985, p.16-17

<sup>25</sup> *Facundo*, op.cit, p. 147.

dimensions, l'une, de pure destruction, la force désorganisatrice qui a mené la France à la *Terreur* de laquelle il fallait sortir ; l'autre, la force des principes qui impliquaient un nouveau fondement<sup>26</sup>. Guizot construit sa solution doctrinaire contre ceux qui voulaient revenir en arrière sous la Restauration. En Argentine, l'action révolutionnaire, avait débouché sur l'anarchie et le despotisme. La révolution en était à son premier moment, celui de la pure destruction et si la révolution est la mise en œuvre du principe de liberté, il fallait passer au moment de la fondation d'un ordre politique de la liberté, qui sera le moment constitutionnel.

En accord avec Guizot, Sarmiento trouve nécessaire de recourir à une sociologie qui s'articule avec une politique, parce que la construction d'un nouveau régime politique suppose une nouvelle relation entre la société et le pouvoir politique. Au contraire de Guizot, il ne verra pas dans la solution doctrinaire la réalisation du principe de liberté. Au contraire pour Sarmiento, la révolution, c'est la démocratie, ce seront donc Tocqueville et Leroux -lectures de jeunesse- qui marqueront ses idées.

Si le despotisme est le mal politique à combattre, Sarmiento situe le bien politique, dans une épopée de la révolution qui trace la marche de l'humanité vers un état supérieur. En elle se livre également le combat entre les valeurs du monde ancien et celles de la modernité ascendante. Ainsi, la "liberté des anciens" et la "liberté moderne" que Benjamin Constant oppose dans sa version de la *Querelle des Anciens et des Modernes*, sont également présentes dans sa pensée. Mais, à la différence de Constant, dans le modèle républicain de Sarmiento, la liberté moderne est en dialogue permanent avec la liberté antique. Cet assemblage se cristallise dans les hommes qu'il a admiré toute sa vie, comme Franklin, dont l'élan inventif et autodidacte l'a touché dans ses premières lectures, ou Horace Mann, l'infatigable éducateur qui lui a transmis sa vision émancipatrice de l'éducation. La confrontation entre la liberté *vertu* et la liberté *intérêt* a agité l'esprit de Sarmiento et comme suggère Natalio Botana, l'idéal antique de la *vertu* persiste dans son modèle républicain tout au long de sa vie<sup>27</sup>. Cependant, nous pouvons peut-être avancer que c'est une autre représentation de la liberté moderne, moins liée à l'intérêt, et qui exprimerait la condition émancipatrice de la raison, qui est sous-jacente dans cette

<sup>26</sup> Pierre Rosanvallon, op. cit., p. 205.

<sup>27</sup> Natalio Botana, *La libertad política y su historia*, Buenos Aires, Ed. Sudamericana/Inst. Di Tella., 1991, p.201.

réappropriation du modèle de la vertu classique. Dans ce sens ce serait bien plus Leroux qui serait dans la ligne de filiation politique de Sarmiento ; Leroux bien conscient du sens politique de cette opposition, et qui voyait dans l'*émancipation* l'essence même de la modernité.<sup>28</sup>

## CONCLUSION

En guise de conclusion on voudrait revenir sur l'idée de nation que Sarmiento a forgée au long de son expérience d'éducateur et d'homme politique. Puisque la nation civique en tant que paradigme philosophique n'est pas un thème nouveau, il est important d'établir alors les conditions de ce qui a été reçu et de ce qui a été inventé. La république moderne arrive dans l'Amérique hispanique portant les habits des révolutions française, anglaise et nord-américaine. Entre la fin du monde colonial et le début de l'ordre politique moderne, Sarmiento, comme les autres membres de sa génération, se forgera sa représentation de la nation dans le dialogue éclectique entre les idées et l'expérience politique de ces nations, comblant le vide laissé par la rupture du lien avec la métropole.

En premier lieu, la nation s'identifie avec la Constitution qui "ordonne et installe un gouvernement" et qui instaure la soumission de chacun à la loi de la cité. On retrouve dans cette formulation un certain nombre de dimensions de la liberté moderne qui sont spécialement visibles dans la lutte contre le colonialisme espagnol. La nation civique oppose la loi au pouvoir de l'arbitraire, la pluralité d'opinion à la voix qui commande, le consensus rationnel à la tutelle du despotisme. Mais cette formulation s'inscrit également dans le *telos* de l'humanité en marche vers l'émancipation. La constitution de la communauté politique sous l'emprise de la loi commune, depuis Rousseau et Kant, est la condition pour l'autonomie et le progrès humain. Ceci s'oppose à l'immobilité rétrograde des systèmes du passé. La complexité de la formulation de ce paradigme ne passe, à notre avis, pas tant par la confrontation entre idéal antique et idéal moderne, celui de la république de la *vertu* et celui de la république de l'*intérêt*, que par l'héritage de certains principes de la révolution

---

<sup>28</sup> Voir Miguel Abensour, *Cahiers de Philosophie Politique*, Editions Ousia, 1983. Présentation, p.6. Par rapport au sens émancipateur de la raison chez Leroux, voir également, du même auteur *Le procès des maîtres rêveurs*, Arles, Editions Sens et Tonka, 2013.



française, qui conjuguent des références spirituelles et libérales, mais également socialistes et humanistes, qui reconnaissent dans l'émancipation de l'humanité l'essence de la modernité, même si ce peuple souverain met du temps à prendre forme dans la réalité.

Ce premier système d'idées est formulé de manières nouvelles au contact de la réalité démocratique nord-américaine. Le paradigme de la nation civique se reformule autour de l'incorporation du principe fédéral et du système représentatif. Sarmiento voit, dans les institutions et les pratiques des premiers groupes d'émigrés arrivés sur le territoire nord-américain, la réalisation de la liberté anglaise qui se laissait apercevoir avec la Réforme. L'Amérique représente dans son paradigme la cloture du passé ; malgré l'incertitude du futur, la république sera démocratique. C'est la raison pour laquelle les formes mixtes de gouvernement n'entrent aucunement dans son modèle, la solution doctrinaire des libéraux français est pour lui équivalente aux formes aristocratiques.

La nation civique s'identifie également avec l'Etat centralisé qui produit et garantit le bien de tous. Prenant ses distances avec les formulations libérales, Sarmiento ne croit pas que l'Etat soit une matrice au sein de laquelle se déroulent les expériences de la société, mais revendique plutôt le modelage de la citoyenneté par l'Etat. L'éducation publique sera la politique qui traduira au mieux cette idée; l'Etat doit éduquer parce que nous ne naissons pas citoyens, bien au contraire, le vivre ensemble de la république doit être enseigné par l'exercice des droits et par l'enseignement des sciences. Le fonctionnement du système politique dépend en particulier de la "volonté" et de la "qualité morale" des hommes qui le composent.

Nous avons décelé les dimensions du paradigme philosophique de la politique de Sarmiento en lisant son œuvre, reconstituant un système fait autant d'idées que de pratiques, dans lequel cohabitent les formes de gouvernement avec les costumes des citoyens, ou des observations autour de la pierre qui cimentait les édifices de la république, le système métrique décimal avec la réforme de l'orthographe, l'astronomie ou la paléontologie avec la réforme religieuse. Un autre système symbolique du politique était en jeu, et débordait les limites du régime politique dans la détermination de la nation. D'autre part, sa vision de la nationalité prend la forme d'un *philosophème* qui dans la particularité de ses propositions vise l'universalité de ce qui est philosophique, et n'aurait pas pu se constituer historiquement sans un discours philosophique en tant que tel.

Cependant, dans son expérience d'homme politique, Sarmiento va se confronter avec des obstacles à la réalisation de ses idées (ou idéaux). Ainsi on peut lire dans une de ses derniers ouvrages cette réflexion :

"Qui étions-nous quand ils nous ont donné le nom d'Américains, et qui sommes-nous quand nous nous donnons celui d'Argentins ? Nous sommes des Européens ? Tant ces visages cuivrés le démentent ! - Nous sommes des Indigènes ? Les sourires dédaigneux de nos dames blondes nous donnent alors la réponse. –Un mélange ? Sommes-nous une nation ? Une nation sans amalgame de matériaux accumulés, sans assemblage ni ciment. Des Argentins ? Jusqu'où ? Depuis quand ?" <sup>29</sup>

Exprimées au moment critique, où les interventions fallacieuses d'un gouvernement dénaturé assombrissaient, une fois de plus, l'espace politique de la république, elles révélaient les doutes persistants sur le sens de la nationalité dont l'action politique s'était écartée. L'Argentine était une république mais elle ne pouvait pas se dire républicaine. Quelles étaient les raisons historiques qui faisaient qu'une nation constituée à partir de principes rationnels, qui cherchait à appliquer les réussites de ces principes testés par d'autres nations, apparaissait aux yeux du monde entier, à la fin du XIX<sup>ème</sup> siècle, comme dénuée de tous principes ?

Plus que de vouloir situer le problème de la viabilité ou non du modèle ou de confirmer la différence entre les énoncés d'un projet et leur mise en pratiques, on envisage une double lecture de Sarmiento: d'une part celle du paradigme philosophique qui sous-tend sa politique, et d'autre part celle de la nation qui ressort de la construction de ses impulsions dans ce dispositif d'idées mis à l'épreuve de la réalité. Comment s'émanciper du colonialisme espagnol? Comment substituer le pouvoir de l'Etat libéral moderne naissant au pouvoir théologico-politique? Comment soutenir la république ? Qui sont ses adversaires ? Ces questions, qui accompagnent les actes d'institution de la république, relèvent le défi d'exister pour la première fois. Ne pas trouver son peuple, refuser la tradition, construire à partir du vide.

La nation civique constitue, pour nous les argentins, un paradigme ambivalent, qui introduit en même temps toute la force des

---

<sup>29</sup> *Conflicto y Armonías de las razas en América, OC (2001) T. XXXVIII, p. 24.*

idées de liberté pour lutter contre le système colonial, et la négation du peuple réel dans l'exercice de la souveraineté. Tout au long du XIX<sup>ème</sup> siècle, le peuple réel sera absent de ces formules qui l'ont pourtant comme sujet. La particularité des républiques sud-américaines vient de cette souveraineté dissociée, dans laquelle le peuple réel ne correspond pas à son concept. Cependant, les protagonistes, soit qu'ils y aient réfléchi, soit qu'ils y aient succombé, n'ont pas oublié ces obstacles. La figure de Sarmiento plus que toutes autres, nous montre bien les difficultés rencontrées pour établir un consensus, basé sur le sentiment, la conscience ou la réalité de la nationalité.

Susana Villavicencio, Buenos-Aires-Paris

## SARMIENTO ET L'EMERGENCE DE LA NATION CIVIQUE EN ARGENTINE

### Résumé

Dans cet article nous avons analysé l'idée de nation que Sarmiento a forgée au long de son expérience d'éducateur et d'homme politique. Puisque la nation civique en tant que paradigme philosophique n'est pas un thème nouveau, il est important d'établir alors les conditions de ce qui a été reçu et de ce qui a été inventé. La république moderne arrive dans l'Amérique hispanique portant les habits des révolutions française, anglaise et nord-américaine. Entre la fin du monde colonial et le début de l'ordre politique moderne, Sarmiento, comme les autres membres de sa génération, se forgera sa représentation de la nation dans le dialogue éclectique entre les idées et l'expérience politique de ces nations, comblant le vide laissé par la rupture du lien avec la métropole.

En premier lieu, la nation s'identifie avec la Constitution qui "ordonne et installe un gouvernement" et qui instaure la soumission de chacun à la loi de la cité. On retrouve dans cette formulation un certain nombre de dimensions de la liberté moderne qui sont spécialement visibles dans la lutte contre le colonialisme espagnol. La nation civique oppose la loi au pouvoir de l'arbitraire, la pluralité d'opinion à la voix qui commande, le consensus rationnel à la tutelle du despotisme.

*Mots clés:* nation civique, république moderne, colonialisme espagnol

Haqif Mulliqi, Prishtinë

## ZONJUSHA GJULIA – NATYRALIZMI SI QËLLIM FILOZOFIK I STRINBERGUT

### Abstrakt

Parathënia e August Strinbergut bërë dramës Zonjusha Gjulia, në fakt, e shpërfaq interpretimin e tij të kësaj vepre. Kur autori e shkruan parathënien e veprës së vetë, kjo është dëshmia më e mirë për emocionet që ka ai, filozofinë e tij si dhe qëllimet që ka. Në këtë parathënie Strinberg shkruan mbi atë se cila është ajo që motivon Zonjushën Gjulia: "Instinkti i lindur amnor, edukimi i gabueshëm nga ana e t'et, natyra e saj personale, apo edhe ndikimi i të fejuarit të saj mbi 'trurin e dobët'". Ky punim yni është përpjekje për të dhënë përgjigje në këto dilema shoqërore dhe filozofike. Po ashtu është përpjekje që të shpalosen aspektet psikologjike të personazheve, dhe i asaj që autori e konsideron të jetë një diagnozë sëmundje e zonjushës në fjalë.

*Fjalët çelës:* Dramë, koha e veprimit, konflikti, natyralizëm, seksizëm, kundërthënie gjinore, etj.

Kur lexohet vepra e Strinbergut, nuk është aq e vështirë që të kuptohet se autorin gjatë gjithë jetës së tij e ka shoqëruar zhgënjimi i cili është pasqyruar në veprën e tij në të cilën vëhet re një lloj përqendrimi që shpie drejt krimit, e keqja e vuajtjes mentale dhe konfliktet seksuale, e që ka refleksion te letërsia që e ka krijuar ai. Për këtë arsye dramën e tij të para, siç ishte *Mjeshtri Ulf* (1872) e ndonjë tjetër përjetuan mospasë, por nuk u dekurajua Strinbergu. Ishte viti 1872 kur Teatri Mbretëror në Stokholm e refuzoi këtë vepër duke e konsideruar të padenjë për t'u inskenuar në skenën e tij, kështu që *Mjeshtri Ulf* nuk u vu në skenë deri në vitin 1881, e që do të thotë deri në moshën 32 vjeçe të autorit, atëherë kur premiera e kësaj drame u ngjiti në skenën e të ashtuquajturin "Teatër të ri" dhe korri sukses të shënuar. Më pas, me dramën e tij *Babai dhe Zonjusha Gjulia A.* Strinbergu krijon drama natyraliste të cilat bazohen te realizimet, tashmë të verifikuara, të Henrik Ibsenit e të cilat iu përgjigjen qëndrimeve që Emil Zola i kishte shpërfaqur te vepra e tij e njohur „Natyralizmi në veprat dramatike”.

Në vitin 1889, nën ndikimet e Andre Antoanit, në Stokholm August Strinbergu e hap teatrin e tij eksperimental, i cili premierë të parë e kishte pikërisht veprën e tij *Zonjusha Gjulia*, si dhe një nga veprat e pakta të këtij autori e cila edhe sot e kësaj ditë ribotohet dhe vihet në skenë, është menduar të ishte vepra e parë që do ngjitej në atë skenë. *Zonjusha Gjulia* ishte vepër që karakterizohej për nga veprimi, si element dominues dramatik, për dallim nga melodramat dhe dramat e manireve të mëdha, të cilat i dominonin repertorët e teatrove të ndryshme. Por kjo vepër e A. Strinbergut, për shembull, u refuzua që të inskenohet në Londër deri në vitin 1927, madje si një produksion privat, ndërsa në Nju-Jork u vu në skenë tek pas Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1956, ndërkohë që edhe në këtë kohë në shumë vende perëndimore vazhdonte të ishte e ndaluar. Kjo duhet të ketë qenë një prej arsyeve që August Strinbergu vendosi të “ikte” nga natyralizmi, për t’u kthyer nga drama subjektivistike dhe gjysmëmitike, por edhe dramës realiste në të cilat vepra, fara e ekspresionizmit si dhe e modernizmave të tjerë është mjaft e vërejtshme. Veprat e tij, si: *Sonata e fantazmës*, *Stuhia*, *Rruga e madhe* janë shkruar ndërmjet vitit 1907 dhe 1909 dhe, që të tria këto, si premiera, u inskenuan në “*Intima Theatre*” në Stokholm, bashkëthemelues i të cilit ishte vetë autori.

Përkundër luftës mentale, August Strinbergu ishte një shkrimtar i frytshëm në mënyrë të mahnitshme në të gjitha llojet e temave që mund të paramendohen, opusi i tij nuk është i të njëjtit nivel në secilën vepër dhe ai nënkupton vepra në prozë dhe poezi prej nëntë vëllimeve, dhe, sikundër u tha, ishin mbi gjashtëdhjetë drama. Sipas profesorit Emin Z. Emini, August Strinbergu qëndron i madh në teknikën dhe forcën dramatike që kanë veprat e tij dhe, mbi të gjitha, ai bashkë me Henrik Ibsenin është dramaturgu i parë që fut një mënyrë të re në të shkruarit e dramës. Me stilin e tij “përmbys” konceptin aristotelian për njësinë e veprimit, duke e zhvilluar konceptin e tij mbi veprimin e ekonomizuar<sup>1</sup>. Sipas tij:

*“Veprimi që çon në kundërveprim për të ndërtuar konfliktin në dramat e tij zakonisht nuk ndodh në strukturën e fabulës, por ai ndodhet kryesisht në kundërthëniet dhe përplasjet e botës mendimore dhe emocionale të personazheve. Personazhet e Ibsenit janë njerëz me mish e gjak, me intelekt e me shpirt dhe nuk janë skelete a marioneta që kryejnë veprime sa për ta shtruar strukturalisht dramën apo thjesht*

<sup>1</sup> <https://telegrafi.com/henrik-ibseni-gjithmone-aktual/>

*për të ndërtuar situata dramatike. Drama e Ibsenit merret me pasojën, sepse veprimi klasik në të shumtën e herëve nuk ndodhet aty: ai tashmë ka ndodhur diku më parë me pasojat e të cilit përsiaten personazhet të cilat artikulojnë nëpërmjet dialogut depërtues, mendimeve të ashpra dhe psikologjisë së thellë të karaktereve”.*<sup>2</sup>

Përveç veprave të përmendura tashmë, veprat më të shquara të Strinbergut janë, pa dyshim, drama *Babai* (1887), *Zonjusha Gjulia* (1888) dhe trilogjia *Vazoja* (1899), *Vallëzimi i vdekjes* (1901) dhe *Loja e ëndrrave* (1902), me të cilat ky autor ushtroi një ndikim të madh në zhvillimin e dramës të shekullit XX, por edhe me analizat teorike përmes të cilave ishte i thellë dhe gjithëpërfshirës.

Në dramat e tij gjejmë edhe aspekte ilustrative, siç është rasti, ta themi, me karakterin e Zonjushës Gjulia, e cila qartësisht vjen para nesh si një fotografi e nënës, në veçanti te momenti kyç i veprës, më vendimtari, i cili pashmangshëm dhe po aq pamëshirshëm i përcakton të gjitha dëshirat tona, kërkesat, sukseset apo edhe mossukseset në jetë. Për këtë qasje, sipas të gjitha gjasave, *Zonjusha Gjulia* edhe konsiderohet të jetë vepra më e rëndësishme e Strinbergut e farkuar në yje,<sup>3</sup> mbi të gjitha për shkak të risive stilistike me të cilat është shërbyer autori i saj e që në njëfarë mënyre konsiderohet të ishin një lloj *manifesti i natyralizmit*, tipik për fundin e shekullit XIX. Në formësimin e një teatri të ri natyralist, Strinbergu i vuri dy “detyrat” kyçe përpara krijuesve bashkëkohorë:

1. Që para së gjithash në mënyrë të pamëdyshtë t’i përmbahen realizmit, qofshin ato me aspektet të cilat ndërlidhen me përmbajtjen (si për shembull, të përmendurit e aspekteve të ndryshme që kanë të bëjnë me fiziologjinë e njerëzve, blasfeminë, pasionet dhe nevojat fizike të njerëzve te *Zonjusha Gjulia*) dhe

2. Interpretimi (mungesa e ndriçimit dhe makijazhit) apo koha (veprimi te *Zonjusha Gjulia*, për shembull, në një episod të tendosur, konfliktuale dhe të pandërprerë, nëntëdhjetë minutëshe).

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> *Strinbergu och mäter Olof är två tvillingbröder, den ene av kött och blod och den andre en diktad gestalt, skugga.*, Lagercrantz, Olof August Strinbergu. Ungern: Wahlström & Widstrand Stockholm. 1982, f. 55.

Natyralizmi është qëllim filozofik i cili të gjitha dukuritë i ndërlihdh me shkaqet e vërteta, duke hedhur poshtë ndikimet transcendentale të fuqive të mbinatyrshe apo edhe të ndonjë përbërësi tjetër ideor<sup>4</sup>. Pra, sipas Strinbergut, natyralizmi kërkon që portretizimi i botës dhe i njerëzve të bëhet ashtu siç ata vërtet janë duke e vështruar atë në mënyrë objektive<sup>5</sup>. Ai ishte shumë i shqetësuar për faktin që forcat themelore të shoqërisë dhe besojnë se mjedisi i një njeriu dhe trashëgimia e tij formësojnë karakterin e një personi, e që është një dallim i madh midis natyralizmit dhe realizmit.<sup>6</sup> Ndërsa vetë natyra është një parim primar i cili qëndron në themele të krijimit të letërsisë natyraliste si derivat i të gjitha proceseve.

Pikërisht këto ishin ato pikëpamjet e Emil Zolës që ndikuan tek A. Strinbergu, sidomos ato pikëpamje që francezi i mori nga kritiku Hipolit Taine, e që ndërlihdhen me fushën e determinizmit, e pastaj edhe nga Claude Bernard, pjesën mbi metodat eksperimentale, ndërsa nga Darvini, pjesën mbi trashëgiminë e shenjave.<sup>7</sup>

#### NJË SHFRYTËZIM MJESHTËROR I MOTIVEVE EKSPRESIONISTE PËRKRAH ATYRE NATYRALISTE

August Strinbergu nga shkrimtarët e dramës pret që t'i përdorin edhe konceptet e reja të ndërtimit të personazheve – skena e *Zonjushës Gjulia* duhet të jetë e “banuar” nga të gjallët, me qenie të plota e jo me karaktere njëdimensionale të cilat e fusin në lëvizje motive të thjeshtëzuara, gati-gati banale. Sipas Strinbergut, teatri është një punëtori psikologjike ku krijohen shpirtrat.<sup>8</sup>

Madje ka të ngjarë se Strinbergu është rebeluar kundër të njëjtave gjëra sikurse edhe Zola, e ato janë tema të “lustruara” të dramave të intrigës. Mirëpo për dallim prej Zolës, idetë e këtij mbi reformën ishin tjetërfare, pra të ndryshme, ndërsa eksperimentet në të cilat e kanë “degdisur” ato paraqesin krejtësisht forma të veçanta

---

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Book title: *What Was Naturalism: Materials for an Answer* Contributors: Edward Stone - Editor. Publisher: Appleton-Century-Crofts. Place of publication: New York, 1959.

<sup>8</sup> Boyko-Head, C., *A Lancanian Analysis of Miss Julie by August Strinberg and The Balcony by Jean Genet*, McMaster University, 1990, f. 64.

dramatike. Bile kjo pozitë është përshkruar saktësisht te paragrafi i parë i parathënies për *Zonjushën Gjulia* në vitin 1888, ku thuhet:

*“Ka kohë që teatri më është dukur – sikundër edhe arti në përgjithësi – si ndonjë ‘Bibel pauperum’, një bibël në fotografi për ata që nuk dinë ta lexojnë të shtypur apo të shkruar; ndërsa shkrimtari teator si ndonjë prift laik i cili i shpërndan mendimet bashkëkohore në një formë të popullarizuar, aq të popullarizuar sa që klasa e mesme, e cila kryesisht e përbën publikun teator, pa shumë mundime mund ta kuptojë se për çfarë është fjala. Për këtë arsye teatri gjithmonë ka qenë një shkollë popullore për rininë, për gjysmanalfabetët dhe për gratë, të cilët ia kanë dalë që akoma brenda vetes ta ruajnë atë forcë që ta mashtrojnë veten e tyre apo edhe duke e lejuar që të tjerët t’i mashtrojnë, do të thotë që janë të aftë t’u dorëzohen iluzioneve dhe të pranojnë sugjestionë nga shkrimtarët. Për këtë arsye, në kohën e sotme – kur duket se mendimet e retarduara, jo të plota, që realizohen me fantazi zhvillohen në të menduar, në hulumentim dhe shqyrtim – e bënë që teatri, njëllojshëm sikurse edhe religjioni në rrugëtimin që të fitojë formën e diçkaje që po zhduket, e për çka nuk mund të gëzohet, ngase na mungojnë parakushtet e duhura. Në favor të një shikimi të këtyllë flet kriza e teatrit e cila sundon në tërë Evropën, e jo më pak as rrethana e cila vendeve të kulturuar, të cilat i japin mendimtarët më të mëdhenj të të sotmes, siç janë Anglia dhe Gjermania, drama është krejtësisht e vdekur, siç është rasti edhe me shumicën e arteve të tjera.*

*Në disa vende të tjera është besuar se drama e re mund të krijohet me përplotësimin e formave të vjetra me të reja, me përmbajtje më bashkëkohore. Por kjo nuk ka ndodhur: E para, nga shkaku se mendimet e reja nuk e kishin akoma kohën që të popullarizohen mjaftueshëm në mënyrë që publiku të jetë në gjendje ta kuptojë se për çfarë është fjala; e dyta, për shkak se luftat partiake aq shumë i kanë gëlltitur shpirtrat sa që nuk ka mund të shfaqet ndonjë përjetim tjetër objektiv - ngase përderisa, nga njëra anë, do të krijoheshin kundërthënie deri atëherë, nga ana tjetër, shumica, duke e përfillur apo duke e vërshëlyer do të ushtronte një presion publik, ashtu siç ndodh përgjithësisht në sallën teatrore dhe e treta, ngase ende nuk janë gjetur forma për përmbajtje të reja, ashtu që nga vera e re kanë pëlçitur shishet e vjetra”.*<sup>9</sup>

<sup>9</sup> <https://sites.broadviewpress.com/lessons/Dramanthology/StrinbergMissGjulia->



Këto janë vetëm disa nga dilemat që Strinbergu i pati me teoritë e tij para kritikës, por edhe krijuesve të tjerë. Këto dilema ishin dy: natyralizmi apo ekspresionizmi?

Por edhe pse në dramën e tij asocijimi i parë yni bie te natyralizmi, Strinbergu mjeshhtërisht i ka shfrytëzuar edhe motivet ekspresioniste të thuash tek akëcila vepër, pra jo vetëm te *Zonjusha Gjulia*, dhe se aluzioni te fuqitë mistike, shfrytëzimi i simboleve, rituali i vallëzimit, festivalet pagane, mjegullnajat që përdor ai e dëshmojnë këtë për të cilën po flasim. Këto janë arsytet se pjesa më e madhe e studiuesve të dramës dhe e historisë së saj, si Cesare Mollinari, Ema Pleadini, Erika Fischer-Lichte, Ronald Harvud dhe të tjerë e konsiderojnë veprën e Strinbergut si një kthesë në dramaturgjinë moderne. Ibseni, sikundër e kemi thënë në këtë studim, në veprat e tij dramatike u shkëput nga traditat e poezisë së tragjedisë, duke e përdorur në vepra një lloj dialogu të konsiderueshëm, potent (muskulor) dhe të kursyer, shumë të përafërt me të biseduarit kolokuial, por është e qartë se Strinbergu ka vazhduar më tutje. Lidhur me këtë ai vetë do të shprehet:

*“U jam shmangur konstruksioneve matematikore dhe simetrike, ashtu siç bëhet kjo edhe në jetën e përditshme, që asnjëra nga temat e të konversuarit nuk shteron deri në përfundim, por një tru e pranon pa dashje atë me të cilin pajtohet. Në këtë mënyrë edhe dialogu im shtegton, duke u furnizuar me materie nga disa skena të mëhershme të cilat më pas do të përpunohet, të bëhet të pranueshme, të përsëritura, të përpunuara dhe të ndërtuara si një temë në kompozicionin muzikor”.*<sup>10</sup>

Në pjesët, siç është edhe kjo që pason në këtë dramë, Strinbergu me një stil të veçantë, por edhe të pazakontë për kohën kur e ka krijuar këtë vepër bën lojë duke i përsëritur frazat që i ka përdorur edhe më herët, ndërkohë që qëllimi i këtij veprimi të autorit është që këto përsëritje të përdoren vetëm si pjesë e diskutimeve ndërmjet personazheve në stilin që njëri prej tyre ia kthen fjalët tjetrit, duke e rikthyer në fakt situatën pararendëse si:

---

/StrinbergMissGjulia\_print.html

<sup>10</sup> Harvud, Ronald, *Istorijska pozornica – Celi svet je pozornica*, CLIO, Beograd, 1998, f. 280.

ZONJUSHA GJULIA

Ah, i tillë qenkeni...

ZHAN

E çfarë tjetër do të mund të isha, vallë? Vetëm nëpërmjet dërdëllitjes u hidhet laku femrave!

ZONJUSHA GJULIA

I pacipë!

ZHAN

Merde!

ZONJUSHA GJULIA

Dhe tanimë arritët ta shihni shpinën e shqiponjës...

ZHAN

Epo, jo tamam shpinën...

ZONJUSHA GJULIA

Domethënë që unë i bie të kem qenë ajo dega e parë...

ZHAN

Po, dhe ajo degë ishte e tëra e kalbur...

ZONJUSHA GJULIA

Dhe do të ishte dashur që të luaja rolin e tabelës me emrin e hotelit, domethënë...

ZHAN

Ndërsa unë vetë hotelin

ZONJUSHA GJULIA

Të ulesha brenda, të ndillja klientët tuaj, të falsifikoja llogaritë tuaja...

ZHAN

Me këto do të merresha unë...

ZONJUSHA GJULIA

E kush do të kishte menduar, vallë, se shpirti i një njeriu mund të ishte kaq thellësisht i fëlliqur!

ZHAN

Atëherë lajeni!

ZONJUSHA GJULIA

Shërbëtor, lake ngrihuni në këmbë kur denjoj të ju flas!

ZHAN

Konkubinë e shërbëtorit, e përdala e lakeut, mbylle gojën dhe hiqmu qafe! Pikërisht ti do të duhej të vije të më qortosh e të më quash horr!

Kaq vulgare sa ç'ke qenë ti këtë mbrëmje, asnjë nga ato të rangut tim, kurrë më parë s'pati qenë! A mos kujton ti vallë se një shërbëtore e çfarëdoshme e kërkon mashkullin në mënyrën tënde? A mos ke parë ti vallë ndonjë vajzë të kategorisë sime që ta japi veten (në shpirt e në trup) në mënyrën siç e dhe ti? Diçka të tillë e kam parë të ndodhë vetëm mes shtazëve dhe të përdalave.

Këtu e vërejmë saktë se August Strinbergu bën një përpjekje të qëllimshme që t'u shmanget marrëdhënieve simetrike në veprën e tij, gjegjësisht konstruksioneve matematikore në dialogët ndërmjet personazheve, duke e lënë që, tek ata, në mënyrë të rregullt të veprojnë mendja njerëzore dhe kështu ta konstruktojë realitetin ashtu siç e sheh dhe e kupton ai vetë, e që është i ngjashëm me realitetin në jetën e njëmendtë si dhe një vargu të tërë të kërkesave të tij e të cilat i shtron te parathënia e *Zonjushës Gjulia*. Ndërsa ky është ai elementi për të cilin themi se Strinbergu i vuri themelet e teatrit natyralist dhe mbase veprës më të inskenuar të Strinbergut *Zonjusha Gjulia*.<sup>11</sup>

## PËRPJEKJA QË TË KRIJOHET NJË GJUHË E RE SHPREHËSE NË DRAMË

*Zonjusha Gjulia* është dramë përmes së cilës autori, përpiket të bëjë një lloj shqyrtimi të rrjedhës psikologjike të subjektit dhe, në këtë mënyrë, bazamenti natyralist shërben si veprim metaforik përmes të cilit dehijerarkizohen mjete të caktuara të shprehjes teatrore, ndërsa vetë teksti i dramës në të njëjtën kohë shndërrohet në shembull të prodhuesit të vazhdueshëm të shenjave skenike. Secili element në këtë vepër e posedon të drejtën për vënie skenike të pavarur, pra dominimin dhe diskursin vetanak. Secili element do të thotë flet për identitetin e vet i cili, në varshmëri nga fuqia skenike që e posedojnë, i ka mundësitë e shumëfishimit, e që mund të lexohet si një lloj realiteti edhe për teatrin bashkëkohor, përmes një realiteti që e synon edhe vizualitetin dhe i cili pavarësisht nga arsyetimet teorike që mund të artikulojnë me këtë rast, rrjedh nëse jo edhe më herët, atëherë, sigurisht që nga koha e Didros dhe Gëtes, apo edhe që nga periudha e Zhulienit. Ta kujtojmë se me replikën fillestare të Zhanit për Zonjushën Gjulia, Strinbergu mjeshtërisht ia del që ta hapë një fushë

<sup>11</sup> Strinbergu, August, *Zonjusha Julie*, NB "Gjon Buzuku", Prishtinë. 2015, f. 54-55

të madhe të aksionit dramatik, që e jep lirinë e plotë të veprimit të personazheve në këtë dramë.<sup>12</sup>

Me një qasje të këtillë A. Strinbergu ka bërë përpjekje që në këtë pjesë të jetës së tij krijuese t'ia del ta krijojë një gjuhë shprehëse dramatike, e cila mund të konsiderohet krejtësisht fine - me ritme të shkëputura të të folurit dhe të të menduarit skenik si një prej elementëve më të fuqishëm të modernizmit. Por ka mendime se këto forma të të folurit janë krejtësisht të natyrshme dhe se vetvetiu rrjedhin në veprën e tij, por edhe mendime të tilla se, megjithëkëtë, ato janë kompozuar dhe orkestruar me një vëmendje dhe pedantëri të madhe nga autori.

Kur u përmendën ritmet e shkëputur, ritmet e dramave të Strinbergut, siç është *Zonjusha Gjulia*, ato gjithsesi janë mjaft specifike dhe po i krahasuam me ritmet në dramat e autorëve të tjera, ato dallojnë vërejtshëm me ato që i hasim ta themi te dramat e Ibsenit, por edhe te ato të Bernard Shout. Te këta dy të fundit ritmet janë shumë më të qeta se ato te drama e Strinbergut. Ndërsa në një dramë si kjo shohim se po këto ritme brenda vetes ngërthejnë doza të caktuara të ekspresionit, ndërsa ngrohtësia që vjen në fund të dramës mund të ndërlidhet pikërisht me ngrohtësinë e gjakut të personazhes kryesore të kësaj drame dhe jo me ngrohtësinë e diellit sikundër te të tjerët, ngase Gjulia gjatë gjithë kohës së rrjedhës së veprimit në dramë është e kuptueshme se flet si për diçka, apo edhe dikush që në fakt është në një proces të shuarjes. Ndaj këtu, sikurse edhe në disa prej veprave kryesore të këtij autori, haset ajo që mund të quhet *nocion i të diskutuarit*, për aq më shumë kur veprat e Strinbergut na cytin që ta fokusojmë vëmendjen tonë jo vetëm te jeta reale e personazheve, por edhe te krijimi i simboleve të ndryshme për të cilat kemi folur tashmë, pastaj edhe për pasqyrimin e ëndrrave jetësore të njerëzve të ndryshëm të cilat dallojnë në përmasat e pasqyrimin të dëshirave të tyre reale. Shfrytëzimi i simboleve në veprën e Strinbergut është rezultat i ndikimit të drejtpërdrejtë të Mejerholdit në dramën e këtij autori. Sidomos shenjat janë të vërejtshme te drama e tij *Krimi dhe krimi*, ku duke shfrytëzuar simbolet, në radhë të parë të përdorimit të ngjyrës së verdhë si simbol i fajit të Morisit dhe të Henrijetës, e më pas shpërfaqet edhe ngjyra e zezë e cila e dominon skenën kur Morisi i merr dorezat e verdha dhe kravatën po ashtu të verdhë të marra si

<sup>12</sup> Robin on, *Miss Julie and Other Plays, Con – tributors, August Strinbergu*, Oxford, 1998, f. 134.

dhuratë. Ndërsa në fund e gjithë skena pllakoset nga ngjyra e verdhë, e shkëlqyer, si shenj shprese.

Në dramë hasim edhe një shprehje të kryeneçësisë e cila është një lloj fare kryengritëse në dramë, apo edhe mënyrë e të kuptuarit si dhe të pranuarit të gjërave të krijuara nga ambicjet e personazheve dhe qasjen e tyre ndaj njëri-tjetrit. Kështu, mu për këtë, në dramë *Zonjusha Gjulia* u “masakrua” nga trupa të ndryshëm të censurës, para së gjithash, siç shpreheshin ata, për shkak të përmbajtjes “shokuese” të veprës, duke u sorollatur rreth luftës së stërvjetëruar ndërmjet gjinive dhe klasave. Ndërsa pak a shumë ekziston një bindje se *Zonjusha Gjulia* s’është gjë tjetër veçse një si tërheqje e vërejtjes për gruan e tij të parë dhe të pafat, konteshës Siri nga Eseni. Kur e pyetën për këtë paralele Strinbergun, ai u gjej se e ka të vështirë që të jetë i bindur për këtë gjë, apo edhe, për çdo rast, jo në mënyrë të qartë dhe të mjaftueshme.<sup>13</sup>

Sido që të jetë, mund ta përsërisim se Strinbergu ka qenë një urrejtës patologjik i femrave, ndërsa ideja e tij ishte që zonjushën Gjulia ta paraqesë si një mostër para publikut. Disa studiues dhe kritikë të veprës së Strinbergut gjurmët e kësaj urrejtjeje i hasin edhe në disa nga veprat e tij të mëhershme, siç ishin për shembull *Martestat*, për të cilën u shpall heretik apo edhe *Manastiri*, që ishte një portret i ngrysur i martesës së tij të dytë.<sup>14</sup>

Strinbergu ishte i mirë si kritikues i shoqërisë, por i pabesueshëm për shkak që ai i mbrojti ndërrimet e këndvështrimet e shpejta duke bëri ndryshimin një cilësi të mirë. Sipas Knut Hamsun, ai ishte "një radikal, por një radikal reaksionar". Strinbergu besoi që "një vjershëtar vërtet duhet të sakrifikojë vetën si person për veprën e vetë", dhe ai në jetë flijoj jo vetëm vetën, por pa konsiderim edhe të tjerë për këtë arsye. Veprimtaria e tij është personale dhe intensive, që ai të gjejë udhët e veta, por edhe paralajmëroi drejtime letrare që e bëjnë atë të pëlqyeshëm. Strinbergu është shkrimtari më i madh në letërsinë suedeze.

<sup>13</sup> Meidal, Björn, Wanselius, Bengt, Strindbergs världar. Stockholm: Bokförlaget Max Ström, 2012, f. 116.

<sup>14</sup> Urrejtja e Strinbergut ndaj grave ishte trampolinë e shumë episodeve pikodramatike në jetën e tij, e të cilat ndikuan që në një moment të jetës së tij, ai të pushojë plotësisht në të shkruar, pas së cilës fazë nisin eksperimentet e tij për atë që e quajti „teatër intim“, duke e përdorur muzikën kamertale dhe duke e transponuar fokusin te personazhet dytësore, me shpresë se mund të krijonte personazhe më të mira.

## MBI PËRMBAJTJEN E DRAMËS ZONJUSHA GJULIA

Në kuzhinën e kontit bisedojnë shërbëtori Zhan dhe kuzhinierja Kristinë. Gjatë një bisede jo edhe aq të gjatë ata arrijnë të përfundimi se Zonjusha Gjulia është një femër mjaft e çuditshme, madje-madje e egër. Është festa e Natës së Shën Gjonit. Kristina mendon se sjellja e Gjulias para së gjithash është si shkak-pasojë e prishjes së fejesës së saj. Babai i saj nuk është në shtëpi, por asaj nate është një ngrohtësi e vërtetë pranverore. Nga ana tjetër, Zhan është i habitur se përse zonjusha në fjalë nuk është më shumë e kujdesshme ndaj çështjeve të cilat realisht kanë ndikim të hetueshëm te personaliteti i saj, para së gjithash duke vallëzuar me këdo që e oferton atë, ndërkohë që hove-hove sillet edhe si një adoleshente me sens tërbimi. Në këtë çast Gjulia futet në kuzhinë dhe aty zë fill një bisedë tjetër. Gjulia është mjaft e shtendosur dhe joshëse. Pinë bashkë me Zhanin dhe gjithnjë e më tepër ajo tregon afërsi me të. Nga ana e tij, Zhan fillon t'ia tërheqë vërejtjen se kjo që po bën Gjulia karshi tij nuk është mençuri dhe se njerëzit shumë shpejt do të fillojnë t'i përgojnë ata. Mirëpo Gjulia nuk brengosët për këtë gjë dhe vazhdon flirtimin e saj me shërbëtorin. Pas pak çastesh, edhe Jena nis flirtimin e tij me zonjushën, me ç'rast i thotë se ai që nga fëmijëria e tij ka qenë i dashuruar në të dhe se njëherë ka sprovuar të bëjë vetëvrasje, pasi që e kishte të ndaluar që të luante me të. Gjulia duket gjithnjë e më "e ndezur" dhe, pas pak, vendos që të shkojë me Zhanin në dhomën e tij. Në kuzhinë tubohen fshatarët e lumtur që pijnë dhe këndojnë një këngë të bukur. Pas largimit të fshatarëve nga kuzhina, duke dalë nga dhoma, aty kthehen Gjulia dhe Zhani, me ç'rast krijohet menjëherë përshtypja se tashmë shumëçka ka ndryshuar në raportin mes tyre. Tashti Zhan përpiket ta bindë Gjulia se është mirë që të ikin së bashku nga aty dhe që ta ndërtojnë një hotel diku në një vend tjetër. Por Gjulia është e vetëdijshme se një gjë e tillë është e pamundshme, dhe pavarësisht kësaj, ajo ka dëshirë të dëgjojë nga Jeni se ai e dashuron. Zhani nuk ndjen më asnjë lloj respekti ndaj saj, po ende gjithnjë e më tepër e përbuzë, duke mos hezitur t'ia thotë se edhe vajzat më të zakonshme gëzojnë më shumë respekt se ajo dhe se është fundosur në vetë fundin:

ZONJUSHA GJULIA

*(E dërmuar fare)*

Keni të drejtë! Goditmëni me shpulla, shkelmëni me këmbë; asgjë më të mirë nuk kam merituar Jam një e pacipë, unë; por ndihmomëni! Ndhimmomëni që të dal nga mjerimi im, nëse ekziston një mënyrë për ta bërë këtë gjë!

ZHAN

*(Më i zbutur)*

Nuk dëshiroj ta çnderoj veten gjer në pikën që të heq dorë nga nderi që ju pata joshur; por a besoni ju vallë se një burrë i rangut tim do të mund të kish guxuar t'i ngrinte sytë gjer në lartësinë tuaj, nëse ju vetë nuk do ta kishit provokuar atë? Akoma jam kaq i shushatur nga kjo gjë...

ZONJUSHA GJULIA

Dhe krenar...

ZHAN

E përse jo? Sidoqoftë duhet të bini edhe ju dakord se kjo ishte një fitore tepër e lehtë për të mundur njeriu të krenohet me të!

ZONJUSHA GJULIA

Goditmëni sërish pra!

ZHAN

Jo! Përkundrazi, falmëni ju lutem për gjithçka që nga goja ime doli! Unë nuk guxoj që ta godas një person të pambrojtur, e aq më pak një grua. Megjithatë nuk mund ta mohoj se më jep kënaqësi fakti që kam



konstatuar tashmë se ajo çfarë, këtu lart, në nivelin e rangut tuaj, shkëlqen aq fort, sa neve të rangjeve të ulëta na verbon, në të vërtetë nuk është gjë tjetër veç një flori falas; se shpina e shqiponjës është edhe më e murrme; se mollëzat fisnike janë të kuqe veç nga trupimi, se thonjtë e ndritshëm mund t'i kenë majat e zeza dhe se shamtë tuaja prej batisti të rafinuar janë gjithë djersë, sado që me aromë vjollcash të jenë parfumuar... Nga ana tjetër, më vjen fort keq të shikoj se gjithçka që pata aspiruar nuk është as e lartë dhe as e fuqishme; më dhemb shpirti tek ju shikoj që keni rënë kaq poshtë, sa që tashmë gjendeni në nivelin e kuzhinieres suaj; më dhemb njëlloj sikur i shikoj lulet e vjeshtës të rrënuara nga breshëri dhe të shndërruara në bimë të fëlliqura!

## ZONJUSHA GJULIA

Jeni duke më folur sikur tanimë të ndodheshit tërësisht më lart se niveli im!

## ZHAN

Dhe faktikisht aty ndodhem tashmë, sepse, shikoni, unë fare mirë mund t'ju bëjë juve konteshë, ndërsa ju mua kurrë nuk do të mund të më bëni kont.<sup>15</sup>

Këtu e kuptojmë se ai e ka superioritetin mbi personalitetin e Gjulias dhe se, në fakt, asnjëherë nuk e ka dashur atë, duke krijuar kështu një gjendje që pikërisht kjo rrethanë t'i shkaktojë neveri të madhe.

Pastaj Zhan ia rrëfen tregimin mbi familjen e tij, nënës dominuese e cila e ka rritur si dhe për babain që gjithmonë ka lëshuar pe për çdo gjë dhe i cili asnjëherë nuk ka pasur forcë që t'i kundërvihet nënës, anipse ajo e ka tradhtuar, ia ka djegur fermën dhe, përfundimisht, e ka përulur e shtri përdhe. Ai konstaton se nëna i ka urryer meshkujt dhe se Gjulia duhet t'i betohej se as ajo nuk do të pranojë asnjëherë në jetë që të shndërrohet në shërbëtoreshë të meshkujve.

<sup>15</sup> Strinbergu, August, *Zonjusha Julie*, NB "Gjon Buzuku", Prishtinë. 2015, f. 60-61.

Nga ana e saj, Gjulia e di mirë se për të dhe Zhanin nuk mund të ketë ndonjë të ardhme. Ajo është një mbetje e degjeneruar e shtresës të cilës i përket dhe e cila po zhbëhet, ngase po e shkatërrojnë gjenet e dobëta si dhe rrethi jo i shëndetshëm, përderisa Zhani është një rezil ambicioz i cili, duke i falënderuar vullnetit të vetë, por edhe arrogancës, po ia dilte në shkallëzimet shoqërore. Zhani gjithashtu nuk është i vullnetshëm që të lëshojë pe para dëshirave të Gjulias për të ikur duke u përpjekur që ta bindë Gjulian që ajo të marrë udhë e vetme. Gjulia është plotësisht e pavullnetshme aq sa, nga oportunitizmi i saj karshi qëndrimit të Zhanit, ajo madje i lejon atij që të japë urdhra. Ai gjithashtu ia bën me dije se për një grua të origjinës së saj gjëja më e mirë që do të duhej ta bënte në këtë rrethanë do të ishte që t'ia merrte jetën vetes. Gjulia, pas kthimit të papritur të babait të saj, trishtohet duke e kuptuar se çfarë ka bërë nga vetvetja. Ajo e lut Zhanin që ta urdhërojë atë që të bëjë vetëvrasje, ngase vetëm këtë gjë nuk do të mund t'ia bënte vetes me dëshirë. Zhani disa çaste mëdyshtet dhe, kur zotëria i bie ziles, ai vendosë që Gjulian ta shpiej drejt vdekjes.

### ZONJUSHA GJULIA APO NJË SHPREHJE E FUQISHME DRAMATIKE

*Zonjusha Gjulia* është shkruar, siç e kemi theksuar, në vitin 1888, në kohën kur August Strinbergu për të dytën herë, por tashti gjithsesi më qëndrueshëm dhe për një kohë shumë më të gjatë mahnitet nga natyralizmi, i cili në veprën e tij gjithmonë ka qenë i orientuar vendosmërisht nga psikologjia, madje shumë më shumë se sa ai francez i cili një vëmendje të madhe ia ka kushtuar vështrimit më të hollësishëm si dhe të fotografimit të dukurive të jashtme. Pikërisht është kjo dramë një shembull klasik i natyralizmit psikologjik strinbergian dhe në të njëjtën kohë përfaqëson edhe shqyrtimin më të rëndësishëm të këtij stili në dramatikë.

Konflikti në tragjedinë *Zonjusha Gjulia* pa dyshim është një shprehje e fuqishme dramatike. I ndërtuar në kundërthëniet ndërmjet mashkullit dhe femrës në përgjithësi dhe i mprehur me teh të mprehtë deri te përplasja ndërmjet vitales, të pahijshmes, por edhe të vendosmërisë dhe mashkullit këmbëngulës dhe aristokrates së degjeneruar, si dhe i përshkuar me një lloj , të thuash, prirjeje perverze drejt shkatërrimit, pra të një lloji të mazohizmit, prirje kjo që Gjulian e tërheq “drejt fundit”. Do të thotë se fjala është për një vepër ku vihet

re një shikim tejet interesant autorial mbi këto marrëdhënie, si dhe një shikim natyroro-shkencor-vital i konfliktit efektiviteti i të cilit varet nga mënyra e trajtimit si dhe e formësimit.<sup>16</sup> Por këtu, megjithatë, një mënyrë parimore natyraliste e formësimit (siç është ai i Strinbergut) nuk është më i përshtatshmi në krijimtarinë e dramës.

Nëse do të kishim dëshirë që në mënyrë më të thelluar ta shqyrtojmë ndikimin e natyralizmit të të gjitha veprimet në *Zonjushën Gjulia*, kjo do të na shpinte pa dyshim te një shqyrtim shumë i gjatë dhe shumë i detajuar i tërë veprës. Ndaj themi se është krejtësisht e mjaftueshme që këtu të shtrohet një shikim të vetëm dy elementëve të kësaj tragjedie natyraliste, do të thotë të skicimit të karaktereve të veprës si dhe të dialogëve në mënyrë që të shihet se si këtë autor natyralizmi e tërhoqi nga një dramatikë e pastër e deri tek ajo e vërteta.

Me vetëdijen e njeriut i cili në mënyrë parimore e ndjek drejtimin, vetë Strinbergu mbi kompozimin e karaktereve të tij thotë si në vijim:

*“Shpirtrat e mi (karakteret) janë konglomerat i shkallëve të kaluara kulturore si dhe atyre që ende vazhdojnë, themia nga librat dhe gazetat, pjesë të njerëzve, arna të shqyer të kostumeve festive që janë të rjepura deri në leckosje në po të njëjtën mënyrë siç është i konstruktuar edhe shpirti njerëzor në esencën e tyre”<sup>17</sup>*

Janë këto fjalë të këtij autori të cilat e bëjnë zbulimin e aspiratës, e cila qëndron në harmoni të plotë me estetikën natyraliste si doktrinë, por mbase edhe me realitetin e zakonshëm kur flitet mbi konsekuencën e formës e cila August Strinbergut i rezultoi me sukses në mënyrë të plotë. Por pikërisht nga fakti se kjo që ka bërë Strinbergu në këtë vepër është treguar në mënyrë të shkëlqyer në shpërfaqjen e shpirtrave të personazheve të tij, ndeshemi me një lloj mjegullnaje si dhe me një papërcaktueshmëri pikërisht në konfliktin qendror të *Zonjushës Gjulia*, ngase ky konflikt është i qartë dhe i kuptueshëm vetëm atëherë kur në dramë bëhet përballja, gjegjësisht kundërvënia e dy personazheve konkrete dhe të përcaktuara mirë. E që konflikti të

<sup>16</sup> Wverdell, William R., *The First Moderns: Profiles in the Origins of Twentieth-Century Thought*, University of Chicago Press, Chicago., 1997, f, 216..

<sup>17</sup> Williams, Raymond, *Drama from Ibsen to Brecht*, Chato & Windus, London, 1968, f. 91.

jetë i pastër, drama kërkon një lloj të thjeshtëzimit të karaktereve apo të shpirtrave, thjeshtëzim i cili synon që akcilin personazh ta paraqesë si inkarnacion të këtij apo edhe të atij parimi jetësor ose, thënë më mirë, disa fuqi jetësore të elementeve. Në mesin e personazheve të cilët në këtë mënyrë janë paraqitur në këtë vepër, konflikti është pashmangshëm i shprehur dhe i përcaktuar mprehtë.

Sa i përket karaktereve të dramës *Zonjusha Gjulia* në parathënien e kësaj drame thuhet:

*“Gjatë kalimit të kohës fjala karakter e ka fituar një domethënie të shumëkuptueshme. Fillimisht ajo e përshkruante vijëzën dominuese të kompleksit shpirtëror, ndërsa shpirti është i përzier në përmbajtje në veçanti në rrafshin e temperamentit. Më pastaj kjo fjalë u shndërrua në një term mikroborgjez për automat, pra për dikë natyra e të cilit është bërë e fiksuar apo edhe e dikujt i cili tashmë i është përshatur një roli special në jetë. Në fakt, një personazh i cili ka pushuar tashmë që të zhvillohet më tej, ndërsa ai karakter që do të vazhdonte të rritej, thjesht u quajt njeri i pakarakter në kuptimin negativ të fjalës, natyrisht, nga fakti se atë është e vështirë për ta kapur, për ta klasifikuar si dhe për ta ndjekur. Ky koncept mikroborgjez mbi imobilitetin e shpirtit është bartur edhe në teatër, e i cili te qytetaria mikroborgjeze ka dominuar gjithmonë. Kështu, karakteri nisi që njeriun ta vështrojë si të fiksuar dhe të kryer: ... Për këtë arsye unë, thotë Strinbergu, nuk besoj në periudhat e thjeshtëzuara të karaktereve teatrore (...) Shpirtrat e mi (karakteret) janë konglomerate të fazës së kaluar dhe kësaj të tanishmes së qytetërimit”.*<sup>18</sup>

## STRINBERGU: LËVIZ NË RRETH QË KONFLIKTIT THEMELOR TË DRAMËS T’I RRËMBEHET MPREHTËSIA DHE FUQIA

Njësoj sikurse edhe në të të skicuarit të karaktereve, parimshmëria natyraliste e Strinbergut ka ndikime edhe te dialogu në të cili gjithashtu flet te parathënia e *Zonjushës Gjulia*, në pjesën kur flet për shmangien e *simetrisë dhe matematizimit të dialoguar të konstruktuar në mënyrë franceze*.<sup>19</sup> Këtu vetë autori e pranon se në veprën e tij kemi të bëjmë me një dialog me amplituda të ndryshme i

<sup>18</sup> Shiko te parathënia e autorit për dramën *Zonjusha Gjulia*.

<sup>19</sup> Po aty.

cili “noton” andej-këndeje, por që nuk e shteron asnjë çështje, ngase nuk ka dyshim se në kontradiksion me një shfaqje të ngurtë mbi dialogun e vërtetë të dramës, i cili për shkak të ekonomizimit të vërtetë në dramë gjithmonë duhet të jetë e përshtatshme, adapte dhe e aplikueshme edhe në këtë përshtatshmëri shteruese. Për dialogun sorollatës është e domosdoshme edhe ajo dialektika e huaj dramatike të cilën Gëte e madhëron kur flet për Antigonen, e që ka të bëjë me atë dialektikë drejt së cilës dialogu vendimtar zhvillohet në atë mënyrë që në konflikt i ndërthurë anët me besueshmëri të lartë, të cilat me këmbëngulje i mbrojnë qëndrimet e tyre si dhe bindjet përmes formulimeve më racionale dhe më të thella që kanë. Por në vend se në këtë mënyrë “matematikore” të shkallëzohen, dialogu në këtë vepër të Strinbergut lëviz në rreth, e që konfliktit themelor të dramës ia rrëmben mprehtësinë dhe fuqinë e tij.

Veçoritë e këtilla janë përbërëse për *Zonjushën Gjulia* në veçanti, nëse këtë çështje do ta vështrojmë nga këndvështrimi dramaturgjik dhe dramatik. Me këtë, kuptohet, nuk është e shteruar as e shënjuar veçoria artistike e kësaj vepre në të cilën në një plotni të pazakontë shprehet fuqia krijues e Strinbergut. Fuqia me të cilën ai i formëson këto karaktere të pazakonshme dhe të komplikuar apo edhe të shpirtave me të cilët i bashkon dhe i konstrukton pjesët, copëzat dhe arnat dhe lecat e elementëve njerëzorë në personalitete që janë gjithmonë të gjallë dhe të tëra. Në fakt edhe ky është një element i dramës moderne, sepse me këtë qasje Strinbergu nuk e “fotografon” personazhin si qenie e krijuar nga ndikimet evolutive darviniste – natyraliste (bilogjike), por para së gjithash si një personalitet me individualitet krejtësisht unikal, i cili është rezultat edhe i shumë faktorëve të tjerë pos atyre të biologjisë, e që e dëshmon se kjo fuqi është vërtet një fuqi krijuese.

Në këtë dramë të A. Strinbergut është tronditës sinqeriteti përmes të cilit zbulohen fshehtësitë, e në veçanti ndjenjat jo të bukura të shpirtit njerëzor si dhe shikimi i pagabuar nëpër labirintet e errëta të atyre dy zemrave problematike dhe shkatërruese të Gjulias dhe Zhanit. Te *Zonjusha Gjulia* është e habitshme edhe “transheja” me plot zikzake nga e cila në mënyrë të pandërprerë, me plot gjallëri dhe të thuash në çdo pore të veprës në fjalë vlon dialogu i pasur, lëvizës dhe shpirtëror strinbergian. Përbërja e begatë e mendimeve krijon përshtypjen se nuk mund të shterohet asnjëherë, ndaj dhe rreth August Strinbergut buron një shkëlqim i përqendrimit të vlershëm njerëzor si

dhe i synimit që të arrihet tek e vërteta, paçka se është e eklipsuar nga ajo që është detyruar që ta përjetojë zemra e tij.

### FRIKA NGA FEMINIZMI I HERSHËM EVROPIAN

Të kthehemi edhe njëherë te parathënia e *Zonjushës Gjulia*. Në këtë parathënie i bëhet një përshkrim tejet interesant personazhes kryesore të veprës së tij, Gjulias. Ai atë e portretizon si një grua me një tru të dobët dhe jointligjente. Në dramë Zhani e komenton atë që ai e quan sjellje çmendurake të Gjulias. Zonjusha Gjulia është një femër e sëmurë, ndërsa ajo sëmundje tashmë e ka gjykuar atë që të përfundojë me shkatërrim. Kështu del se A. Strinbergu në këtë vepër i shpërfaq interesimet e tij mbi psikologjinë deri në atë shkallë sa që në dramë, jo rrallë, hasim përshkrime, madje të detajuara të patologjisë së Gjulias. Me këtë rast mund të ndalohej te dy nocione relevante të psikologjisë nga koha e August Strinbergut: histeria si dhe ajo që autori përpiqet ta paraqesë si mazohizëm. E pra histeria tradicionalisht është konsideruar të jetë një sëmundje femrash, ndërsa në fund të shekullit XIX ajo u definua të jetë një sëmundje që i “godet” femrat në ato çaste kur ato nuk ia dalin apo edhe kur i refuzojnë që t’i pranojnë dëshirat e tyre seksuale dhe kur nuk shndërrohen në objekt seksual<sup>20</sup>. Këtë mund ta kuptojmë edhe si përpjekje të Strinbergut që lexuesit dhe shikuesit e veprës së tij Gjulian ta shikojnë si një femër të frustruar dhe mbi të gjitha hysterike, aq më tepër kur atë meshkujt e neveritin, por dhe në të njëjtën kohë e tërheqin edhe në kuptimin e seksualitetit, e edhe në mënyra tjera.<sup>21</sup>

Strinbergu, nga frika prej feminizmit të hershëm evropian, problemin e Gjulias ia përshkuan nënës, e cila ka besuar në barazinë e gjinive dhe e cila me të vërtetë i ka urreyer meshkujt. Gjithashtu në një mënyrë e akuzon edhe babain e munguar shpesh, i cili në edukimin dhe formimin e Gjulias nuk kishte kurrfarë kontributi. Gjulia nga e ëma e trashëgoi urrejtjen për meshkujt, ndaj dhe në atë mënyrë që e bën ajo mëton ta sprovtojë të fejuarin e saj duke ëndërruar gjatë kësaj kohe për shkatërrimin e gjinisë “mashkullore”.

<sup>20</sup> Williams, Raymond, *Drama from Ibsen to Brecht*, Chato & Windus, London, 1968, f. 106.

<sup>21</sup> Gilman, Richard, *The Making Modern Drama*, Da capo Press, Inc, New York, 1987, f. 103

Përveç sadizmit (kënaqësia e fituar nga dhembja e të tjerëve), Strinbergu është i interesuar edhe për mazohizmin e Gjulas (kënaqësinë nga dhembja personale) veçanërisht i identifikuar si i femrave. Kur Gjulia propozon vetëvrasjen, Zhan e pohon se ai vetë kurrë nuk do të mund ta bënte një gjë të tillë dhe se dallimi ndërmjet gjinive është ai se meshkujt nuk janë mazohistë, ndërsa femrat janë. Kështu, Gjulia në fakt e përmbylli jetën e saj duke iu nënshtruar vullnetit të Zhanit, ndërsa ky, siç mund ta kuptojmë nga skena e fundit, i ngeli lojal kontit.

Nga ana tjetër, R. Gillman, në studimin e tij për këtë vepër të Strinbergut mendon se është tejet interesante që të bëhet edhe analizimi i rolit të Zhanit e në veçanti të sjelljes së tij e cila në rrafshin social është plotësisht e ndryshme nga ai i Gjulas (ajo me gjak aristokrateje e ai shërbëtor, fëmijë fshatari), por ai punon te vetja: mëson frëngjisht, di ta degustojë verën – ka punuar si *sommelier* dhe ka ambicje që një ditë ta hapë një hotel në Zvicër, gjë që është tregues se çfarë ambicje e udhëheqin dhe se si, me të gjitha forcat që ka, bën përpjekje që ta ndryshojë, gjegjësisht ta avancojë statusin e tij shoqëror për të kaluar në “shtresën e lartë”.<sup>22</sup>

Zonjusha Gjulia, siç u kuptua tashmë, është një e sëmurë psikike, ndaj dhe nuk ka aftësi që t’u përshtatet rrethanave në të cilat, në fund, nuk arrin ta ketë asnjë lloj kontrolli mbi veten. Këtu kemi të bëjmë me një motiv darvinist, i cili në harmoni me parimet e të shkruarit në natyralizëm mund të jetë edhe një prej veçorive të vetë August Strinbergut dhe gjendjes së tij të rënduar shpirtërore, për të cilin shumë biografë të tij e theksojnë se ishte një person i sëmurë psikikisht, ndërsa përmendet se si ai jetën e tij, në mënyrë të vetëdijshme dhe me qëllim, e shndërron në një vepër letrare, në dramë, pra duke u identifikuar me personazhe të ndryshme aty (...), por duke i ndryshuar në mënyrë të vazhdueshme rolet që do t’i shërbejnë si paradigma.<sup>23</sup>

I këtij mendimi është edhe studiuesi kroat G. Ferçec i cili në punimin e tij *Dialogu pa rrjetë mbrojtëse* e thotë se Zonjusha Gjulia u krijua nga fundi i periudhës kyçe të zhvillimit të karakterit dhe fillimit të sëmundjes së autorit, pra atëherë kur pikërisht në raport me gratë bën përpjekje që t’i zgjidhë disi konfuzionet e tubuara të cilat, siç e theksuam më lart, i mbetën nga e ëma e tij dominuese në familje, për

<sup>22</sup> Po aty, f. 105.

<sup>23</sup> Peternai, Kristina, *Andjeo u kući ili demon u krevetu*, ALEPH No 10/11, 2003, f. 35.

shkak të së cilës praktikisht gjatë gjithë jetës është ndjerë të jetë një person i parealizuar.<sup>24</sup> Pamundësia për prezencë mentale të nënës së tij gjatë gjithë jetës Strinbergun do ta mbajë larg grave të cilat i takon, prandaj e zhvillon një urrejtje të pakufishme për to. E tëra kjo periudhë u shënua me dominimin e subjekteve femërore në veprën e Strinbergut, por edhe me përpjekjet e tij që të ikë nga kjo gjendje njëkohësisht duke e poseduar një nevojë personale dhe emocionale që të rikthehet dhe të “qëndroj” sa më pranë atij subjekti duke ia krijuar shkrimtarit nevojën për diçka të tillë. Dhe mu kjo gjendje, ky vizion i tij për t’i portretizuar femrat si të tilla, këtë qasje jo vetëm në botën e dramës dhe të letërsisë në përgjithësi, por edhe në shkencat shoqërore dhe në psikologji e përkufizon si “Antifeminizëm i Strinbergut”.

### NATYRALISTËT PËRPIQEN QË DIALOGËT E VEPRËS T’I PARAQESIN ASHTU SIÇ FLITET NË PËRDITSHMËRI

Te *Zonjusha Gjulia* August Strinbergu ka dashur të paraqesë atë se qeniet njerëzore nuk posedojnë liri, as vullnet, apo mbase edhe po e patën atë e kanë shumë të pakët, ngase trashëgimia dhe rrethi i tyre aq të fuqishëm në ruajtjen dhe kultivimin e rrjedhave të veprimit njerëzor sa që është shumë e vështirë që të ndërhyhet aty për të ndryshuar çfarëdoqoftë. Gjithashtu e mendon se qeniet njerëzore nuk kanë shpirt, ndërsa besimi dhe morali janë të parëndësishme.<sup>25</sup>

Një krijimtari letrare do të duhej që ta paraqesë jetën të atillë çfarë ajo në të vërtetë është, pa teprime, prejuridikime, rrëfime pendese të personazheve, pa paragjykime dhe zbukurime, që do të thotë në mënyrë objektive. Në këtë rrafsh gjejmë se natyralizmi është i përafërt me realizmin. Por ai shkon më larg se sa realizmi në kuptimin se bën përpjekje që ta prezantojë fotografinë e detajuar të jetës së përditshme, përderisa realizmi i shmang detajet e “parëndësishme” kur e bën përshkrimin e një skene të caktuar. Bile-bile shkrimtari natyralist i inkorporon ato në vepër. Gjithashtu ai mëton që skena të jetë sa më shumë që është e mundshme e “natyrshme” dhe të jetë pa ekuivoke objektive dhe e qetë. Më me kënaqësi natyralistët, në vend që të manipulojnë me personazhet si me kukullat apo edhe me marionetat,

<sup>24</sup> Fercec, Goran, *Dijalog bez zaštitne mreze*, www.hnksi.hr/vijest.asp?dID=174, (shikuar për herë të fundit me 11.1.2020).

<sup>25</sup> Në kohën kur e ka shkruar dramën *Zonjusha Gjulia*, August Strinbergu ka qenë ateist dhe, tek më pas është kthyer te krishterimi, madje nën ndikimin e veprave të Emanuel Suedenborgut.



kanë dëshirë që ato personazhe t'i kundrojnë sikur të ishin kafshë të egra e të lira dhe më pas të informojnë mbi aktivitetet e tyre. Më në fund natyralistët përpiqen që dialogët e veprës t'i paraqesin siç flitet në përditshmëri, në vend të ndonjë dialogu të konstruktuar dhe të "fatur" në gojën e personazheve të dramës, duke i gjetur mënyrat e të folurit të njerëzve në një kohë, në një hapësirë, por edhe në një situatë të caktuar.

Ja një shembull me të cilin do ta ilustrojmë këtë që u tha më lart:

*(Tregon nga Kristina, e cila e ulur në një karrige, pranë vatrës, ka rënë në gjumë të thellë.)*

ZONJUSHA GJULIA

Do të jetë pa dyshim një bashkëshorte e këndshme ajo kur të bëhet e juaja. Mos gërhet, rastësisht?

ZHAN

Jo, nuk gërhet, por flet në gjumë.

ZONJUSHA GJULIA

*(Me cinizëm)*

Hehehehe: po ju, nga e dini këtë gjë?

ZHAN

*(Paturpësisht)*

E di, sepse e kam dëgjuar.

*(Pauzë gjatë së cilës të dy vështrojnë njëri-tjetrin)*

ZONJUSHA GJULIA

Po për se nuk uleni, vallë?

ZHAN

Nuk guxoj t'ia lejoj vetes këtë në praninë tuaj!

ZONJUSHA GJULIA

Po nëse do t'ua urdhëroja unë?

ZHAN

Atëherë do t'ju bindesha.

ZONJUSHA GJULIA

E atëherë uluni! Por, një moment! A nuk më jepni dot vallë, para së gjithash, diçka për të pirë?

ZHAN

Puna është se nuk e kam idenë se çfarë ka në qilar... Besoj se nuk ka asgjë tjetër veç birrës.

ZONJUSHA GJULIA

E kush e çanë kokën se ka veç birrë? Jam njeri me shije të thjeshta unë; dhe e parapëlqej përherë birrën krahasuar me verën.

*(Zhani shkon te qilari, merr aty një shishe birre dhe e hap atë; merr edhe një gotë dhe një pjatë dhe ia shërben zonjushës)<sup>26</sup>*

---

<sup>26</sup> Strinbergu, August, *Zonjusha Julie*, NB "Gjon Buzuku", Prishtinë, 2015, f. 22-23.

## NËPËR PERSONAZHE TË ZONJUSHËS GJULIA

E veçantë e kësaj dramë, s' do mend, është karakteri i Gjulias. Një zonjushë njëzet e pesë vjeçe, e bija e një konti të njohur, është heroina tragjike e kësaj veprë të Strinbergut. Karakteristika e saj më e shquar është ajo se nuk heziton ta deklarojë se i rrenë meshkujt.

I urren meshkujt si pasojë e ndikimit që te ajo ka ushtruar nëna e sadiste, se i është pjekur në mendje që pozita e saj në shoqëri e në veçanti në pronat familjare, të shumta që i kanë e bën superiore ndaj shërbëtorëve të familjes. Mirëpo tundimet e saj seksuale atë e hedhin pikërisht në kraharorin e shërbëtorit Zhan, i cili faktikisht për të përfaqëson gjithë atë që e urren Gjulia, pra mashkullin dhe shërbëtorin e bindur.

Për ta zbrërthyer më lehtë dhe më thjeshtë filozofinë e këtij teksti dramatik na ndihmon August Strinbergu te parathënia e *Zonjushës Gjulia*, ku faktikisht ai nuk e bëri një parathënie të zakonshme, siç mund ta kemi hasur aty-këtu në veprat e dramaturgëve të tjerë, por me saktësi e bën edhe interpretimin e veprës, me çfarë e dëshmon mendimin se kur autori ia shkruan parathënien dramës së vetë, kjo është vetëm një dëshmi i shpërfaqjes së emocioneve të tij, pastaj edhe të filozofisë së tij si dhe të qëllimeve që ka ai autor në krijimin e veprës në fjalë.<sup>27</sup>

Në këtë parathënie A. Strinbergu shkruan mbi ato gjëra që janë faktorët kryesor të cilët e motivojnë Zonjushën Gjulia të pozicionohet dhe të sillt ashtu siç e praktikon ajo:

*... Instinkti i lindur i nënës, edukimi i gabueshëm nga ana e babait, si dhe ndikimi i të fejuarit të saj tek truri i "dobët".<sup>28</sup>*

Strinbergu këtu e thekson edhe mosprezencën e madhe të babait në jetën e Gjulias. Autori është i interesuar edhe për psikologjinë dhe ky përshkrim që i bën karakterit të Gjulias është një lloj i diagnostifikimit të asaj për të cilat vetë Strinbergu mendon se janë të meta të Gjulias.

<sup>27</sup> Översättning av Balić-Matetić, B., Budak, S., Buljan, M., Kulundžić, J. Och Matetić, Z. Stålhammar, M. Att, *Översätta är nödvändigt. Falun*, ScandBook, Stokholm, 2015, f. 304.

<sup>28</sup> Strindberg, August, *Gospodjica Julija - Otac*, "Reč i misao", Beograd, 1960, f. 3.

Zonjusha Gjulia është edukuar nga një nënë feministe e cila i urrente meshkujt për çfarë edhe Gjulia herë është e neveritur prej tyre, por ekzistojnë edhe herë të tjera kur atë e tërheqin ata.

Gjulia është e trishtuar nga seksi, por është e gatshme që të flirtojë me gjininë e kundërt duke dhënë shenja se ajo e preferon atë. Urrejtja e saj ndaj meshkujve madje i shpie deri tek ajo dëshirë që ata, pra meshkujt, t'i shndërrojë në robër të sadizmit të saj. Por në fund mund të konstatohet se *Zonjusha Gjulia*, para së gjithash, është një dramë mazohiste, kur e shohim se është pikërisht Gjulia ajo që e “mirëpret” thyerjen e saj psikike, ndërkohë që pak a shumë Strinbergu e akuzon pikërisht atë për rënien që pëson. Siç e thamë tashmë, Gjulia i dorëzohet shërbëtorit Zhan, i cili pjesërisht vë në pah figurën e tij, madje atërore, të cilit i lutet dhe përgjërohet që ta shpëtojë dhe “ta thyejë”, në kuptimin që ta joshë dhe t'i kërkojë asaj që ta shfrytëzojë seksualisht. Ndërsa sa i përket kësaj mund të diskutojmë mbi atë se a thua Zonjusha Gjulia dhe fati i saj tragjik faktikisht i zbulojnë fantazirat mizogjene të August Strinbergut?!

Nga ana tjetër, personazh i fuqishëm i kësaj drame është edhe ai i shërbëtorit Zhan, një tridhjetvjeçari të klasës së ulët shoqërore dhe i pa kurrfarë ndikimi. Por Zhanin, edhe pse është një shërbëtor, Strinbergu e nxjerr të jetë edhe i mençur, edhe elokuent i cili në bisedat që zhvillon mund të përdor edhe fraza të caktuara frënge<sup>29</sup> të cilat i ka mësuar përmendsh në kohën kur ka punuar si “sommelier” në Zvicër. Por ai e di se kjo gjë dhe kjo lojë fjalësh, madje në gjuhë të huaja, mund të jetë edhe joshëse për Gjulian:

## ZHANI

(...) Për mua, ju ishit simbol i pamundësisë së të dalë nga rrethi i njerëzve mes të cilëve patët lindur.

## GJULIA

Është vërtet sharmante mënyra juaj e të shprehurit! Mos keni ndjekur ndonjë shkollë?!

<sup>29</sup> Williams, Raymond, libri tashmë i cituar, f. 110.

## ZHANI

“Pak, të them të drejtën, por kam lexuar shumë romane dhe kam vajtur shpesh në teatër. Gjithashtu përherë i kam dëgjuar bisedat e njerëzve të ngritur dhe mbi të gjitha prej tyre kam mësuar gjithçka”.<sup>30</sup>

Pra, Zhani përfaqëson shtresën e ulët të shoqërisë nga fundi i shekullit XIX në kohën kur kanë filluar që, në mënyrë të fuqishme, të hidhen poshtë dallimet klasore duke ua mundësuar pjesëtarëve të shtresës së “ulët” që të nxjerrin kokë dhe të fillojnë të jenë të barabartë në shoqëri me “të lartit” dhe të fuqishmit. Kur Zhani joshet nga zonjusha me magjepsjen e pafuzueshme, ai e thërret atë në dhomën e vetë dhe, sipas Strinbergut, mu këtu thyhet dhe përthyhen kufijtë e shtresave shoqërore.

Ky është ai çasti që Zhanin e mbyt në ëndrra dhe në fantazi dhe ai nis që të ëndërrojë, paqartësisht, se një ditë do ta hapë hotelin e vet dhe se do të ngrihet në shoqëri si një kont i vërtetë, siç është ta themi edhe i ati i Gjulias. Por me zhvillim e sipër të veprimt, ai nuk mund që të dalë nga “gëzhoja” e vet dhe vazhdon të mbetet vetëm një shërbëtor i zakonshëm. Gjithashtu, në këto andralla Zhani e shikon Gjulian të nënshtruar, e për shkak të këtyre fantazirave madje nis ta përbuzë atë dhe mos t’i honeps urdhrat e saj, duke mos qenë më kështu një shërbëtor i bindur. Ndaj kjo fantazi dhe këto sjellje “rebelimi Zhanin e shtyjnë dalëngadalë drejt të qenit një sadist i urryer i cili kënaqet tej mase me shkatërrimin e Gjulias. Por përkundër të gjitha krekosjeve, në fund të dramës që të dy ndjejnë dhe nuk e fshehin frikën duke iu nënshtruar autoritetit të Kontit, e që në fakt është autoriteti i babait (të Gjulias) dhe i padronit (të Zhanit).

## ZHANI

Po, por...

*(Zilja bie fort. Gjulia brof në këmbë: Zhani e ndërron nxitimthi xhaketën.)*

<sup>30</sup> Strinbergu, August, *Zonjusha Julie*, NB “Gjon Buzuku”, Prishtinë. 2015, f. 37-38.

ZHANI

Konti qenka në shtëpi! Dhe Kristina që nuk është këtu... mendoni!...

*(Shkon tek tubi zëpërçues, flet dhe dëgjon sipas rastit.)*

ZONJUSHA GJULIA

E ka parë katastrofën?

ZHANI

Po, zoti kont, jam Zhani! *Nis të dëgjojë. Nuk dëgjohet ajo që thotë konti.*) Po, zoti kont! *(Dëgjon.)* Po, zoti kont, menjëherë! *(Dëgjon.)* Menjëherë, zoti kont! *(Dëgjon.)* Patjetër! Pas gjysmë ore! Mos kini dyshim!

ZONJUSHA GJULIA

*(Skajshmërisht në ankth.)*

Çfarë tha? Oh, Jezusi im, çfarë tha?

ZHANI

Tha se i donte gati çizmet dhe kafënë pas gjysmë ore!

ZONJUSHA GJULIA

Pra, pas gjysmë ore!... Oh, sa e lodhur jam! Nuk jam më e aftë për të bërë asgjë: as që të pendohem, as për të ikur, as për të ndenjtur, as për të jetuar..., as për të vdekur! Ndihmomëni tani! Urdhëromëni dhe unë do t'ju bindem si të isha një qen! Bëmëni këtë nder të fundit: shpëtomani nderin tim, shpëtomani emrin tim! Ju e dini atë që *do të duhej* ta doja, por nuk ia dal dot që ta dua... Duajeni pra për mua dhe urdhëromëni që ta bëj!

## ZHANI

Nuk e kuptoj arsyen, por tani më as nuk mund ta bëj!... Nuk arrita ta kuptoj! Ndoshta është për shkak të këtyre petkave prej shërbëtori që tani mbaj veshur... që më pengojnë që të mund të jap urdhra... Sapo konti nisi të më flasë..., nuk di..., nuk e shpjegoj dot; ndoshta është për shkak të atij karakterit servil që më është skalitur në palcë. Besoj që nëse konti tani do të zbriste këtu dhe do të më urdhëronte që t'ia prisja vetes gurmazin, unë do të bëja këtë gjë menjëherë!<sup>31</sup>

Ndërsa Kristina është një kuzhinierë 35-vjeçare dhe ne, përmes interaksionit të saj me zonjushë Gjulia, e kuptojmë se si ajo atë dhe Zhanin që t'i definojnë dhe zbardhin motivet e tyre. Kristina i pranon motivet e saj prej shërbëtoresh duke mos dhënë kurrfarë shenjash se ka dëshirë të ngritet dhe të dalë jashtë nga klasa së cilës i përket. Kristina në *Zonjusha Gjulia* e ka rolin e njëfarë gjyqtari moral. Është pesë vjet në moshë më e madhe se Zhani, ndërsa dhjetë më e madhe se Gjulia dhe në sjelljen e saj vihet re një pjekuri më e madhe, por edhe indiferenca ndaj çështjeve dhe problemeve të cilat asaj nuk i përkasin. Ajo e ka të ditur se çfarë duhet të bëjë dhe çfarë pritet nga ajo në përgjithësi. I kryen punët e saj, planifikon ta krijojë familjen e saj me Zhanin dhe, siç u tha, nuk i intereson përkatësia te shtesa më e lartë. Kur vjen në dhomën e Zhanit, Kristina e kupton se çfarë ka ndodhur ndërmjet zonjushës dhe shërbëtorit, por ajo nuk e merr për të keq këtë rrethanë, përveçse Gjulia e sheh si viktimë të asaj që ka ndodhur. Ndërsa Zhanit do t'ia merrte për diçka të keqe nëse ai do të kishte fjetur me ndonjërin prej vajzave të shtresës së tyre, e që drejtpërsëdrejti na lë ta kuptojmë se Kristina nuk e sheh Gjulia si kërcënim apo edhe si dikush që mund t'i rrezikojë planet e saj me Zhanin.

Në “intermezzo” të dramës, Strinbergu jep shumë udhëzime për regjisorët e mundshme mbi atë se si mund të inskenohet kjo vepër. Është fjala për udhëzime mjaft specifike. Këtë, siç e thekson autori, para së gjithash e bën me qëllim që gjatë vënies në skenë të ruhet për aq sa është e mundshme fryma autentike e veprës. Për shembull, sipas autorit, enët e kuzhinës do të duhej të ishin të punuara nga bakri, hekuri, etj., ndërsa për tryezën në të cilën shërbëtorët ushqehen

<sup>31</sup> Strinbergu, August, *Zonjusha Julie*, NB “Gjon Buzuku”, Prishtinë. 2015, f. 96-97-98.

Strinbergu rekomandon të jetë e punuar nga pisha e bardhë. Gjithashtu ai mendon se në skenë nuk duhet të ketë ndërprerje për kalimin nga një pjesë në tjetrën, duke rekomanduar që ai kalim të bëhet përmes lojës së pantomimës dhe të vallëzimit.

Për sa i përket pantomimës, ai mendon se ajo duhet të futet në përdorim atëherë kur kuzhinierja e Kontit ndodhet e vetme në skenë duke kryer punët e saj:

### PANTOMIMË

*Luhet asisoj që aktorja duket se është vetëm; sipas rasteve ia kthen shpinën publikut; nuk shikon nga salla; nuk ngutet, sikur nuk ka frikë se publiku do të bezdiset.*

*KRISTINA është vetëm. Dëgjohen nga larg tingujt e violinave që bien sipas ritmit të kërcimit skocez.*

*Kristina këndon me zë të ulët duke i shoqëruar tingujt e muzikës; pastron tavolinën, lanë disa pjata, i thanë dhe i vendos ato te rafti.*

*Pastaj e heq përparësen, merr një pasqyrë nga sirtari i tavolinës, e vendos atë drejtë mbi piano duke e mbështetur tek vazoja japoneze dhe nis ta bëjë rrengun. Ndez një qiri dhe, te flaka e tij, ngroh furqeta me anë të të cilave i kaçurelos balluket.*

*Paskëtaj i afrohet pragut të derës dhe nis të dëgjojë. Kthehet te tavolina. Aty e gjen shaminë e harruar nga zonjusha; e kap dhe i merr erë. Pastaj e hap mbi tavolinën, dhe, si hutueshëm, e tendos mirë, dhe e palos sërish në katërshe.<sup>32</sup>*

Ndërsa në vallëzim, me të cilin emër Strinbergu e quan baletin, ai i rekomandon shërbëtorët të cilët e festojnë Natën e Shën Gjonit, e të cilët futen në kuzhinë përderisa Gjulia dhe Zhani janë në dhomën e shërbëtorit. Shërbëtorët e lënë verën edhe uiskin mbi tryezë, ndërsa vallëzojnë dhe këndojnë. Gjithashtu Strinbergu “rekomandon” se nuk do të duhej të kishte dritë shumë të kufizuar, për çfarë aktorët do të mund të bartnin pak apo edhe aspak makijazh në fytyrë.

<sup>32</sup> Po aty, f. 17.



## NJË DRAMË ME DY KULMINACIONE

Drama *Zonjusha Gjulia* ka dy kulminacion:

1) Ai kur zonjusha e pranon ftesën e Zhanit që të shkojnë bashkë në dhomën e tij, ndërsa biseda e tyre kur të kthehen më pas në skenë jep indikacione se ata kanë kryer marrëdhënie seksuale.

Duke pasur parasysh se August Strinbergu atë akt nuk e shfaq para publikut në skenë, atëherë ky moment teknikisht nuk mund të konsiderohet kulminacion. E kulminacion është ai kur Gjulia pranon që të shkojë në dhomën e shërbëtorit, ngase ky është ai momenti kur në dramë ndodh kthesa e madhe në marrëdhëniet dhe në fatin e personazheve, dhe

2) Kulminacion mund të jetë edhe ai çasti kur Gjulia e merr në dorë briskun e Zhanit dhe e kryen vetëvrasjen.

Por nëse do të duheshim përcaktuar vetëm për njërin, siç e përcakton Gustav Frajtagu, kulminacioni kryesor në *Zonjusha Gjulia* ai kur zonjusha vendos të shkojë në dhomë, ngase nga ky vendim i saj, nga kjo ngjarje e papritur çdo gjë në jetën e saj merr teposhtë. <sup>33</sup> Ky është çasti i *përcaktimit* të personazhit nga i cili pastaj përcaktohet fati i saj njësoj si në dramën klasike, përkatësisht antike.

Në këtë vepër gjejmë elementë të qartë të simbolizmit, e që janë të zakonshëm për veprat dramatike të Strinbergut. Kështu ta themi Diana, qeni i zonjushës Gjulia, mund të kuptohet edhe si simbolizmi i saj. Diana është ajo që është mbarësuar me një qen që jeton diku në atë fermë. Kështu, Diana, që jeton në shtëpi, simbolizon Gjulian, aristokraten, ndërsa qeni i fermës e përfaqëson në rrafshin simbolik Zhanin. Por mbi të gjitha, marrëdhënia ndërmjet qenve që jetojnë gjithashtu jetë të ndryshme, në fakt është paralajmërim i marrëdhënies seksuale ndërmjet Gjulias dhe shërbëtorit. Simbolizëm gjejmë edhe në çastin kur Kristina hyn në kuzhinë për të gatuar diçka për qenin, ndërsa ia sqaron Zhanit se këtë gatim e ka kërkuar zonjusha që ta “ndërpresë” lindjen e pasardhësve të Dianës me atë qen pa “pedigre”.

<sup>33</sup> Boyko-Head, C. *A Lancanian Analysis of Miss Julie by August Strindberg and The Balcony by Jean Genet*, McMaster University, 1990, f. 88.

Kjo e simbolizon mënyrën e thjeshtë, mënyrën të cilën në fund të fundit e kërkon zonjusha Gjulia për ta tejkalojë turpin e aktit të saj, të takimit seksual me shërbëtorin, Zhan.

Më tutje mund të përmendim edhe situatën në të cilën zonjusha Gjulia kërkon nga i fejuari i saj që të hidhet mbi kamxhik. Kjo kërkesë, gjegjësisht ky aksion e simbolizon synimin e saj që ta dominojë mashkullin, e që është diçka që ia ka mësuar e ëma në vargun e “leksioneve” se pse dhe si duhet urryer meshkujt. Ndërsa kur Zhan i pi verë “Claret”, aty gjejmë simbolikën e klasës së lartë dhe synimi e tij që të arrijë atje. Birra që e pi Gjulia i përket klasës së ulët, ndërsa vera klasës së lartë, dhe ky çast e shpërfaq hutinë e saj dhe atë se ajo nuk është akoma plotësisht e formuar, ndaj dhe kështu, duke eksploruar, e kërkon identitetin e vet. Këtu ka ndikim edhe elementi tjetër, se e ëma e Gjulias rrjedh nga shtresa e ulët, ndërsa i ati nga shtresa e lartë – është kont pra.

Kristina i merr erë shamisë së Gjulias të cilën, siç e thamë asaj i bie në tokë, pastaj e palos në katër pjesë të barabarta, – kështu këtë te ky aksion i kuzhinieres mund të hasim simbolizmin e kureshtjes së saj mbi shtresën e lartë, të cilën kjo nuk e synon, por e cila, sipas saj ka aromë të mirë, duke e pranuar kështu statusin e saj prej shërbëtojeje. Ndërsa kafazi për zogj mbi të gjitha e simbolizon vetë Gjulian, e cila është “e burgosur”, e fatit të vet, e mbi të gjitha e trashëgimisë së saj dhe rrethit që e harkon.

Vrasja e zogut nga ana e Zhanit duke përdorur sëpatën me këtë rast është një shenj e cila paralajmëron mundësinë e vdekjes së zonjushës Gjulia, e cila më pas kryen vetëvrasje me briskun e Zhanit.

Konti nuk paraqitet në skenë fare, por kur kthehet nga vizita që ua ka bërë të afërmve, sigurisht edhe ai për festën e Shën Gjjonit, e shpërfaq autoritetin e vetë e që simbolizohet përmes ziles së tubit të zërit në të cilin zonjusha dhe shërbëtori duhet të përgjigjen.

Briskun me të cilin Zhan rruhet, ndërsa zonjusha vetëvritet, është një instrument mashkullor i cili e simbolizon fuqinë fatale të mashkullit ndaj femrës, e në rastin konkret të Zhanit ndaj Gjulias.<sup>34</sup>

<sup>34</sup> Williams, Raymond, *Drama from Ibsen to Brecht*, Chato & Windus, London, 1968, f. 87.

TRONDITJA E MADHE QË SHKAKTOI ZONJUSHA GJULIA JO  
VETËM SI SHKAK I PORTRETIZIMIT TË SINQERTË TË  
SKESUALITETIT DHE TË MARRËDHËNIEVE TË NJË BURRI  
DHE TË NJË GRUAJE

*Zonjusha Gjulia* në përshkrimin e begatë të August Strinbergut është një prej dramave më të mira dhe më të njohura të këtij autori, por në të njëjtën kohë kjo është drama më personale e tij edhe nga fakti se vetë ai e shkroi parathënien subjektive dhe të gjatë për të duke u përpjekur që lexuesve, në një mënyrë apo tjetrën, t’ua sqarojë për çfarë në fakt ka shkruar aty dhe njëherësh t’i rrëmbejë dhe fusë në rrjedhën e veprimit dhe të mendimeve të tij.

*Zonjusha Gjulia* fillimisht shkaktoi një habi dhe një shok të njëmendtë për kritikët e kohës kur u botua për shkak të përshkrimit të drejtpërdrejtë dhe të sinqertë të seksualitetit. Privatisht drama u shfaq në vitin 1898 në Kopenhagë, ajo në pjesën më të madhe të shteteve evropiane u ndalua, ndërsa në atdheun e autorit, pra në Suedi nuk është shfaqur madje deri në vitin 1939. Por *Zonjusha Gjulia* shumë shpejt e arriti një famë të jashtëzakonshme dhe popullaritet të madh tek publiku si dhe një pranueshmëri të madhe kulturore dhe shoqërore, sidomos në atë që atëbotë njihej si “nëntokë e teatrit”, ndërsa siç mund të gjykohet, sukseset arritën më ngadalë se kaq, pra, deri-diku në të njëzetat e hershme të shekullit XX, për t’u shndërruar në një aset dhe aspekt të rëndësishëm të dramaturgjisë moderne.

Një tronditje aq të madhe në atë kohë e shkaktoi kjo dramë jo vetëm për shkak të portretizimit të sinqertë të skesualitetit dhe të marrëdhënieve të një burri dhe të një gruaje, sa për faktin se seksi në këtë vepër paraqitet veç, qartësisht, i ndarë nga kuptimet dhe nocionet e dashurisë. Ideja mbi një marrëdhënie burrë – grua, e cila ekskluzivisht bazohet tek “mbretëria” e pasionit njerëzor, në atë kohë ishte diçka skandaloze dhe e mjaftueshme që të shkaktojë censurë; ndërsa kjo, për të qenë të saktë, është shfrytëzuar vetëm si diçka që jep mundësi që të iniciohen problemet, ngase akti për të cilin u bënë aq debate, siç e kemi theksuar më herët në këtë libër, është pjesë të cilën ne nuk e shohim në skenë.

Drama *Zonjusha Gjulia* fokusohet në shkatërrimin e aristokrates Gjulia, e cila nuk i përket tërësisht shoqërisë së saj (ndërsa në parathënie të veprës A. Strinbergu këtë element të zonjusha Gjulia e

quan qëndrim i një *gjysmëgruaje meshkujrre*.<sup>35</sup>) Zonjusha Gjulia rebelohet kundër kufizimeve që i has ajo duke qenë grua, por edhe si pjesëtare e klasës së lartë. Që nga fillimi i dramës sjelljet e saj janë të tillë e të cilat ndikojnë që ajo të largohet nga klasa e vet dhe rrethit të gjerë të cilit i përket.

Ajo nuk brengoset aspak për rendin klasor dhe për konventat shoqërore, por në këtë vepër gjejmë edhe situata kur për një çast Gjulia pohon se “dallimet klasore as që duhet të ekzistojnë”, ndërsa në tjetrën ai insiston që Zhani ta trajtojë si një grua nga shtresa e lartë e shoqërisë. Këto pikëpamje kontraverse në fund rezultojnë me shkatërrimin e saj shoqëror, humbjen e respektit nga shërbëtorët e saj, e në fund të dramës edhe me vetëvrasje.<sup>36</sup>

Kjo dramë po ashtu llogaritet të jetë drama më e rëndësishme e periudhës së natyralizmit. Lëvizja e cila në pjesën më të madhe të saj është mbështetur te darvinizmi (kur individët luftojnë për pozitën në shoqëri ashtu sikurse edhe kafshët luftojnë për mbijetesë dhe po ashtu edhe tek njerëzit sikurse tek kafshët, aty ku mund të mbijetojnë vetëm më të aftit, gjë që na fut në teorinë e njohur darviniste që ka të bëjë me “Seleksionimin natyror”). Si një vepër natyraliste, *Zonjusha Gjulia* fokusohet pikërisht te Gjulia dhe Zhani dhe lufta e tyre për ekzistencë në shoqërinë të cilës i përkasin. Strinbergu e ka pohuar vetë se baza për përmbajtjen e kësaj drame është një tregim i vërtetë mbi një fisnike të re, aristokrate, e cila kishte marrëdhënie seksuale me shërbëtorin e saj, anipse ajo në fund e mbijeton situatën dhe nuk kryen vetëvrasje për ta mbyllur kështu ngjarjen.

Strinbergu ka jetuar në një kohë kur “roli i gjinive dhe i përkatësisë shoqërore nisën të bëhen më labile, ndërsa drama e tij i ruan ato konflikte të cilat janë të pashmangshme në shoqërinë e cila lufton për të krijuar ndryshime.”<sup>37</sup>

Për dallim nga ajo kohë për të cilën folëm, sot *Zonjusha Gjulia* vlerësohet të jetë një vepër e jashtëzakonshme, madje pikërisht nga ato arsye për shkak të të cilave në kohën kur lindi vepra censorët e kishin shpallur të ishte aq shokuese, se është drama e parë e cila trajton aktin e seksit të ndarë nga dashuria. Paraqitja që i bën fuqisë së pasionit dhe të skesualitetit Strinbergu në këtë vepër dramatike

<sup>35</sup> Kölén, A. *En vakendröm där allt käns tillåtet*. Tillgänglig på: [https://www.malmostadsteater.se/sites/all/files/download/mst\\_froken\\_julie\\_web.pdf](https://www.malmostadsteater.se/sites/all/files/download/mst_froken_julie_web.pdf), . 2017 (për herë të fundit konsultuar më 23 janar, 2020).

<sup>36</sup> Po aty.

<sup>37</sup> Po aty.

(bashkë me pasojat e shpeshta të këtij akti) është një momentum i cili ka ushtruar një ndikim të jashtëzakonshëm te shumë autorë të ardhshëm, veçanërisht te dramaturgu i madh amerikan Tenesi Uilliamsi në dramën e tij *Macja mbi çatinë e nxehtë*. Edhe pse në një mënyrë apo tjetrën rëndësia e kësaj vepre nuk u evidentua gjatë kohës së jetës së autorit, vendi i tij në dramën moderne, në veçanti si një shembull i jashtëzakonshëm i natyralizmit dhe i modernizmit në dramë dhe në teatër, sot është i padiskutueshëm.

Haqif Mulliqi

MISS. GULIA - NATURALISM AS A PHILOSOPHICAL  
OBJECTIVE OF STRINDBERG

Abstract

August Strindberg foreword to the play Miss Julia, in fact, reveals his interpretation of this work. When the author writes the foreword of his work, this is the best evidence of his emotions, his philosophy as well as of his goals. In this foreword, Strindberg writes about what motivates Miss Julia: "The innate maternal instinct, the wrong education from her father, her personal nature, or even the influence of her fiancé on the 'weak brain'". This work is an attempt to provide answers to these social and philosophical dilemmas. It is also an attempt to reveal the psychological aspects of the characters, and of what the author considers to be a diagnosis of the disease of the respective lady.

Arsim Bajrami & Florent Mucaj, Prishtinë

## ASPEKTE KUSHTETUESE TË DIALOGUT KOSOVË - SERBI

### Abstrakt

Punimi synon të paraqesë një pasqyrë të qartë të normalizimit të marrëdhënieve në Ballkanin Perëndimor ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, përmes një procesi të dialogut, i cili ka nisur që më shumë se tetë vjet. Një proces i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka krijuar rezultate të ndryshme nga të dyja shtetet, përfshirë këtu edhe pasojat dhe implikimet e ndryshme kushtetuese.

Duke marrë për bazë këtë fakt, punimi sjell një analizë e cila ka në sfond perspektivën dhe dimensionin kushtetues të dialogut Kosovë - Serbi, duke marrë parasysh veprimet juridike dhe faktike që janë ndërmarrë deri tani nga palët në proces. Punimi analizon këtë proces nga fillimi e deri tani, duke sjellë një këndvështrim për përmbylljen e procesit dhe praktikisht normalizimin e marrëdhënieve dhe arritjen e një pajtimi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe të Serbisë.

*Fjalë çelës:* Dialogu; Kosovë-Serbi; kushtetutë; marrëveshje ndërkombëtare; zbatim i marrëveshjeve.

### 1. KONTEKSTI I PROCESIT NGA NJË DIALOG TEKNIK NË NJË DIALOG POLITIK

Marrëdhëniet Kosovë-Serbi mund të përshkruhen përveç tjerash edhe përmes një të kaluarë të largët historike. Megjithatë, për të pasur të qartë kontekstin e raporteve të krijuara ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mund të nisemi vetëm nga viti i largët 1945, kur pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe ndryshimit të rrethanave gjeopolitike, Kosova, nën pretekstin e kundërrevolucionit, u vendos nën administrimin e dhunshëm ushtarak me urdhër të Titos.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Shkelzen Gashi, *Historia e Kosovës në tekste mësimore të Historisë në Kosovë, Shqipëri, Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni*, botoi Alder Habitus (Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë), Prishtinë, 2016, f. 91.

Pas krijimit të Republikës Federative të ish-Jugosllavisë, Kosova përjetoi periudha të ndryshme brenda këtij shteti federal, ndërsa në vitin 1974 kishte statusin e Republikës de facto dhe ishte e përfaqësuar në nivelin federal njëjtë sikur edhe Republikat e tjera. Konflikti ndërmjet Serbisë dhe Kosovës kishte eskaluar me luftën në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, e cila kishte përfunduar me intervenimin e NATO-s dhe me ndërhyrjen e Këshillit të Sigurimit më 1999. Pas ndërhyrjes ushtarake dhe miratimit të Rezolutës 1244 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara – OKB-ja, Kosova filloi realitet të ri politik e juridik, krejtësisht të ndryshëm nga ai i para vitit 1999. Ky realitet zgjati deri me shpalljen e pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008.<sup>2</sup>

Shpallja e pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008 hapi një kapitull të ri të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si dy shtete të ndryshme. Se shteti i Kosovës ishte një realitet tanimë i krijuar, këtë e vërtetoi edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë - GJND, e cila në Opinionin Këshilldhënës të datës 22 korrik 2010 lidhur me deklaratën e pavarësisë së Kosovës dhe rrjedhimisht shpalljen e pavarësisë së Kosovës ndër të tjera kishte konstatuar se shpallja e pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008 nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare si dhe nuk kishte shkelur Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe Kornizën Kushtetuese.<sup>3</sup>

Nxjerrja e Opinionit Këshilldhënës të GJND-së për deklaratën dhe rrjedhimisht shpalljen e pavarësisë së Kosovës kishte krijuar një moment të disfavorshëm për Serbinë sa i përket raportit me Kosovën. Kështu, më 9 shtator 2010 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi një rezolutë, e cila u mbështet nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, sipas së cilës Asambleja e Përgjithshme kishte pranuar përmbajtjen e opinionit këshilldhënës të GJND-së për Kosovën dhe, ndër të tjera, kishte përshëndetur procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke e cilësuar atë se kishte katër qëllime si: paqja dhe stabiliteti në rajon, promovimi i bashkëpunimit, arritja e përparimit në rrugën drejt BE-së dhe përmirësimi i jetës së popullit.<sup>4</sup>

<sup>2</sup> Shih më shumë kontekstin e këtyre ngjarjeve në: Marc Weller, “*Shtetësia e Kontestuar - administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*”, Prishtinë, 2011, f. 255-386.

<sup>3</sup> International Court of Justice Reports of Judgments, Advisory Opinions and Orders Accordance with International Law of the Unilateral Declaration Of Independence in Respect Of Kosovo Advisory Opinion of 22 July 2010, paragrafi 120.

<sup>4</sup> Resolution adopted by the General Assembly, [without reference to a Main

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e OKB-së konsiderohet akti i parë përmes të cilit filloi një proces i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në të cilin ishin të kyçura të dyja shtetet. Pas nxjerrjes së rezolutës nga OKB-ja shihej qartë gatishmëria e dy shteteve që të futen në një proces të dialogut, me ndërmjetësimin e BE-së.

Hapi i parë i Kosovës në raport me fillimin e dialogut me Serbinë ishte rezoluta e nxjerrë më 10 mars 2011 nga parlamenti (kuvendi). Përmes kësaj rezolute Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte mbështetur dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si dy shtete të pavarura dhe sovrane. Sipas kësaj rezolute, dialogu do të zhvillohej vetëm për çështje teknike, pa e prekur sovranitetin, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm kushtetues të Republikës së Kosovës.<sup>5</sup> Në këtë rezolutë përcaktohej se udhëheqës i dialogut do të jetë një i emëruar nga Kryeministri. Për këtë ishte emëruar personi përgjegjës nga qeveria si dhe më vonë Republika e Kosovës krijoi ministrinë e veçante për çështjen e dialogut me Serbinë. Kjo ishte edhe e ashtuquajtura faza kur dialogu zhvillohej në nivel teknik.

Gjatë kohës së udhëheqjes së dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në nivel teknik janë arritur shtatë marrëveshje: 1. Marrëveshja për lëvizjen e lirë, 2. Marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufirit/Marrëveshja e IBM-it, 3. Marrëveshja për regjistrat kadastralë, 4. Marrëveshja për regjistrat civilë, 5. Marrëveshja për përfaqësimin rajonal, 6. Marrëveshja për njohjen e diplomave dhe 7. Marrëveshja për njohjen e ndërsjelltë të vulave doganore. Ndërsa u iniciuan diskutimet për çështjet lidhur me telekomunikacionin dhe energjinë.<sup>6</sup>

Pas një procesi njëvjeçar të një dialogu teknik, Kuvendi i Kosovës nxori përsëri një rezolutë tjetër (më 18 tetor 2012) për normalizimin e marrëdhënie ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila e ngritte këtë proces në nivel politik, pasi që rezoluta përcaktonte që udhëheqjen e dialogut do ta bënte qeveria.<sup>7</sup> Një ditë pas miratimi të kësaj rezolute në Kuvendin e Republikës së Kosovës kishte pasuar

---

Committee (A/64/L.65/Rev.1)] 64/298. Request for an advisory opinion of the International Court of Justice on whether the unilateral declaration of independence of Kosovo is in accordance with international law, 9 September 2010.

<sup>5</sup> Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-R-001, Prishtinë, më 10 mars 2011.

<sup>6</sup> *Dialogu Kosovë-Serbi, sfidat dhe rruga përpara* (analizë e shkurtë), mars 2018, botoi Kosovo Democratic Institute, f.7.

<sup>7</sup> Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-R-08, Prishtinë, më 18 tetor 2012.



takimi ndërmjet Kryeministrit të Kosovës dhe Kryeministrit të Serbisë, të cilët me takimin e tyre në mënyrë automatike e kishin ngritur dialogun në nivel politik.<sup>8</sup>

## 2. STATUSI KUSHTETUES I MARRËVESHJEVE TË ARRITURA NË DIALOGUN KOSOVË-SERBI DHE TRAJTIMI I NDRYSHËM NGA TË DYJA SHTETET

Që nga koha e fillimit të procesit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nga viti 2011 e deri në vitin 2015, janë arritur njëzet marrëveshje si rezultat i këtij procesi. Pjesa më e madhe e marrëveshjeve janë arritur gjatë kohës kur procesi i dialogut është udhëhequr nga të deleguarit e qeverisë dhe rrjedhimisht ka qenë në nivel teknik, kurse marrëveshjet më të rëndësishme të cilat kanë pasur ndikim dhe implikime kushtetuese janë arritur gjatë kohës kur procesi i dialogut është udhëhequr nga ish-kryeministrat e Kosovës dhe të Serbisë.<sup>9</sup>

Ajo që është me rëndësi të trajtohet në këtë pjesë ka të bëjë me atë se si i trajton rendi kushtetues i Kosovës dhe i Serbisë këto marrëveshje. Kjo çështje shtrohet në këtë kontekst, duke pasur parasysh faktin që asnjëra prej marrëveshjeve të arritura deri tani ndërmjet Kosovës dhe Serbisë gjatë procesit të dialogut nuk i janë nënshtruar ratifikimit kushtetues dhe nuk janë shpallur në gazetën zyrtare. Përjashtim nga kjo bën vetëm marrëveshja e parë e parimeve që rregullon normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë dhe atë vetëm sa i përket Republikës së Kosovës. Kjo marrëveshje është ratifikuar me 2/3 e votave të Kuvendit të Republikës së Kosovës më 27 qershor 2013.<sup>10</sup> Kjo marrëveshje asnjëherë nuk ishte ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Serbisë.

Pra asnjëra nga marrëveshjet e arritura në dialogun Kosovë-Serbi nuk kanë kaluar në procedurën e ratifikimit të brendshëm, kurse

<sup>8</sup> Bëhet fjalë për Kryeministrin e atëhershëm të Kosovës z. Hashim Thaçin dhe atë të Serbisë Ivica Daçiq.

<sup>9</sup> *Dialogu Kosovë-Serbi, sfidat dhe rruga përpara (analizë e shkurtë)*, mars 2018, botoi Kosovo Democratic Institute, f.18. Në këtë analizë janë identifikuar edhe zbatimi i marrëveshjeve, bazuar në të dhënat që ka ofruar Qeveria e Republikës së Kosovës.

<sup>10</sup> LIGJ nr. 04/L-199 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDRËKOMBËTARE TË PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË.

në Republikën e Kosovës vetëm një marrëveshje ka kaluar në procedurën e ratifikimit të brendshëm përmes parlamentit. Por si e përcakton kushtetuta e Kosovës dhe e Serbisë ratifikimin, respektivisht statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare? Në përgjithësi kushtetuta e Republikës së Kosovës ofron një qasje miqësore me të drejtën ndërkombëtare<sup>11</sup>, ky fakt dëshmohet me një numër të caktuar të neneve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, siç është për shembull neni 19 i Kushtetutës. Në këtë kontekst sistemi kushtetues i Kosovës vendin e marrëveshjeve (traktateve) ndërkombëtare për nga fuqia e ka caktuar mbi dispozitat ligjore dhe nën dispozitat kushtetuese, sepse kështu qartë e përcakton neni 19 i Kushtetutës.

Marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat lidhen sipas Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve 1969, mund të ratifikohen në Republikën e Kosovës në dy mënyra dhe atë: Nga Kuvendi në qoftëse marrëveshjet kanë të bëjnë me: *territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake; të drejtat e njeriut; anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe marrjen përsipër të detyrimeve financiare të Republikës së Kosovës*.<sup>12</sup> Të gjitha këto marrëveshje ratifikohen me 2/3 e votave. Kurse marrëveshjet e tjera, të cilat nuk hyjnë në kuadër të këtyre kategorive konsiderohen të ratifikuara vetëm pas nënshkrimit nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës.<sup>13</sup> U kuptua se asnjë marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të hyjë në fuqi në Republikën e Kosovës nëse ato nuk shpallën në gazetën zyrtare. Në rastin konkret, asnjë nga marrëveshjet e nënshkruara në procesin e Dialogut Kosovë-Serbi nuk janë shpallur në gazetën zyrtare, gjithnjë në përjashtim të marrëveshjes të cilën e përmendëm më sipër dhe e cila është ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës në muajin qershor 2013.<sup>14</sup> Nisur nga ky argument kushtetues, për rendin juridik të Kosovës asnjë nga marrëveshjet e arritura në procesin e dialogut, sipas kushtetutës, nuk mund të cilësohet e ratifikuar për shkak se nuk ka kaluar në procedurën e ratifikimit të

<sup>11</sup> Visar Morina, Fisnik Korenica and Dren Doli, "The relationship between international law and national law in the case of Kosovo: A constitutional perspective", Oxford University Press and New York University School of Law, I•CON 9, 2011, f.296.

<sup>12</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, neni 18.1.

<sup>13</sup> Ibid, neni 18.2.

<sup>14</sup> Shih: LIGJ nr. 04/L-199 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE TË PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË.

brendshëm kushtetues dhe as nuk është shpallur në gazetën zyrtare; këtu përjashtim bën pra vetëm një marrëveshje, siç u tha më sipër.

Pra, që një marrëveshje të jetë pjesë e rendit juridik në Republikën e Kosovës duhet të plotësojë kushtin e ratifikimit si dhe të shpallet në gazetën zyrtare, gjë që nuk ka ndodhur me marrëveshjet që janë pjesë e dialogut. Megjithatë, këtu përveç ratifikimit të brendshëm nuk duhet të anashkalojnë ratifikimin ndërkombëtar, që lidhet me nenin 14 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve. Megjithatë kjo nuk është me rëndësi për rendin e brendshëm të Republikës së Kosovës. Duke marrë parasysh pikërisht argumentin që marrëveshjet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk kanë kaluar procedurën e ratifikimit të brendshëm për tu bërë pjesë e rendit kushtetutës të Republikës së Kosovës, nganjëherë këto marrëveshje janë cilësuar edhe si marrëveshje politike dhe që nuk i plotësojnë kushtet për të qenë traktate ndërkombëtare në kuptim kushtetues.<sup>15</sup> Këto marrëveshje si të tilla janë trajtuar, në zbatimin e tyre, sipas parimit të mirëbesimit të palëve që i kanë nënshkruar, e që në këtë rast janë Kosova dhe Serbia.

Përkitazi me atë se si janë trajtuar kushtetushmërisht marrëveshjet e dialogut Kosovë-Serbi, në Republikën e Serbisë situata qëndron edhe më keq se në Republikën e Kosovës. Madje në Republikën e Serbisë asnjëra prej marrëveshjeve të lidhura në procesin e dialogut nuk i janë nënshtruar procedurës së brendshme të ratifikimit. Kjo është kështu edhe për faktin se kushtetuta e Republikës së Serbisë e përcakton qartë ratifikimin e traktateve ndërkombëtare, se ajo bëhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Serbisë.<sup>16</sup> Po ashtu ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare në Republikën e Serbisë sipas kushtetutës së saj përcaktohet edhe me ligj.<sup>17</sup>

Një çështje kushtetuese e rëndësishme përsa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare në Republikën e Serbisë është edhe fakti se ato mund të vlerësohen na Gjykata Kushtetuese, nëse të njëjtat janë në pajtim me Kushtetutën.<sup>18</sup> Madje Gjykata Kushtetuese e Republikës së Serbisë, duke u bazuar në këtë kompetencë të saj, në

<sup>15</sup> Artikull: “*Hasani: Marrëveshjet Kosovë-Serbi janë politike*”, Portali Telegrafi, artikull i datës 23.3.2012. <https://telegrafi.com/hasani-marreveshjet-kosove-serbi-jane-politike/>, qasur së fundi me 10.12.2018.

<sup>16</sup> Kushtetuta e Republikës së Serbisë (2006), nenin 105, (15.6).

<sup>17</sup> Ibid, neni 99.

<sup>18</sup> Ibid, neni 167.2

vitin 2014, me anë të një vendimi të saj kishte shpallur si akte politike marrëveshjet që ishin lidhur nga ana e Serbisë në procesin e dialogut me Kosovën, duke nënkuptuar se ato nuk kanë ndonjë vlerë juridike në sistemin kushtetues serb dhe se nuk i plotësojnë kushtet që si të tilla të trajtohen si akte që kanë efekt juridik në rendin kushtetues të Republikës së Serbisë.<sup>19</sup> Duke pasur parasysh faktin që marrëveshjet e arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në procesin e dialogut nuk janë trajtuar në atë mënyrë që të bëhen pjesë e rendeve juridike të brendshme përmes ratifikimit kushtetues, kjo ka bërë që edhe zbatimi i tyre të mos jetë i plotë, sidomos kjo ka qenë e shprehur nga ana e Serbisë. Nga të gjitha marrëveshjet e lidhura, vetëm katër prej tyre janë zbatuar plotësisht.<sup>20</sup> Kryesisht zbatimi i marrëveshjeve të dialogut është bërë sipas parimit të vullnetit të palëve dhe mirëbesimit.<sup>21</sup>

Në kuptim të faktit se si janë trajtuar kushtetushmërisht marrëveshjet e arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në procesin e dialogut flasin dy argumente kryesore kushtetuese. Argumenti i parë ka të bëjë me atë se të gjitha marrëveshjet e arritura nga ky proces nuk kanë kaluar nëpër procedurë të ratifikimit dhe argumenti i dytë ka të bëjë me atë se të gjitha marrëveshjet nuk janë shpallur në gazetën zyrtare, një kusht ky i domosdoshëm që të ato të konsiderohen si marrëveshje ndërkombëtare me efekt juridik në rendin juridik të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Siç e thamë, përjashtim nga kjo bën marrëveshja e arritur më 19 prill 2013 për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, cila është ratifikuar dhe është shpallur në gazetën zyrtare vetëm nga kuvendi i Republikës së Kosovës, duke u konsideruar kështu pjesë e rendit juridik në bazë të nenit 19 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Të njëjtën marrëveshje, pra atë të 19 prillit 2013, Gjykata Kushtetuese e

<sup>19</sup> Konkluzioni (përfundimi) i datës 10.12.2014 për refuzimin e propozimit për vlerësimin e kushtetutshmërisë së marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, 19 prill 2013. Konkluzioni - Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, nr.13/2015. I qasshëm: <http://www.ustavni.sud.rs/page/predmet/sr-Cyrl-CS/11165/?NOLAYOUT=1>, qasur më 4.1.2019.

<sup>20</sup> *Dialou Kosovë-Serbi, sfidat dhe rruga përpara* (analizë e shkurtë), mars 2018, botoi Kosovo Democratic Institute, f.18. Në këtë analizë janë identifikuar edhe zbatimi i marrëveshjeve bazuar në të dhënat që ka ofruar Qeveria e Republikës së Kosovës.

<sup>21</sup> Ilir Deda dhe Ariana Qosaj - Mustafa, "Analiza e zbatimit të marrëveshjeve teknike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Analizë politike nr.2/13, qershor 2013, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave-KIPRED, f.18-20.

Republikës së Serbisë e kishte konsideruar si një akt politik, e cila nuk i plotëson kushtet që të jetë një traktat ndërkombëtar me efekte juridike në rendin kushtetues serb.<sup>22</sup> Ky fakt për më tepër vë në pah edhe trajtimin e ndryshëm që i ka bërë Republika e Kosovës dhe ajo e Serbisë të njëjtës marrëveshje, ku në njërën anë është bërë ratifikimi nga Republika e Kosovës,<sup>23</sup> kurse në anën tjetër të njëjtën Republika e Serbisë e ka shpallur akt politik dhe që nuk i plotëson kushtet e një traktati ndërkombëtar sipas Kushtetutës së Republikës së Serbisë.

Trajtimi në mënyra të ndryshme i marrëveshjeve të arritura në dialog nga ana e Kosovës dhe e Serbisë shihet edhe nga pikëpamja e zbatimit të tyre. Serbia në vazhdimësi është treguar neglizhente dhe ka bllokuar zbatimin e marrëveshjeve që kanë dalë nga dialogu në Bruksel.<sup>24</sup> Një qasje e tillë e Serbisë ndaj dialogut vjen edhe si pasojë e perceptimit të saj për statusin e Kosovës, duke pasur parasysh faktin që në vazhdimësi Republika e Serbisë e konsideron Kosovën, sipas kushtetutës së saj, si krahinë autonome, kurse institucionet e Kosovës si institucione të përkohshme vetëqeverisëse, duke mos e njohur Deklaratën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës të datës 17 shkurt 2008 dhe Opinionin Këshilldhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës të 22 korrikut 2010, që vërteton se shpallja e pavarësisë së Kosovës është tërësisht në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Një trajtim i tillë i statusit të Kosovës si palë në dialogun nga ana e Republikës së Serbisë shihet edhe në arsyetimin që i ka bërë Gjykata Kushtetuese Konkluzionit të saj të datës 10.12.2014 përmes të cilit nuk e ka pranuar kërkesën e qeverisë për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (19 prill 2013), ku në vazhdimësi potencohet se Kosova është

<sup>22</sup> Edhe një herë shih: Konkluzioni (përfundimi) i datës 10.12.2014 për refuzimin e propozimit për vlerësimin e kushtetutshmërisë së marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, 19 prill 2013. Konkluzioni - Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr.13/2015. I qasshëm <http://www.ustavni.sud.rs/page/predmet/sr-Cyrl-CS/11165/?NOLAY-OUT=1>, qasur me 4.1.2019.

<sup>23</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës ka ratifikuar me 2/3 e votave Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë në qershor të vitit 2013.

<sup>24</sup> Shih më shumë: “Raport mbi gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit”, Ministria për Dialog e Republikës së Kosovës, 1 janar - 15 qershor 2016. Nga përmbajta e raportit dhe gjendja e zbatimit shihet që zbatimi i disa marrëveshjeve të arritura në procesin e dialogut janë bllokuar nga Republika e Serbisë.

pjesë kushtetuese e Serbisë, në nivel të Krahinës, si dhe që institucionet e Republikës së Kosovës cilësohen si institucione të përkohshme vetëqeverisëse, kurse shteti i Kosovës, cilësohet si “e ashtuquajtura Republika e Kosovës”, duke kontestuar në fakt realitetin e krijuar pas 17 shkurtit 2008, kur Kosova u shpall shtet i pavarur dhe sovran.<sup>25</sup>

### 3. IMPLIKIMET KUSHTETUESE TË DIALOGUT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE ATË TË SERBISË

Procesi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka pasur një sërë pasojash dhe implikimesh kushtetuese sidomos në Republikën e Kosovës. Ky fakt lidhet drejtpërsëdrejti me argumentin që Kosova në vazhdimësi i ka trajtuar më seriozisht obligimet e marra nga procesi i dialogut dhe një gjë e tillë është vërejtur edhe në procesin e zbatimit të marrëveshjeve. Ndërkaq në anën e kundërt, Serbia, në kuadër të rendit të saj kushtetues, marrëveshjet e arritura i ka trajtuar si akte politike që nuk kanë një formë të traktatit ndërkombëtar obligativ, ashtu siç përcaktohet në konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve 1969, respektivisht në nenin 2.

Sa i përket palës kosovare implikimi i parë kushtetues në raport me dialogun Kosovë Serbi lidhet me vetë ratifikimin që i ka bërë Republika e Kosovës marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve të nënshkruar më 19 prill 2013 nga ana e Kosovës dhe Serbisë. Me faktin që kjo marrëveshje është ratifikuar dhe është shpallur në gazetën zyrtare, e njëjta është bërë pjesë e sistemit juridik dhe për të Republika e Kosovës ka marrë obligime për ta zbatuar këtë

<sup>25</sup> Shih më shumë arsyetimin e Konkluzionit (përfundimit) i datës 10.12.2014 për refuzimin e propozimit për vlerësimin e kushtetutshmërisë të marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, 19 prill 2013, paragrafët I-IX. Konkluzioni - Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr.13/2015. I qasshëm <http://www.ustavni.sud.rs/page/predmet/sr-Cyrl-CS/11165/?NOLAYOUT=1>, qasur më 04.1.2019. Për një qasje të tillë shih edhe: Милош Прица, МА Асистент Правног факултета, Универзитет у Нишу “ЗАКЉУЧАК УСТАВНОГ СУДА О ОДБАЦИВАЊУ ПРЕДЛОГА ЗА ОЦЕНУ УСТАВНОСТИ И ЗАКОНИТОСТИ ПАРАФИРАНОГ „ПРВОГ СПОРАЗУМА О ПРИНЦИПИМА КОЈИ РЕГУЛИШУ НОРМАЛИЗАЦИЈУ ОДНОСА“ ИЗМЕЂУ ВЛАДЕ РЕПУБЛИКЕ СРБИЈЕ” UDK: 342.565.2:340.142(497.11) Рад прихваћен: 14.04.2015. Рад прихваћен: 04.05.2015, f.230-233.

marrëveshje.<sup>26</sup> Sikundër Republika e Serbisë kësaj marrëveshje nuk i ka njohur statusin e aktit juridik, por e ka cilësuar si akt politik, duke e ndërlidhur këtë me natyrën politike të procesit të dialogut. Së këndejmi marrëveshja e arritur më 19 prill 2013 në procesin e dialogut mund të konsiderohet si ndër marrëveshjet më të rëndësishme deri më tani që nga fillimi i dialogut në vitin 2011. Këtë e themi edhe për faktin se marrëveshja e 19 prillit 2013 ka pasur më së shumti implikime kushtetuese, sidomos në Republikën e Kosovës.

Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve e 19 prillit 2013, mes tjerash, obligon Republikën e Kosovës për krijimin asociacionit të komunave me shumicë serbe në Republikën e Kosovës. Krijimi i asociacionit me shumicë serbe ka dalë të jetë edhe pasoja ose implikimi më i madh kushtetues që kanë pasur marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut, pasi që për krijimin e këtij asociacioni ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është dashur të nënshkruhet edhe një marrëveshje tjetër me qëllim që të detajohet mënyra e funksionimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe. Kjo marrëveshje ishte nënshkruar në vitin 2015 nga ana e dy ish-kryeministrave, ai i Kosovës dhe i Serbisë.<sup>27</sup> Marrëveshja e dytë për asociacionin e komunave me shumicë serbe e nënshkruar në vitin 2015 kishte për qëllim themelimin e këtij asociacioni mbi bazën e kornizës që kishte përcaktuar marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë më 19 prill 2013 dhe e ratifikuar nga ana e kuvendit të Republikës së Kosovës.<sup>28</sup>

Nënshkrimi i marrëveshjes së dytë nga ana e Kosovës dhe e Serbisë për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, obligim të cilin Kosova e kishte marrë nga marrëveshja e parë për normalizimin e marrëdhënieve, e ratifikuar në vitin 2013 nxiti debat në skenën politike dhe profesionale në Republikën e Kosovës, ku fillimisht u hodhën dyshime se marrëveshja e dytë ishte në kundërshtim me kushtetutën dhe se i kishte dhënë asociacionit të komunave me shumicë serbe edhe kompetenca ekzekutive dhe pushtet përtej kushtetues dhe një rol që mund të cënonte edhe kompetencat e pushtetit qendror në Republikën e Kosovës.<sup>29</sup> Madje për të

<sup>26</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 18.1 dhe neni 19.1.

<sup>27</sup> Marrëveshja: Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore, 25 gusht 2015.

<sup>28</sup> Shih: LIGJ nr. 04/L-199 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE TË PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË, pika 1-6 e tekstit të Marrëveshjes.

<sup>29</sup> Artikulli: "Asociacioni pa kompetenca ekzekutive", botoi gazeta "Zëri", 8 korrik

kundërshtuar krijimin e një asociacioni të komunave me shumicë serbe në nivel të tillë, partitë politike opozitare organizuan edhe peticion për kundërshtimin e kësaj marrëveshje sipas të cilëve e njëjta i hapte rrugë edhe ndarjes së Kosovës.<sup>30</sup>

Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes së dytë për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe (2015), në Kosovë u krijua një situatë e paqartë ndërmjet obligimit për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, që dilte nga marrëveshja e parë për normalizimin e marrëdhënieve e 19 prillit 2013 dhe dilemave për pajtueshmëri me kushtetutën e marrëveshjes së dytë të datës 25 gusht 2015, e cila ishte një marrëveshje implementuese e marrëveshjes së parë, duke detajzuar themelimin dhe mënyrën e funksionimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe. Në një situatë e cila prodhoi debat të madh në Kosovë duke ngritur dilema që marrëveshja e dytë për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe ishte në kundërshtim me kushtetutën, presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga kërkoi nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti "*Asociacioni - Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/elementet kryesore*" me frymën e kushtetueses, respektivisht me nenin 3.1 si dhe me kapitullin II dhe III të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Presidentja e Republikës së Kosovës kërkuesën e saj e dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese më 31 tetor 2015, ose mbi dy muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes së dytë (2015). Kërkesa e presidentes Jahjaga u bazua në kompetencën e saj për të dërguar çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese sipas nenit 84.9, ndërlidhur me nenin 112 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.<sup>31</sup>

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, pas vlerësimit të kërkesës së Presidentes së Republikës së Kosovës lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së dokumentit *Asociacioni - bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme / Elementet kryesore*, që ishte një marrëveshje e dytë që kishte dalë nga

2015. E qasshme në: <https://zeri.info/aktuale/41033/asociacioni-pa-kompetenca-ekzekutive/>, qasur me 5.1.2019.

<sup>30</sup> Artikull "*Opozita në Kosovë, me peticion kundër marrëveshjeve me Serbinë*", 18.9.2015, botoi Radio Evropa e Lirë. I qasshëm në: <https://www.evropaelire.org/a/27255557.html>, qasur më 5.1.2019.

<sup>31</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim ne Rastin nr. K0130/15 Parashtrues Presidentja e Republikës se Kosovës. Prishtine, 23 dhjetor 2015 Nr. ref.:AGJ877/15, (procedura në Gjykatë, paragrafi 6 dhe 7).



dialogu si marrëveshje zbatuese e asaj të 13 prillit 2013, gjeti se ky dokument nuk ishte plotësisht në pajtim me frymën e Kushtetutës, që reflektohet në nenet 3, 7, 12, 21, 44, 57, 59, 60, 61, 62, 79, 81, 93, 101, 112, 123, 124 dhe 127 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton se marrëveshja e dytë për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe prekte 18 nene të Kushtetutës dhe si rrjedhojë nuk ishte në pajtim me frymën që mishërohet në këto nene të Kushtetutës. Ndër të tjera, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i dhjetorit të vitit 2015 jepte udhëzime për qeverinë e Republikës së Kosovës se cilat nene të kushtetutës së Republikës së Kosovës do të duhej të merreshin parasysh me rastin e themelimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Pra e tërë situata e krijuar në Republikën e Kosovës lidhur me themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, i bazuar në dy marrëveshje ndërkombëtare që prodhoi edhe një aktgjykim të gjykatës kushtetuese, i cili gjeti se marrëveshja e dytë mbi parimet për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe e 25 gushtit 2015 ishte në kundërshtim me 18 nene të Kushtetutës. Ky fakt fuqizon argumentin se dialogu Kosovë-Serbi, posaçërisht marrëveshja e parë e 19 prillit 2013 dhe ajo e 25 gushtit 2015 kishin implikime të mëdha kushtetuese dhe si të tilla krijuan edhe pasoja konkrete juridiko-kushtetuese në Republikën e Kosovës për faktin se procesi i krijimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe morri një rrugë tjetër pa një derë të qartë dalëse.

Pavarësisht gjetjeve të gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, sipas aktgjykimit të datës 23 dhjetor 2015, duhet të kuptohet që obligimi për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe është një obligim ndërkombëtar të cilin Kosova e ka marrë me rastin e ratifikimit të marrëveshjes së 19 prillit 2013 në kuvend me 2/3 e votave dhe këtij obligimi Kosova nuk mund t'i ikë.

Duhet theksuar se nga mbi tridhjetë (30) marrëveshje<sup>32</sup> të arritura deri me tani në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Marrëveshja për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe e datës 25 gusht 2015, ndërlidhur me obligimet e dala nga Marrëveshja e 19 prillit 2013, ka krijuar më së shumti pasoja kushtetuese duke prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë dispozitat e

<sup>32</sup> Shih më shumë numri marrëveshjet e arritura në dialogun Kosovë-Serbi: *Dialou Kosovë-Serbi, Sfidat dhe Rruga Përpara*, (analizë e shkurtë), Mars 2018, botoi Kosovo Democratic Institute, f.16-17.

Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ndonëse transparenca në kuadër të procesit të dialogut Kosovë-Serbi ishte një karakteristikë negative që e ka përcjellë këtë proces që nga fillimi, ka pasur edhe marrëveshje të tjera të nënshkruara të cilat në mënyrë indirekte kanë prekur sistemin kushtetues, ani pse për këtë nuk ka pasur vlerësim nga Gjykata Kushtetuese. Me këtë rast vlen të përmendet Marrëveshja e ashtuquajtur për drejtësi e datës 9 shkurt 2015, sipas të cilës në pjesën veriore të Mitrovicës do të ketë një njësiti të Gjykatës së Apelit.<sup>33</sup> Çështja kryesore këtu qëndron se me nenin 21 të Ligjit për gjykatat e Republikës së Kosovës, Gjykata e Apelit ka juridiksion në tërë territorin e Kosovës dhe se selia e saj është në Prishtinë. Ekzistenca e një njësiti të Gjykatës së Apelit është në kundërshtim me këtë dispozitë dhe në njëfarë forme e prish parimin e një sistemi unik gjyqësor dhe është në kundërshtim edhe me vetë organizmin e brendshëm të Gjykatës së Apelit.<sup>34</sup> Duke pasur parasysh që të gjitha marrëveshjet e tjera, përpos asaj të 19 prillit 2013, nuk janë ratifikuar dhe nuk janë shpallur në gazetën zyrtare, atëherë të ato nuk do të trajtohen si pjesë e këtij punimi në kuptimin e implikimeve dhe pasojave eventuale kushtetuese që kanë pasur.

Ajo që duhet ritheksuar ka të bëjë me atë që Republika e Kosovës e ka bërë pjesë të sistemit juridik, përmes ratifikimit kushtetues vetëm Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë e datës 19 prill 2013. Përmes kësaj Marrëveshje Republika e Kosovës ka marrë obligim që të krijojë asociacionin e komunave me shumicë serbe, të bëjë integrimin e strukturave të sigurisë së Serbisë në strukturat e sigurisë së Kosovës, respektivisht në policinë e Kosovës, të organizojë zgjedhjet në ato komuna etj.<sup>35</sup> Kosova është treguar mjaft e përgjegjshme në zbatimin e këtyre obligimeve<sup>36</sup>, përkundër që Serbia nuk e ka bërë një gjë të

<sup>33</sup> Marrëveshja për drejtësinë, lidhur më 9 shkurt në Bruksel, pika 11. Teksti jozyrtar i botuar në portalin Koha.Net me titull: “*Teksti i Marrëveshjes Kosovë-Serbi për Gjyqësorin*”, datë 11.2.2015.

<sup>34</sup> Ligji nr. 06/L - 054 për gjykatat, datë 18.12.2018, nenet 21 dhe 24.

<sup>35</sup> Shih: LIGJ nr. 04/L-199 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE TË PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË, veçanërisht pikat 1-12 e tekstit të Marrëveshjes.

<sup>36</sup> Bahri Cani, Intervistë për *Deutsche Welle* me shefin e Policisë së Kosovës në Veri Zhelko Bojiq, datë 24.11.2016. “*Bojiq: Policët serbë nga strukturat paralele janë integruar!*” E qasshme në: <https://www.dw.com/sq/bojiq-polic%C3%ABt-serb%C3%AB-nga-strukturat-paralele-jan%C3%AB-integruar/a-36500191>, qasur më 5.1.2019.

tillë, madje siç u theksuar edhe më sipër Marrëveshjen e 19 prillit 2013, të cilën Kosova e ka ratifikuar, Serbia e ka shpallur akt politik përmes gjykatës së saj kushtetuese.

Ani pse Republika e Kosovës ka marrë përsipër themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe sipas marrëveshjes së 19 prillit 2013, një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur për shkak të gjetjeve (shkeljeve) që i ka bërë Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në Vendimin e saj të 23 dhjetorit 2015. Megjithatë, ky është një obligim që Republika e Kosovës duhet ta përmbushë, gjithnjë duke pasur parasysh sugjerimet e dhëna nga ana e Gjykatës Kushtetuese të saj lidhur me mënyrën e krijimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe. Republika e Kosovës ka bërë përpjekjet e saj për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe duke krijuar ekipin menaxhues për themelimin e tij,<sup>37</sup> por në opinionin publik e profesional në Prishtinë vazhdimisht është shfaqur frika për krijimin e mundshëm të një asociacioni të komunave me shumicë serbe, i cili mund të ketë kompetenca ekzekutive dhe se një gjë e tillë rrjedhimisht është jokushtetuese.<sup>38</sup> Edhe pse asociacioni i komunave me shumicë serbe nuk është finalizuar ende, Kosova ka ndërmarrë veprimet konkrete për themelimin e këtij mekanizmi. Pas themelimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe, Republika e Kosovës do të përmbushë një obligim ndërkombëtar dhe kushtetues të cilin e ka marrë në vitin 2013 me Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve.

Sa i përket implikimeve kushtetuese të dialogut Kosovë-Serbi, në Republikën e Serbisë duhet përmendur se ky proces ka provokuar disa vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Serbisë, gjithnjë mbi supozimin e shprehur nga Serbia se Kosova është pjesë integrale e kushtetutës së saj. Serbia më shumë e ka parë dialogun si

<sup>37</sup> Artikull: “Formohet ekipi menaxhues për themelimin e Asociacionit të komunave serbe”, Agjencia e lajmeve “Kosova Press”, datë 8.9.2016. I qasshëm në: <http://www.kosovapress.com/sq/lajme/formohet-ekipi-menaxhues-per-themelim-e-asociacionit-te-komunave-serb-85191/>, qasur me 5.1.2019.

<sup>38</sup> Bekim Bislimi, artikulli “Asociacioni i zhveshur nga kompetencat ekzekutive”, botoi Radio Evropa e Lirë, 12.5.2018; i qasshëm: <https://www.evropaelire.org/a/asociacioni-kompetencat-kosova/29221750.html>, qasur më 5.1.2019. Për një qasje të tillë shih edhe deklaratat e politikanëve serbë në Kosovë: Artikull: “Rashiq: Nuk pres që Asociacioni të ketë kompetenca ekzekutive”, datë 18.8.2018, botoi “Info Globi”, i qasshëm në: <https://infoglobi.com/rashiq-nuk-pres-qe-asociacioni-te-kete-kompetenca-ekzekutive/>, qasur më 5.1.2019.

një proces politik, duke e kontestuar pozitën e barabartë me Kosovën në këtë proces dhe duke mos njohur Kosovën si shtet, por si pjesë të saj. Ky faktor ka ndikuar drejtpërsëdrejti që Republika e Serbisë të krijojë pengesa të qarta në zbatimin e marrëveshjeve, por edhe t'i trajtojë marrëveshjet që kanë ndalë nga dialogu si akte politike, që nuk kanë efekt juridik dhe që nuk i plotësojnë kushtet të jenë traktate ndërkombëtare sipas nenit 167 të Kushtetutës.<sup>39</sup> Në njëfarë forme Serbia nuk i ka pranuar si obligim i saj ndërkombëtar marrëveshjet e dala nga dialogu dhe i ka zbatuar ato në një mënyrë selektive dhe me një dinamikë shumë më të ulët sesa Kosova.

Përveç kësaj, sa i përket implikimeve të tjera kushtetuese të marrëveshjeve që kanë dalë nga procesi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, vlen të veçohet edhe fakti tjetër që Gjykata Kushtetuese e Serbisë ka shfuqizuar marrëveshjet për diplomat dhe atë për regjistrat kadastralë.<sup>40</sup> Po ashtu Gjykata Kushtetuese e Serbisë, me vendimet e saj, kishte sfiduar edhe marrëveshjet tjera të arritura në kuadër të dialogut, ku ndër të tjera në një vendim të saj kishte përcaktuar se *“Udhëzimi për kontrollin e kalimit të vijës administrative në drejtim të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë („Gazeta zyrtare e RS“ nr 98/11) nuk është në pajtim me Kushtetutën. Gjykata e hedh poshtë kërkesën për pezullimin e zbatimit të akteve dhe veprimeve të caktuara, që ndërmerren në bazë të Udhëzimit të sipërpërmendur (rasti IVo-224/2013)“.*<sup>41</sup>

Nga i gjithë procesi i dialogut, ajo që është diskutuar në raste të caktuara në opinionin publik në Serbi është ndryshimi i Kushtetutës së Serbisë për të mundësuar heqjen e autonomisë së Kosovës nga Kushtetuta e Serbisë.<sup>42</sup> Gatishmëria për të hequr Kosovën nga Kushtetuta e Serbisë, përkatësisht preambula dhe neni 8 e 182, në

<sup>39</sup> Konkluzioni (përfundimi) i datës 10.12.2014 për refuzimin e propozimit për vlerësimin e kushtetutshmërisë së marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, 19 prill 2013. Konkluzioni - Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, nr.13/2015. I qasshëm <http://www.ustavni.sud.rs/page/predmet/sr-Cyrl-CS/11165/?NOLAYOUT=1>, qasur më 4.1.2019.

<sup>40</sup> Analizë, KIPRED, Qendra për Arsim, *“Ndikimi legjislativ i Marrëveshjes së prillit Kosovë-Serbi”*, përgatitur nga Valdrin Dërvishaj, korrik 2014, fq. 9.

<sup>41</sup> Raporti i Misionit Diplomatik të Republikës së Kosovës në Beograd dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës më 1 prill 2015.

<sup>42</sup> Artikulli i gazetës „Danasi“ mbi ndryshimet e mundshme të Kushtetutës serbe *„Serbia fshin autonominë e Kosovës nga Kushtetuta“* Autore: Marija Stojanović, 17.10.2017.

opinionin publik nuk shihej si një rezultat i dalë nga dialogu, por më shumë si një rezultat i presionit dhe kushtit të vënë nga Bashkimi Evropian si dhe për anëtarësimin e Serbisë në të.<sup>43</sup>

Perceptimi i dialogut në mënyra të ndryshme nga ana e Serbisë, sidomos në kuptim të obligueshmërisë së marrëveshjeve të arritura, në vazhdimësi ka qenë një sfidë për procesin e dialogut dhe normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

#### 4. A PO SHKON PROCESI I DIALOGUT KOSOVË - SERBI DREJT FAZËS PËRFUNDIMTARE?

Siç u pa edhe më sipër, dialogu Kosovë-Serbi, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian (BE), kishte kaluar në faza të ndryshme dhe me një qasje krejt të ndryshme ndaj këtij procesi nga të dyja palët. Megjithatë në këtë punim nuk do të merremi shumë me qasjen e Serbisë në procesin e dialogut, pasi që në vazhdimësi është parë që Serbia nuk e trajton Kosovën si palë e barabartë në këtë proces, duke kontestuar shtetësinë e saj të shpallur më 17 shkurt 2008, të vërtetuar edhe me Opinionin Këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në vitin 2010 dhe ky është një fakt i ditur botërisht dhe ndërkombëtarisht deri më sot.

Siç u tha edhe më sipër, dialogu Kosovë-Serbi kishte pasur dy faza, atë të nivelit teknik, që përfundoj në vitin 2013, si dhe atë të nivelit politik<sup>44</sup>, që filloi pas takimit të parë të dy ish-kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë në fund të vitit 2013. Faza politike e dialogut krijoi edhe Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve të cilën Kosova e ratifikoi, në procedurë kushtetuese, me 2/3 e votave të parlamentit. Kjo marrëveshje deri tani mund të konsiderohet si hapi më i madh që është bërë në procesin e dialogut.

Që nga fillimi i dialogut në vitin 2011 e deri tani, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka nxjerr disa rezoluta, ku kishte rikonfirmuar qëndrimin e Republikës së Kosovës për këtë proces. Kështu në Rezolutën e nxjerr më 10 mars 2011, Kuvendi i Kosovës kishte shprehur mbështetjen e dialogut, duke vënë në dukje që dialogu do të

<sup>43</sup> Ibid.

<sup>44</sup> Për një klasifikim të tillë të fazës teknike dhe politike të dialogut shih grafikën në studimin: Donika Emiri and Isidora Stakic “*Belgrade and Pristina: lost in normalisation?*”, European Union Institute for Security Studies (EUISS), prill 2018, f.4-5.

zhvillohet ndërmjet dy shteteve sovrane.<sup>45</sup> Pasi dialogu mes Kosovës dhe Serbisë kaloi në nivel politik, në muajin tetor 2012 Kuvendi i Republikës së Kosovës nxori edhe një rezolutë tjetër përmes së cilës autorizoi qeverinë për udhëheqjen e dialogut dhe konfirmoi që në procesin e dialogut dhe rezultatet e tij duhet të kihet parasysh sovraniteti i Republikës së Kosovës, rendi unik kushtetues dhe integriteti territorial, çështje këto që për Republikën e Kosovës ishin dhe janë të panegociueshme.<sup>46</sup>

Parimet e mishëruara në rezolutat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, atë të vitit 2011 dhe 2012 i kishte mbështetur edhe Qeveria e Republikës së Kosovës në platformat e saj përkitazi me procesin e dialogut. Kështu në Platformën e vitit 2011 Qeveria e Republikës së Kosovës kishte vendosur si parime të panegociueshme në dialog parimet si në vijim: statusin e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran; sovranitetin dhe integritetin territorial; rregullimin e brendshëm kushtetues të Republikës së Kosovës.<sup>47</sup> Të njëjtat çështje si të panegociueshme nga Republika e Kosovës në procesin e dialogut ishin përfshirë edhe në Platformën katërvjeçare për dialogun të qeverisë së Republikës së Kosovës 2014-2018.<sup>48</sup>

Procesi i dialogut Kosovë - Serbi kishte kaluar në faza të ndryshme të dinamikës dhe pas arritjes së marrëveshjes së dytë për asociacionin e komunave me shumicë serbe, praktikisht deri në fund të vitit 2017 ishte udhëhequr nga qeveria, respektivisht në nivel kryeministrash. Megjithatë, normalizimi i marrëdhënieve dhe procesi i dialogut pësoi një regres të konsiderueshëm për faktin se Republika e Serbisë dhe diplomacia e saj u angazhuan maksimalisht për të penguar Republikën e Kosovës të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare, përfshirë këtu Interpol-in dhe UNESCO-n.<sup>49</sup> Viti 2017 e gjeti procesin e dialogut në një gjendje jo të mirë dhe pa një agjendë të qartë të negocijimit. Pas zgjedhjes së qeverisë së Republikës së Kosovës më 9 shtator 2017, Republika e Kosovës, respektivisht qeveria, emëroi një

---

<sup>45</sup> Rezolutë e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-R-001, Prishtinë, 10 mars 2011.

<sup>46</sup> Rezolutë e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-R-08, Prishtinë, 18 tetor 2012.

<sup>47</sup> Platforma e Republikës së Kosovës për dialogun teknik ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Prishtinë, mars 2011, f. 6.

<sup>48</sup> Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun e Brukselit /periudha 2014 – 2018, Prishtinë 15 janar 2015, f. 6.

<sup>49</sup> *Dialogu Kosovë-Serbi, sfidat dhe rruga përpara, (analizë e shkurtë)*, mars 2018, botoi Kosovo Democratic Institute, f.11.

përgjegjës për dialogun teknik dhe një gjë të tillë e bëri edhe Republika e Serbisë,<sup>50</sup> pra në të njëjtën mënyrë kishte vepruar edhe Republika e Serbisë.<sup>51</sup>

Ajo që duhet theksuar lidhur me pozicionin e Republikës së Kosovës në raport me dialogun me Serbinë është obligimi që ka marrë Republika e Kosovës për këtë proces përmes Marrëveshjes së stabilizim-asocijimit të cilën e ka lidhur me Bashkimin Evropian, marrëveshje kjo e ratifikuar edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës në muajin nëntor të vitit 2015.<sup>52</sup> Procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përmes dialogut tani më është një obligim kontraktual i Republikës së Kosovës, i cili është marrë përmes Marrëveshjes së stabilizim-asocijimit.<sup>53</sup> Kjo do të thotë që normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është një obligim dhe kusht për Kosovën në rrugën e saj për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Një gjë e tillë vlen edhe për Republikën e Serbisë. Një obligim i rëndësishëm për Republikën e Kosovës, që rrjedh nga Marrëveshja e stabilizim-asocijimit me BE-në ka të bëjë edhe me zbatimin e marrëveshjeve që kanë dalur nga dialogu me Serbinë. Neni 13.3 (pika a) i kësaj marrëveshje përcakton ndër të tjera që *“Kosova vazhdimisht duhet të zbatojë në mirëbesim të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog me Serbinë”*. Kjo lidhet edhe me faktin që përveç marrëveshjes së prillit të vitit 2013, Republika e Kosovës asnjë marrëveshje tjetër nuk e ka ratifikuar dhe nuk e ka shpallur në gazetën e saj zyrtare dhe në vazhdimësi i ka zbatuar marrëveshjet e dialogut sipas parimit të mirëbesimit. Zbatimi në mirëbesim i marrëveshjeve të dialogut është edhe një ndër faktorët që Republika e Serbisë nuk i ka marrë seriozisht zbatimin e marrëveshjeve, duke krijuar në vazhdimësi barriera. Kjo ka ndodh

<sup>50</sup> Artikull: *“Avni Arifi emërohet shef i negociatave me Serbinë”*, portali Koha.Net, 12.1.2018. I qasshëm: <https://www.koha.net/arberi/68765/avni-arifi-emerohet-shef-i-negotiatave-me-serbine/>, qasur më 5.1.2019.

<sup>51</sup> Artikull: *“Belgrade-Pristina dialogue continues at technical level”*, botuar në b92, 15.01.2018. I qasshëm në: [https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2018&mm=01&dd=15&nav\\_id=103267](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2018&mm=01&dd=15&nav_id=103267), qasur më 6.1.2019.

<sup>52</sup> Artikulli I Bekim Shehut *“Kuvendi i Kosovës ratifikon marrëveshjen e MSA-së”*, Deutsche Welle shqip, 2.11.2015. I qasshëm: <https://www.dw.com/sq/kuvendi-i-kosov%C3%ABs-ratifikon-marr%C3%ABveshjen-e-msa-s%C3%AB/a-18821725>, qasur më 6.1.2019.

<sup>53</sup> Marrëveshja e stabilizim-asocijimit ndërmjet Kosovës\*, në një tërësi anë, dhe Bashkimin Evropian e Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, 2015, neni 13.

edhe si pasojë e mungesës së mekanizmave efikas për zbatimin e këtyre marrëveshjeve, por edhe për shkak të statusit juridik të tyre sidomos në Republikën e Serbisë.

Edhe fillimi i vitit 2018 e gjeti dialogun në një fazë të heshtur dhe pa progres, ku palët shkëmbenin deklarata njëra me tjetrën për mos përbushje të obligimeve të dyanshme. Gjatë vitit 2018 në procesin e dialogut kishte takime në nivel të presidentëve të të dyja shteteve. Gjatë këtyre takimeve Republika e Serbisë kryesisht aludonte në mospërbushjen e obligimeve lidhur me moskrijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe nga ana e Republikës së Kosovës, duke e bërë përgjegjëse kështu edhe Bashkimin Evropian. Ky qëndrim i Serbisë kishte ardhur përmes deklaratave të presidentit serb Aleksandër Vuçiç.<sup>54</sup> Ndërkaq deklaratat e Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga presidenti Thaçi, aludonin në nevojën për të pasur një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve, me qëllim të lehtësimit të jetës së qytetarëve.<sup>55</sup>

Nga veprimet dhe deklaratimet e bartësve të funksioneve shtetërore në Republikën e Kosovës dhe të Serbisë, pas një stagnimi të procesit të dialogut në vitin e fundit, duket që ky proces po shkon drejt fazës finale. Megjithëse nuk është ende një agjendë të qartë se si do të përmbillet dhe se çka do të bisedohet në fazën finale të procesit të dialogut, ka pasur deklarime që pjesë e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të jetë edhe çështja e kufijve shtetëror ndërmjet dy shteteve, në mënyrë që kjo çështje të definohet.<sup>56</sup> Në mungesë të një agjende të qartë për përmbylljen e fazës përfundimtare të dialogut në Kosovë gjatë vitit 2018 në vazhdimësi kishte qëndrime të ndryshme rreth këtij procesi, për çka edhe u shtrua nevoja për një unitet politik në këtë procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Si rrjedhojë e kërkesave për unitet politik Kuvendi i Republikës së Kosovës më 15 dhjetor 2018 ka nxjerrë një rezolutë të re, ku ka përcaktuar kornizat e dialogut, duke emëruar edhe një

---

<sup>54</sup> Artikulli “*No Progress Reported In Kosovo, Serbia Normalization Talks*”, radio Free Europe, 24.03.2018. I qasshëm: <https://www.rferl.org/a/no-progress-reported-talks-vucic-thaci-normalize-relations-kosovo-serbia-brussels/29120862.html>, qasur më 6.1.2019.

<sup>55</sup> Ibid.

<sup>56</sup> Shih më shumë artikullin Andrew MacDowall, “*Could land swap between Serbia and Kosovo lead to conflict?*”, botues The Guardian, 22.8.2018. I qasshëm: <https://www.theguardian.com/world/2018/aug/22/serbia-kosovo-could-land-swap-between-lead-conflict>, qasur më 6.1.2019.



delegacion shtetëror gjithëpërfshirës, i cili do ta udhëheq dialogun në fazën përfundimtare.<sup>57</sup>

Se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është duke shkuar drejt përmbylljes qartësohet edhe në pjesën përfundimtare të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës të 15 dhjetorit 2018, ku përmendet marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.<sup>58</sup> Megjithatë edhe para nxjerrjes së kësaj rezolute në spektrin politik dhe profesional të Republikës së Kosovës është folur për një marrëveshje ligjërish të obligueshme dhe me fuqi detyruese.<sup>59</sup>

Një çështje tjetër e cila ka krijuar debat në Republikën e Kosovës në fazën përfundimtare të dialogut me Serbinë është edhe fakti se kush mund ta udhëheqë dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë në këtë fazë. Ka pasur edhe debate që një gjë e tillë nuk mund të bëhet nga presidenti i shtetit për shkak të mungesës së legjitimitetit kushtetues.<sup>60</sup>

Nëse e shikojmë këtë çështje nga prizmi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi, duhet theksuar se në nenin 84.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i jepet kompetencë presidentit që të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare, por edhe një rol aktiv në përfaqësimin e shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në anën tjetër, kompetencën për të ndërmarrë të gjitha veprimet për lidhje të marrëveshjes ndërkombëtare presidentit ia jep edhe Ligji në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare i Republikës së Kosovës, i cili përcakton se Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme mund të ndërmarrin të gjitha veprimet për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare pa pasur nevojë për autorizim nga ndonjë institucion tjetër.<sup>61</sup> Edhe në bazë të Konventës së Vjenës për të drejtën e traktateve, presidenti i shtetit, kryeministri dhe ministri i punëve të jashtme konsiderohen si të parët që kanë fuqi të plota për ndërmarrjen e veprimeve për lidhjen e një marrëveshje ndërkombëtare.<sup>62</sup>

<sup>57</sup> Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës 06-R-015, datë 15.12.2018.

<sup>58</sup> Ibid, f.5

<sup>59</sup> Artikulli “*Marrëveshja përfundimtare Kosovë - Serbi, me fuqi detyruese*”, botoi “Zëri”, 3.5.2018. I qasshëm: <https://zeri.info/aktuale/197392/marreveshja-perfundimtare-kosove-serbi-me-fuqi-detyruese/>, qasur më 6.1.2019.

<sup>60</sup> Artikulli: “*Opozita në Kosovë: Presidenti nuk ka legjitimitet të udhëheqë dialogun me Serbinë*”, botoi AlsatM, datë 3.7.2018. I qasshëm: <https://www.alsat-m.tv/opozita-ne-kosove-presidenti-nuk-ka-legjitimitet-te-udheheqe-dialogun-me-serbine/>, qasur më 6.1.2019.

<sup>61</sup> LIGJI nr. 04/L-052 PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE, neni 6.1.

<sup>62</sup> Konventa e Vjenës për të drejtën e traktateve 1969, neni 7.

Gjithashtu në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës, ligjet në fuqi i japin kompetencën presidentit jo vetëm për të lidhur, por edhe për të autorizuar lidhjen e një marrëveshje ndërkombëtare e cila bën pjesë në grupin e marrëveshjeve që ratifikohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përfshirë këtu edhe procedurat e negocijimit.<sup>63</sup>

Megjithatë, pavarësisht debateve për udhëheqjen e dialogut, krijimi i ekipit për dialog nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës përmes rezolutës i ka dhënë një rrugë tjetër kësaj çështjeje dhe tani Republika e Kosovës do të përfaqësohet në procesin e dialogut me një delegacion gjithëpërfshirës shtetëror që do të udhëheqë dhe përfaqësojë Republikën e Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë.<sup>64</sup> Duke bërë përpjekje për krijimin e një uniteti të brendshëm përkritazi me përfaqësimin në procesin e dialogut me Serbinë nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës është propozuar edhe një projektligj i veçantë për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë. Ky projektligj e përcaktonte delegacionin shtetëror që do të përfaqësojë Republikën e Kosovës në dialog si një organ i veçantë, i cili do të përbëhej nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, pjesë e të cilit do të jetë edhe shoqëria civile.<sup>65</sup> Përmes projektligjit për delegacionin shtetëror në procesin e dialogut, Republika e Kosovës synonte të zgjidhë problemin e unitetit të brendshëm për mënyrën e udhëheqjes dhe menaxhimit të dialogut me Serbinë dhe përmes këtij delegacioni shtetëror të paraqitet edhe një platformë dhe agjendë e qartë për përmbylljen e procesit të dialogut me Serbinë. Kjo pasi që çështja e unitetit të brendshëm në skenën politike kosovare është shfaqur e nevojshme edhe pas deklarimeve të ndryshme të bartësve të institucioneve përkritazi me procesin e dialogut me Serbinë.

Megjithatë, Projektligji për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë u shpall në kundërshtim

<sup>63</sup> LIGJI nr. 04/L-052 PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE, neni 7.1., i cili përcakton që veprimet për lidhjen e marrëveshjeve që ratifikohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës autorizohen nga ana e presidentit.

<sup>64</sup> Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës 06-R-015, datë 15.12.2018, f.3-4.

<sup>65</sup> Projektligji për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, draft jozyrtar, botuar në portalin Telegrafi.com. I qasshëm: <https://telegrafi.com/wp-content/uploads/2018/12/PSD-Projektligj-per-delegacionin-shtetror.pdf>, qasur më 6.1.2019.

me dispozitat kushtetuese nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Përmes këtij vendimi Gjykata Kushtetuese u mundua që të sqarohet se cili institucion kushtetues duhet të udhëheqë dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ajo çfarë është e sigurt dhe që mund të nxirret si përfundim nga vendimi respektiv i Gjykatës Kushtetuese ka të bëjë me faktin se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë trajtohet kushtetushmërisht si pjesë e politikës së jashtme dhe ushtrimit të kompetencave kushtetuese në këtë fushë nga ana e institucioneve kushtetuese.<sup>66</sup>

## 5. SI MUND TË DUKET MARRËVESHJA PËRFUNDIMTARE PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE KOSOVË-SERBI NGA KËNDVËSHTRIMI I PALËS KOSOVARE

Një proces i dialogut i filluar para më shumë se nëntë vitesh dukej që është në përfundim e sipër. Të paktën një gjë e tillë mund të thuhet duke marrë parasysh veprimet që ishin ndërmarrë nga Republika e Kosovës për këtë proces përmes nxjerrjes së rezolutës dhe krijimit të delegacionit shtetëror për udhëheqjen e dialogut në cilësinë e një organi të veçantë.

Ani pse pa një agjendë të detajuar për dialogun, Kuvendi i Republikës së Kosovës në Rezolutën e tetorit 2018 përcaktoi tri qëllime kryesore që Republika e Kosovës synon t'i arrijë në këtë proces, siç janë: Njohja e ndërsjellë e palëve të përfshira në proces, anëtarësimi i Republikës së Kosovës në OKB dhe përshpejtimi i proceseve integruese në BE dhe NATO për Republikën e Kosovës.<sup>67</sup> Ndërkaq, në rezolutën e kuvendit (2018) përcaktohet qartë se për Republikën e Kosovës janë të paprekshme integriteti territorial dhe sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës, përfshirë edhe karakterin unitar të shtetit.<sup>68</sup>

Në mungesë të platformës së dialogut Kosovë-Serbi, nga të dyja shtetet, mbetet akoma e paqartë se çka do të negociohet në fazën përfundimtare të këtij procesi si dhe çfarë do të përmbajë marrëveshja potenciale përfundimtare që do të krijojë ky proces. Deri tani sidomos

<sup>66</sup> AKTGJYKIM në rastin nr. K043/19, Prishtinë, 27 qershor 2019, nr. ref.: 1387/19.

<sup>67</sup> Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës 06-R-015, datë 15.12.2018, f.1 (Parimet e marrëveshjes gjithëpërfshirëse).

<sup>68</sup> Ibid f.2 (përkufizimi dhe korniza e dialogut).

nga ana e Serbisë nuk ka pasur ndonjë indicje se cilat çështje do të negociohen në procesin e dialogut. Ndërkaq në këtë aspekt, sa i përket palës kosovare, është obligim i përcaktuar në Marrëveshjen e stabilizim-asocijimit, se Kosova duhet t'i zgjedhë përmes dialogut çështjet e pazgjidhura me Serbinë<sup>69</sup>, që hipotetikusht mund të jenë të shumta.

Procesi i dialogut stagnoi tërësisht gjatë vitit 2019, sidomos pas zhvillimeve politike në Republikën e Kosovës dhe dorëheqjes së kryeministrit Haradinaj. Ky zhvillim afektoi në mënyrë të drejtpërdrejtë procesin e dialogut dhe pasivizoi në shkallë maksimale të dyja palët. Kjo situatë vazhdon edhe sot e kësaj dite deri në krijimin e qeverisë së re të Republikës së Kosovës.

Megjithatë, një gjë të cilën duhet ta bëjë të qartë Republika e Kosovës në procesin e dialogut është ndryshimi i pozicionit të Serbisë në këtë proces, në kuptimin e asaj që procesi përfundimtar i dialogut nga Serbia të trajtohet si një dialog ndërshtetëror, që nënkupton njohjen e pavarësisë dhe subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Një gjë të tillë Serbia nuk e ka bërë, pasi që në vazhdimësi në kuptim të rendit të brendshëm juridik të saj ajo Kosovën e ka trajtuar si pjesë të saj, kurse institucionet e Kosovës si institucione të përkohshme vetëqeverisëse. Nëse një gjë e tillë nuk sqarohet, atëherë do të jetë problem i konsiderueshëm edhe natyra juridike e marrëveshjes përfundimtare.

Duke pasur parasysh çështjet e shumta që kanë mbetur të pazgjidhura në procesin e dialogut të deritashëm, por edhe çështjet e ndërsjella ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ekziston supozimi i qëndrueshëm se teksti i marrëveshjes përfundimtare duhet të jetë i detajuar dhe që parasheh me precizitet të gjitha çështjet që janë objekt negocijimi në dialog.

Është me rëndësi të thuhet se natyra juridike e marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të ketë formën e tillë të një traktati të obligueshëm ndërkombëtar ndërmjet dy shteteve, ashtu siç parashihet në Konventën e Vjenës për të drejtën e traktateve 1969.<sup>70</sup> Kjo nënkupton që marrëveshja përfundimtare duhet të ketë të njëjtin status juridik në të dyja shtetet palë të dialogut, si në Kosovë

<sup>69</sup> Marrëveshja e stabilizim-asocijimit ndërmjet Kosovës\*, në një të anë, dhe Bashkimit Evropian e Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, 2015, neni 13, paragrafi 3 (c).

<sup>70</sup> Konventa e Vjenës për të drejtën e traktateve, 1969, neni 2.1 (a).

ashtu edhe në Serbi. Gjithashtu, marrëveshja përfundimtare duhet të kalojë edhe në rrugën e ratifikimit kushtetues, në Republikën e Kosovës dhe Serbisë, bazuar në kushtetutat e të dyja shteteve.<sup>71</sup> Nëse marrëveshja përfundimtare e dialogut nuk trajtohet në mënyrë të njëjtë nga të dyja palët në dialog dhe nëse nuk ratifikohet sipas procedurave kushtetuese të njëjta, si dhe nëse nuk shpallet në gazetën zyrtare të të dyja shteteve si e tillë, është vështirë e besueshme që mund të ketë një përmbyllje të suksesshme të procesit të dialogut. Serbia nga ana e saj e ka dëshmuar me rastin e Marrëveshjes së 19 prillit 2013 për normalizimin e marrëdhënieve, se marrëveshjet e arritura në dialog nuk i ka trajtuar me status të njëjtë kushtetues sikurse Republika e Kosovës.

Nga ajo që është parë deri tani, Republika e Kosovës e ka bërë të qartë se në marrëveshjen përfundimtare me Serbinë në dialog nuk mund të preket integriteti territorial, sovraniteti i Republikës së Kosovës, karakteri unitar i shtetit dhe rregullimi kushtetues gjithashtu. Kjo, siç u tha më lart, është theksuar në të gjitha dokumentet që ka përgatitur për procesin e dialogut deri tani Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, kurse një gjë e tillë u bë e qartë edhe me Rezolutën e fundit të Kuvendit të muajit tetor 2018. Deri më tani në opinionin profesional juridik në Prishtinë janë bërë përpjekje për të nxjerrë konkluzione se cilat do të ishin çështjet që minimalisht duhet t'i zgjidhte Kosova në procesin e dialogut, e të cilat do të ishin edhe pjesë e marrëveshjes. Lidhur me këtë një analizë e Grupit për studime juridike dhe politike, ndër të tjera thekson disa çështje që mund të përbënin minimumin e përmbytjes së marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Disa nga këto çështje që përmenden në këtë studim janë: Njohja juridikisht e plotë e Republikës së Kosovës nga Republika e Serbisë; Abrogimi i Rezolutës 1244; Zgjidhja gjyqësore e konflikteve në rast të moszbatimit të marrëveshjes; Një marrëveshje ku palë e tretë do të jetë edhe BE; Një status të caktuar për forcat e KFOR-it në Republikën e Kosovës; Reciprociteti në çështjen e pozitës së komuniteteve joshumicë; zgjidhja e çështjes së personave të pagjetur etj.<sup>72</sup>

<sup>71</sup> Kushtetutën e Republikës së Kosovës 2008 dhe atë të Republikës së Serbisë 2006.

<sup>72</sup> Studim, Grupi për Studime Politike dhe Juridike - GLPS, “ÇFARË ËSHTEË MINIMUMI I NJË PLATFORME PËR DIALOGUN E FAZËS FINALE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË”, Prishtinë, nëntor-dhjetor 2018.

Republika e Kosovës ka përcaktuar si një parim njohjen nga Serbia, si kusht që dialogu të ketë sukses. Në mënyrë që t'i përgjigjet neglizhencës së Serbisë në procesin e dialogut, Kosova i ka vendosur taksë 100% të gjitha produkteve që importohen nga Serbia në Kosovë.<sup>73</sup> Masa e tillë ka acaruar në mënyrë të konsiderueshme gatishmërinë për një vazhdim të fazës përmbyllëse të dialogut dhe kjo u pa qartë gjatë pjesës më të madhe të vitit 2019.

Megjithatë, t'i kthehemi çështjes së asaj se çka mund të përmbajë marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Natyrisht, një proces i pajtimit nuk mund të konsiderohet i përmbyllur nëse nuk do të ketë njohje të shtetësisë dhe pavarësisë së Republikës së Kosovës nga Serbia, që do të rezultonte me krijimin e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy shteteve, në pajtim me Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike 1969. Megjithëse një gjë e tillë nga deklaratimet e bartësve shtetëror të Serbisë duket aktualisht e pamundur.<sup>74</sup>

Pashmangshëm një çështje tjetër e cila duhet të definohet në marrëveshjen përfundimtare është edhe abrogimi i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe fitimi i një ulëse të Kosovës në OKB. Kjo do të përbente një hap të rëndësishëm në kompletimin e shtetësisë së Kosovës. Një gjë e tillë pala kosovare e ka bërë të qartë edhe në rezolutën e fundit të Kuvendit.

Duke pasur parasysh që Serbia nuk është sjellë korrekte dhe praktikisht ka qenë e papërgjegjshme në zbatimin e marrëveshje të dala nga dialogu, marrëveshja përfundimtare duhet të sigurojë një mekanizëm efikas, gjyqësor ose një mekanizëm tjetër i cili do të siguronte që marrëveshja përfundimtare e dialogut do të përmbushej.

*“Një formë e shprehjes së këtij garancioni është që Marrëveshja të përfshijë një klauzolë që i njeh GjND-së jurisdikcionin për të gjykuar dhe rrjedhimisht zgjidhur çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve, përfshirë zbatimin e detyrueshëm të vendimeve të saj në rastet kur njëra palë i shmanget detyrimeve të dhëna në marrëveshje, apo qëllimit të saj”*<sup>75</sup>

<sup>73</sup> Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/76, datë 21.11.2018.

<sup>74</sup> Artikull: “Serbia Will Not Recognise Kosovo Despite New 100% Tariffs – President Vucic”, botoi Sputnik, 23.11.2018. I qasëm në: <https://sputniknews.com/europe/201811231070055956-serbia-kosovo-recognition-tariff-hike/>, qasur me 7.1.2019.

<sup>75</sup> Studim, Grupi për Studime Politike dhe Juridike - GLPS, “ÇFARË ËSHTË MINIMUMI I NJË PLATFORME PËR DIALOGUN E FAZËS FINALE NË MES

Përveç mekanizmit gjyqësor përmes GJND-së, mund të gjendet edhe ndonjë mekanizëm tjetër garantues për zbatimin e kësaj marrëveshje, një opsion për këtë mund të jetë BE-ja, mund të vendosë sanksione në procesin e anëtarësimit të Kosovës apo Serbisë në BE në rast të moszbatimit të obligimeve që dalin nga marrëveshja përfundimtare. Kjo çështje megjithatë duhet të parashihet qartë dhe në mënyrë precize në marrëveshje.

Një aspekt tjetër duhet të definohet në marrëveshjen përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është edhe mbështetja e Serbisë ndaj Kosovës dhe praktikisht moskrijimi i pengesave reale për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe mekanizmat ndërkombëtarë. Një gjë e tillë do të nënkuptonte edhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete nga Serbia.

Çështja e të pagjeturve mbetet një temë pezull që nga koha kur kjo u diskutua në bisedimet e Vjenës dhe si rezultat u përfshi edhe në planin e Ahtisaarit në bazë të të cilit Kosova e shpalli pavarësinë me 17 shkurt 2008.<sup>76</sup> Si probleme të pazgjidhura me Serbinë që mund të përfshihen në marrëveshje përfundimtare janë edhe çështjet ekonomike dhe pronësore të trashëguara dhe që kanë mbetur pezull si dhe çështja e borxhit ndërkombëtar. Kthimi i artefakteve arkeologjike dhe etnologjike të Kosovës të marra nga Serbia është një problem tjetër që duhet të gjejë hapësirë në negocijim në procesin përfundimtar të dialogut si dhe të jetë pjesë e marrëveshjes përfundimtarë.<sup>77</sup>

Gjithashtu në marrëveshjen përfundimtare, ligjërisht të obligueshme në procesin e dialogut, duhet të rregullohet edhe fati i të gjitha marrëveshjeve që janë lidhur deri tani në procesin e dialogut. Një klauzolë e tillë do t'i ndihmonte palëve që të rregullonin statusin juridik të obligueshmërisë së marrëveshjeve të arritura deri tani si dhe do të siguronte zbatim efikas dhe njohje të pasojave faktike që kanë krijuar marrëveshjet e nënshkruara në dialog.

Një problem tjetër, i cili është obligim ndërkombëtar i Republikës së Kosovës dhe që duhet të rregullohet në detaje në marrëveshjen përfundimtare është krijimin dhe statusi i asociacionit të komunave me shumicë serbe në Republikën e Kosovës, obligim ky i mbetur pezull që nga vitit 2013, i cili duhet marrë formën e tij në

---

*TË KOSOVËS DHE SERBIË*”, Prishtinë, nëntor-dhjetor 2018.

<sup>76</sup> Propozimi gjithëpërfshirës për marrëveshjen për statusin e Kosovës, 2 shkurt 2007, dispozitat e përgjithshme, neni 5.

<sup>77</sup> Ibid, neni 6, Aneksi V.

marrëveshjen përmbyllëse të dialogut. Pala kosovare në këtë aspekt duhet të ketë kujdes që këtë ta bëjë duke respektuar kushtetutën, por edhe të gjeturat e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të saj të datës 23 dhjetor 2015. Mbase një ndër sfidat më të mëdha në kuadër të kësaj marrëveshjeje do të jetë statusi juridik dhe pozita e asociacionit të komunave me shumicë serbe në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, që shfaq tendencën e qartë të palës serbe për shfrytëzimin mbi baza etnike të këtij mekanizmi.

Pala kosovare në të gjitha çështjet e pazgjidhur me Republikën e Serbisë, të cilat duhet të synojë që t'i mbyllë në procesin e dialogut, duhet të ketë kujdes maksimal që marrëveshja përfundimtare të mos e prek dhe të mos e tejkalojë Planin Ahtisari në bazë të të cilit është shpallur dhe është njohur ndërkombëtarisht shteti i Kosovës me 17 shkurt 2008. Nëse marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të prekte në një formë apo një tjetër garancionet që ofron Planin Ahtisari për shtetin e Kosovës, praktikisht do të prekej edhe thelbi i shtetësisë së Kosovës dhe sistemi kushtetues që buron nga Deklarata e pavarësisë e vitit 2008. Rreziku real që të preket sistemi kushtetues dhe koncepti ahtisarian i shtetit të Kosovës ekziston te dizajnimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe. Praktikisht përmes asociacionit të komunave mund t'i ofrohen më shumë të drejta komunitetit serb sesa edhe i njëj vetë kushtetuta e Republikës së Kosovës, situatë kjo e cila do të krijonte pashmangshëm edhe ndryshime të kushtetutës së Kosovës.

Një gjë e cila duket qartazi në sfond është që marrëveshja përfundimtare e dialogut ka pritshmëri reale që të krijojë ndryshime kushtetuese në Kosovë dhe në Serbi. Në Serbi kjo është e evidente për shkak të heqjes së Kosovës nga kushtetuta serbe, kurse në Kosovë një pritshmëri e tillë lidhet me pozitën e pakicave, gjegjësisht të statusit të asociacionit të komunave rreth të drejtave të komunitetit joshumicë serb në Republikën e Kosovës.

## 6. PËRFUNDIM

Procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, i cili tani pas nëntë vitesh po shkon drejt përfundimit, duhet të prodhojë një marrëveshje përfundimtare, e cila do të jetë një traktat ndërkombëtar i obligueshëm



për të dyja shtetet, e që do të bëjë pajtimin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe të Serbisë.

Traktati përfundimtar duhet të sjellë një pajtim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, ku shtetet do t'i zgjidhin çështjet e mbetura pezull dhe do t'i normalizojnë marrëdhëniet e tyre si dy shtete të pavarura dhe me subjektivitet të plotë ndërkombëtar.

Ajo që do të jetë me rëndësi në përmbylljen e procesit të dialogut ka të bëjë me përmbajtjen e marrëveshjes përfundimtare, mekanizmat e zbatimit dhe obligueshmërinë e saj, si dhe fakti nëse kjo marrëveshje do të krijojë ndryshme kushtetuese në Republikën e Kosovës dhe atë të Serbisë ose dhe të prekë sovranitetin e të dyja shteteve.

Arsim Bajrami & Florent Mucaj, Prishtinë

## CONSTITUTIONAL ASPECTS OF THE KOSOVO-SERBIA DIALOGUE

### Abstract

The paper aims to present a clear picture of the normalization of relations in the Western Balkans between the Republic of Kosovo and that of Serbia, through a process of dialogue, which has begun for more than eight (8) years ago.

The process of dialogue has produced different results for both countries so far, including various consequences and implications of a constitutional nature. Taking this into account, this paper offers an analysis that has the perspective and the constitutional dimension of the Kosovo- Serbia dialogue in its background, taking into account the legal and factual actions that have been undertaken so far by the parties in the process. The paper analyzes this process from the beginning to date, bringing a constitutional point of view and conclusions, for the conclusion of the process and practically the final normalization of relations and the conclusion of a final agreement of reconciliation between the Republic of Kosovo and that of Serbia, but also the constitutional consequences which can be brought by this agreement.

*Key words:* the process of dialogue; constitution; international agreement; implementation of agreements; constitutional changes

## REFERENCAT:

- [1] AKTGJYKIM në rastin nr. K043/19, Prishtinë, me 27 qershor 2019, nr. ref.: 1387/19;
- [2] Analizë, KIPRED, Qendra për Arsim, “*Ndikimi Legjislativ i Marrëveshjes së Prillit Kosovë-Serbi*”, përgatitur nga Valdrin Dërvishaj, korrik 2014;
- [3] Artikull “*Opozita në Kosovë, me peticion kundër marrëveshjeve me Serbinë*”, 18.9.2015, botoi: Radio Evropa e Lirë, i qasshëm në: <https://www.evropaelire.org/a/2725557.html>;
- [4] Artikull i gazetës „Danas“ mbi ndryshimet e mundshme të kushtetutës serbe „*Serbia fshin autonominë e Kosovës nga Kushtetuta*“ Autore: Marija Stojanoviç, 17.10.2017;
- [5] Artikull: “*Asociacioni pa kompetenca ekzekutive*”, botoi gazeta “Zëri” 8 korrik 2015. E qasshme në: <https://zeri.info/aktuale/41033/asociacioni-pa-kompetenca-ekzekutive/>;
- [6] Artikull: “*Avni Arifi emërohet shef i negociatave me Serbinë*”, portali Koha.Net, 12.1.2018. I qasshëm: <https://www.koha.net/arberi/68765/avni-arifi-emerohet-shef-i-negociatave-me-serbine/>;
- [7] Artikull: “*Belgrade-Pristina dialogue continues at technical level*”, botuar në b92, 15.1.2018. I qasshëm në: [https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2018&mm=01&dd=15&nav\\_id=103267](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2018&mm=01&dd=15&nav_id=103267);
- [8] Artikull: “*Formohet ekipi menaxhues për themelimin e Asociacionit të komunave serbe*”, Agjencia e lajmeve Kosova Press, datë 8.9.2016. I qasshëm në: <http://www.kosovapress.com/sq/lajme/formohet-ekipi-menaxhues-per-themelim-e-asociacionit-te-komunave-serb-85191/>;
- [9] Artikull: “*Hasani: Marrëveshjet Kosovë-Serbi janë politike*”, Portali Telegrafi, artikull i datës 23.3.2012, <https://telegrafi.com/hasani-marreveshjet-kosove-serbi-jane-politike/shtetuta-e-republikes-se-kosoves-2008/>;
- [10] Artikull: “*Marrëveshja përfundimtare Kosovë - Serbi me fuqi detyruese*”, botoi “Zëri”, 3.5.2018. I qasshëm: <https://zeri.info/aktuale/197392/marreveshja-perfundimtare-kosove-serbi-me-fuqi-detyruese/>;
- [11] Artikull: “*No Progress Reported In Kosovo, Serbia Normalization Talks*”, radio Free Europe, 24.03.2018. I qasshëm: <https://www.rferl.org/a/no-progress-reported-talks-vucic-thaci-normalize-relations-kosovo-serbia-brussels/29120862.html>;
- [12] Artikull: “*Opozita në Kosovë: Presidenti nuk ka legjitimitet të udhëheqë dialogun me Serbinë*” botoi AlsatM, datë 3.7.2018. I

- qasshëm: <https://www.alsat-m.tv/opozita-ne-kosove-presidenti-nuka-legjitimet-te-udheheqe-dialogun-me-serbine/>;
- [13] Artikull: “*Rashiq: Nuk pres që Asociacioni të ketë kompetenca ekzekutive*”, datë 18.8.2018, botoi “Info Globi”. I qasshëm në: <https://infoglobi.com/rashiq-nuk-pres-qe-asociacioni-te-kete-kompetenca-ekzekutive/>;
- [14] Artikull: “*Serbia Will Not Recognise Kosovo Despite New 100% Tariffs – President Vucic*”, botoi “Sputnik”, 23.11.2018. I qasshëm në: <https://sputniknews.com/europe/201811231070055956-serbia-kosovo-recognition-tariff-hike/>;
- [15] Artikull: Andrew MacDowall “*Could land swap between Serbia and Kosovo lead to conflict?*”, botues The Guardian, 22.8.2018. I qasshëm: <https://www.theguardian.com/world/2018/aug/22/serbia-kosovo-could-land-swap-between-lead-conflict>;
- [16] Artikull: Bekim Shehu “*Kuvendi i Kosovës ratifikon marrëveshjen e MSA-së*”, Deutsche Welle shqip, 2.11.2015. I qasshëm: <https://www.dw.com/sq/kuvendi-i-kosov%C3%ABs-ratifikon-marr%C3%ABveshjen-e-msa-s-%C3%AB/a-18821725>;
- [17] Bahri Cani, Intervistë për *Deutsche Welle* me shefin e Policisë së Kosovës në Veri Zhelko Bojiq, datë 24.11.2016. “*Bojiq: Policët serbë nga strukturat paralele janë integruar!*” E qasshme në: <https://www.dw.com/sq/bojiq-polic%C3%ABt-serb%C3%AB-nga-strukturat-paralele-jan%C3%AB-integruar/a-36500191>;
- [18] Bekim Bislimi, Artikull “*Asociacioni i zhveshur nga kompetencat ekzekutive*”, botoi Radio Evropa e Lirë, 12.5.2018. I qasshëm: <https://www.evropaelire.org/a/asociacioni-kompetencat-kosova/29221750.html>;
- [19] *Dialogu Kosovë-Serbi, sfidat dhe rruga përpara*, (analizë e shkurtë), mars 2018, botoi Kosovo Democratic Institute;
- [20] Donika Emini and Isidora Stakic “*Belgrade and Pristina: lost in normalisation?*”, European Union Institute for Security Studies (EUISS), prill 2018;
- [21] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim në rastin nr. K0130/15, parashtrues Presidentja e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 23 dhjetor 2015, nr. ref.:AGJ877/15;
- [22] Ilir Deda dhe Ariana Qosaj - Mustafa, “*Analiza e zbatimit të Marrëveshjeve teknike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Analizë politike*, nr.2/13, qershor 2013, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave - KIPRED;
- [23] International Court of Justice Reports of Judgments, Advisory Opinions and Orders Accordance with International Law of the

- Unilateral Declaration Of Independence in Respect Of Kosovo Advisory Opinion of 22 July 2010;
- [24] Konkluzioni (përfundimi) i datës 10.12.2014 për refuzimin e propozimit për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, 19 prill 2013. Konkluzioni - Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr.13/2015. I qasshëm: <http://www.ustavni.sud.rs/page/predmet/sr-Cyrl-CS/11165/?NOLAYOUT=1>;
- [25] Konventa e Vjenës për të drejtën e traktateve 1969;
- [26] Kushtetuta e Republikës së Serbisë (2006);
- [27] LIGJ nr. 04/L-199 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE TË PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË;
- [28] LIGJI nr. 04/L-052 PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE;
- [29] Ligji nr. 06/L - 054 për gjykatat, datë 18.12.2018;
- [30] Marc Weller, “*Shtetësia e kontestuar - administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*” Prishtinë 2011;
- [31] Marrëveshja e stabilizim-asocijimit ndërmjet Kosovës\*, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian e Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, 2015;
- [32] Marrëveshja për drejtësinë, lidhur më 9 shkurt në Bruksel, pika 11. Teksti jozyrtar i botuar në portalin Koha.Net, me titull: “*Teksti i Marrëveshjes Kosovë-Serbi për gjyqësorin*”, datë 11.2.2015;
- [33] Marrëveshja: Asociacioni/bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/elementet kryesore, 25 gusht 2015;
- [34] Platforma e Republikës së Kosovës për dialogun teknik ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Prishtinë, mars 2011;
- [35] Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun e Brukselit, periudha 2014 – 2018, Prishtinë, 15 janar 2015;
- [36] Projektligji për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, draft jozyrtar, botuar në portalin Telegrafi.com. I qasshëm: <https://telegrafi.com/wp-content/uploads/2018/12/PSD-Projektligji-per-delegacionin-shteteror.pdf>;
- [37] Propozimi Gjithëpërfshirës për marrëveshjen për statusin e Kosovës, 2 shkurt 2007.
- [38] *Raport mbi gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit*”, Ministria për Dialog e Republikës së Kosovës, 1 janar - 15 qershor 2016;

- [39] Raporti i Misionit Diplomatik i Republikës së Kosovës në Beograd, dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës më 1 prill 2015;
- [40] Resolution adopted by the General Assembly, [without reference to a Main Committee (A/64/L.65/Rev.1)] 64/298. Request for an advisory opinion of the International Court of Justice on whether the unilateral declaration of independence of Kosovo is in accordance with international law, 9 September 2010;
- [41] Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës 06-R-015, datë 15.12.2018;
- [42] Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-R-001, Prishtinë, 10 mars 2011;
- [43] Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-R-08, Prishtinë, 18 tetor 2012;
- [44] Studim, Grupi për Studime Politike dhe Juridike - GLPS, “ÇFARË ËSHTË MINIMUMI I NJË PLATFORME PËR DIALOGUN E FAZËS FINALE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBIË”, Prishtinë, nëntor - dhjetor 2018;
- [45] Shkelzen Gashi, *Historia e Kosovës në tekstet mësimore të Historisë në Kosovë, Shqipëri, Serbi, Mali të Zi dhe Maqedoni*, botoi Alder Habitus (Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë), Prishtinë, 2016;
- [46] Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/76, datë 21.11.2018;
- [47] Visar Morina, Fisnik Korenica and Dren Doli, “*The relationship between international law and national law in the case of Kosovo: A constitutional perspective*”, Oxford University Press and New York University School of Law, I•CON 9, 2011;
- [48] Милош Прица, МА Асистент Правног факултета, Универзитет у Нишу “ЗАКЉУЧАК УСТАВНОГ СУДА О ОДБАЦИВАЊУ ПРЕДЛОГА ЗА ОЦЕНУ УСТАВНОСТИ И ЗАКОНИТОСТИ ПАРАФИРАНОГ „ПРВОГ СПОРАЗУМА О ПРИНЦИПИМА КОЈИ РЕГУЛИШУ НОРМАЛИЗАЦИЈУ ОДНОСА“ ИЗМЕЂУ ВЛАДЕ РЕПУБЛИКЕ СРБИЈЕ” UDK: 342.565.2:340.142(497.11) Рад примљен: 14.4.2015. Рад прихваћен: 4.5.2015.

Stéphane Douailler, Paris\*

## VIOLENCES ET AMOURS POLITIQUES : LE DROIT AU SEIN DE LEUR DECHAINEMENT

### Abstrakt

Të menduarit mbi të drejtën përballë kaosit mund të kuptohet në dy mënyra. Sipas së parës, mund të përfytyrohet situata si një ballafaqim në të cilin nga fuqia e institucionit pritët, nga rendi dhe rregullimi që i vishet të drejtës që ajo të bëjë të mundur drejtpeshimin e fuqisë shkatërruese e cila diktohet brenda fenomeneve kaotike dhe në fund të triumfojë mbi to. Kësisoj ballafaqimi i kaosit me të drejtën e shtron atëherë skenën fillestare dhe themeluese e cila kërkon sundimin e ligjit. Në Raportete midis këtyre relateve i kemi zbrëthyer këtu në mbështetje të koncepteve të T. Hobbesit dhe J. Lockut, në njerën anë dhe atyre të Alexandre Kojève, në anën tjetër.

*Fjalët çelsës:* e drejta, kaosi, Hobbes, Locke, Kojève

Penser le droit face au chaos, semble pouvoir s'entendre de deux façons. On peut, selon la première, représenter la situation comme un face-à-face, dans lequel on attend de la puissance d'institution, d'ordre et de régulation qu'on prête au droit qu'elle vienne équilibrer la puissance destructrice qu'on décèle dans les phénomènes chaotiques et à la fin en triompher. Le face-à-face du chaos et du droit (re)pose alors la scène primitive et fondatrice qui appelle un règne du droit. L'idée du chaos sert à radicaliser l'apparence de ce qui est supposé se tenir en amont de l'état de droit. Elle fait écho à ceux des récits et des fables de l'état de nature qui accompagnent les pensées politiques du contrat social quand ils tendent à vider l'état antérieur à la société politique de toute capacité, ou presque, à s'organiser socialement, ainsi qu'à augmenter en proportion la fonction instituante attendue d'un pouvoir politique. Elle prend son sens de se situer par rapport à une sorte d'échelle du chaos qui place à deux pôles opposés l'état de nature décrit par Thomas Hobbes (1651) comme un espace d'affrontement aléatoire entre forces brutes et celui pensé par

---

\* Profesor i filozofisë në Univerzitetit Parisi 8. Autor i disa veprave të çmuara nga filozofia.

John Locke (1690) comme une première esquisse de relations sociales. Le marqueur que le chaos introduit à cet égard renvoie à un double repérage. Il se laisse comprendre comme la traduction d'un jugement sur l'état des choses. Jugement qui serait plus noir chez Thomas Hobbes que chez John Locke. Mais il exprime aussi une différence d'ambition du pouvoir politique. Thomas Hobbes confère à ce dernier plus de puissance que ne le fait John Locke. Et alors cette introduction du chaos dans la réflexion sur le droit et la politique rejoint assez facilement une tentation pour la philosophie. Elle conforte cette dernière, d'un côté, dans l'idée que ce sont ses jugements les plus noirs, ceux par lesquels elle revient aux conditions du chaos originel, qui lui font toucher le plus dur roc de la réalité. Elle appuie, d'un autre côté, le projet que celle-là se donne quand elle s'attribue la tâche d'abriter les chances du réel face au chaos dans le pouvoir que sa puissance de penser revendique d'exercer sur l'être. Et cette tentation pour la philosophie semble pouvoir être aussi une tentation pour le droit. Celle, d'un côté, de surmonter, par les voies dans lesquelles se surmonte le chaos et se réaffirme le droit, l'impureté historique et toujours menaçante des constructions juridiques. Celle, d'un autre côté, d'ouvrir au droit toute l'extension de phénomènes chaotiques innombrables pour y créer des phénomènes juridiques nouveaux. Et alors dans ces représentations diverses s'appliquant à penser un droit face au chaos c'est aussi bien une démesure logée au cœur du droit qui se laisse reconnaître. La vue effrayée qui discerne dans diverses configurations disparates le chaos lui-même vient soutenir des mouvements immanents au droit qui le poussent vers une plus grande puissance et vers une revendication de son règne que toutes sortes de philosophies peuvent assez aisément se laisser convaincre d'accompagner. Le regard par lequel le droit s'éprouve plonger dans un chaos le rejette vers la pensée de l'organisation nécessaire à la vie, l'arrime aux puissances de liaison qui soutiennent le vivant, l'incite à orienter le champ entier de la vie dans les voies d'une soumission au juridique. Répondant à la disparité des phénomènes par des figures de liaison du chaos le droit s'empporte dans une inflation juridique de liens. Par ce mouvement, la démesure du chaos demeure, passe et se transforme dans une démesure du juridique. Aussi maintenir le droit dans des tâches de mesures semble-t-il requérir quelque autre pensée de la relation du droit aux phénomènes chaotiques, ainsi sans doute qu'une autre représentation du chaotique en eux.

Souhaiter un règne du droit a pour limite l'idée même de règne. Car dans le jeu convenu qui revendique d'opposer un règne du droit aux règnes de la force, c'est le règne, et avec le règne la force, qu'on voit

l'emporter. C'est pourquoi, préservant dans le contexte de la deuxième guerre mondiale un effort de pensée face au déchaînement de violences et de mythes qui s'abattit alors sur l'Europe, Alexandre Kojève ne se tourna pas vers des forces de liaison du droit. Elles s'étaient, en réalité, entièrement effondrées. Les rationalités efficaces, les récits historiques utiles, les éthiques convaincues et responsables que les contributions de la philosophie du droit élaborent à l'usage des règnes juridiques, s'avéraient, à ce moment extrême, sans impact sur les destructions opérées par la création d'un ordre nouveau œuvrant à la fondation d'un troisième empire à l'intérieur de l'histoire du monde. Le rassemblement du vivant, dans lequel la relation juridique entre en consonance avec des dispositifs sensibles, se révélait dans la France de la collaboration au milieu de laquelle Alexandre Kojève engageait sa réflexion, entièrement disqualifié par les amours affichées par un vieux maréchal pour la terre, le travail, la famille. Aussi est-ce en réalité à l'opposé d'actes de liaison, que ceux-là ambitionnent de mesurer le chaos, la vie ordinaire ou un passage de l'un à l'autre, qu'Alexandre Kojève entreprit d'identifier – dans une condition au moins minimale – l'impératif pour un droit de se différencier du simple jeu des forces en interaction. Il se mit en quête d'un support pour une relation au monde capable de se déprendre de la saturation catastrophique qu'en effectuaient à ce moment les phénomènes chaotiques de pouvoir. Il entreprit de chercher une position d'écart soustraite aux calculs, aux compromis, aux mêlées de pouvoirs en lutte, et se tourna vers l'état de non liaison avec ce qui l'entoure que l'*autorité* inscrit dans son phénomène (Kojève 1942). À première vue, le phénomène général de l'autorité paraît lui-même assez impuissant face aux multiples forces qui s'emploient à lier le monde selon leurs déterminations. L'autorité agit de l'extérieur, dans une temporalité propre, depuis une autre source, avec des règles distinctes. Elle semble manquer d'appuis dans la situation pour être réellement efficace. Elle se tient aux bords de la belle âme, de l'utopie, du fantasme, de l'arbitraire. Toute conjuration des forces à son endroit paraît en mesure de la réduire à une condition évanescence. Il suffit, semble-t-il, que les forces qui l'entourent s'abstiennent de la reconnaître pour qu'elle ne puisse agir. Prenant néanmoins le contrepied de cette apparence fragile devant les dénis de reconnaissance qu'on peut prêter à cet égard au déchaînement chaotique des phénomènes de pouvoir, Alexandre Kojève ébauche un programme philosophique d'analyses multiples qui se fait fort de ressaisir l'autorité et la soustraction aux champs de forces qu'elle opère comme un fait de culture, menant vers l'identification de pas moins de 64 types d'autorités sans compter les variantes (Kojève 1942 : 90), ainsi que vers



la conception d'un opérateur obéissant aux quatre causes d'Aristote (Kojève 1942 : 129). Il en ressort que ce n'est que contrainte par un certain état des forces que l'autorité peut se trouver réduite à une condition minimale. En elle-même, impulsant la quadruple causalité aristotélicienne, elle est en puissance de configurer un monde. Aussi un état du monde, et jusqu'à celui qu'Alexandre Kojève avait sous les yeux, peut-il en réalité s'appréhender sous l'effet de deux puissances d'égale extension : comme monde configuré par un champ des forces et comme monde configuré par un opérateur qui s'en soustrait. Cette double configuration semble pouvoir s'énoncer dans les termes suivants. Du monde comme champ des forces on dira : (1) Il est un monde composé de parties. Il ne cesse de composer les puissants et les dominés, les riches et les pauvres, les citoyens et les exclus, les hommes et les femmes... ; (2) Il est un monde présent. Il identifie l'être à son présent et à l'équilibre des forces qu'il est au moment où il est ; (3) Il est un monde d'interactions. Il est le monde qui résulte des actions les unes sur les autres, et selon les relations qui les unissent, des parties qui le composent ; (4) Il est un monde continu. Il dispose le *continuum* au sein duquel les parties interagissent comme forces et saturent le monde de leurs relations présentes. Du monde ouvert par l'existence d'un opérateur se soustrayant au champ des forces on dira au contraire : (1) Il est un monde possédant une instance d'impartialité qui refuse de céder à la division en parties, ainsi que le soutient imperturbablement la justice ; (2) Il est un monde contenant une temporalité excédentaire qui refuse de céder à la pression du présent, ainsi que la met en œuvre l'invention politique ; (3) Il est un monde déterminable par une causalité propre qui refuse de céder au champ d'interactivité des parties, ainsi que le présuppose universellement le recommencement de séquences inédites ; (4) Il est un monde faisant accueil à un élément émancipé qui refuse le jeu défini entre les parties ainsi que le pose indéfectiblement l'expérience de la liberté. Face au monde chaotique de 1942, Alexandre Kojève cherchait ainsi à faire retour par le biais de l'autorité vers les puissances d'être impartial (espace du droit), de ne pas dépendre du présent (espace de la politique), de se tenir à l'origine d'un nouveau (espace de la création), de faire place à un sujet émancipé (espace de la liberté). Et, dans le contexte où il élaborait cette réflexion, Kojève invita aussi bien à reconnaître ces puissances dans des figures, à les saisir par une réminiscence historique. Accompagnant l'histoire de l'Europe et du monde, ces figures auraient été celles du *juge* (impartial), du *chef* (emportant hors du présent), du *père* (géniteur d'un autre), du *maître* (affirmant sa liberté).

## LA CRÉATION DU VIDE

De nombreuses indications signaleraient cependant que ces figures retrouvées par Alexandre Kojève au sein du phénomène général de l'autorité risquent de ne plus produire pour nous que certains effets limités. Entre les statures acheminées par l'histoire du *juge*, du *chef*, du *père*, du *maître*, et les espaces dans lesquels nous estimons devoir penser le droit, la politique, la création, la liberté, bien d'autres instances se sont rendues visibles. Plutôt que des figures développées dans le temps ou même recrées par intermittences, ce sont sans doute des supports de manifestations discontinues qu'il convient de concevoir. Et c'est bien dans cette direction qu'Alexandre Kojève proposait lui-même d'orienter l'approfondissement philosophique. Vers une détermination métaphysique et ontologique totale de l'opérateur de non liaison. Prolongeant l'essai sur *La notion de l'autorité*, une *Esquisse d'une phénoménologie du droit* (Kojève 1943) se lance sur le plan du droit dans ce travail en entreprenant de dégager la forme de toute relation juridique et de la saisir depuis son aptitude à provoquer l'intervention d'un tiers impartial, désintéressé, ainsi que – comme un approfondissement de la réflexion l'établit – quelconque. L'un des effets visibles de la reprise de l'analyse est d'effacer tout reste de transcendance qui aurait pu demeurer attaché à des figures comme celles de *juge*, de *chef*, de *père*, de *maître*. Qui aurait pu continuer à en faire des avatars ou des substituts de figures divines. Alexandre Kojève (1943 : 42) suspend la situation susceptible de donner lieu à une relation juridique à l'état de non liaison créé par « l'acte anthropogène primordial. » Le droit, pour Kojève, trouve son fondement au sein de « l'acte dans et par lequel un animal *Homo sapiens* se crée en tant qu'être humain tel nécessairement que (cet acte) le rend apte à entrer en interaction avec un autre être humain créé de la même manière de façon à provoquer (la situation juridique) de l'intervention d'un troisième être semblable (impartial, désintéressé, quelconque) » (*ibid.*) Au milieu des forces chaotiques qui se déchirent le monde, ultimement au milieu du chaos de la tempête élémentaire, Alexandre Kojève s'engage dans une reprise systématique du droit qui le ressaisit depuis la nature d'un acte, depuis la distinction par laquelle cet acte en tant qu'acte humain se sépare de tout autre processus, depuis la différence qui identifie cet acte en tant qu'acte juridique parmi les autres actes humains, depuis l'histoire totale que cet acte s'avère accomplir au sein de l'histoire anthropogène, depuis le système achevé du droit que la possibilité de cet acte laisse entrevoir. Cet acte est celui de la manifestation de l'humain comme « vide créé

dans le monde naturel par le désir anthropogène » (Kojève 1943 : 238.) Alexandre Kojève reprend, au milieu des phénomènes chaotiques qui l'entourent, le principe supérieur qui avait impressionné quelques années auparavant les auditeurs de son cours d'introduction à la *Phénoménologie de l'esprit* de Hegel (Kojève 1933-1939.) L'humain est un « quelque chose où la nature n'existe pas. » Il est « la présence d'une absence, de l'absence en lui de la nature en général, de l'animal [...] qu'il serait s'il ne s'était pas constitué en être humain. » Il est le désir et la réalisation de soi-même comme ce vide qu'il désire et réalise en « remplissant un vide par un autre vide, une absence par une autre absence » (Kojève 1943 : 238.) Face au chaos, à ses déchaînements colorés et sombres, le droit enchaînerait des pages blanches. Non pas mesure ni liaison du chaos, il mesurerait avec application des plages vides que l'humain réussirait à dessiner en lui.

## LA PROMOTION ANTROPOMORPHE

Aussi est-ce à partir de la considération de créateurs de vide qu'il paraît possible de définir des supports à l'action de ne pas se lier avec le jeu des forces. Le trait qui semble les distinguer particulièrement des figures remémorées du *juge*, du *chef*, du *père*, du *maître*, est que ces créateurs de vide sont dits pouvoir être, sous certaines conditions de réalité, n'importe qui. Des individus « quelconques » ou « censés pouvoir être quelconques » au sein d'une situation donnée (Kojève 1943 : 79-94.) Alexandre Kojève ouvre très largement ce champ du quelconque. Celui-là ne paraît pas d'une extension moindre que celle des phénomènes chaotiques. Il examine, du point de vue de leur puissance de création du vide et de leur aptitude à engendrer une situation juridique, les animaux, les femmes, les fous, les choses, les enfants, les esclaves, les groupes sociaux exclus à un titre ou à un autre. Il examine de même les dieux, les personnes morales, les groupes, les collectifs, les institutions. Avec le quelconque, ce sont en quelque sorte toutes les revendications de justice, celles des incapables comme celles des fictions, qui requièrent d'ouvrir et d'édifier le champ du droit. Alexandre Kojève soumet alors ce quelconque, virtuellement chaotique, à trois déterminations : (1) Il n'existe de relation juridique qu'entre des supports de désirs anthropogènes. Cette détermination exclut choses, animaux, dieux, etc. en tant que tels, c'est-à-dire en tant qu'ils ne sont pas porteurs, sous quelque aspect, d'un désir humain susceptible d'entrer en relation avec un autre désir humain ; (2) La possibilité pour une entité incapable ou

fictive quelconque de se revendiquer support d'un désir anthropogène introduit dans le droit des « phénomènes juridiques littéraires » (Kojève 1943 : 29.) Ces phénomènes recouvrent des « erreurs terminologiques » qui consistent à se tromper sur la nature de l'entité, et des « erreurs anthropomorphiques » qui consistent à se tromper sur la nature du désir anthropogène. Ces dernières concernent bien pour leur part des relations juridiques. C'est seulement l'anthropo-morphisme qu'elles mettent en œuvre qui conduit à comprendre « inadéquatement » le désir anthropogène dont l'entité est porteuse. Les incapables et les fictions supports de projections anthropomorphes se laissent rattacher aux supports de relations juridiques par le lien qui rattache l'humanité au temps. C'est parce que les enfants en bas âge deviendront hommes, c'est parce que les femmes sont nées d'hommes et donneront vie à des hommes, c'est parce que l'esclavage peut être aboli, c'est parce que les fous peuvent guérir, c'est parce qu'une personne morale peut agir à la façon d'un humain et ainsi de suite, que, pour Alexandre Kojève, des sujets juridiques « littéraires » peuvent être admis à ouvrir et à édifier un champ du droit ; (3) De tels phénomènes juridiques « inadéquats », qui se présentent en nombre avec l'admission du quelconque, et que leur appartenance au tout temporel de l'humanité valide au regard de la relation juridique, doivent pouvoir faire l'objet d'une récapitulation compréhensive au sein de la conscience juridique historique telle que la philosophie en déploie le mouvement total jusqu'à un système achevé du droit. Leur succession est requise de dérouler, d'étape en étape, un « anthropomorphisme » qui aboutit à l'essence vraie de l'humain. Ainsi Alexandre Kojève préserve-t-il un ordre, une rationalité, une logique, donc tout le contraire d'un chaos, dans la promotion anthropomorphe par laquelle des créateurs de *vide* se présentent au départ des relations juridiques. Mais il semble alors que se recrée l'écart qui avait empêché de reprendre sans relance les figures remémorées du *juge*, du *chef*, du *père*, du *maître*. Pas plus que les pratiques que le droit, la politique, la création ou la liberté mettent en ce moment sous nos yeux ne s'avéraient pouvoir se soutenir de ces figures, pas plus elles ne se laissent reprendre et comprendre dans les visibilitées auxquelles semble pouvoir parvenir le travail de récapitulation d'une conscience fondatrice.

## LES AVENTURES DE L'ÊTRE À L'ÉCART

Car il faut sans doute réfléchir hors des formes anthropomorphes. L'une de leurs contestations se manifeste par exemple aujourd'hui dans

nos villes dans une figure renouvelée du misanthrope. Deux psychopathologues, Antony N. Clark et Ganesh D. Mankikar, l'ont réorganisé en 1975 sous les espèces d'un cas clinique auquel ils ont proposé de réserver l'appellation de *syndrome de Diogène* (Clark et Mankikar 1975, cité par Goureau 2007). Le cas concerne la conduite présentée par certains sujets âgés, habitants des villes, qui, se montrant indifférents à la honte, choisissent de négliger l'hygiène et de vivre isolés et agressifs dans un dénuement matériel au milieu d'objets de rebut qu'ils accumulent. Ces sujets dressent au cœur de notre monde divers spectacles du chaos. En même temps, refusant toute aide, se montrant hostiles à tout secours social et médical, ils semblent soulever des problèmes juridiques spécifiques et contemporains. Est-on autorisé à les soigner alors qu'ils refusent de se reconnaître malades ? Peut-on définir à leur intention un droit d'ingérence humanitaire ? S'attachant aux choses que les hommes ont rejetées plutôt qu'aux hommes, s'efforçant de vivre comme une chose parmi les choses plutôt que de conserver quoi que ce soit d'humain, ces sujets manifestent exactement le contraire de l'appartenance à l'humanité, qui, dans la construction kojévienne, préparait leur intégration ordonnée parmi les créateurs de vide générateurs de relations juridiques. Ce qu'ils manifestent à cet égard est plutôt une grève qu'ils font de l'humanité, et une mesure plus effectivement prise d'un chaos qui se serait substitué à l'humanité. Aussi est-il en réalité rien moins que certain que la prise en compte du phénomène chaotique qu'ils représentent à l'instar de nombreux autres phénomènes du présent ait à orienter aujourd'hui le champ du droit vers l'intervention d'urgence, le secours humanitaire et la responsabilité de protéger, comme semblerait y inciter le contexte général. Au cours de sa longue histoire littéraire, la figure du misanthrope a, en effet, généralement tenu deux orientations. Elle produit l'effondrement catastrophique des semblants par lesquels le monde tient à lui-même. Elle tient le compte de la série des points effondrés qu'une opération de reconstruction aura à reprendre. Il convient probablement de tenir les deux. Dans l'analyse à laquelle son livre d'entretien avec Dominique-Antoine Grisoni publié sous le titre *La peau des mots* (Desanti 2004) soumet la question des droits de l'homme, Jean-Toussaint Desanti se tourne, afin de proposer une image, vers les statues de Giacometti. La forme humaine que celles-là continuent de manifester – rappelle-t-il – ne cesse de s'évider. C'est ainsi en elles-mêmes qu'elles créent l'homme comme vide. Elles laissent tomber hors de sa maigre silhouette le semblant d'assise par lequel les humains affectent de se tenir dans le monde. Elles réduisent jusqu'à l'évanescence les appuis qui les

rattacheraient encore à ce qui les entoure. Les statues de Giacometti ne sont plus qu'en marche. Mobiles et furtives, elles avancent depuis un point d'extrême fragilité. Mais c'est alors précisément en ce point qu'elles se tiennent. Qu'elles font face au chaos. Qu'elles dessinent le vide dans lequel se maintient un espace apte à souder par un geste ou un signe des corps vivants en écart. Le chaos qui environne ne contraint en réalité à aucune des deux tentations qui se présentent à ses côtés : celle de faire grossir à sa mesure les institutions, les sujets, les philosophies ; celle de figer à son encontre le roc d'un refus. Il laisse aussi bien s'ouvrir une ligne d'écarts sans cesse susceptible d'être reprise et autrement cartographiée.

Stéphane Douailler

## VIOLENCES ET AMOURS POLITIQUES : LE DROIT AU SEIN DE LEUR DECHAINEMENT

### Résumé

Penser le droit face au chaos, semble pouvoir s'entendre de deux façons. On peut, selon la première, représenter la situation comme un face-à-face, dans lequel on attend de la puissance d'institution, d'ordre et de régulation qu'on prête au droit qu'elle vienne équilibrer la puissance destructrice qu'on décèle dans les phénomènes chaotiques et à la fin en triompher. Le face-à-face du chaos et du droit (re)pose alors la scène primitive et fondatrice qui appelle un règne du droit. Nous avons examiné les rapports entre violences et droit à l'appui, d'une part, des concepts de Hobbes et de Locke, et d'autre part de celles de A. Kojève.

*Mots clés:* le droit, le chaos, Hobbes, Locke, Kojève



Frashër Demaj, Prishtinë

## BURIME BRITANIKE PËR ARRESTIMIN DHE INTERNIMIN E GRAVE DHE FAMILJEVE SHQIPTARE QË NGRITËN KRYE KUNDËR PUSHTETIT OSMAN 1910-1912

### Abstrakt

Shumica prej krerëve të Lëvizjes Kombëtare, krahas kontakteve dhe aktiviteteve diplomatike e shihnin rezistencën e armatosur antiosmane si mundësi reale për t'i realizuar pretendimet për liri e shtet kombëtar. Për këtë qëllim krerët e Lëvizjes Kombëtare intensifikuan aktivitetet organizative në të gjitha vilajetet shqiptare ku u mbajtën tubime të vogla dhe takime me tribunë popullore dhe udhëheqës lokal. Vendimi për të filluar aktivitetet kryengritëse u mor në dhjetor të vitit 1909 në një mbledhje e cila u mbajt në rrethinat e Shkupit. Aty morën pjesë udhëheqësit më të shquar të Lëvizjes Kombëtare nga Vilajeti i Kosovës si: Isa Boletini, Idriz Seferi, Sylejman Batusha, Shaban Kopriva, Hasan Ferri, Hasan Hysen Budakova, Ramadan Zaskoci dhe shumë të tjerë.

Në shenjë kundërvënje, Qeveria Osmane urdhëronte ndëshkimin e shqiptarëve kryengritës të cilët i quante “rebelë” dhe “tradhtarë” të Perandorisë si dhe marrjen e masave të ashpra ndaj tyre dhe familjeve të tyre. Arrestimi, burgosja dhe internimi i familjeve të kryengritësve, ish-oficerëve shqiptarë të ushtrisë osmane, që kishin kaluar në anën e kryengritjes dhe të personaliteteve të tjera shqiptare të kohës ishte bërë temë e përditshme e raporteve konsullore të të gjitha përfaqësive diplomatike. Në vëzhgimin e kësaj situatë ndër më aktivët ishin britanikët. Kështu, në disa nga raportet e konsullit të përgjithshëm në Selanik Harry Llamb njoftohet për marrjen peng dhe deportimin e familjeve të kryengritësve dhe personaliteteve të njohura shqiptare.

Zëvendëskonsulli Peckham nga Shkupi njoftonte lidhur me pengmarrjen, arrestimin dhe dëbimin e grave dhe familjeve shqiptare. Asnjë popull në botë nuk është më i ndjeshëm kur preket nderi dhe dinjiteti i grave dhe familjet e tyre se sa shqiptarët e veriut, qofshin mysliman a të krishterë, deklaronte Peckham.

Sipas burimeve britanike në një nga raportet e datës 7 korrik 1912, nga Prizreni, Gjakova dhe Peja njoftohet se janë marrë gratë dhe familjet e atyre shqiptarëve që janë bashkuar me kryengritësit. Këto familje janë transportuar në Shkup. Nuk dihet statusi i tyre nëse janë të arrestuar, të marrë peng apo të burgosur. Në një raport tjetër të konsullit Harry Llamb thuhej se: “Dëbimi i familjeve të kryengritësve në Shkup e ka rënduar edhe më shumë këtë krizë dhe ka qenë shkaku i acarimit të madh të popullsisë me organet e administratës osmane”. Qeveria osmane, sipas burimeve britanike, kishte hartuar një listë me emrat e kryengritësve dhe personaliteteve kryesore shqiptare për të cilat kishte lëshuar fletarrestime.

*Fjalë çelës:* Perandoria Osmane, kryengritësit, gratë dhe familjet shqiptare, arrestimi, deportimi, konsullatat britanike, krerët shqiptarë.



Pas vendimeve të Kongresit të Manastirit 1908 dhe Kongresit të Elbasanit 1909, në vilajetet shqiptare u krijuan kushte dhe rrethana më të favorshme për të ngritur nivelin e aktiviteteve në përpjekjet për çlirim dhe krijimin e shtetit kombëtar. Vendimi për alfabetin e përbashkët dhe hapja e Normales së Elbasanit ishin vendime sa të rëndësishme, aq edhe përcaktuese për fatin e popullit shqiptar. Shumica prej krerëve të Lëvizjes Kombëtare, krahas kontakteve dhe aktiviteteve diplomatike e shihnin rezistencën e armatosur antiosmane si mundësi reale për t'i realizuar këto aspirata. Për këtë qëllim krerët e Lëvizjes Kombëtare intensifikuan aktivitetet organizative në të gjitha vilajetet shqiptare, ku u mbajtën tubime të vogla dhe takime me tribunë popullorë dhe udhëheqës lokal e me autoritet. Vendimi për të filluar aktivitetet kryengritëse u mor në dhjetor të vitit 1909 në një mbledhje e cila u mbajt në rrethinat e Shkupit. Aty morën pjesë udhëheqësit më të shquar të Lëvizjes Kombëtare nga Vilajeti i Kosovës si: Isa Boletini, Idriz Seferi, Sylejman Batusha, Shaban Kopriva, Hasan Ferri, Hasan Hysen Budakova, Ramadan Zaskoci etj.<sup>1</sup>

Veprimet e para kryengritëse kundër osmanëve nisën në mars në rajonin e Gjakovës, duke përfshirë edhe Junikun, që u bë çerdhe e rëndësishme e nismave kryengritëse.

Në ndërkohë kryengritja përfshiu gjithë Rrafshin e Dukagjinit. Situata u acarua pas atentatit ndaj Mytesarifit të Pejës më 31 mars 1910. Atentati ndaj tij u bë në çastin kur ai i shoqëruar nga majori Rushit Beu, komandant i regjimentit të ushtrisë osmane, doli nga shtëpia e Asllan bej Begollit. Mytesarifi u plagos në këmbë, kurse komandanti vdiq në vend<sup>2</sup>. Në të njëjtën kohë kryengritësit e rrethinave të Prizrenit i detyruan repartet ushtarake osmane të mbylleshin në qytet, ndërsa pjesën tjetër të tërhiqej në drejtim të Fushë-Kosovës. Më 5 prill 1910 repartet e Garnizonit të Prishtinës u ndeshën me kryengritësit në Babin Most. Kryengritësit i detyruan forcat osmane të tërhiqeshin në Prishtinë, madje ata zunë rob edhe disa oficerë të ushtrisë osmane.<sup>3</sup> Më 8 prill 1910 sulltan Mehmet Reshati V me dekret e shpalli gjendjen e jashtëzakonshme me

<sup>1</sup> Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, më tej (AIHT), Vj. 20-19-1100, raporti i konsullit austro-hungarez nga Selaniku, nr. 121 dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

<sup>2</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë, më tej AQSH i RSH, f. 65, D.121, f. 3. Letër e Lazër Mjedës nga Prizreni drejtuar një miku të tij më 3 prill 1910.

<sup>3</sup> Arkivi i Kosovës, më tej AK, Fondi DASSIP, K,12, telegram srpskog kraljevskog konzula iz Prištine, 21 (25) 03 (1910), MID Beograd.

arsyetimin se duhej kthyer rendin dhe qetësinë publike.<sup>4</sup> Sipas dekretit Qeveria Osmane urdhëronte ndëshkimin e shqiptarëve kryengritës të cilët i quante “rebelë” dhe “tradhtarë” të Perandorisë si dhe marrjen e masave të ashpra ndaj tyre dhe familjeve të atyre që guxojnë të ngrenë krye kundër autoriteteve të Perandorisë.<sup>5</sup> Brenda masave qeveritare parashihej shpërndarja sa më shpejt e forcave kryengritëse, çarmatosja e tyre, arrestimi dhe nxjerrja para gjykatave ushtarake, zbatimi i shërbimit të detyrueshëm ushtarak, mbledhja me forcë e taksave dhe veprime tjera ndëshkuese. Qeveria Osmane urdhëroi Ministrinë e Luftës që të përgatiste sa më shpejt ekspeditën ushtarake për të zbarkuar në zonat e kryengritjes. Në krye të forcave osmane do të vihej gjenerali Shefqet Turgut Pasha, njeriu që konsiderohej ndër më të zotët në ushtrinë osmane.<sup>6</sup> Veprimet e bazuara në masat qeveritare nxitën edhe reagimin e diplomacisë së Fuqive të Mëdha, të cilat informoheshin përmes përfaqësive të veta konsullore dhe diplomatike. Shumica prej tyre, përfshirë diplomacinë britanike, ishin kundër masave të tepruara qeveritare osmane, sepse, sipas tyre, në vend të vendosjes së kontrollit qeveritar osman do të nxiteshin reagime të pakontrolluara të popullsisë shqiptare kundër regjimit osman.<sup>7</sup>

Reagime të ashpra kundër ndërhyrjes dhe ndëshkimeve të qeverisë osmane pati edhe nga grupi i deputetëve shqiptarë në parlamentin osman në mbledhjen që iu kushtua kryengritjes shqiptare në gjysmën e prillit 1910. Ata e kundërshtuan me forcë dërgimin e ekspeditës ndëshkuese ushtarake në Vilajetin e Kosovës dhe kërkuan që këto vendime të revidoheshin menjëherë, sepse çdo vonesë do të sillte për pasojë daljen e situatës nga kontrolli dhe masivizimin e kryengritjes së armatosur. Për këtë çështje pati një kundërreagim të menjëhershëm nga disa deputetë xhonturq,<sup>8</sup> të cilët donin ta izolonin kryengritjen dhe të mos lejonin që të sensibilizohej opinioni politik e diplomatik në Evropë lidhur me kërkesat politike të shqiptarëve. Qarqe politike konservatore brenda Parlamentit Osman refuzonin çdo kërkesë politike, sociale, ekonomike dhe reformatore që vinte nga shqiptarët, sepse vilajetet shqiptare dhe disa toka tjera të pushtuara i

<sup>4</sup> AK, Fondi DASSIP, K,12, Fasiklla II, F.IV-82, telegram srpskog kraljevskog konzula iz Skoplja, br. 818, 9 (22) 04 1910, MID Beograd.

<sup>5</sup> Më gjerësisht: Frashër Demaj, *Shqiptarët në dokumentet diplomatike të Britanisë së Madhe*, Prishtinë 2019.

<sup>6</sup> *Historia e popullit shqiptar II, Rilindja Kombëtare në vitet 30 të shek. XIX-1912*, Tiranë 2002, f. 427.

<sup>7</sup> The National Archive (më tej THNA), FO 195, 144-2407, Albania 3251-5510.

<sup>8</sup> Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, I, Prishtinë 2004, f. 328.

shihnin si mundësi të mëtejshme për shtrirjen dhe qëndrimin e Perandorisë në Gadishullin Ballkanik e me këtë rast edhe në kontinentin evropian. Disa deputetë shqiptarë si: Hasan Prishtina, deputet i Prishtinës; Saidi, deputet i Shkupit; Hysen Fuadi dhe Shabani, deputetë të Prishtinës; Nexhip Draga, deputet i Shkupit; Hasan Muhidini, deputet i Sjenicës; Shahin Tekiu, deputet i Korçës; Myfidi, deputet i Gjirokastrës; Hamdiu, deputet i Prevezës; Ismail Qemali e Azizi, deputetë të Beratit dhe Ahmed Hamdiu, deputet i Pejës,<sup>9</sup> kërkuan nga qeveria që me urgjencë të ndërpriste ndërmarrjen e masave ndëshkuese dhe të tregojë më konstruktive lidhur me kërkesat e shqiptarëve.

Deputetët bënë edhe një deklaratë të firmosur prej tyre në të cilën shpreheshin kundër masave të jashtëzakonshme. Këtë deklaratë e bëri publike Nexhip Draga më 10 prill 1910. Për të fuqizuar argumentet në favor të shqiptarëve Ismail Qemali, Myfit Libohova dhe deputetë të tjerë shqiptarë sollën prova që dëshmonin për administrimin e keq të vendit nga qeveritarët dhe administrata e korruptuar e shtetit osman<sup>10</sup>. Përpjekjet e deputetëve shqiptarë për të penguar dërgimin e ekspeditës ushtarake në Kosovë nuk dhanë rezultat. Edhe propozimet e tyre për të dërguar në Shqipëri një komision parlamentar për hetimin e gjendjes në terren dhe në mënyrë të veçantë të shkaqeve të kryengritjes u hodhën poshtë.<sup>11</sup>

Në situatën e krijuar deputetët shqiptarë e konsideronin se duhet vënë kontaktet me përfaqësuesit diplomatikë dhe t'i njoftonin ata drejtpërdrejt për gjendjen në teren dhe për pasojat e ushtrimit të presionit dhe dhunës ndaj atyre shqiptarëve që kërkonin reforma, liri, autonomi dhe pavarësi nga Perandoria Osmane. Për këtë qëllim Ismail Qemali i shtroi ambasadorit austro-hungarez, Pallaviçinit, kërkesën që deputetët shqiptarë parashtruan në parlamentin osman, ku përveç ndërprerjes së ndjekjes së shqiptarëve të revoltuar kërkohet me urgjencë zbatimi i reformave të premtuara nga ana e qeverisë. Ismail Qemali vuri kontakte edhe me ambasadën britanike në Stamboll dhe me përfaqësitë franceze, gjermane dhe italiane të cilët donte t'i

<sup>9</sup> AIHT, A-IV-34, Dosja pn me titull "Kronika e ndodhive në Shqipëri 1908-1912 sipas procesverbaleve të Parlamentit Otoman, botuar në fletoren zyrtare "Takvim Vakaji".

<sup>10</sup> AIHT, A-IV-34, Dosja pn me titull "Kronika e ndodhive në Shqipëri 1908-1912 sipas procesverbaleve të Parlamentit Otoman, botuar në fletoren zyrtare "Takvim Vakaji".

<sup>11</sup> *Historia e popullit shqiptar ...II*, f. 429.

njoftonte me informacione të sakta që i kishte marrë nga informatorët e tij në terren. Ai u bënte të ditur përfaqësuesve diplomatikë në Stamboll, se kërkesat e shqiptarëve nuk kishin vetëm karakter ekonomik e social, por me këto kërkesa shqiptarët gradualisht synonin autonominë e Shqipërisë dhe kërkonte përkrahjen e tyre.<sup>12</sup>

Përkundër tensionimit të skajshëm të marrëdhënieve të qeverisë osmane me shqiptarët dhe represionit që ushtronte administrata e Stambollit ndaj kryengritësve dhe familjeve të tyre, këta të fundit nuk u ndalën, por u rigrupuan dhe u riorganizuan në një nivel më të lartë duke hartuar plane konkrete për shtrirjen e kryengritjes.

Drejtimesit e kryengritjes hartuan një strategji të veprimit sipas së cilës lëvizjet kryengritëse do të zhvilloheshin në tri drejtime. Luftëtarët e Shalës, të Llapit e të Drenicës, nën komandën e Isa Boletinit, u përqendruan në Grykën e Carralevës dhe vunë nën kontroll vijën Ferizaj-Shtime-Prizren. Hasan Hysen Budakova me forcat e tij u përqendrua në rajonin malor në perëndim të Ferizajt deri në anën jugore të Carralevës. Grupimi i tretë i kryengritësve, nën komandën e Idriz Seferit, mori përsipër të mbronte Grykën e Kaçanikut dhe rrugën Tetovë-Shkup për të mos lejuar depërtimin e ushtrisë osmane, e cila vinte nga qendra e vilajetit në drejtim të pjesës së brendshme të Kosovës.<sup>13</sup>

Edhe forcat osmane ishin të vendosura që të godisnin me forcën e armëve kryengritësit shqiptarë, prandaj mobilizuan reparte të shumta ushtarake që do t'i sillnin nga anë të ndryshme të Perandorisë Osmane. Forcat osmane më 21 prill, pas luftimeve të rrepta, arritën t'i afroheshin Shtimes e cila ishte në duar të kryengritësve. Luftimet në Shtime ndikuan në intensifikimin e veprimeve të kryengritësve të kazasë së Gjilanit, të Preshevës, të Kumanovës, të Shkupit dhe të Kaçanikut.<sup>14</sup> Më 24 prill 1910 rreth 3.000 kryengritës, nën udhëheqjen e Idriz Seferit, shtinë në dorë Grykën e Kaçanikut dhe i dolën prapa shpine ushtrisë osmane, duke e vënë atë në një pozitë të pafavorshme.<sup>15</sup>

Më 30 prill ushtria osmane, e komanduar nga Shefqet Turgut Pasha dhe e përbërë në fillim nga rreth 10.000 veta, filloi sulmin kundër kryengritësve shqiptarë në Shkallën e Kaçanikut. Para sulmit

<sup>12</sup> Po aty.

<sup>13</sup> *Historia e popullit shqiptar ...II*, f. 430.

<sup>14</sup> Sadulla Brestovci, *Idriz Seferi, kreshniku i Karadakut*, "Rilindja", Prishtinë, 21.1.1970, f. 13.

<sup>15</sup> Po aty.

të përgjithshëm ushtria osmane goditi me artileri fshatrat përreth për t'u futur pastaj me këmbësori. Forcat osmane ishin të bindura që sulmi ndaj fshatrave shqiptare, familjeve të kryengritësve dhe djegia e shkatërrimi i pronave të tyre do t'i detyronin forcat kryengritëse që të hiqnin dorë nga kryengritja dhe t'u dorëzoheshin autoriteteve shtetërore osmane. Pas dy ditë luftimesh forcat osmane arritën t'i detyronin të shpërndareshin forcat e organizuara të kryengritësve shqiptarë.

Në këto luftime mbetën të vrarë e të plagosur rreth 500 luftëtarë shqiptarë,<sup>16</sup> por edhe forcat osmane patën humbje në njerëz dhe në teknikë luftarake. Shefqet Turgut Pasha në shenj hakmarrjeje urdhëroi ushtrinë të ushtronte dhunë mbi popullsinë e pambrojtur civile nëpër fshatra, duke plaçkitur, djegur shtëpitë, duke arrestuar njerëz dhe duke shkretuar fshatra të tëra.

Këto veprime çnjerëzore të kualifikuara si masa ndëshkuese ndaj popullsisë shqiptare nxitën reagimin e diplomatëve të huaj, të cilët i rekomanduan qeverisë në Stamboll që ta shkarkonte nga posti valiun e Kosovës Mas'har beun, të cilin e konsideronin përgjegjës për situatën e krijuar. Ata e akuzonin valiun se kishte kaluar çdo masë normale të ndëshkimit dhe kishte ushtruar dhunë ndaj popullsisë civile në shenjë hakmarrjeje dhe në pamundësi që të arrestonte kryengritësit që i quante “rebelë” dhe “tradhtarë” të Perandorisë.<sup>17</sup> Qeveria osmane gjithashtu mbylli të gjitha shkollat shqipe, ndoqi mësuesit dhe intelektualët, ndaloi gazetat dhe botimin e librave në gjuhën shqipe dhe i akuzoi deputetët shqiptarë si përkrahës të rebelimit e të kryengritjes dhe për lidhje sekrete me kryengritësit.<sup>18</sup>

Me gjithë reagimet e diplomatëve perëndimorë, ushtria osmane nuk ndaloi së vepruari në ndërmarrjen e masave ndëshkuese ndaj shqiptarëve. Gjatë muajve qershor-korrik 1910 vazhduan operacionet edhe në zona të tjera, në përfundim të Rrafshit të Dukagjinit për t'u hedhur më pas në Shkodër dhe drejt Lumës e Dibrës. Ndër më të zëshmit që shfaqti indinjatën e tij në Parlamentin Osman ishte Hasan Prishtina i cili kërkoi nga qeveria e Stambollit të ndaloheshin këto veprime çnjerëzore ndaj popullsisë shqiptare e cila ishte krejtësisht e pafajshme<sup>19</sup>.

<sup>16</sup> AIHT, Vj. 20-1-1-78 raporti i konsullit austro-hungarez nga Selaniku, nr. 93, 2 maj 1910 dërguar ambasadorit të mbretërisë dualiste në Stamboll.

<sup>17</sup> Frasher Demaj, Shqiptarët në dokumentet...vep e cit, f.131.

<sup>18</sup> *Historia e Popullit Shqiptar ...II*, f. 436

<sup>19</sup> Kujtim Nuro, Nezir Bato, *Hasan Prishtina, Dokumente*, Tiranë 1983, f. 31

Sa i takon arsyes së ngritjes së shqiptarëve në kryengritje dhe represionit osman ndaj tyre kishte mendime të ndara në qarqet diplomatike. Disa mendonin se Qeveria e Stambollit kishte të drejtë të ndërmernte masa kundër rebelimit “të shtetasve të vet”, kurse të tjerët e akuzonin për nxitje të revoltave dhe kryengritjes për shkak të mosmbajtjes së premtimeve, mungesës së reformave dhe për shkak të masave që ndërmoi kundër arsimit dhe kulturës shqiptare.<sup>20</sup> Të njëjtin mendim e ndanin edhe diplomatët britanikë në raportet që i dërgonin qeverisë së tyre në Londër. Dhunën e qeverisë së Stambollit ndaj shqiptarëve e konsideronin si masë të tepruar, sepse në vend të rezultateve kishte dhënë efekte të kundërta.<sup>21</sup>

Shuarja e kryengritjes së vitit 1910 në Vilajetin e Kosovës dhe masat e ndërmarra ndaj kryengritësve shqiptarë dhe familjeve të tyre nga autoritetet osmane nuk arritën ta shuanin vullnetin dhe bindjen e shqiptarëve për liri e pavarësi.

Në fillim të vitit 1911 lëvizja kryengritëse shqiptare mori dimensione dhe përmasa të reja, duke u zhvendosur nga Vilajeti i Kosovës në Vilajetin e Shkodrës. Në fazën e parë të përgatitjes së kryengritjes udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare u përpoqën të siguronin armatimin e nevojshëm në mënyrë që kryengritja të rezultonte me sukses. Armët u siguruan rrugëve të ndryshme: nga vendet fqinje, nga rrethimi i depove të armëve, shpërthimi i tyre dhe grabitja e armatimeve, por një pjesë e konsiderueshme u siguruan edhe nga Italia. Për këtë situatë informonte edhe konsulli austro-hungarez në Manastir, i cili theksonte se “pushkët dhe municionet kanë ardhur nga Italia në Mal të Zi” dhe duhej t’i dorëzoheshin Isa Boletinit.<sup>22</sup> Kryengritësit u përpoqën në vazhdimësi që pas vetes të tërhiqnin edhe oficerë dhe nizamë shqiptarë të ushtrisë osmane, të cilët ishin të gatshëm të bashkoheshin me kryengritjen.<sup>23</sup> Oficerët dhe ushtarët shqiptarë ishin shumë të rëndësishëm për kryengritjen, sepse ata kishin eksperiencë dhe njihnin taktikat e ushtrisë osmane. Këto përpjekje në shumë raste rezultuan me sukses pasi që një numër i madh i oficerëve shqiptarë të nxitur nga Hasan Prishtina jo vetëm që

<sup>20</sup> AK, Fondi DASSIP, K.12 Izveshtaj srpskog generalnog konzulla iz Solluna, Br. 324, 13 (29) 4 1910, Ministarstvo Inostranih Dela (MID), Beograd.

<sup>21</sup> Më gjerësisht: Frasher Demaj, *Britania e Madhe dhe çështja shqiptare 1875-1913*, Prishtinë 2010.

<sup>22</sup> AIHT, Vj. 20-14-41 Raporti i ambasadorit austro-hungarez nga Manastiri, nr. 6 më dt.19 janar 1911 dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

<sup>23</sup> Frashër Demaj, *Shqiptarët në dokumentet diplomatike të Britanisë së Madhe 1911-1912*, Prishtinë 2019, f. 131.

refuzuan të luftonin kundër kryengritësve, por edhe u bashkuan me kryengritjen.<sup>24</sup> Pas një varg përgatitjesh udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare kishin vendosur që kryengritja të shpërthente në prill të vitit 1911. Sipas planeve, kryengritja do të fillonte përnjëherë në vilajetin e Shkodrës dhe të Kosovës e më pas do të përfshinte edhe vilajetin e Manastirit dhe të Janinës.<sup>25</sup> Informacionet për lëvizjen dhe përgatitjet e shqiptarëve i përcillte edhe nënkonsulli britanik në Shkup W. Hough, i cili e njoftonte në letrat që i dërgonte ambasadorit britanik në Stamboll Charles Marlyng dhe ky i fundit ia përcillte shefit të diplomacisë britanike Edward Grey-it.<sup>26</sup>

Pas njoftimeve për përgatitjen e kryengritjes, diplomatët e Fuqive të Mëdha u vunë në veprim. Ata ishin të vendosur që të mbronin interesat e tyre gjeostrategjike në rajonin e Ballkanit dhe druanin se situata lehtësisht mund të dalë prej kontrollit dhe të marrë përmasa ballkanike. Rusët këmbëngulnin pranë Portës së Lartë që t'i jepte fund kryengritjes përmes ekspeditës ushtarake, kurse Austro-Hungaria e këshillonte Stambollin që të mos shkonte shumë larg në masat e dhunës ndaj shqiptarëve.<sup>27</sup>

Edhe diplomacia gjermane kërkonte që Perandoria Osmane të mos e "tepronte" me ashpërsinë e saj në masat që do të ndërmerre ndaj kryengritësve shqiptarë. Në anën tjetër, ministri i Jashtëm i Italisë San Xhuliano, nëpërmjet ambasadorit të tij në Stamboll ia bënte të qartë Portës së Lartë se Italia nuk i miratonte masat e ashpra të ushtrisë turke në Shqipëri.<sup>28</sup> Franca i vështronte këto zhvillime me interes të shtuar, por pa pasur interesa të drejtpërdrejta në vilajetet shqiptare. Britanikët ia tërhiqnin vërejtjen Stambollit që të mos nxiste dhunë dhe konflikte në një kohë shumë të papërshtatshme për Perandorinë, pasi që shtetet ballkanike mezi prisnin eskalimin e situatës dhe hyrjen në luftë kundër osmanëve. Sipas diplomacisë britanike çdo acarim i tepruar i marrëdhënieve të Portës me shqiptarët do t'i dobësonte të dy palët dhe nga kjo situatë do të përfitonin shtetet ballkanike, kryesisht serbët, malazetët, bullgarët dhe grekët. Interesimi i britanikëve shihej qartë edhe në njoftimet, raportet,

<sup>24</sup> Po aty

<sup>25</sup> Nikollë Ivanaj, *Historija e Shqipërisë së Re*, pjesa II, Tiranë 1943, f. 39.

<sup>26</sup> Arkivi i Institutit të Historisë në Prishtinë, më tej (AIHP), Fondi i dokumenteve britanike, Dosja: Dokumente britanike për kryengritjen e vitit 1910; PRO FO 371/ 1228, MF 1577.

<sup>27</sup> *Historia e popullit shqiptar ...II*, f. 438.

<sup>28</sup> AIHP, Fondi i Londres, Dosja: Dokumente britanike për kryengritjen e vitit 1911; PRO FO 371/ 1228, MF 1577.

dërgesat, telegramet dhe letërkëmbimet e nënkonsullatave, konsullatave dhe ambasadave të Mbretërisë së Bashkuar dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme.<sup>29</sup> Kështu nënkonsulli britanik në Manastir Geary në raportin që i dërgonte ambasadorit të tij në Stamboll Z. Marling përmendte këmbënguljen dhe deklaratën e udhëheqësve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare lidhur me kërkesat e tyre politike, që në përmbajtje synonin autonominë si fazë kaluese drejt pavarësisë së plotë sipas shembullit të shteteve ballkanike. Në raport përmendet edhe përpjekja e qeverisë xhonturke për t'i përçarë ata mbi baza fetare në kristianë dhe muhamedanë dhe rreziku i përhershëm që situata të dilte jashtë kontrollit sidomos pas ngjarjeve të fundit dhe dëbimit të grave dhe familjeve shqiptare në shenjë hakmarrje ndaj kryengritësve.<sup>30</sup> Shqiptarët e besimit islam Porta vazhdonte t'i quante "tradhtarë të Perandorisë", prandaj, e revoltuar, i ndiqte dhe i ndëshkonte ata dhe familjet e tyre.

Pas shuarjes së kryengritjes së vitit 1911, krerët e Lëvizjes Kombëtare, duke mos pasur alternativë të dytë e shihnin kryengritjen e përgjithshme si të vetmen rrugë për ta detyruar qeverinë osmane t'ua njohë shqiptarëve të drejtat e tyre. Ata menduan se kryengritja duhej të fillonte në pranverën e vitit 1912.<sup>31</sup> Për këto lëvizje të shqiptarëve dhe përgatitjet e tyre njoftonte kryekonsulli i Austro-Hungarisë në Selanik më 5 janar 1912, në raportin e dërguar shefit të tij në Vjenë z. Erental. Ai shprehej se "forcimi i ndjenjës kombëtare dhe i unitetit ka bërë përparime të dukshme veçanërisht në Kosovë dhe se po punohet me intensitet të lartë në të gjitha pjesët e Shqipërisë me qëllim të organizimit të një kryengritje të madhe."<sup>32</sup>

Këto përgatitje u shoqëruan me një veprimtari të dendur politike në parlamentin xhonturk kundër qeverisë. Hasan Prishtina në fjalimin e mbajtur në seancën e parlamentit osman më 11 janar 1912 sulmoi qeverinë xhonturke për terrorin e padëgjuar që kishte ushtruar mbi popullin shqiptar gjatë kryengritjes së Kosovës". Ai iu kërcënua qeverisë me kryengritje të re nëse nuk do të zbatoheshin reformat në Shqipëri.<sup>33</sup> Fjalimi i guximshëm i Hasan Prishtinës e nxiti vezirin e

<sup>29</sup> Frashër Demaj, *Shqiptarët në dokumentet...* vep. e cit. f.131.

<sup>30</sup> AIHP, Fondi i Londrës, Dokumente britanike për Kryengritjen shqiptare të vitit 1911, shkresë e nënkonsullit Geary në Manastir dërguar ambasadorit britanik Marling në Stamboll. Dok. nr. 62, Manastir, 18 dhjetor 1910.

<sup>31</sup> Zekeria Cana, *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe*, Prishtinë, 2008, f. 7.

<sup>32</sup> *Hasan Prishtina (Përmbledhje dokumentesh) 1908-1934*, Tiranë, 1983, f. 51.

<sup>33</sup> Hasan Prishtina, *Një grusht kujtime mbi kryengritjen shqiptare të vitit 1912*,



madh që ta akuzonte dhe ta quante Hasanin rebel që kërkonte t'i vinte zjarrin Perandorisë.

Më 5 maj 1912 Hasan Prishtina, bashkë me Zejnullah bej Vuçitërnin, doli në krye të lëvizjes kryengritëse në Drenicë dhe në Rrafshin e Kosovës. Përkrah tij ishin udhëheqësit e shquar të kryengritjes së armatosur si Isa Boletini, Bajram Curri, Idriz Seferi dhe drejtues të tjerë të krahinave kryengritëse. Për këto veprime përfaqësuesi i Italisë në Sofje informonte Romën se Hasan Prishtina, Zejnullah Beu dhe Isa Boletini ishin "organizatorët e zellshëm të kryengritjes".<sup>34</sup>

Në këtë kohë në qarqet e huaja diplomatike qarkullonin të dhëna se në Vilajetin e Kosovës, Qeveria osmane kishte dërguar 50.000 pushkë me municion të nevojshëm.<sup>35</sup> Hyrja e gjithë këtij arsenali luftarak për diplomacinë britanike ishte shumë brengosëse, sepse ajo gjithnjë ishte druajtur nga lindja e një Krize të re Lindore e cila mund të ishte më e ashpër dhe më e rrezikshme se gjithë të tjerat. Duke parë seriozitetin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, diplomacia britanike filloi ta shikonte më ndryshe këmbënguljen e shqiptarëve për shtet kombëtar.<sup>36</sup> Qarqet konsullore në terren filluan të ndryshojnë qëndrimin për Lëvizjen Shqiptare dhe filluan të vlerësojnë se çështja shqiptare assesi nuk mund të anashkalohet, por ajo duhet të zgjidhet sa më shpejt në mënyrë që të shmanget kriza në rajonin e Ballkanit. Për të qenë sa më të njoftuar me zhvillimet e përditshme, qeveria britanike shtoi kapacitetet në konsullatat e veta. Nëpunësit konsullorë mblidhnin të dhëna në terren nga informatorët e vet që përcillnin situatën dhe lëvizjet ushtarake si dhe zhvillimet e përditshme duke filluar që nga përgatitjet për lëvizje kryengritëse, keqtrajtimin e familjeve të kryengritësve, mospajtimet ndërmjet krerëve lokalë e deri te qëndrimi zyrtar dhe masat e qeverisë osmane.<sup>37</sup>

Ndërkohë gjendja në terren u ashpërsua edhe më shumë. Popullsia e nahisë së Pejës më 6 maj 1912 ngriti krye duke u shfaqur me forcë kundër administratës osmane. Si kundërreagim, komanda e ushtrisë osmane nisi me shpejtësi në drejtim të Pejës dy batalione me

Shkodër 1921, f. 5.

<sup>34</sup> AK, F. MDAE, Telegram i Legatës Italiane nga Sofja nr. 373, dt. 17. 05. 1912, dërguar MPJ-së në Romë.

<sup>35</sup> AK, Dokumenti..., Knj. V, Sv. 2, d. 301, st. 541, Poslanstvo Kraljevine Srbije - Priština, Predsedniku MS i MID Kraljevine Srbije - Beograd, 9. 5. 1912.

<sup>36</sup> THNA, Albania FO 373/2/1, E 132.

<sup>37</sup> THNA, Albania FO 373/2/1, E 133.

trupa ushtarake dhe armatime të shumta. Luftimet ndërmjet forcave kryengritëse dhe atyre osmane vazhduan nga data 11 deri më 14 maj.<sup>38</sup>

Më 20 maj repartet ushtarake ndihmëse të nisura nga Mitrovica hynë në Pejë e rrethuar, ku u bashkuan me garnizonin e ngujuar atje. Për të tërhequr vëmendjen dhe për të ndihmuar kryengritësit në regjionin e Pejës, lëvizja kryengritëse u shtri edhe në sanxhakun e Prishtinës. Në këtë mënyrë forcat osmane u detyruan që të shpërndareshin për ta mbajtur situatën nën kontroll. Më 9 maj 1912 një çetë shqiptare u përlesh me repartin e xhandarmërisë në Llap e në Kushutovë dhe u ndërmor një sulm mbi depon e armëve në postën e xhandarmërisë në Vushtrri.

Më 23 maj 1912 arriti në Ferizaj divizioni i nizamëve nga Stambolli, i specializuar për kryerjen e detyrave të veçanta dhe i pajisur me armatime e mjete moderne luftarake. Në fundin e majit 1912 ishin angazhuar drejtpërsëdrejti në luftime 19 mijë ushtarë të pajisur me armatime dhe artileri të rëndë.<sup>39</sup>

Pas Kuvendit të Junikut Hasan Prishtina lëshoi një proklamatë në të cilën, midis tjerash, thuhej: "Sot Shqipëria Veriore dhe Jugore i kapi armët që me anën e kryengritjes t'i fitojë të drejtat e veta që u janë marrë."<sup>40</sup>

Kryengritës të tjerë të viseve të Hasit, të Gashit dhe të Bytyçit, nën drejtimin e Bajram Currit goditën katër batalione të përqendruara në Qafën e Prushit. Forcat qeveritare u thyen keq, duke lënë në duart e shqiptarëve municione, armë, mitraloza e topa, që u përdorën për armatosjen e kryengritësve. Suksesi i kryengritësve në Qafë të Prushit ushtroi ndikim në popull dhe, siç theksonte Hasan Prishtina, i dha një shtytje të fuqishme lëvizjes së armatosur edhe në viset e tjera.<sup>41</sup>

Ndërkohë 4.000 ushtarë osmanë rrethuan më 30 qershor 1912 Boletin, ku gjendeshin 1.500 kryengritës nën komandën e Isa Boletinit. Këtu u zhvilluan luftime të rrepta gjatë të cilave turqit patën rreth 100 ushtarë të vrarë. Të vrarë dhe të plagosur pati edhe në anën e kryengritësve. Pas dy javë luftimesh, kryengritësit u detyruan të tërhiqeshin nga Boletini në drejtim të Pazarit të Ri.

<sup>38</sup> *Historia e popullit shqiptar ...II*, f. 469.

<sup>39</sup> Po aty.

<sup>40</sup> Hasan Prishtina, *Përmbledhje dokumentesh*, d. 31, f. 61; Zekeria Cana, *Shpalime historike I*, Prishtinë, 1982, f. 214- 217."

<sup>41</sup> *Historia e popullit shqiptar ...II*, f. 473.

Xhonturqit ushtruan një terror të pashembullt mbi popullsinë shqiptare. Valiu i Kosovës Masar Beu njoftonte më 30 qershor telegrafisht Adil Beun, ministrin e Punëve të Brendshme, se “burgosja dhe internimi i familjeve të kryengritësve nuk i tremb shqiptarët, por i ka nxitur edhe më shumë.”<sup>42</sup>

Arrestimi, burgosja dhe internimi i familjeve të kryengritësve, ish-oficerëve shqiptarë të ushtrisë osmane që kishin kaluar në anën e kryengritjes dhe të personaliteteve të tjera shqiptare të kohës ishte bërë temë e përditshme e raporteve konsullore të të gjitha përfaqësive diplomatike. Në vëzhgimin e kësaj situatë ndër më aktivët ishin britanikët. Kështu në raportin e konsullit të përgjithshëm në Selanik Harry Llamb dërguar **Gerard A. Lowther, H. B. M. ambasador i jashtëzakonshëm në Stamboll** njoftohet për deportimin e familjeve të kryengritësve dhe personaliteteve të njohura shqiptare.<sup>43</sup> Konsulli Llamb më 11 korrik 1912 nga Konsullata e Përgjithshme e madhërisë së tij në Selanik, në raportin nr. 88 citonte zëvendëskonsullin Peckham në Shkup dhe korrespondentin e “Yeni Asr-it”.<sup>44</sup>

Duke iu referuar paragrafit të fundit të Thirtjes së zëvendëskonsullit Peckham-it nr. 49 në lidhje me dëbimin e familjeve të shqiptarëve kryengritës, konsulli Llamb përpiqet të paraqesë përkthimin e ekstrakteve nga dy letra nga korrespondenti në Shkup i “Yeni Asr-it”, që tregojnë se edhe vetë turqit nuk janë të pavetëdijshtëm për pasojat e mundshme të arrestimit dhe dëbimit të grave dhe familjeve shqiptare.<sup>45</sup> Në raport konsulli Llamb shpreh pajtimin e tij të plotë me vërejtjet e zëvendëskonsullit Peckham lidhur me pengmarrjen, arrestimin dhe dëbimin e grave dhe familjeve shqiptare. Asnjë popull në botë nuk është më i ndjeshëm në asnjë çështje tjetër se sa shqiptarët e veriut kur preket nderi dhe dinjiteti i grave dhe i familjeve të tyre qofshin myslimanë apo të krishterë.<sup>46</sup> Andaj nëse vazhdohen këto veprime të Qeverisë së Stambollit ndaj shqiptarëve, kryengritjet e këtyre të fundit jo vetëm që nuk do të ndalen, por ato do të masivizohen edhe më shumë, duke vënë në pikëpyetje pastaj edhe qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e administratës osmane në territoret e banuara me shqiptarë.

<sup>42</sup> Po aty.

<sup>43</sup> THNA, FO 195, 144-2407, Albania 3251-5510 viti 1912.

<sup>44</sup> Po aty.

<sup>45</sup> THNA, FO 195, 144-2407, Albania 3251-5510 viti 1912, Thirrja e zëvendëskonsullit Peckham në Shkup nr.49/9.

<sup>46</sup> Frashër Demaj, Shqiptarët në dokumentet... vep. e cit., f. 131.

Në një nga artikujt e “Yeni Asr-it”, të cilave iu referohen konsulli i përgjithshëm Llamb dhe zëvendëskonsulli Peckham të datës 7 korrik 1912 nga Prizreni, Gjakova dhe Peja, janë marrë gratë dhe familjet e atyre shqiptarëve që janë bashkuar me kryengritësit. Këto familje janë transportuar në Shkup. Nuk dihet statusi i këtyre shqiptarëve nëse janë të arrestuar, të marrë peng apo të burgosur, por dihet se forcat osmane hynë me dhunë në shtëpitë e tyre nga mesnata dhe në orët e hershme të mëngjesit kur gratë dhe fëmijët ishin akoma të fjetur. Këto u mblodhën menjëherë dhe u morën me nxitim, me rrobat që kishin të veshura pa iu dhënë asnjë mundësi për të marrë asgjë nga gjërat personale. Të deportuarve nuk ju dha zyrtarisht asnjë shpjegim për arsyet e marrjes peng dhe nuk u lejuan të komunikonin me njëri-tjetrin.

Deportimi nga shtëpitë e tyre i familjeve shqiptare dhe dërgimi i tyre nga Prizreni, Peja dhe Gjakova në Shkup ishte një veprim i zellit të gabuar të individëve të papërgjegjshëm dhe që nuk kishte asnjë mbështetje ligjore në legjislacionin e Perandorisë Osmane, deklaronte zëvendëskonsulli Peckham<sup>47</sup>.

Në artikullin e “Yeni Asr-it” ndër të tjera thuhej: “Cili do të jetë shpjegimi për marrjen peng të fëmijëve siç është rasti i marrjes së vajzës 12 apo 13-vjeçare të Shani efendiut? Ajo u mor nga prehri i gjyshes së saj të lodhur e të mërziur, e cila kujdesej për vajzën pas vdekjes së djalit të saj fatkeq”.<sup>48</sup> Çfarë faji kishte gruaja e Ahmed beut nga Gjakova, apo gratë tjera të mbetura në shtëpi pa kujdesin e burrave të tyre dhe me përgjegjësinë për fëmijët e tyre të cilat u bënë cak i sulmeve hakmarrëse të ushtrisë osmane, thuhej në një nga raportet konsullore.<sup>49</sup>

Harry Llamb në raportin e tij citon edhe një pjesë të artikullit të “Yeni Asr-it” të datës 10 korrik 1912, ku në mes tjerash thuhet: ”Dëbimi i familjeve të kryengritësve në Shkup e ka rënduar edhe më shumë këtë krizë dhe ka qenë shkak i acarimit të madh të popullsisë me organet e administratës osmane. Në mesin e familjeve të deportuara ishte edhe ajo e Xhemal beut nga Prishtina. Çështja e transferimit të familjes së Xhemal beut, një nga bejlerët shqiptar më me influencë dhe një nga figurat kryesore të kësaj lëvizjeje nga Prishtina në Shkup është diskutuar shumë dhe është vlerësuar si një

<sup>47</sup> Frashër Demaj, Shqiptarët në dokumentet... vep e cit, f.132.

<sup>48</sup> THNA, FO 195, 144-2407, Albania 3251-5510 viti 1912.

<sup>49</sup> THNA, FO 195, 144-2407, Albania 3251-5510 viti 1912.

gabim i madh”.<sup>50</sup> Edhe autoritetet lokale osmane druajnë se dëbimi nga Prishtina e anëtarëve të një familjeje kaq të rëndësishme do të jepte rezultate shumë të këqija, sepse kryengritja në Shqipëri është në pikën e hyrjes në një fazë akute dhe që qeveria osmane duhet të veprojë jo vetëm me fuqi dhe qëndrueshmëri, por edhe me qartësi dhe largpamësi.<sup>51</sup>

Një formë tjetër e presionit të qeverisë osmane ndaj shqiptarëve ishte marrja peng e grave dhe familjeve shqiptare me afat, pra deri në momentin e dorëzimit të kryengritësve. Kjo pengmarrje përcillej me ultimatium në rast se nuk dorëzohen burrat kryengritës brenda tri ditëve do të internohen gratë dhe familjet e tyre në Anadoll dhe do t’u sekuestrohet e prona e tyre. Për një kërcënim të tillë raportonte edhe zëvendëskonsulli Peckham nga Shkupi në letërkëmbimin e datës 12 korrik 1912, ku përmendte edhe raportimet e mëhershme dhe telegramet nr. 14 dhe 17 dhe raportet e datave 6 dhe 9 (korrik F.D) në të cilat kishte alarmuar për këto veprime arbitrare të administratës osmane.<sup>52</sup>

Qeveria osmane, sipas burimeve britanike, kishte bërë një listë me emrat e kryengritësve dhe personaliteteve kryesore shqiptare, duke bërë edhe njoftim publik në qytetet kryesore të Shqipërisë. Në njoftimin e opinionit u bëhej thirrje udhëheqësve të kryengritjes që brenda afatit të caktuar nga qeveria të dorëzohen të gjithë ata të cilëve u janë nisur familjet për t’u internuar për në Anadoll. Të gjithë të dorëzuarve do t’u ktheheshin familjet dhe pronat e sekuestruara, kurse ata që nuk dorëzohen, familjet e tyre do të internohen dhe pronat e sekuestruara nuk do t’u kthehen kurrë.<sup>53</sup>

Nga ana tjetër krerët dhe kryengritësit shqiptarë citohet të kenë thënë: “Turqit nuk janë të zotët në luftën kundër burrave dhe tani po i burgosin gratë dhe po vjedhin pasurinë tonë”. Shqiptarët sipas kanunit të tyre jo vetëm që nuk i luftojnë gratë, por edhe armiku i tyre nese është me gra, në atë moment ata tregojnë respekt dhe nuk e luftojnë. Shqiptarët më parë e pranojnë vrasjen se vjedhjen (konfiskimin e pasurisë F.D). Ata e konsiderojnë vjedhjen si një krim të rëndë, kurse vrasjen si një incident i zakonshëm në jetë.<sup>54</sup>

<sup>50</sup> THNA, FO 195, 144-2407, Albania 3251-5510 viti 1912.

<sup>51</sup> THNA, FO 195, 144-2407, Albania 3251-5511 viti 1912.

<sup>52</sup> THNA, FO 195, 144-2407, Albania 3251-5512 viti 1912.

<sup>53</sup> Frashër Demaj, Shqiptarët në dokumentet..., vep e cit, f.132.

<sup>54</sup> THNA, FO 195, 144-2407, Albania 3251-5510 viti 1912. Raport i zëvendëskonsullit Peckham për konsullin e përgjithshëm Harry Llamb me temë

Duke pasur parasysh këto fenomene në kulturën e tyre të përditshme, mund të imagjinohet se çfarë stuhie zemërimi u ngrit kur qeveria i dërgoi në Shkup familjet e Ahmed beut, Riza beut dhe Hysni Currit të Gjakovës; të Jahja beut, Sadik efendiut dhe Shani efendiut të Prizrenit dhe të Mahmud Zajmit të Pejës.<sup>55</sup> Gruaja e Riza beut thuhet se në momentin e rrethimit të shtëpisë së saj ka shkuar në dritare dhe u ka thënë ushtarëve osman “ikni se u mbuluat me turp duke luftuar me gra, shkoni luftoni me burra që po luftojnë për lirinë e tyre”.<sup>56</sup> Kurse në Prishtinë shqiptarët u organizuan dhe u betuan e gjithë popullata e Prishtinës se më parë do të vdisnin sesa të lejonin gruan e Xhemal beut për t’u marrë nga ushtarët dhe për t’u larguar nga qyteti e për t’u internuar në Anadoll.<sup>57</sup> Administrata osmane, duke e ndjer presionin e shqiptarëve dhe reagimin e përfaqësive diplomatike në qytete të ndryshme shqiptare dhe ambasadave të shteteve perëndimore në Stamboll, e ndryshoi afatin e ultimatumit kërcënues dhe vendosi ta shtyente internimin e grave dhe familjeve deri në një vendim të dytë. Në ndërkohë u lëshuan fletarrestime dhe thirrje për gjyq për shumë krerë shqiptarë dhe për udhëheqësit e kryengritjes, madje për ata që ishin më të rëndësishëm për kryengritjen dhe më të rrezikshëm për autoritetet osmane u premtuan edhe shpërblime për kokat e tyre.

Pra, sipas burimeve diplomatike britanike, në periudhën e kryengritjeve shqiptare 1910-1912, një nga format e dhunës dhe represionit osman ndaj shqiptarëve që nuk pajtoheshin me regjimin osman, por ishin ngritur kundër tij ishin edhe arrestimet, marrja peng, burgosja dhe internimi i grave e i familjeve, si dhe konfiskimi i pasurisë së kryengritësve dhe krerëve shqiptarë të cilët përpiqeshin të rezistonin dhe të organizoheshin në kërkim të lirisë, çlirimit të vilajeteve shqiptare dhe formimit të shtetit të tyre fillimisht autonom e pastaj shtetit të pavarur kombëtar.

---

arrestimin e grave dhe nisjen e tyre për internim në Anadoll dhe konfiskimin e pasurisë së kryengritësve dhe krerëve shqiptarë nga ana e autoriteteve osmane.

<sup>55</sup> THNA, FO 195, 144-2407, Albania 3251-5510 viti 1912.

<sup>56</sup> THNA, FO 195, 144-2407, Albania 3251-5510 viti 1912.

<sup>57</sup> THNA, FO 195, 144-2407, Albania 3251-5510 viti 1912.

Frashër Demaj

BRITISH SOURCES ON THE ARREST AND DEPORTATION OF  
ALBANIAN WOMEN AND FAMILIES RISING AGAINST THE  
OTTOMAN POWER 1910-1912

Abstract

Most of the leaders of the National Movement, in addition to contacts and diplomatic activities, saw the anti-Ottoman armed resistance as a real opportunity to realize the claims for freedom and nation-state. For this purpose they intensified organizational activities in all Albanian vilayets where small gatherings and meetings were held with popular tribunes and local leaders. The decision to start insurgent activities was taken in December 1909 at a meeting held on the outskirts of Skopje. It was attended by the most prominent leaders of the National Movement from the Vilayet of Kosovo such as: Isa Boletini, Idriz Seferi, Sylejman Batusha, Shaban Kopriwa, Hasan Ferri, Hasan Hysen Budakova, Ramadan Zaskoci and many others.

In opposition, the Ottoman government ordered the punishment of the Albanian insurgents whom it called "rebels" and "traitors" of the Empire and the taking of harsh measures against them and their families. The arrest, imprisonment and exile of the families of the insurgents, former Albanian officers of the Ottoman army who had sided with the insurgency and other Albanian personalities of the time had become a daily topic of consular reports of all diplomatic missions. In observing this situation among the most active were the British. Thus, in some of the reports of the Consul General in Thessaloniki, Harry Llamb is informed about the taking hostage and deportation of the families of the insurgents and well-known Albanian personalities.

Vice consul Peckham from Skopje reported on the abduction, arrest and deportation of Albanian women and families. No people in the world is more sensitive to any issue than northern Albanians, whether Muslim or Christian, when the honor and dignity of women and their families is affected, Peckham declared.

According to British sources from Prizren, Gjakova and Peja, it is reported that the wives and families of those Albanians who joined the insurgents were taken away. These families were transported to Skopje. Their status is unknown whether they have been arrested, taken hostage or imprisoned. The Ottoman government, according to British sources, had compiled a list of names of insurgents and main Albanian personalities for whom it had issued arrest warrants.

*Keywords:* Ottoman Empire, insurgents, Albanian women and families, arrest, deportation, British consulates, Albanian leaders.

Rreze Kryeziu-Breznica, Prishtinë

## KOMPOZITORËT E MUZIKËS ARTISTIKE NË KOSOVË - NDARJA HISTORIKE SIPAS MUZIKOLOGJISË KOSOVARE

### Abstrakt

Muzika artistike në kuptimin e themelimit të institucioneve profesionale në Kosovë, siç është shkolla kompozicionale, filloi të zhvillohej nga mesi i shekullit të 20-të, gjatë periudhës së ish-Jugosllavisë. Pikërisht popullsia shqiptare në Kosovë duhej ta ndante fatin e saj me popujt e tjerë të shtetit të atëhershëm jugosllav pas Luftës së Dytë Botërore, nga viti 1945. Si pjesë integrale e këtij zhvillimi u krijuan rrethana të reja ekonomike, politike, sociale dhe kulturore të cilat mundësuan zhvillimin e muzikës artistike si një segment i rëndësishëm i jetës kulturore. Para kësaj periudhe nuk kishte institucione muzikore profesionale, as artistë, kompozitorë, instrumentistë apo këngëtarë të arsimuar në Kosovë. Opusi krijues i kompozitorëve shqiptarë me siguri mund të hedhë dritë në rrethanat e mësipërme. Dhe kjo vjen si rezultat i programit të shfrytëzuar në opusin e tyre, ku përveç mbështetjes melodike e ritmike të rrjedhura nga folklori muzikor shqiptar, ata janë mbështetur fuqimisht në ngjarjet e mëdha historike të vendit, të cilat ne mund t'i dëshmojmë sot përmes muzikës së tyre.

Ky punim përpiket të ndihmojë në identifikimin e karakteristikave që çuan në ndarjen aq të njohur historike të kompozitorëve në gjenerata dhe gjithashtu të identifikojë problemet specifike që fillimisht ndikuan në shfaqjen e vonuar të një tradite të tillë në Kosovë. Përkundër të gjitha vështirësive, rrethanave politiko-historike të cilat kishin mbingarkuar Kosovën dhe që vazhdojnë të kenë një ndikim të madh edhe sot (2020), muzika artistike (sjell dhe trajtuar shumë vonë) ka arritur shumë. Të paktën ajo kapërceu periudhën e errët dhe kushtet e pafavorshme që e kishin prekur atë me shekuj. Tërë kjo është mundësuar nga kompozitorët dhe opusi i tyre krijues.

*Fjalët çelës:* Muzika artistike, shqiptarët, Kosova, kompozitorët, institucionet, ndarja historike.

### HYRJE

Zhvillimi i muzikës artistike shqiptare në Kosovë filloi pas Luftës së Dytë Botërore dhe ajo ndau të njëjtin fat me vendet e tjera të Ballkanit. Muzika artistike në Kosovë ka kaluar dhe është përballur



me situata të ndryshme politike, sociale dhe ekonomike të cilat patën një ndikim të fortë në zhvillimin e saj.

Sidoqoftë, ndikimi ishte më i fortë për shkak të fillimit të luftës së fundit në Kosovë (e cila u inicua nga viti 1990, gati një dekadë para), një luftë që bëri dhjetë vjet të detyrueshme të dezertimit të jetës kulturore dhe arsimore për shqiptarët e Kosovës. Serbia - dhe shumë serbë, duke e parë Kosovën si zemrën e tyre kulturore krijuan një kushtetutë të re në vitin 1989 që revokuan statusin autonom të saj. Udhëheqësit shqiptarë të Kosovës vepruan si kundërpërgjigje në vitin 1991 duke organizuar një referendum që shpie në shpalljen e pavarësisë së Kosovës.<sup>1</sup> Serbia ndërmori masa shtypëse kundër shqiptarëve të Kosovës në vitet e 90-ta të shek XX, duke provokuar një kryengritje të shqiptarëve kosovarë.<sup>2</sup> Kjo tregon një situatë të ndërlikuar në lidhje me identitetin etnik dhe kombëtar, që u transformua thellësisht në pjesën e dytë të shekullit të 20-të dhe u ndje sidomos në kohën e zgjedhjeve të para që ndodhnin ndonjëherë pas Luftës së Dytë Botërore në Jugosllavi, sepse disa nga njësitë që ishin pjesë e saj filluan të shpallin pavarësinë e tyre (Sllovenia dhe Kroacia në vitin 1991). Luftërat e njëpasnjëshme të qeverisë jugosllave filluan kundër shteteve respektive të cilat nga kjo periudhë kohore e tutje kërkuan pavarësinë e tyre nga ai shtet. Kjo përfshin edhe Kosovën, e dëshmuar me luftë (mars - qershor 1999) me ndërhyrjen e forcave të NATO-s, e cila filloi bombardimet në bazat ushtarake të Serbisë kur Slllobodan Miloseviqi (1941-2006) pranoi humbjen e tij.

Rrethanat e lartpërmendura politike dhe sociale, si dhe ndryshimet e tjera dramatike brenda Kosovës kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e muzikës artistike në Kosovë, e cila nga këndvështrimi im ishte dhe është një sferë neutrale e identitetit pasi filloi në një vakum - një zbrazëti për sa i përket veprimtarive të saj që nuk ekzistonin para shekullit të 20-të. Nëse kthehemi prapa në histori, një rol më i fortë i muzikës shqiptare u vu re sidomos në vetëdijen publike gjatë tensioneve të vazhdueshme me shtetin serb (1912-1913) gjatë Luftës së Parë Ballkanike, Luftës së Parë Botërore (1913-1918) dhe

---

<sup>1</sup> John B. Allcock and John R. Lampe, "Yugoslavia": FORMER FEDERATED NATION [1929–2003], Encyclopaedia Britannica, 2012, <https://www.britannica.com/place/Yugoslavia-former-federated-nation-1929-2003>, qasur për here të fundit (Mars 02, 2020).

<sup>2</sup> Central Intelligence Agency, "Kosovo", Central Intelligence Agency Web, 2013, më tepër në vegëzën <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>, qasur për here të fundit, (Mars 06, 2020).

Luftës së Dytë Botërore (1939-1945) - tensione që përfundimisht çuan në luftën e vitit 1999.

Megjithatë situata në lidhje me shqiptarët në Kosovë ishte më e mirë në vitin 1945. kur erdhi në pushtet qeveria socialiste nën udhëheqjen e Josip Broz Titos. Për periudhën e sipërpërmendur edhe historiani dhe akademik britanik Noel Macolm në librin e tij *Kosova një histori e shkurtër* deklaroi se shqiptarët e Kosovës e konsideronin Titon si njeriun që ndaloi ose kundërshtoi politikat armiqësore të regjimit të ish-Jugosllavisë.<sup>3</sup> Tito shtypi sistematikisht të gjitha manifestimet e nacionalizmit në të gjithë Jugosllavinë, duke kërkuar të sigurojë që asnjë republikë ose kombësi të mos fitojë sundimin mbi të tjerët. Por autorët Daniel Bethlehem dhe Marc Weller në librin e tyre *Krizat jugosllave në të drejtën ndërkombëtare* vunë në dukje: "Kur Kosova u bë provincë me vendim të Titos, kufijtë e Kosovës nuk përputheshin saktësisht me zonat e zgjidhjes etnike shqiptare në Jugosllavi (një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve të Kosovës mbeti në Republikën e Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë)".<sup>4</sup> Kjo do të thotë se ishte një ndarje e padrejtë territoriale, por Tito mori këtë vendim për të "kënaqur" Kosovën, duke e shpallur atë si provincë dhe gjithashtu për të kënaqur vendet e tjera që ishin pjesë e Jugosllavisë, duke ruajtur stabilitetin e qeverisë së tij.

Pas vdekjes së Titos, situata në Kosovë po bëhej më e vështirë çdo ditë sidomos kur Slobodan Milloseviqi erdhi në pushtet në 1989. Më 1990, sipas Bethlehem dhe Weller, Millosheviqi kishte ndaluar punën e Kuvendit të Kosovës, delegatët e të cilit kishin shpallur Deklaratën e pavarësisë së Kosovës më 2 korrikt.<sup>5</sup> Reagimet nga pala serbe u pasqyruan nga burgosjet e intelektualëve dhe kryengritësve shqiptarë, dëbimi i mësuesve dhe studentëve nga institucionet arsimore (të cilët në atë kohë po refuzonin planprogramin e ri serb që përjashtonte mësimin e letërsisë dhe historisë shqiptare).<sup>6</sup> Pushtimi i plotë i Kosovës i gjeti shqiptarët të papërgatitur dhe plotësisht të paimpërvuar për një mjedis të tillë. Kjo përfundimisht ndikoi në rrjedhën tonë të përgjithshme kulturore dhe në veçanti në muzikë. Sidoqoftë, përkundër gjithë torturave të ushtruara, të gjitha ndikimet politike, muzika dhe fuqia e saj mbizotëruan duke shoqëruar popullin

<sup>3</sup> Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, "KOHA", Prishtinë, f. 398.

<sup>4</sup> Daniel Bethlehem and Marc Weller, *The Yugoslav Crises in International Law*, Cambridge University Press, Cambridge, 1997, f. 15.

<sup>5</sup> Ibid.

<sup>6</sup> Malcolm, *Kosova, një histori e shkurtër*, f. 423.

e Kosovës nëpër kohërat më të errëta. Muzika artistike në Kosovë u pasua nga ndërprerje të njëpasnjëshme, megjithatë ajo vazhdon të tërheqë një interes të jashtëzakonshëm.

Muzika artistike e shqiptarëve të Kosovës, përfshirë opusin krijues të kompozitorëve, ishte e izoluar si rezultat i efektit negativ të ndryshimeve dramatike të përshkruara më lart dhe rrethanave të tjera historike gjatë dhe pas vitit 1945 dhe gjithashtu gjatë viteve 1990. Edhe sot në kohën e shkrimit të këtij punimi në vitin 2020 efekti negativ i rrethanave të sipërpërmendura mund të evidentohet lehtë. Kosova ende nuk ka një sallë të përshtatshme për koncerte dhe shfaqje të muzikës artistike. Mungesa e kushteve për realizimin e aktiviteteve të saj kontraston me interesin e fortë të kompozitorëve vendës për kultivimin e saj. Si rezultat i mungesës së vendit, që është i nevojshëm për prezantimin e formave specifike, vetëm disa nga kompozitorët ekzistues vazhdojnë të kompozojnë në ditët e sotme.

Pavarësisht kësaj situate, muzika artistike në Kosovë u promovua, u prezantua dhe u zhvillua që nga pas Luftës së Dytë Botërore<sup>7</sup> dhe merita shkon për faktorët kyç që mundësuan prezantimin dhe kultivimin e saj - kompozitorët. Shikuar nga një perspektivë më e gjerë ndërkombëtare, kultura muzikore profesionale e pas vitit 1945 njihet si një periudhë që iu dha mundësi kompozitorëve të eksperimentojnë me tonalitetin, formën dhe orkestrimin.<sup>8</sup> Kompozitorët kosovarë, specifikisht në fillet e krijimtarisë së tyre artistike, e kishin të pamundur të shfrytëzojnë këto stile, duke konsideruar mosekzistimin dhe pamundësinë për të analizuar ato. Kjo dhe parandaloi barazinë e zhvillimit të muzikës artistike në Kosovë me atë të Evropës Perëndimore. Megjithatë, qëllimi i këtij punimi është të evidentojë se ky zhanër muzikor për një kohë relativisht të shkurtër arriti në pozicionin e njëjtë me atë në Evropë e më gjerë, dhe kjo sa i përket stileve dhe teknikës kompozicionale në opusin krijues të kompozitorëve tanë.

<sup>7</sup> Engjëll Berisha, *Zhvillimi i stileve në veprat e kompozitorëve shqiptarë të Kosovës*, Libri shkillor dhe arteve, Prishtinë, 1997, f. 12-20.

<sup>8</sup> Leon Botstein, "Modernism - The Late 20<sup>th</sup> Century", *Oxford Index*, 2001, për më tepër në vegëzën <http://oxfordindex.oup.com/view/10.1093/gmo-9781561592630.article.40625>, qasur për herë të fundit, (Mars 16, 2020).

## MUZIKA ARTISTIKE NË KOSOVË - KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME PARAKUSHTET E ZHVILLIMIT TË SAJ

Si pjesë integrale e shteteve të cilat ndodheshin nën Jugosllavi, në vitin 1945 edhe në Kosovë u krijuan rrethana të reja ekonomike, politike, sociale për zhvillimin profesional të muzikës artistike si një segment i rëndësishëm i jetës kulturore gjatë kësaj periudhe. Para kësaj periudhe nuk kishte institucione muzikore profesionale, as artistë, kompozitorë, instrumentistë apo këngëtarë të arsimuar në Kosovë.

Sipas muzikologut të mirënjohur kosovar Engjëll Berisha, parakusht për vazhdimësinë e zhvillimit të muzikës artistike në Kosovë ishin shoqëritë amatatore me aktivitetet e tyre rreth fundit të shekullit 19-të, periudhë kjo e njohur edhe si Rilindja Shqiptare.<sup>9</sup> Vetë periudha karakterizohej nga amatorizmi në muzikë. Një tjetër rëndësi shumë e madhe për filltet dhe zhvillimin e muzikës artistike në Kosovë kanë ansamblet gjysmëprofesionale të formuara në qytete të ndryshme të Kosovës, si Shoqëria Kulturore Artistike "Agimi" në Prizren e themeluar më 1944 dhe shoqëri të tjera të këtij lloji që përbëheshin nga kori dhe orkestra kamerale me rëndësi unike për muzikën artistike.<sup>10</sup>

Meritë e veçantë shkon për themelimin e institucioneve muzikore në Kosovë të cilat prezantuan dhe kontribuan në zhvillimin e mëtutjeshëm të muzikës artistike në vend, duke filluar në vitin 1948 kur u themelua shkolla e parë e këtij lloji (shkolla e parë profesionale muzikore "Josip Sllavenski", sot "Lorenc Antoni", në Prizren). Menjëherë pas themelimit të fakultetit të muzikës (1975) pasoi prezantimi i kompozitorëve të parë profesionistë, i orkestrave, i ansambleve, trupa e baletit etj. Për më tepër, në Kosovë, në gjysmën e shekullit 20-të një pjesë e kushteve parësore për prezantimin dhe zhvillimin e saj janë përbushur. Megjithë rrethanat e vështira, u ndez shkëndija për një fillim të jetës kulturore.

Siç u përmend më herët, hapat e parë të muzikës artistike janë të lidhura me aktivitetet e grupeve amatore-instrumentale, të ansambleve frymore dhe atyre vokalo-korale të formuara në qytete të ndryshme të

<sup>9</sup> Engjëll Berisha, *Studime dhe vështrime mbi muzikën*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2004, f. 87.

<sup>10</sup> Berisha, *Studime dhe vështrime mbi muzikën*, f. 87-90.

Kosovës. Jeta kulturore gjithashtu u përmbush me shfaqje nga koret që ishin pjesë e ritit të krishterë në atë periudhë. Rëndësia e muzikës fetare mbi atë laike në shoqërinë e përgjithshme është rezultat i koreve që janë pjesë e pandashme dhe integrale e misionit arsimor dhe kulturor të besimit katolik në të gjitha katedralet.

Muzikologjia kosovare zhvillimin e muzikës artistike (nga 1945 deri më 1975) e ndan në tri faza zhvillimore të bazuara në: opuse të përcaktuara, trajtimin/aplikimin e traditave muzikore kombëtare dhe popullore si dhe në mjedisin muzikor institucional.<sup>11</sup> Tri periudhat u zhvilluan në kohën e të ashtuquajturës Jugosllavi e Titos (1945-1980) ose Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, e cila për aq kohë sa zgjati siguroi zhvillim të përgjithshëm shoqëror të Kosovës. Nuk është rastësore që pas vitit 1975 edhe muzikologu Berisha, që bëri ndarjen, nuk la informacion të shkruar për zhvillimin e muzikës artistike në Kosovë. Ishte kjo fazë kur marrëdhëniet e Kosovës me Jugosllavinë po ndërlikoheshin. Kosova, si dhe shtetet e tjera, pjesë e qeverisë së atëhershme të Jugosllavisë, kishte filluar të kërkonte pavarësi. Kjo ide erdhi si rezultat i shtypjes që iu bë asaj, veçanërisht pas vdekjes së Titos. Viti 1980 shënon fillimin e një periudhe të gjatë dhe të vështirë për Kosovën, që solli luftën e vitit 1999, dhe gjithashtu pavarësinë e Kosovës në vitin 2008.<sup>12</sup> Ishte pikërisht mungesa e dëshmive të shkruara për atë që ndodhi me muzikën artistike pas asaj periudhe (pas vitit 1975), çfarë më bëri shumë kurioze dhe vendosa të ndërmar një hulumtim të plotë për zhvillimin e muzikës artistike pas vitit 1975, dhe arrita në përfundimin se ne përballemi këtu me një tjetër zhvillim të ri (periudhë të re) të muzikës artistike, duke filluar nga viti 1975 e deri në ditët e sotme të vitit 2020.

Nëse kthehemi te periudhat ndarëse të saj, periudha e parë (1945–1955) e zhvillimit përfshin dekadën e “çlirimit” të menjëhershëm dhe njohjes së Kosovës si provincë nën Jugosllavi. Sipas Berishës, kjo ishte periudha e cila u karakterizua edhe nga fillimi i veprimtarive të para muzikore nga shoqëri amatore dhe gjysmëprofesionale e deri në krijimin e institucioneve arsimore përkatëse muzikore, duke filluar me shkollën e parë filllore të muzikës në Prizren (Kosovë) në 1948.<sup>13</sup> Kjo tregoi që këto shoqëri shërbyen si një platformë brenda së cilës mund të ushtronin aktivitetin e tyre

<sup>11</sup> Engjëll Berisha, *Studime dhe vështrime mbi muzikën*, f. 87.

<sup>12</sup> John B. Allcock, *Encyclopaedia Britannica*, <https://www.briannica/place/Kosovo>, qasur për herë të fundit (Mars 06, 2020).

<sup>13</sup> Berisha, *Studime dhe vështrime mbi muzikën*, f. 87.

performues të muzikës popullore, orkestrat frymore, si dhe koret, të cilat fillimisht kishin një repertor të kufizuar (p. sh. SHKA<sup>14</sup> “Agimi”). Këto shoqëri ishin karakteristike në të gjithë Jugosllavinë, si një fazë fillestare drejt prezantimit të muzikës profesionale që është e barabartë me hapjen e institucioneve të para arsimore muzikore. Sipas muzikologut serb Roksanda Pejoviq këto shoqëri ishin shtyllat e jetës muzikore (jugosllave). Në Kosovë, në Serbi dhe në tërë ish-Jugosllavinë ata siguruan koncerte me programe të përziera: kompozime korale, solistë dhe orkestër, duke përfshirë edhe pjesë dramatike. Kjo fazë karakterizohet gjithashtu nga krijimi i muzikës artistike përmes shprehjes kombëtare të shfaqur nga vepra korale dhe këngë nga kompozitorët e parë shqiptarë të muzikës artistike në Kosovë si Lorenc Antoni (1909-1991) dhe Rexho Mullaj (1923-1982).

Nga viti 1955 deri në vitin 1965 del në dritë periudha e dytë, një periudhe në të cilën tashmë ishin krijuar kushtet themelore për një zhvillim të mëtejshëm profesional muzikor që gjithashtu me krijimin e shkollave profesionale të muzikës dorëzuan gjeneratën e parë të muzikantëve profesionistë që konsiderohej se do të jepnin kontributin e tyre për vitet në vazhdim. Mungesa e arsimit të lartë muzikor nuk ishte problemi më i madh për Kosovën, megjithëse një institucion i tillë nuk ekzistonte në vend. Talentët e rinj mund të bëheshin pjesë, të studionin në Universitetin e Arteve në Beograd (Serbi) të themeluar në vitin 1957, i cili siguroi një përgatitje profesionale për një numër të madh të kompozitorëve kosovarë të kësaj gjenerate, por edhe pasardhësve. Ndikimi muzikor rus në Jugosllavi (shkolla nacionale ruse e shekullit 19-të) vërehet edhe te kompozitorët kosovarë të kësaj faze. Kjo tregoi se kompozitorët vendës përfaqësojnë vazhdimësi përse i përket përfshirjes së folklorit muzikor në opuset kompozicionale, si orientimi i vetëm i mundshëm i asaj kohe. Sidoqoftë, qasja e tyre themelore për modifikim dhe frymëzim bazohet në faktin se bëhet fjalë për kompozitorë të arsimuar profesionalë, si: Vinçenc Gjini (1935- ), Mark Kaçinari (1935-1985), Fahri Beqiri (1936- ), Esat Rizvanolli (1936-2006), Akil Koci (1936- ), Halit Kasapolli (1937-1959) etj., të cilët kishin një vizion të qartë për trendet muzikore evropiane, pavarësisht nevojës së afirmimit të identitetit muzikor kombëtar.

Periudha e tretë filloi nga viti 1966 dhe zgjati deri më 1975. Situata kulturo-politike mbeti e njëjtë gjatë kësaj periudhe. Kosova

---

<sup>14</sup> Shoqëri Kulturore Artistike.

ishte akoma pjesë e Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë dhe institucionet e shoqatave profesionale në Serbi si qendër Jugosllave vazhduan të përdoren nga muzikantë shqiptarë të Kosovës, të cilët deri në vitin 1975 nuk kishin mundësinë për të themeluar Fakultetin e Muzikës. Gjatë kësaj periudhe në Jugosllavi, muzika artistike vazhdoi me tendencat e Evropës Perëndimore dhe duke qenë pjesë e saj po ndodhte e njëjta situatë në lidhje me opuset krijuese të kompozitorëve shqiptarë të Kosovës. Kompozitorët kosovarë filluan të shfaqin interes për trende të ndryshme stilistike, nga romantizmi te muzika eksperimentale dhe këtu mund të përmenden kompozitorë si Zeqirja Ballata (1941- ), Rauf Dhomi (1945-), Rafet Rudi (1949-), Gjon Gjevelekaj (1951- ), Bashkim Shehu (1952- ) etj., por disa prej tyre mbetën tradicionalë sa i përket qasjes në stile të reja muzikore, ndër ta është kompozitori Rauf Dhomi.

Këto periudha të lartpërmendura sollën edhe një periudhë tjetër të zhvillimit të muzikës artistike në Kosovë nga viti 1975 e deri në ditët e sotme të vitit 2020, të cilën unë e titulloj si periudha e brezit të ri të kompozitorëve.

Kjo periudhë përfshin punën e kompozitorëve si Mendi Mengjiqi (1959- ), Baki Jashari (1960- ), Valton Beqiri (1967- ) dhe atyre të rinjve si Kreshnik Aliçkaj (1981-), Donika Rudi (1982-), Dafina Zeqiri (1984-), Drinor Zymberi (1986-) etj., të cilët pasurojnë opusin kombëtar me një spektër të gjerë të formave muzikore solistike, korale, kamertale, simfonike, forma kryesore vokale-instrumentale, deri tek oratorio (oratoriumi i parë në fondin e muzikës artistike në vend, *Homagium Matri Teresiae* (Homazh për Nënë Terezë, 1999) nga kompozitori Mendi Mengjiqi. Prandaj kjo periudhë karakterizohet me zgjerimin e teknikave kompozuese si motiv për përvetësimin e mjedisit brenda muzikës artistike të Evropës Perëndimore. Më tej, në këtë periudhë, një rëndësi e madhe i jepet formimit të orkestrave dhe ansambleve (që nga viti 1969), të cilat vazhdimisht kontribuojnë për kriteret më të larta, për profesionalizëm dhe pasurim të jetës muzikore.

Periudha apo faza e tretë dhe e ajo e re e muzikës artistike në Kosovë karakterizohet me rrethana dramatike shoqërore dhe politike (shpërbërja e Jugosllavisë filloi rreth vitit 1980, për të vazhduar me disa kriza politike deri në 1990), një periudhë në të cilën filloi lufta ndëretnike. Sidoqoftë, pikërisht kjo fazë në fillimet e saj paraqet krijimin e fakultetit të parë të artit muzikor (1975) si institucioni kryesor dhe më i rëndësishmi deri në ditët e sotme dhe më tej

vendosja e orkestrave dhe koreve profesionale. Më vonë ana e errët e kësaj periudhe ndikoi edhe në zhvillimin kulturor. Midis viteve 1990 dhe 2000 jeta kulturore në Kosovë ishte viktimë e heshtjes së dhunshme të imponuar nga regjimi i Millosheviqit, i cili regjim ndaloi arsimin e shqiptarëve në Kosovë, por shqiptarët (si përgjigje) u organizuan dhe përdorën shtëpitë private si shkolla të asaj kohe. Punonjësit shqiptarë ishin dëbuar nga çdo institucion, publik dhe privat.

Aktiviteti i orkestrave profesionale, korit dhe çdo shoqate apo institucioni muzikor në Kosovë ishte ndalur. Kjo paraqet një nga kohët më të rënda dhe të vështira, por një nga më të frytshmit për kompozitorët e muzikës artistike, disa prej të cilëve u larguan nga Kosova gjatë kësaj kohe si: Vinçenc Gjini dhe Bashkim Shehu në Kroaci, Gjon Gjovelekaj në Francë, të cilët nuk u kthyen më kurrë. Disa nga kompozitorët e tjerë, të cilët u larguan nga Kosova gjatë periudhës së lartpërmendur, janë Zeqirja Ballata dhe Baki Jashari, që shkuan në Slloveni, por pas përfundimit të luftës në Kosovë (1999) u kthyen të vazhdojnë të japin kontributin e tyre në fushën e pedagogjisë dhe kompozimit. Puna dhe kompozimet e tyre, megjithatë, janë mënyra më e mirë për të treguar rrethanat nëpër të cilat po kalonin njerëzit e Kosovës.

Pas vitit 2000 jeta kulturore filloi ringjalljen e saj dhe sot përveç rrethanave të vështira politike dhe sociale si një vend i pasluftës, zhvillimi i saj vazhdon. Këto faza paraqesin aktivitetet kryesore të muzikës artistike në Kosovë. Disa u regjistruan dhe u diskutuan nga muzikologu Engjëll Berisha dhe disa u hulumtuan dhe u përpunuan nga unë – fazë kjo që përfshinë të gjithë komponentët, nga veprimtaritë e para muzikore dhe rrethanat e asaj periudhe, por edhe ato që vijnë së bashku me një gjeneratë të re të kompozitorëve shqiptarë të Kosovës si faktor kryesor për zhvillimin e mëtutjeshëm të saj.

## KOMPOZITORËT E MUZIKËS ARTISTIKE NË KOSOVË - NDARJA HISTORIKE

Siç është përmendur tashmë, fundi i Luftës së Dytë Botërore dëshmoi instaurimin e regjimit komunist në Jugosllavi dhe imponimin e realizmit socialist në muzikë. Megjithëse kjo periudhë zgjati vetëm disa vjet, ndikimi i dëmeve të shkaktuara zgjati shumë më tepër.



Krijimi i institucioneve të para të muzikës artistike (shkolla e muzikës në Prizren në 1948) gjithashtu mundësoi zhvillimin gradual të muzikantëve profesionistë, shumica e të cilëve për shkak të mosekzistencës së një institucioni të tillë në Kosovë do të ishin të detyruar të vazhdojnë studimet e mëvonshme muzikore në qytete të tjera të ish-Jugosllavisë si në Beograd, Zagreb dhe Sarajevë, ku Beogradi ishte më i madhi (nën fuqinë e të cilit ishin të gjitha shtetet e tjera jugosllave).

Duke u kthyer në qytetin e tyre të lindjes nga qytetet e lartpërmendura ish-jugosllave, kompozitorë si: Esat Rizvanolli, Rafet Rudi, Zeqirja Ballata, Rauf Dhomi, Mendi Mengjiqi sollën dhe praktikuan rregulla harmonike dhe polifonike, forma vokale, instrumentale dhe vokale-instrumentale, zhanret dhe strukturat, mjetet e shprehjes karakteristike për vendet ku ata morën arsimin e tyre. Sidoqoftë, shumica vendosën që puna e tyre në një masë të madhe të bazohej në elemente të folklorit muzikor shqiptar.

Me hapjen e institucioneve të arsimit të lartë u shfaq nevoja edhe për prodhimin muzikor. Opusi profesional kompozicional pa institucione të tilla nuk do të ekzistonte. Në Kosovë filloi gradualisht jeta koncertale e muzikës artistike, e konsideruar si një shtysë tjetër e madhe për zgjerimin e opusit kompozicional të kompozitorëve shqiptarë të Kosovës. Të gjitha këto rrethana kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në muzikën e kompozitorëve, por pas disa vitesh aktiviteti ajo u rrëzua plotësisht në periudhën 1990-1999, ku qeveria serbe me regjimin e asaj kohe ndaloi dhunshëm procesin arsimor për shqiptarët e Kosovës dhe jeta kulturore padyshim që do të shkonte në heshtjen e saj totale.

Kompozitorët e kësaj periudhe ishin vetëm në rolin e pedagogëve të muzikës në shkollat e njohura si "shkollat shtëpi". Ata vazhduan krijimtarinë e tyre kompozicionale në fshehtësi, e cila do të prezantohej vetëm pas vitit 1999. Kompozitorët që u larguan nga Kosova si: Vinçenc Gjini, Zeqirja Ballata, Gjon Gjovelekaj, Bashkim Shehu e Baki Jashari vazhduan prezantimin e punës së tyre në vendet ku ata zgjodhën të jetojnë. Kompozitorët dhe krijimtaria e tyre është një pasqyrim i jashtëzakonshëm i jetës së shoqërisë shqiptare në këtë kohë, një opus që nuk u lejua të kapërcejë ideologjinë e realizmit socialist, duke hequr dorë për kohë të gjatë nga rrymat bashkëkohore, avangarde, moderniste.

Si rezultat i hapjes së departamentit të muzikës artistike në kuadër të Shkollës së Lartë Pedagogjike në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë, në vitin 1963, së bashku me veprimtarinë pedagogjike të muzikantëve me reputacion mund të identifikojmë kompozitorë të ndryshëm. Aktualisht (2020) numri i kompozitorëve është shumë (në lidhje me Kosovën), por relativisht pak prej tyre (përveç nëse janë angazhuar në prodhimin e muzikës ‘popullore’) janë në gjendje të fitojnë dhe të jetësojnë nga puna e tyre, thjesht nga kompozicioni. Shumë prej tyre janë të angazhuar në mësimdhënie ose në ndonjë formë të administrimit muzikor dhe kompozimit i kushtojnë kohë dhe energji të mbetur.

Ndërsa ishte aktive që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore (1945) kur u mendua se u krijuan kushte përkatëse për kultivimin dhe zhvillimin e muzikës artistike në Kosovë, ajo deri në fillimin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë (1992) vazhdoi aktivitetin e saj në këtë fushë. Pas kësaj periudhe (pas vitit 1992) vështirë se dikush ka dëgjuar për kompozitorë të Kosovës në skenën ndërkombëtare dhe për kompozimet e tyre. Që nga fillet e muzikës artistike në Kosovë e deri në ditët e sotme, mund të theksoj se ishin rreth 20 kompozitorë që kanë kompozuar dhe që vazhdojnë veprimtarinë e tyre. Sidoqoftë, vlen të përmendet se opusi i këtyre kompozitorëve përmban vepra nga format më të vogla e të thjeshta muzikore e deri tek ato orkestrale e vokalo-instrumentale, si kantata dhe opera. Si rezultat i analizës sime, kam konstatuar se harku stilistik në kuadër të opusit të tyre shkon nga stili muzikor kombëtar, te romantizmi - romantizmi nacional, neoromantizmi dhe neoklasicismi e deri te lëvizjet stilistike avangarde të shekullit të 20-të. E ndodhur në një sfond të ndërlikuar shoqëror dhe politik, për të nxjerrë në pah rrethanat sociale dhe ekonomike në të cilat ata jetuan dhe krijuan dhe mungesa e informacionit, e arkivit dhe dokumentacionit tjetër përkatës në lidhje me muzikën artistike të shqiptarëve të Kosovës, më bëri që të filloj me konstruimin e saj nga eksperiencat e mëparshme. Për të arritur qëllimin tim, unë kam përdorur fillimisht mënyrën e biografive, koncepti i së cilës ishte dhe mbetet diskutabil edhe në ditët e sotme në të gjithë botën.

Megjithatë, në shekullin e 20-të, kur muzika artistike në Kosovë e kishte fillimin e saj, shumë kompozitorë të njohur botërorë po përpiqeshin të gjenin teknika të reja kompozicionale ose të ktheheshin përsëri në forma që rridhnin nga shekulli 19-të. Pikërisht fundi i shekullit të 19-të dhe i shekullit të 20-të karakterizohen për pluralizëm stilistik. Sergei Rachmaninoff (1873-1943) dhe Edward Elgar (1857-

1934) janë kompozitorët që vazhduan të zhvillojnë gjuhën muzikore të shekullit 19-të. Modernizmi në muzikë u bë gjithnjë e më i spikatur dhe i rëndësishëm dhe ndër të parët modernistë mund të përmendim Bela Bartók-un (1881-1945), Igor Stravinsky-n (1882-1971) dhe Charles Ives-in (1874-1954). Arnold Schoenberg (1874-1951) dhe kompozitorë të tjerë si Alban Berg (1885-1935) dhe Anton von Webern (1883-1945), që e bartin këtë prirje në formën e tyre më ekstreme duke braktisur tonalitetin së bashku me konceptimin tradicional të melodisë dhe harmonisë. Impressionistët, përfshirë Claude Debussy-in (1862-1918) dhe Maurice Ravel-in (1875-1937), kërkuan tekste të reja dhe i kthyen shpinën formave tradicionale, ndërsa shpesh ruanin edhe parimet tradicionale harmonike. Të tjerë si Francis Poulenc (1899-1963) dhe grupi i kompozitorëve të njohur si Les Six shkroi muzikë në kundërshtim me idetë impresioniste dhe romantike të kohës. Kompozitorë të tillë si Darius Milhaud (1892-1974) dhe George Gershwin (1898-1937) kombinuan idiomat klasike dhe të xhazit. Të tjerë, si Dmitri Shostakovich (1906-1975), Sergei Prokofiev (1891-1953), Paul Hindemith (1895-1963), Pierre Boulez (1925-2016), dhe Heitor Villa-Lobos (1887-1959) zgjeruan paletën klasike për të përfshirë më shumë elementë disonantë pa kaluar në ekstremet e kompozitorëve të dymbëdhjetëtingullshit dhe serializmit.<sup>15</sup>

Të gjitha këto zhvillime kishin ndikimin e tyre në muzikën artistike në Kosovë, konkretisht te kompozitorët përmes opusit të tyre kompozicional, duke u dhënë vizione të reja, duke zgjeruar njohuri për stilet e muzikës artistike të kohës dhe në të njëjtën kohë duke u dhënë atyre mundësinë që të jenë sa më afër botës. Shumica e kompozitorëve u njohën me muzikën artistike perëndimore gjatë studimeve në ish-Jugosllavi, si pjesë e kurrikulës së tyre arsimore.

Zhvillimin e muzikës artistike në Kosovë (deri në ditët e sotme, viti 2020) e kam ndarë në katër gjenerata, dhe si të tillë e kam ndarë edhe shkollën kompozicionale në Kosovë, vazhdimisht në lidhje me periudhën kohore që ata jetuan dhe kompozuan. Për më tepër udhëzimet stilistike merren si një element përcaktues, edhe pse ka pasur dhe ka dallime të dukshme, të cilat do të pasqyrohen te kompozitorët e përmendur më poshtë.

<sup>15</sup> Grup editorësh, "Twentieth Century Music", *New World Encyclopaedia*, 2008, [http://www.newworldencyclopedia.org/entry/Twentieth-century\\_music](http://www.newworldencyclopedia.org/entry/Twentieth-century_music). qasur për herë të fundit, (Mars 12. 2020).

**Gjenerata e parë** e kompozitorëve të muzikës artistike në Kosovë përfaqësohet nga Lorenc Antoni dhe Rexho Mullaj. Këta kompozitorë jetuan dhe kompozuan në kohën e ish-Jugosllavisë (si dhe gjenerata e dytë dhe e tretë dhe pjesa e kompozitorëve nga gjenerata e katërt), kur Kosova u njoh si krahinë autonome socialiste në kuadër të Jugosllavisë (1946-1990). Kjo ishte periudha e kohës kur artet filluan kultivimin e tyre, si dhe periudhë kur u krijuan institucionet profesionale muzikore në pjesë të ndryshme të Jugosllavisë. Sidoqoftë, situata e tillë nuk vazhdoi në Kosovë deri në vitin 1970. Ishte pikërisht viti 1975 kur u krijua Fakulteti i Artit Muzikor dhe veprimtaria e tij ishte e ndaluar në vitin 1991. Kjo do të reflektohej sidomos për gjeneratën e parë dhe të dytë të kompozitorëve shqiptarë në Kosovë.

Lorenc Antoni dhe Rexho Mullaj njihen si pionierët e muzikës artistike në Kosovë jo vetëm nga fakti që ata kanë krijuar bazat moderne të kompozimit, por edhe për mbartjen e përvojave nga puna me grupe amatore në fushën e muzikës. Kjo tregon se opusi kompozicional i kompozitorëve të lartpërmendur karakterizohet nga një shprehje tradicionale muzikore, e marrë nga folklori muzikor shqiptar, e identifikuar në opusin e tyre krijues përmes elementeve melodike dhe ritmike. Në këtë periudhë fokusi kryesor i kompozitorëve Antoni dhe Mullaj ishte në kompozimet korale, veçanërisht opusi i Antonit përmban më shumë kompozime korale nga të gjithë kompozitorët e tjerë. Lorenc Antoni kompozoi veprën e parë të muzikës artistike në Kosovës, ishte kjo një këngë me titull "Në breg të Liqenit" kushtuar Nënës Terezë (e cila me motrën e saj Age Bojaxhu interpretuan këtë këngë) premierë në 1928 në Shkup (Maqedoni) (SHKA "Zani i Maleve"). Kompozimet korale janë format e para muzikore të kompozuara në kuadrin e muzikës artistike në Kosovë. Teknika kompozicionale e kompozitorëve u imponua nga koret të cilët ishin amatorë si pjesë e shoqërive kulturore artistike të kohës. Për më tepër, Mullaj i njohur si përkrahës i romantizmit në fazat e mëvonshme, përveç kompozimeve korale, i kushtoi vëmendje edhe kompozimeve orkestrale dhe kështu kompozoi simfoninë e parë në Kosovë në vitin 1972.<sup>16</sup> Siç u cilësua më lart, në kohën kur jetuan këta dy kompozitorë dhe filluan veprimtarinë e tyre muzikore, Kosova ende nuk kishte institucione arsimore muzikore, si dhe institucione të tjera profesionale. Këta dy kompozitorë ishin të kufizuar që brenda

<sup>16</sup> Sokol Shupo, *Biographical Dictionary of Albanian Composers*, ASMUS, Tiranë f. 242.

atyre rrethanave të vështira shoqërore dhe ideologjike të zhvillonin mësimet e para të muzikës vetëm në fëmijëri, si autodidakte dhe më vonë të ndiqnin mësimet private.

Kjo situatë pa dyshim që do të ndikonte drejtpërdrejt në krijimtarinë e tyre, e cila mbeti pa përpunime të rëndësishme tekniko-kompozicionale (veçanërisht kur i referohemi Lorenc Antonit). Për më tepër, ndikimi i situatës politike në atë kohë duhet të përmendet kur Mullaj, si rezultat i krijimit të tij u burgos si student me direktiva të qeverisë së atëhershme të Jugosllavisë. Kjo bëri që ai t'i linte studimet që i kishte filluar në Beograd (Serbi). Kjo tregoi se ndryshimi mes dy kompozitorëve është i dukshëm edhe nga rrethanat e jetës nëpër të cilat ata kaluan e jetuan dhe ne do t'i shohim këto rrethana si një ndikim domethënës në edukimin profesional, duke e ditur që Lorenc Antoni nuk ishte në një situatë aq të vështirë siç ishte Rexho Mullaj.

Ndërsa gjenerata e parë e kompozitorëve përfaqësohej nga dy kompozitorët: Lorenc Antoni dhe Rexho Mullaj, *gjenerata e dytë* na siguroi një numër më të madh kompozitorësh që përfaqësonin këtë periudhë - kompozitorë që jetuan dhe kompozuan në kushte më të mira krahasuar me gjeneratën e parë, sepse ata patën mundësinë të shkolloheshin brenda dhe jashtë vendit tonë (në qytetet kryesore të ish-Jugosllavisë si Beogradi, Zagrebi, Sarajeva etj.) për shkak të ndryshimeve shoqërore.<sup>17</sup> Duhet të merren në konsideratë që tani se shkollat e mesme të muzikës (nga viti 1949) ekzistonin për ta, gjë që ishte një lehtësim i madh për talentët e rinj, të cilët një ditë do të bëhen përfaqësuesit e muzikës artistike në Kosovë.

Kompozitorët e kësaj gjenerate jetuan dhe kompozuan pothuajse në të njëjtën periudhë kohore, por ne nuk mund të gjejmë shumëçka të përbashkëta midis tyre nëse analizojmë opusin e tyre ose krahasojmë aktivitetet e tyre muzikore. Pasi të kemi një përmbledhje dhe analizë të përgjithshme të opuseve kompozicionale me siguri do të konkludojmë se ideja themelore e kompozitorëve të kësaj gjenerate ishte transformimi artistik i karakteristikave të muzikës folklorike. Jo shumë u shkrua ose u botua për kompozitorët e gjeneratës së dytë dhe kompozimet e tyre, nëse krahasohen me ato të gjeneratës së parë. Aktiviteti i tyre muzikor dhe opusi krijues u zhvilluan gjatë kohëve më të vështira sociale dhe politike të Kosovës, ku dhuna dhe spastrimi etnik po merrnin përmasa të mëdha.

<sup>17</sup> Berisha, *Studime dhe vështrime për muzikën*, f. 48.

Kriteri i ndarjes bazuar në orientimet stilistike dhe parimet ideoestetike do të shihet saktësisht në këtë brez të kompozitorëve, duke marrë parasysh që ka dallime të rëndësishme stilistike midis këtyre kompozitorëve. Siç u përmend më lart, baza e përbashkët e orientimit ideoestetik veçanërisht në fazën e parë të krijimtarisë së tyre është shndërrimi artistik i elementeve popullore dhe tradicionale kombëtare, zbulimi i anës psikologjike dhe gjetja e harmonive të fshehura, duke përfshirë pasurimin me ton modern. Prandaj prapambetja e dukshme që karakterizon muzikën tonë në fillimin e jetës së saj gradualisht hiqet. E rëndësishme për t'u përmendur në lidhje me këtë gjeneratë është se ata na sollën vepra të ndryshme, duke filluar nga ato korale nga invencioni origjinal, si poema simfonike *Skënderbeu* (1968) nga Fahri Beqiri, kantata *Fjala e Skënderbeut* (1968) nga Esat Rizvanolli dhe baleti i parë nga Akil Koci *Sokoli dhe Mirusha* (1976).<sup>18</sup> Veçantia e kësaj gjenerate është se ato mund të kenë shumë ngjashmëri dhe shumë dallime në të njëjtën kohë, çka në fund të fundit e pasuroi muzikën artistike me stile të ndryshme muzikore evropiane që sollën. Në opusin e kompozitorëve të përmendur, motivi nga folklori muzikor me citime të shpeshta do të mbetet i pranishëm sidomos për kompozimet e Halit Kasapolli e Mark Kaçinari, ndërsa kompozimet e Fahri Beqirit dhe Esat Rizvanolli kanë më pak citime, por janë të pranishme në elementet meloritmike të muzikës sonë popullore. Ngjashmëritë, gjegjësisht citimet e muzikës popullore vërehen në kompozimet e Vinçenc Gjinit, ndërsa Akil Koci në fazën e dytë të krijimtarisë së tij shpërndahet nga këto parime dhe shkon drejt orientimeve avangarde dhe stilistike të muzikës së shekullit të 20-të, siç është serializmi, muzika aleatorike, atoniteti me forma të qarta dhe larg nga parimet e estetikës tradicionale, komponon më shumë një muzikë intelektuale.<sup>19</sup> Niveli i ekuilibruar midis përmbajtjes dhe formës mund të vërehet kur analizohen kompozimet e Fahri Beqirit, Esat Rizvanollit dhe Vinçenc Gjinit. Kjo gjeneratë e kompozitorëve karakterizohet nga një përparim i rëndësishëm i teknikës së kompozimit, zhvillimit stilistik nga kombëtarja drejt avangardës së shekullit të 20-të. Stili i kompozimit të këtyre kompozitorëve është më afër romanantizmit dhe neoklasicismit të vonë e deri tek atmosferat ekspresioniste.

Gjurmët e lartpërmendura të fundit të shekullit të 19-të dhe të artit perëndimor të shekullit XX janë më së miri të dukshme në

<sup>18</sup> Ibid., f. 46.

<sup>19</sup> Ibid., f.46

kompozimet e kompozitorëve shqiptarë të Kosovës si përfaqësues të **gjeneratës së tretë**, pjesë të së cilës janë kompozitorët Zeqirja Ballata, Rauf Dhomi, Rafet Rudi.<sup>20</sup> Kur them gjurmë, i referohem ndikimit të muzikës artistike përëndimore ose më saktë thënë, romantizmit nacional të shekullit të 19-të dhe muzikës atonale të shekullit të 20-të janë qasja e disa kompozitorëve të kësaj gjenerate (jo të gjithë atyre) veçanërisht në fazën e dytë e krijimtarisë së tyre ku shfaqin tendenca drejt avangardës, modernes që në shekullin 20-të. Kompozitorët shqiptarë në Kosovë që filluan krijimet e tyre në fund të shekullit të 20-të ndahen si pjesë e gjeneratës së tretë të kompozitorëve që përfunduan arsimin e tyre edhe në vendet e rajonit në Shkup (Maqedoni), Sarajevë (Bosnje e Hercegovinë) dhe në Universitetin e Beogradit (Serbisë), për shkak të mungesës së një institucioni të tillë në Kosovë deri në vitin 1963.<sup>21</sup> Kompozitorët e lartpërmendur, edhe pse i përkasin të njëjtës gjeneratë, paraqesin dallim stilistik, i cili është i natyrshëm për shkak të pluralizmit ekzistues të stileve në atë periudhë. Kompozitorët ishin gjithashtu të lirë të ktheheshin në stilet paraprake ose qasjen në rryma të reja stilistike që qarkullonin në atë kohë në Evropë. Kjo gjeneratë pasuron fondin e muzikës artistike në Kosovë me formën më komplekse vokalo-instrumentale skenike, me operën (*Goca e Kaçanikut* kompozuar nga Rauf Dhomi, opera e parë nacionale në Kosovë, 1971/72).

Ne mund të vërejmë në kompozimet e kësaj gjenerate një trajtim modern të elementëve përbërës së veprave të tyre, duke filluar nga harmonia, serializmi dhe polifonia. Duke marrë parasysh që stilet ekzistuese, siç janë modernizmi, muzika mikrotonale, neoklasicismi, muzika eksperimentale, minimalizmi, etj., të cilët gjetën shpërndarjen e tyre në muzikën artistike të shekullit të 20-të në Evropë, mezi u pranuan në Kosovë, për shkak të vonësës së shfaqjes së këtij zhanri në vend, duket se kompozitorët e kësaj gjenerate ishin të përgatitur që veprat e tyre do të pranoheshin gradualisht ose nuk do të pranoheshin kurrë. Kjo tregoi se edhe sot nuk kemi një audiencë që do të perceptonte me lehtësi stilin modern të muzikës, sepse ende jemi në ndjekje të përqaftimit të muzikës artistike që vazhdon të ketë një jetë të vështirë këtu.

Si rezultat, vlen të theksohet se kompozitorët si Zeqirja Ballata dhe Rafet Rudi në fazat e tyre të para të krijimtarisë ishin më tradicionalë dhe kjo është e dokumentuar në mënyrë perfekte përmes

<sup>20</sup> Ibid., f. 46.

<sup>21</sup> Berisha, *Zhvillimi i stileve në veprat e kompozitorëve shqiptarë*, f. 68.

analizave të kompozimeve që këta kompozitorë lënë pas (p. sh. veprat korale të Rafet Rudit *Dy kuantë, Një kokë, një tokë* etj., Zeqirja Ballata *Passacaglia për orkestër harqesh*).<sup>22</sup> Ata vazhdimisht kërkonin dhe synonin inkuadrimin e tyre drejt muzikës artistike moderne - avangarde, e cila mund të dëshmohej në fazën e tyre të dytë të krijimitarisë. Nga ana tjetër, një kompozitor i së njëjtës periudhë, Rauf Dhomi demonstroi të kundërtën nga kompozitorët e sipërpërmendur, duke ia kushtuar tërë krijimtarinë e tij stilit nacional, përkatësisht romantizmit të vonë nacional të shprehur te popujt që u çliruan më vonë - në këtë rast popullit shqiptar të Kosovës.

**Gjenerata e katërt.** - Brezi i ri i kompozitorëve përbëhet nga Mendi Mengjiqi, Baki Jashari, Valton Beqiri, i ndjekur nga kompozitorët e rinj si: Kreshnik Aliçkaj, Donika Rudi, Dafina Zeqiri, Drinor Zymberaj etj. Duke qenë të rinj, ata vazhdojnë të shtjellojnë stile të ndryshme muzikore duke kërkuar stilin e tyre origjinal të kompozimit. Dallimin në këtë gjeneratë e bëjnë Mengjiqi, Beqiri dhe Jashari, të cilët stilistikisht janë më afër stileve të Evropës Perëndimore të kësaj kohe.

Mendi Mengjiqi filloi studimet për kompozim në Kosovë dhe i mbaroi në Poloni. Edhe sot opusi i tij krijues ndikohet nga shkolla e re polake e kompozitorëve. Baki Jashari, i cili njihet më së shumti si dirigjent në Kosovë, ka studiuar për kompozim në Slloveni dhe së bashku me Valton Beqiri, i cili është diplomuar në kompozim në Kosovë, stilistikisht i përkasin impresionizmit dhe ekspresionizmit me një rëndësi të madhe kushtuar motiveve të muzikës popullore shqiptare, duke e integruar atë në opusin e tyre profesional. Sa i përket kompozitorëve të rinj, ata morën mësim nga brezi i ri i kompozitorëve shqiptarë si Mendi Mengjiqi. Ata u diplomuan në kompozim në Fakultetin e Artit Muzikor në Prishtinë (Kosovë), department i hapur me insistimin e kompozitorit Mendi Mengjiqi (viti 2000). Tek kompozitorët si Dafina Zeqiri, Kreshnik Aliçkaj dhe Drinor Zymberi lehtë dallohet ndikimi i stilit të kompozimit të Mengjiqit dhe ky ndikim është i dukshëm edhe sot. Donika Rudi filloi studimet për kompozim në Kosovë dhe vazhdoi studimet për muzikë akuzmatike në Belgjikë.

Kompozitorët e gjeneratës së katërt, sot qëndrojnë paralelisht me stilet e muzikës botërore, duke ngritur nivelin e muzikës artistike në vendin tonë për një imazh të qartë për evropianët dhe më gjerë, dhe

<sup>22</sup> Berisha, *Studime dhe vështrime për muzikën*, f. 48.



kjo mund të dëshmohej vetëm përmes punës së tyre kompozicionale. Opusi i tyre krijues erdhi si një nevojë e madhe për zhvillimin e mëtutjeshëm të muzikës artistike në Kosovë, dhe siç thekson kompozitori anglez Don Robertson (1922-2015), ne kemi nevojë për të zhvilluar një muzikë artistike që do të kontribuojë në evolucionin e njerëzimit, diçka që është përparuar sa duhet që të sigurojë ushqimin emocional për popujt e këtij shekulli të ri.<sup>23</sup> Siç përshkroi ai, në fund të fundit, kjo është ajo që ndodhi në secilin prej pesë shekujve të kaluar.<sup>24</sup>

Kompozitorët e gjeneratës së katërt në Kosovë ishin gjithashtu të ekspozuar ndaj stileve të ndryshme të muzikës artistike, të cilat do të jenë më pranë tyre përmes profesorëve të institucioneve të lartpërmendura, por gjithashtu duke filluar periudhën e tyre studentore e cila u mundësonte përpunimin e stileve të ndryshme të muzikës artistike. Brezi i ri i kompozitorëve jeton dhe kompozon në një Kosovë të pavarur, me lirinë e shprehjes në muzikën e tyre. Stili i tyre kompozicional shkon nga nacionalizmi të romanca, neobaroku dhe neoklasikizmi e neoromantizmi dhe tek ekspresionizmi dhe tek opusi krijues i disa kompozitorëve (Mengjiqi, Jashari, Zeqiri dhe Donika Rudi) vërejmë, pra, lëvizjet drejt avangardës - bashkëkohores, siç është muzika e shekullit XX.

Sidoqoftë, me tërë sfidat e problematikat të cilat e shoqëruan që nga fillet e saj, jeta dhe epoka kompozicionale e autorëve të muzikës artistike në Kosovë vazhdon edhe në ditët e sotme, me ose pa përkrahje institucionale, me një ligj për të drejtat e autorit i cili në të vërtetë ekziston që prej 2011, por që nuk është zbatuar asnjëherë edhe në ditët e sotme për të mbrojtur të drejtat e autorëve.

Megjithëkëtë, me tërë zhvillimin e saj të sipërpërmendur, muzika artistike në Kosovë mbetet shumë larg dhe ne duhet të marrim më tej parasysh afinitetin e kompozitorëve tanë që akoma jetojnë dhe realizojnë veprimtarinë e tyre muzikore (në shumicën e rasteve si pedagogë), duke mbetur pa asnjë motiv për të vazhduar përpara me opusin e tyre krijues.

Muzika artistike në Kosovë filloi me krijimtari korale, këngë të përpunuara dhe më vonë të stilizuara nga folklori muzikor. Megjithatë, shikuar në tërësi, ky kombëtarizëm muzikor, që zgjati gati

<sup>23</sup> Don Robertson, *The Classical Music of Twenty-first Century*, Cumming, Ga: Dovesong International, 2000, f. 15.

<sup>24</sup> Robertson, *The Classical Music of Twenty-first Century*, f. 15.

një shekull, nga mesi i shekullit XIX deri në mesin e shekullit XX prodhoi vepra me vlerë, disa prej të cilave ndër më të mirat të kompozuar në Jugosllavi. Në shumë prej tyre ne e identifikojmë si temën kryesore trajtimin e historisë së popullit shqiptar, trajtimin e figurave tona historike.

Kompozitorët kosovarë vazhdojnë t'i sigurojnë fondacionit të muzikës artistike në vend një numër të konsiderueshëm të formave dhe gjinive të ndryshme muzikore, por me një rënie graduale në numër, duke më bërë kështu më kurioze dhe në këtë mënyrë i shtrova vetes dy pyetje:

- A ishte rënia e numrit të kompozitorëve rezultat i teknikave moderne, të cilat tani kërkohen në të gjithë botën, dhe për kompozitorët tanë kjo është akoma vetëm një temë që gjen qarkullimin në Evropë dhe më gjerë, jo tek të gjithë, kjo mund të dëshmohej me opusin e tyre krijues? dhe

- Përsëri a ishin rrethanat dhe vendi i pafat, i cili për një periudhë të gjatë kohore nuk premtonte një jetë të arsyeshme socioekonomike e lëre më të mendojmë për artin, që rezultuan në uljen e motivimit për kompozitorët për një qasje të tillë, apo edhe për zgjerimin e opusit të tyre muzikor?

Sidoqoftë, kompozitorët shqiptarë me tërë afinitetin e tyre krijues në rrethana tejet të pavolitshme, sot vazhdojnë të jenë ende shumë pak të njohur e të promovuar jashtë vendit. Kjo mund t'i atribuohet shfaqjeve shumë të rralla të muzikës së tyre jashtë vendit, por në veçanti mungesës së një politike e strategjie kulturore në vend edhe sot në vitin 2020.

## PËRFUNDIM

Si njëri nga shtetet më të reja në botë, Kosova vazhdon të mbetet një pikë qendrore e interesit për hulumtime në disiplina të ndryshme për shkak të zhvillimit të saj politik, ekonomik dhe pa dyshim kulturor.

Muzika artistike në Kosovë ekziston dhe prezantohet në katër periudha a gjenerata të kompozitorëve, të dëshmuara dhe të ndara përmes praktikës së rregullave harmonike dhe polifonike, orkestrimit,

formave vokale-instrumentale, zhanreve dhe mjeteve të shprehjes. Një kontribut i madh për një ekzistencë të tillë kanë pa dyshim kompozitorët të cilët, me të gjithë mungesën e institucioneve profesionale e dokumentacionit përkatës i cili më vonë do të shërbente edhe si dëshmi e aspektit të tyre historik, për një kohë të shkurtër arritën të krijojnë një identitet muzikor, por edhe duke dhënë një pasqyrim të denjë të kulturës kosovare jashtë saj.

Këta kompozitorë nuk kishin mbështetje nga stilet e mëparshme muzikore si barok, klasicizëm etj. (të tilla nuk ishin të pranishme dhe nuk u zhvilluan kurrë deri në filltet e saj). Ata - të katër gjeneratat e ndara të kompozitorëve, të mbështetur në elementet e folklorit muzikor shqiptar, gjithmonë duke u bashkëdyzuar me invencionin e tyre origjinal, arritën t'i qaseshin profesionalisht dhe të ishin në kohë me tendencat të muzikës artistike në botë. Nga ky punim dua të dëshmoj se përkundër të gjitha vështirësive, rrethanave politike e historike të cilat e kishin mposhtur Kosovën dhe vazhdojnë të kenë një ndikim të madh edhe sot (2020), muzika artistike e cila u soll dhe u trajtua shumë vonë përmes krijimtarisë së kompozitorëve të saj, ka arritur mjaft të paktën duke kapërcyer periudhën e errët që e kishte marrë me shekuj. Sot shpesh në kushte jo të favorshme ajo gjen aplikimin dhe zhvillim e saj me interes të lartë. Zhvillimi i saj edhe sot mundësohet nga vullneti i faktorëve kyç, të cilëve i është dedikuar edhe ky punim. Pa ndonjë përfitim financiar përkatës e shpeshherë as përfitim moral, ata vazhduan ta kultivojnë e prezanojnë muzikën artistike.

Askush nuk mund të mbijetojë si një krijues i lirë në Kosovë. Kompozitorët janë të detyruar të kenë një punë të dytë (në disa raste edhe jashtë profesionit të tyre) në mënyrë që të bëjnë një jetë normale. Artistë të pamotivuar, të angazhuar mund të vërehen lehtësisht në mesin e komunitetit artistik. Në kushte normale njeriu fillon të zgjedhë një profesion fillimisht për shkak të talentit dhe dashurisë për të, vendos ta ndjekë atë dhe potencialisht nga ai siguron edhe jetesën. E njëjta gjë nuk ndodh me muzikën artistike në Kosovë.

Sot kompozitorët e muzikës artistike janë në një pozitë shumë të vështirë brenda komunitetit artistik. Këto probleme pa dyshim që kanë dobësuar koncertimin, krijimtarinë, praninë në skenë. Për më tepër, për shumë vite tani (Kosova, si një shtet në tranzicion) muzika komerciale ka zënë rolin e saj kryesor.

Nëse në një të ardhme të afërt krijohen kushtet për zhvillimin e artit muzikor (siç është infrastruktura e duhur e institucioneve

arsimore muzikore, sallat e koncerteve etj., si dhe mbështetja financiare nga institucionet përkatëse të përmendura më lart, unë jam e sigurt se do të hapej një mënyrë e re e zhvillimit të mëtutjshëm të saj. Vetëm kështu kompozitorët do të vazhdojnë udhëtimin e tyre, duke pasur mundësi më të mëdha drejt arritjes, ofrimit dhe afirmimit të një arti të zhvilluar plotësisht.

Rreze Kryeziu-Breznica, Prishtinë

## ARTISTIC MUSIC COMPOSERS IN KOSOVA - HISTORICAL DIVISION ACCORDING TO KOSOVA MUSICOLOGY

### Abstract

Art Music, if understood in the sense of foundation of professional institutions in Kosovo such as composing school, started to develop by the middle of the 20th century, i.e. still during the Yugoslav period. Precisely, the population of Albanian ethnos in Kosovo was to share its fate with other people of the then Yugoslav State after World War II, from 1945. As an integral part of this development, new economic, political, social and cultural circumstances arose for professional development of Art Music as a significant segment of cultural life during this period. Prior to this period, there were no professional music institutions, no artists, composers, instrumentalists or educated singers in Kosovo. The compositional oeuvre of Albanian composers can surely shed light to the above-mentioned. And this comes as a result of the program of their compositions, which besides the melodic support deriving from Albanian folk music, they have been strongly supported in the great historical events of the country, which we are witnessing today through their music

This article, strives to help identifying the characteristics which led to the so known historical division of composers and also identify the specific problems which initially affected the delayed appearance of such tradition in Kosovo. Despite all difficulties, political-historical circumstances which had overwhelmed Kosovo and continue having a huge impact even today (2017-18), Art Music (brought and dealt with very late), has managed to achieve a lot. At least it overcame the dark period and unfavourable conditions that had received it over for centuries. All this was made possible through composers and their compositional oeuvre.

*Keywords:* Art Music, Albanians, Kosovo, Composers, Institutions, Historical division.

## BIBLIOGRAFIA:

- [1] Andreis, Josip and Cvetko, Dragotin/Đurić-Klajn. (1982). *Historijski razvoj muzičke kulture u Jugoslaviji*, Zagreb, “Školska knjiga”.
- [2] Andreis, Josip (1976). *Povijest glazbe*, Zagreb, “Liber mladost”.
- [3] Antoni, Lorenc (1956), *Folklori muzikor shqiptar*. Prishtinë, “Miladin Popoviq”.
- [4] Arllati, Behar (2014), *Tradita muzikore në Gjakovë*, Prishtinë, “URA”.
- [5] Berisha, Engjëll dhe Kolë Shiroka (2004), *Monografia e SHKA “Agimi”*. Prizren, “Vertigo”.
- [6] Berisha, Engjëll (1998), *Kultura muzikore*, Prishtinë, “Libri shkollor”.
- [7] Berisha, Engjëll (2004), *Studime dhe vështrime për muzikën*, Prishtinë, Academy of Science and Arts of Kosova.
- [8] Berisha, Engjëll (1997). *Zhvillimi i stileve në veprat e kompozitorëve shqiptarë*. Prishtinë, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës.
- [9] Bethlehem, Daniel, Weller, Marc. (1997). *The Yugoslav Crises in International Law*. Cambridge: Cambridge University Press.
- [10] Burrows, John (2005.), *Classical Music*. London - Great Britan, China by Leo.
- [11] Dalhaus, Carl. (1989), *Nineteenth-Century Music*, Berkeley, Los Angeles, London, University of California Press.
- [12] Malcolm, Noel (2011), *Kosova një histori e shkurtër*. Prishtinë, “KOHA”.
- [13] Markovic, Tatjana (2013), *Builing Cultural Memory in South Eastern Europe at the Eve of Modernety*, Vienna, TheMA: Open Access Research Journal for Theatre, Music, Arts II/1-2 Pg. 1-4.
- [14] Munishi, Rexhep (2001), *Identiteti muzikor*, Prishtinë, Shtypshkronja GME.
- [15] Robertson, Don, *The classical music of twenty-first century*. Cumming, GA. Dovesong International, 2000.
- [16] Shupo, Sokol (2005), *Biographical Dictionary of Balkan Composers*, Tiranë, “ASMUS”.

## BURIME NGA INTERNETI:

- [1] Allcock, John B. (2012). "Kosovo, self-declared independent country". *Encyclopaedia Britannica*. Retrived from <https://www.briannica/place/Kosovo>. (accessed September 20, 2018).
- [2] Allcock, John B. and John R. Lampe. (2012). "Yugoslavia": FORMER FEDERATED NATION [1929–2003]. *Encyclopaedia Britannica*. Retrived from <https://www.britannica.com/place/Yugoslavia-former-federated-nation-1929-2003>. (accessed August 02, 2018).
- [3] Botstein, Leon. (2001). "Modernism - The Late 20th Century". *Oxford Index*. Retrived from <http://oxfordindex.oup.com/view/10.1093/gmo/9781561592630.article.40625>. (accessed September 16, 2018)
- [5] Central Intelligence Agency, "Kosovo", *Central Intelligence Agency Web*, 2013, Retrived from <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>. (accessed August 06, 2018).



Hivzi Islami, Prishtinë

## DËSHMI (MEMORIE)

### “FRONTI I JUGUT” - RRËFIM PAS TRI DEKADAVE

Më 19-20 janar 1991 u mbushën gati tri dekada nga takimi i partive politike shqiptare në ish-Jugosllavi, të mbajtur në Stubice Toplice, një vend balneoturistik afër Zagrebit. E posedoj bllokun me shënime që i kisha mbajtur në atë takim në bazë të të cilit mund të rrëfej për ngjarjen, por disa çështje edhe i mbaj në mend mirë. Shënimet në bllok ishin si një lloj procesverbali për nevojat e mia, ndërkaq tezat për diskutim për synimet e lëvizjes shqiptare, strategjinë e veprimit dhe format e organizimit të përbashkët të subjekteve politike shqiptare në ish-Jugosllavi janë në qarkullim, meqenëse u janë shpërndarë pjesëmarrësve të takimit.

Ishte folur një kohë relativisht të gjatë në Kosovë se po kërkohej të mbahej një takim i përbashkët i përfaqësuesve të të gjitha partive politike shqiptare të Kosovës, të Maqedonisë, të Luginës së Preshevës dhe të Malit të Zi. Kërkohej që takimi të mbahej në Zagreb dhe atë do ta organizonte Tomë Berisha, kryetar i Lidhjes Demokratike të Shqiptarëve në Kroaci. Flitej se ishin ftuar disa veta nga LDK-ja, Veton Surroi nga Partia Parlamentare, Luljeta Pula nga Partia Socialdemokrate, Lazër Krasniqi nga Partia Demokristiane, Hivzi Islami nga Partia Fshatare, Burhan Kavaja dhe Hajrullah Gorani nga sindikatat, pastaj individët Adem Demaçi, Mark Krasniqi, Rexhep Qosja, Iljaz Kurteshi, Mahmut Bakalli, Shkëlzen Maliqi, ndoshta edhe ndonjë tjetër. Në Prishtinë kishte hezitime për atë takim nga I. Rugova e të tjerë, por kishte edhe të tillë që e kërkonin me ngulm takimin. Këta që ishin pro, në fakt ishin pjesë e frontit kundër Rugovës (Demaçi, Qosja, Maliqi, Surroi, Bakalli, Kavaja, L. Krasniqi, L. Pula dhe ndonjë tjetër).

Pa LDK-në dhe Ibrahim Rugovën nuk mund të mbahej takimi. Pasi Rugova dhe LDK-ja e pranuan kërkesën për të shkuar, u caktua edhe data e mbajtjes së takimit; me sa më kujtohet Rugova erdhi në takim nga Evropa. Dy ditë para mbajtjes së mbledhjes Ali Aliu,



Mehmet Kraja dhe unë u nisëm me një veturë të marrë me qira nga kompania “Kompas” e Lubjanës. Shkuam më herët, sepse Kraja donte ta regjistronte revistën “Ora” të LDK-së te Ministria e Informimit e Kroacisë. Në takim e parë që patëm Aliu dhe unë me Tomë Berishën në një restoran të Zagrebit e hetuam qartë se ku do të na shpiente loja që ishte përgatitur. Që në minutat e para nuk u pajtuam me Tomë Berishën rreth emërimit të takimit. Ai insistonte të quhej “Kuvend gjithëkombëtar shqiptar” apo “Kuvend historik gjithëshqiptar”. Ne e kundërshtuan dhe i thamë se kjo është shumë pretencioze dhe mund të quhet vetëm takim apo mbledhje konsultative e përfaqësuesve të subjekteve politike shqiptare në Jugosllavi. Morëm vesh se edhe Veton Surroi kishte arritur në Zagreb dhe në mbrëmje u takuam Ali Aliu, Veton Surroi, Mehmet Kraja, Tomë Berisha dhe unë, ku i hartuam tezat e mbledhjes (synimet e lëvizjes shqiptare, strategjia e veprimit dhe format e organizimit të përbashkët të subjekteve politike shqiptare në Jugosllavi). Tomë Berisha vërtitej aty-pari, bënte telefonata, vendi-vend nuk i zihej. Dëgjuam gjithashtu se edhe Mahmut Bakalli ishte tashmë në Zagreb, por një kohë relativisht të gjatë, i vendosur në një hotel luksoz në qendër të Zagrebit; gjatë gjithë kohës kishte pasur në dispozicion edhe një mercedes për të shëtitur gjithandej nëpër Kroaci. Edhe pse Bakalli përfaqësonte vetëm vetveten, kishte marrë guximin që të dilte me kushtrimin për kryengritje të përgjithshme të armatosur në Kosovë, të cilin do ta quante “Kushtrim i Këshillit të Qëndresës Popullore të Kosovës”! Tekstin e kishte të përgatitur me makinë shkrimi.

Ky takim mbahej në një situatë tepër të tensionuar në Kroaci dhe në gjithë ish-Jugosllavinë. Ende ishte në fuqi urdhëresa e Kryesisë së RSFJ-së për çarmatosjen e formacioneve paraushtarake në Kroaci dhe skadonte pikërisht më 20 janar 1991, ndërsa Stipe Mesiqi, si kryetar i kësaj Kryesie nga Kroacia, kishte kërkuar edhe disa ditë të shtyhej afati i realizimit të kësaj urdhërese. Me siguri se kjo shtyrje kishte lidhje edhe me këtë takim. Tomë Berisha dhe Vetoni kërkuan që në takim të merrnin pjesë delegatët tanë të Kuvendit në ekzil. U morëm vesh që të vinin disa delegatë, me Ilaz Ramajlin në krye. Kështu edhe ndodhi. Në takim nuk erdhën të ftuarit A. Demaçi, R. Qosja, M. Krasniqi, I. Kurteshi, L. Pula-Beqiri, Sh. Maliqi, H. Gorani dhe ndonjë tjetër. Arsyet nuk i mësuam.

Nga shënimet e mia del se takimin e hapi Tomë Berisha, kryetar i Lidhjes Demokratike të Shqiptarëve në Kroaci, si nikoqir. Në Kryesi të punës ishin edhe Ibrahim Rugova, Veton Surroi dhe Ali Aliu.

Interesim për t'u marrë me aspekte të ndryshme të çështjes së Kosovës dhe të problematikës demograffike brenda saj shfaqti edhe arkitekti i pensionuar Branislav Kërstiq nga Beogradi. Në librin e tij "Kosova midis të drejtës historike dhe të drejtës etnike",<sup>1</sup> në shqyrtimin e rrjedhave retrospektive dhe aktuale demografike, me gjakftohtësinë që orvatet ta ruajë, dallon nga autorët e tjerë serbë që shkruan libra e pamflete të shumta për Kosovën dhe shqiptarët pas vitit 1981. Ishte shkruar me një ton të matur, pa mitizime të tepruara dhe pa ofendime ndaj shqiptarëve, por për nga përfundimet që nxirreshin dhe porositë që jepeshin për zgjidhjen e çështjes së Kosovës paraqiste botimin më të rrezikshëm jo vetëm për Kosovën dhe shqiptarët, por edhe për serbët dhe Ballkanin. Ndërkaq, pas çlirimit të Kosovës, në vitin 2000 Kërstiq del me projektin tjetër "Kosova para gjyqit të historisë",<sup>2</sup> me të njëjtat porosi. Pas këtyre projekteve qëndronin qarqe dhe institucione të Serbisë, që u dëshmuar më vonë kur Qendra Koordinuese e Qeverisë së Serbisë për Kosovë (shefi i saj N. Çoviq) dhe Kisha Ortodokse Serbe konsulent kryesor e kishin B. Kërstiqin, i cili ishte edhe nënkryetar i kësaj Qendre. Ishte eksponent kryesor i politikës së shkatërrimit të individualitetit të Kosovës dhe të politikës kolonizuese në Kosovë, i biri i ideologut kryesor të reformës agrare në Kosovë midis Dy Luftërave Botërore, Gjorgje Kërstiq.<sup>3</sup> Projekti i përmendur merrej me ndarjen territoriale të Kosovës dhe përfundimi i tij ishte se shqiptarëve të Kosovës, me më se 90% në numrin e përgjithshëm të saj, duhet t'i takojë vetëm 10% e territorit, ndërsa serbëve me më pak se 8% në popullsinë e përgjithshme në fillim të viteve të 90-ta të shek. XX duhet t'u takojë

---

<sup>1</sup> B. Krstić, *Kosovo izmedju istorijskog i etničkog prava*, Kuća Vid, Beograd 1994, ff. 1-318.

<sup>2</sup> B. Krstić, *Kosovo pred sudom istorije*, Beograd, 2000.

<sup>3</sup> Đ. Krstić, *Kolonizacija u Južnoj Srbiji*, Bosanska pošta, Sarajevo, 1928.



90% e territorit! Këtu do të ndalemi vetëm në pjesën demografike të librit të B. Kërstiqit, që zë vendin qendror të tij.

Shqetësimi kryesor i Kërstiqit ishte individualiteti juridik-politik i Kosovës, pastaj shtrirja territorialisht kompakte, numri dhe perspektiva demografike e shqiptarëve dhe brengosja për kinse rrezikimin e prosperitetit demografik, kombëtar e shtetëror të Serbisë dhe të serbëve. Për realizimin e interesit serb dhe vënien e Kosovës nën sovranitet të plotë të Serbisë, sipas tij, duhej amortizuar “albanizimin e Kosovës” dhe duhej “thyer plotësisht” dominimin numerik dhe reprodutiv të shqiptarëve dhe atë përmes rikomponimit territorial të Kosovës, krijimit të autonomisë diferenciale dhe rrjedhimisht ndarjes së Kosovës, synime këto që nuk kishin lidhje me tendencat e një regjionalizimi të ri evropian dhe me integrimet ballkanike e më gjerë, por ishin thjesht një aspiratë shtetomadhe dhe hegjemoniste serbe, ku serbët do t’i sendërtonin “të drejtat e tyre historike” mbi bazë të monumenteve kulturore-historike (kishat dhe manastiret), të cilat sipas tij, ishin të uzurpuara nga shqiptarët, si dhe rrëmbimin e territoreve të pasura me resurse nëntokësore dhe mbitokësore, ku shqiptarët përbënin shumicën dërmuese.

+ + +

Realizimi i planit të Qeverisë së Beogradit për kthyerjen e serbëve në Kosovë, ku kryeideolog përsëri na del arkitekti e urbanisti Branislav Kërstiqi, e që përmendet shifra deri 300.000 sosh, parasheh instalimin e tyre në dhjetëra lokacione, që do të thotë në ngritjen e shtëpive, madje edhe të vendbanimeve të reja brenda enklavave dhe përreth tyre në sipërfaqe jo të privatizuara, ku në shumicën e rasteve ishte pronë e dikurshme e shqiptarëve, e marrë në kuadër të reformës agrare pas Luftës II Botërore dhe në emër të kufizimit të maksimumit në 10 hektarë. Kthyerja parashihej të stimulohej në disa baza, sikurse gjatë viteve të 80-ta të shekullit të kaluar, prej sigurimit të vendeve të punës e deri te ndërtimi i shtëpive dhe ngritja e sistemeve urbane infrastrukturore, që do t’i lidhnin enklavat, pastaj parashiheshin shumë shërbime gratis për ta, sikurse sot, ku serbët në enklava dhe jashtë tyre nuk paguajnë rrymë, ujë, telefon etj., me fjalë të tjera janë shumë të privilegjuar. Ky tip i instalimit ka vetëm një emër: kolonizim i ri, por tani në rrethana të reja. Dhe pse mos të kthehen serbët në Kosovë me këto kushte tepër të favorshme, ku edhe ata që i kanë shitur pronat do të kërkojnë të kthehen në Kosovë, në shtëpi të reja, të cilat një numër i tyre gjithnjë janë gati t’ua shesin shqiptarëve!

Në pjesën "Ekspansioni demografik i popullsisë shqiptare", B. Kërstiq, mbi bazë të një prezantimi ekstensiv të të dhënave nga viti 1931 e këndej, do të përpiqet të nxjerrë përfundimin se si popullata shqiptare në Kosovë pas viteve '60 do të shënojë rritje të shpejtë për interesa politike, meqenëse "kërkesa për konstituimin e Kosovës dhe Metohisë si krahinë" do të bazohet "në dominimin e popullsisë shqiptare" (f. 89), ndërsa numri i serbomalazezëve nga "ekspansioni popullativ i shqiptarëve" dhe "pozita e pavarur autonome, me elemente shtetësie, e Kosovës" (ff. 113, 159, 245) do të zvogëlohet dukshëm pas vitit 1961. Për këtë rritje demografike të shqiptarëve, ndonëse përpiqet që të mos përdorë terma me konotacione ideologjike, megjithatë do të përdorë termin "ekspansion" dhe "eksplosion" të kohës së dominimeve neokolonialiste, të cilat me të madhe i kanë përdorur dhe i përdorin serbomëdhenjtë për shqiptarët si Cvijiqi, Çubrilloviqi, Andriqi, Qosiqi, Macura, Iviqi etj.

B. Kërstiqi nuk kënaqet me rezultatet dhe metodologjinë e regjistrimit të vitit 1948, në të cilin së pari herë, sipas kriterit subjektiv (kombësisë), është nxjerrë përkatësia kombëtare dhe i pëlqejnë rezultatet e regjistrimeve të viteve 1921 dhe 1931 e këtë të fundit madje e cilëson si "të shkëlqyeshëm" (f. 89). Në këto dy regjistrime, siç dihet, popullsia është regjistruar vetëm sipas përkatësisë gjuhësore dhe fetare, ndërsa përkatësia kombëtare, për shkaqe të politikës unitariste serbomadhe, është injoruar. Këto dy regjistrime, pos defekteve të natyrës metodologjike (për shkak se ishin realizuar sipas konceptionit të popullsisë së përkohshme) përshkoheshin edhe me spekulime të shumta rreth numrit të popullsisë josllave, veçanërisht të asaj shqiptare. Në tabelën 9 B. K. nuk i jep as rezultatet e regjistrimit të vitit 1921 (që janë publikuar), kur popullsia shqiptare në Kosovë, edhe përkundër dobësive të shumta të këtij regjistrimi, sipas gjuhës amtare kishte përqindje shumë më të lartë (64,1%) se në vitin 1931 (60,1%) sipas të dhënave të pabublikuara.

B. K. thekson se turqit në "vitin 1948 në shumë komuna të Kosovës nuk janë regjistruar" ose "janë regjistruar si shqiptarë" (f. 90), ngase numri i tyre prej 1.315 më 1948 rritet në 34.583 në vitin 1953, ndërsa përqindja e shqiptarëve zvogëlohet prej 68,5% më 1948 në 64,9% më 1953. Rrjedhat variable, por të kundërta të këtyre dy bashkësive kombëtare, pikërisht sikundër edhe rënia e numrit të shqiptarëve në Maqedoni (prej 197.389 më 1948 në 162.524 më 1953) dhe rritja e madhe e numrit të turqve në tërë ish-Jugosllavinë (prej 97.954 më 1948 në 259.535 më 1953) janë tregues evident të

deklarimit jo të turqve si shqiptarë, siç thekson B. K., por të shqiptarëve si turq, për t'u shpërngulur në Turqi nën psikozën e frikës e të pasigurisë dhe torturave masive ndaj tyre (aksioni i mbledhjes së armëve, inskenimi i grupeve "armiqësore irredentiste", i kryengritjes së armatosur dhe i bashkimit me Shqipërinë, ndjekja e intiligjencisë, reduktimi edhe i atyre të drejtave të pakta qytetare e kombëtare të shqiptarëve, siç ishin ndalimi i përdorimit të gjuhës shqipe në jetën publike dhe i simboleve kombëtare, mbyllja e Institutit Albanologjik, Bibliotekës Popullore të Kosovës, mbyllja e shkollave shqipe e deri te likuidimet e fshehta fizike të shqiptarëve). Gjuha amtare, të cilës B. K. i jep përparësi të madhe në përcaktimin kombëtar, është indikatori tjetër që e hedh poshtë tezën e autorit për regjistrimin e turqve si shqiptarë. Sipas regjistrimit të vitit 1953 si turq (me përcaktim kombëtar) në Kosovë ishin përcaktuar 34.583 veta, ndërsa kishin deklaruar se gjuhën turke e flasin 25.103, në Maqedoni kjo mospërputhje ishte 203.938:153.160, kurse në ish-Jugosllavi prej 259.535 vetave me përkatësi kombëtare turke vetëm 181.887 ose 70,0% kishin deklaruar se e flasin gjuhën turke. Sipas regjistrimit të vitit 1961 kjo mospërputhje rritet edhe më tepër: prej 182.964 turqve sa ishin të evidentuar në ish-Jugosllavi, vetëm 90.883 ose 50,0% të tyre e kanë folur gjuhën turke.

B. K. si njësi komparabile për përcjelljen dhe studimin e lëvizjes së popullsisë preferon komunën dhe mbi këtë bazë edhe prezanton ecurinë e numrit të popullsisë së Kosovës prej 1931-1991. Me të drejtë thekson se përcjelljen e popullsisë sipas komunave e vështirësojnë ndarjet e shpeshta territoriale-politike që bëheshin në tërë ish-Jugosllavinë. Mirëpo nuk mund të qëndrojë konstatimi i tij "...se në asnjë pjesë të Jugosllavisë ndarjet territoriale nuk janë bërë disa herë dhe në atë mënyrë si në Kosovë e Metohi" dhe se ndryshimet e tilla "...nuk janë bërë për shkak të nevojave të popullsisë dhe organizimit më të mirë territorial të pushtetit, por për arsye të ndryshimit të raportit të forcave në zgjidhjen e çështjes nacionale në Kosovë e Metohi" (f. 93). Vërtet një absurd! Kush e ka drejtuar pushtetin në Kosovë deri në gjysmën e viteve të 60-ta, kur edhe janë bërë ndryshimet më të mëdha territoriale-administrative në tërë ish-Jugosllavinë? Më 1948 Kosova kishte 16 rrethe e qytete (Serbia 81; Jugosllavia 338) dhe 235 këshilla popullore të vendit (Serbia 1968; Jugosllavia 8.063), më 1953 18 rrethe dhe 201 komuna (Serbia 87 dhe 1678; Jugosllavia 351 dhe 4.139), më 1961 në Kosovë rrethet suprimohen (Serbia ka 15; Vojvodina 6; Jugosllavia 75), ndërsa numri

i komunave zvogëlohet në 28 (Serbia 155; Jugosllavia 774).<sup>4</sup> Sipas ndarjes administrative-territoriale që ka bërë Serbia në vitet e 80-ta e të 90-ta, Kosova kishte 31, kurse Serbia 168 komuna.

Është interesant se rritjen e numrit të popullsisë shqiptare dhe zvogëlimin e numrit të popullsisë serbe B. K. e sheh jo si rezultat të nivelit të zhvillimit social, ekonomik, urban, arsimor, shëndetësor dhe të emancipimit të femrës posaçërisht, por kryesisht në Kosovën si njësi autonome dhe konstitutive në ish-Federatën Jugosllave dhe në një politikë afatgjate të konceptuar mirë të saj dhe thekson "...se në vetëdijen e serbëve dhe malazezëve krahina autonome nuk përjetohet si vend i tyre, ndërsa në vetëdijen e shqiptarëve përjetohet" (f. 84). Prandaj edhe tërë analizën e lëvizjes së popullsisë shqiptare dhe serbo-malazeze e shtrinë me theksim të posaçëm në periudhën e decentralizimit të ish-Federatës dhe forcimit të autonomitetit të Kosovës, duke dashur të nxjerrë përfundim se për këtë trend të kundërt të sjelljes demografike të dy popujve faktore është pikërisht autonomia e Kosovës me elemente të shtetësisë. Mirëpo asnjë e dhënë nuk flet në favor të tezës se serbët dhe malazezët në kohën e funksionimit të autonomisë ishin të diskriminuar. P. sh. numri i serbëve të punësuar në sektorin shoqëror ishte në rritje të vazhdueshme: më 1970 32.739, më 1980 45.183 dhe më 1986 48.429. Pra, në periudhën 1970-1986, deri kur Millosheviqi përmes Kosovës erdhi në pushtet, rritja e tyre në punësim ishte 47,9%. Ose t'i marrim banesat shoqërore: sipas regjistrimit të vitit 1981 nga fondi i përgjithshëm i tyre në pronësinë shoqërore në Prishtinë (8.075 banesa ose 1/3 e fondit të Kosovës) 49% u takonte serbëve dhe malazezëve, të cilët në popullsi merrnin pjesë vetëm me 19,4%, ndërsa shqiptarët dispononin me 41% në banesa, kurse në popullsi merrnin pjesë me 70,1%.<sup>5</sup> Por problemi kryesor për shovinistët dhe hegjemonistët serbë, pra edhe për B. K., qëndron në barazinë e shqiptarëve me serbët dhe malazezët në Kosovë dhe në afirmimin e tyre në kohën e ekzistimit të autonomisë së Kosovës.

Për ta përforcuar tezën e dallimeve në lëvizjen e kundërt të popullsisë shqiptare dhe serbe në Kosovë B. K. bën edhe krahasimin midis rritjes së popullsisë shqiptare në Kosovë dhe në Shqipëri, duke theksuar se "...lëvizja e popullsisë së Shqipërisë i përgjigjet rregullsisë

<sup>4</sup> V. Simeunović, *Stanovništvo Jugoslavije i socijalističkih republika 1921-1961*, Studije, analize i prikazi, br. 22, Savezni zavod za statistiku. Beograd 1964, ff. 16-19.

<sup>5</sup> *Sociološka studija grada Prištine*, Ekonomski institut, Priština 1986, ff. 40-41.

sikurse në vendet në zhvillim, ndërsa popullsia shqiptare në Kosovë bën përjashtim" (f. 114) dhe se dallimet midis tyre në trendin e shtimit demografik rriten pas viteve të 60-ta. Dhe, sipas B. K., në shembullin e popullsisë shqiptare në Ballkan mund të konkludohet "...se kombi, feja, doket, mënyra e jetës, rajoni gjeografik, nuk mund t'i shpjegojnë këto dallime të papritura" (f. 114). Pastaj për ta "mishëruar" edhe më shumë tezën e përmendur thekson se "...rritja e shqiptarëve në Mal të Zi është më afër malazezëve në këtë republikë se sa e shqiptarëve në Kosovë" dhe se kjo dukuri shpjegohet me "...shkallën e lartë të integritit të shqiptarëve me popullsinë tjetër në Mal të Zi" (f. 109).

Do të pajtohem me B. K. se dallimet në vëllimin e lindjeve dhe shtimin e popullsisë së një kombi nuk janë etnikisht dhe konfesionalisht të determinuara, tezë që e kundërshtonin qarqet politike dhe shumë demografë, sociologë, politikologë etj. serbë, por dallimet në dinamikën e lëvizjes së popullsisë shqiptare në Kosovë dhe Shqipëri janë kryesisht rezultat i pozitës tjetër sociale-kulturore të femrës në Shqipëri (aktive në jetën ekonomike, e ngritur në pikëpamje arsimore etj.) dhe se popullsia e Shqipërisë më herët ka hyrë në procesin e transicionit demografik edhe në sferën e mortalitetit, edhe në atë të natalitetit. Ndërsa rënia e natalitetit dhe zvogëlimi i rritjes së popullsisë shqiptare në Mal të Zi është jo rezultat i integritit të saj në shoqërinë malaziase, por ekskluzivisht pasojë e shpërnguljes masive të të rinjve të moshës riprodutive, së pari në Kosovë e pastaj në SHBA, proces që ka filluar qysh para 30 viteve dhe po merr dimensione brengosëse. Fundja, dallime të mëdha në nivelin e natalitetit dhe të rritjes demografike ka midis serbëve në Kosovë dhe serbëve në Serbi e Vojvodinë. Në Kosovë gjatë tërë periudhës së pasluftës serbët kishin natalitet disa herë më të lartë: më 1981 numri mesatar i fëmijëve të lindur gjallë në një grua serbe ishte: në Kosovë 3,52, në Serbi 1,85 dhe në Vojvodinë 1,87 fëmijë. Arsyet për këtë sjellje diferencuese riprodutive të serbëve janë të njohura.

Rritja e popullsisë shqiptare në Kosovë, në Maqedoni, në Preshevë etj. shpjegohet me faktin se në rrjedhat e ndryshimeve intensive shoqërore-urbane dhe kulturore janë përfshirë vonë e ngadalë në sektorët më kryesorë të riprodhimit dhe të zhvillimit të popullsisë: femra si faktor kryesor i përtëritjes biologjike, familja si suazë vendimtare e procesit të lindjes, amësisë dhe riprodhimit biosocial dhe fshati si strukturë dominante në shoqërinë shqiptare. Popullsisë rurale-agrare të Kosovës dhe të rajoneve të tjera shqiptare edhe sot i bie barra kryesore e riprodhimit të popullsisë. Kjo popullatë

deri vonë ishte afër gjendjes ku ekuilibri demografik midis lindjes dhe shuarjes së jetës arrihej me humbje të mëdha njerëzish për shkak të mortalitetit të lartë, sikurse te popullatat paraindustriale. Në anën tjetër, nataliteti është dukuri shumëdimensionale dhe afatgjate demografike dhe rënia e tij nga niveli i lartë në të ulët nuk mund të bëhet shumë shpejt.

+ + +

Një pjesë të mirë të librit B. K. ia kushton shpërnguljes së serbëve nga Kosova dhe "okupimit të territorit" të saj nga shqiptarët, madje procesin e shpërnguljes së serbëve e cilëson si "dyndje" të tyre (fq. 84), ndërsa shpërnguljet e shqiptarëve, madje as ato në Turqi e as spastrimin e heshtur etnik që po e zbaton vitet e fundit pushteti okupues serb me represion dhe terror sistematik nuk i përmend fare!. Jep të dhëna "të fryra" për shpërnguljen e serbëve (f. 83) dhe në kontekstin në çfarë e trajton këtë problem, "ndjekës" të tyre dalin shqiptarët dhe autonomia e Kosovës: "Popullsia shqiptare me ekspansion demografik e ka shpërngulur popullsinë serbe dhe malazeze" (f. 153). Në periudhën 1961-1990, kur B. K. fajtorë kryesorë për rritjen e shqiptarëve dhe zvogëlimin e numrit të serbëve dhe malazezëve e konsideron autonominë e Kosovës, sipas tij nga Kosova u shpërngulën rreth 140.000 serbomalazezë, ndërsa prej 1951-1981 rreth 103.000 sish (f. 83)! Sipas vlerësimeve tona, në mbështetje të regjistrimeve, prej vitit 1966-1981 drejtpërdrejt nga Kosova janë shpërngulur rreth 52.000 serbë. M. Roux-i (1994), në bazë të rezultateve të regjistrimit të vitit 1981, vlerëson se saldoja negative për Kosovën për të gjitha periudhat (deri në vitin 1981) është rreth 65.000 serbë, ndërsa sipas tij, kur të merret parasysh mortaliteti i të shpërngulurve, humbja e pastër mund të arrijë në rreth 72.000 serbë. Sipas B. K. në periudhën 1981-1990 Kosovën e kanë braktisur 49.000 serbë (f. 83), ndërsa sipas të dhënave të policisë së Kosovës të mbledhura nga shërbimet e lajmërimit e të çlajmërimit të sekretariateve komunale të punëve të brendshme (të cilat vetë i jepte çdo migrant), e të cilat si botim intern i publikonte Enti Statistikor i Kosovës, prej 1 .VI. 1983 deri 31 .XII. 1988 Kosovën e braktisën 19.571 serbomalazezë. Prej tyre, për shkaqe ekonomike emigruan 46,0%, për shkak të shkollimit 6,0% dhe për shkaqe familjare 48,0%. Pjesa dërmuese e të shpërngulurve u ngulit në Serbi, kryesisht në

zonën urbane të Beogradit (rreth 40,0%) dhe në qytetet e tjera (Kraleva, Kragujevci, Nishi etj).<sup>6</sup>

Shpërngulja e serbomalazezëve nga Kosova pas vitit 1966, kur të përjashtohen rastet, nuk ishte dukuri e shkaktuar për arsye të presioneve të shqiptarëve mbi ta, "ekspansionit" të tyre demografik dhe funksionimit të autonomisë, por për shkak të humbjes së privilegjeve që gëzonin deri atëherë dhe mostolerimit të barazisë nacionale, pastaj për shkaqe të pasigurisë së atyre serbëve që i përkisnin aparatit shtetëror e policor e që u kishin bërë shumë të këqija shqiptarëve në kohën e Rankoviçit, për arsye të gjendjes shumë më të mirë ekonomike në Serbi dhe fitimeve të mëdha nga shitja e pasurisë së patundshme në Kosovë, si dhe për shkaqe familjare dhe individuale, meqenëse shumica dërmuese ishin të ardhur në Kosovë në kuadër të valës së parë dhe valës së dytë të kolonizimit të Kosovës dhe në mënyra të tjera. Fundja, në ish-Jugosllavi mobiliteti hapësinor e social i popullsisë ishte masiv; sipas regjistrimit të vitit 1981 vendin e lindjes e kishin ndërruar 9.184.451 banorë, që përbënte 41% të popullsisë së gjithmbarshme të vendit, ndërsa kufijtë republikanë e krahinorë i kishin kaluar 1.760.333 banorë, kryesisht pjesëtarë të atyre bashkësive kombëtare të cilat "amat" e tyre kombëtare i kishin në njësitë e tjera federale. Popullsia e çdo nacionaliteti kryesisht ishte e orientuar drejt hapësirave ku gjuha, feja, doket, kultura dhe veçoritë e tjera etnike ishin të njëjta apo të ngjashme dhe veçanërisht nëse rajonet imigruese ofronin më shumë në pikëpamje ekonomike e kulturore. Rrjedhat e mëvonshme pas vdekjes së (1980), veçanërisht lufta e serbëve kundër të gjithë popujve të tjerë për synime hegjemoniste, do të tregonin se në këto lëvizje të popullsisë kanë pasur ndikim të konsiderueshëm edhe rritja e konflikteve dhe e nacionalizmave si dhe rrethanat e tjera.

Edhe sipas B. K. po del se vetëm "pozicioni konstitucional i Kosovës", i interpretuar si "nacionalizëm shqiptaromad", na paska qenë "burim" i tensionimeve ndëretnike, "ndjekës" i serbëve dhe malazezëve dhe "rrezikim i territorit historik serb" (!), tezë kjo që fare nuk dallon nga ajo e nacionalistëve dhe ortodoksistëve serbë, si p. sh. e teologut serb D. Bogdanoviç në "Librin për Kosovën", ku shprehimisht thoshte: "...u tregua se problemi i Kosovës as nuk është në radhë të parë çështje e veprimtarisë armiqësore dhe e kundërrevolucionit, por shumë më tepër se kaq - është problem i

<sup>6</sup> H. Islami, "Demografski problemi Kosova i njihovo tumačenje", në librin Kosovo - Srbija - Jugoslavija, KRT, Ljubljana 1989, f. 48.

konstituimit të Krahinës si formë e shtetësisë së shqiptarëve me tendencë drejt formimit të Republikës së pavarur në Federatën Jugosllave".<sup>7</sup> Millosheviqi erdhi në pushtet më 1986 dhe atë përmes Kosovës, ndërsa autonomia e Kosovës u rrënuar në fillim të vitit 1989 dhe Kosova u shndërrua në një koloni klasike, mirëpo shpërngulja e serbomalazezëve vazhdoi me intensitet edhe më të dukshëm pas këtyre viteve, kështu që sot në Kosovë, hiq pjesëtarët e aparatit policor, ushtarak e administrativ, nuk ka më shumë se 150.000 serbomalazezë si popullsi e përhershme, por pushteti serb këtë tash nuk e problematizon, sepse shqiptarët më nuk mund t'i fajësojë para botës dhe opinionit serb. Po ta pranonte faktin e shpërnguljes së serbëve pas aneksimit dhe okupimit të plotë të Kosovës, ky pushtet publikisht do ta pranonte politikën dështuese të tij në Kosovë.

"Veçantia e lëvizjes së popullsisë së Kosovës qëndron edhe në atë se vërehet dukuria e imigrimeve shumë më të mëdha në komunat me përbërje të përziera kombëtare se sa në komunat ku dominon popullsia shqiptare" (f. 156), shkruan Kërstiqi dhe vazhdon: "Bazë për këtë sjellje është Krahina kështu siç është definuar" (f. 158). Kjo tezë e tij çon drejt konkludimit se ardhja e shqiptarëve në këto komuna bëhej për shkak të presionit në serbë e malazezë, tezë kjo që e përshkoi tërë fushatën antishqiptare të qarqeve politike e shkencore serbe në vitet e 80-ta. Mirëpo edhe të dhënat që i jep vetë B. K. në tabelën 35 (f. 157) nuk tregojnë një tendencë të tillë, sepse më shumë kanë ardhur shqiptarë në komunat ku popullata shqiptare përbën më se 90%, kur të krahasohet numri absolut i imigruesve, si p. sh. në komunën e Rahovecit me 92,2% shqiptarë më 1981 (4.160 të ardhur) në raport me komunën e Istogut me 71,8% shqiptarë (2.832 të ardhur), pastaj në komunën e Gllogovcit me 99,8% shqiptarë (3.400 të ardhur) në krahasim me komunën e Vitisë me 73,4% shqiptarë (2.069 imigrues). Komunat që krahasohen kanë përafërsisht numër të njëjtë të popullsisë së përgjithshme. Po athua në Prishtinë si qendra më atraktive për shqiptarët, në kohën e funksionimit të autonomisë së Kosovës, shqiptarët jo vetëm të Kosovës, por edhe të Maqedonisë, Serbisë së Jugut dhe Malit të Zi vinin për t'u punësuar, për t'u shkolluar, për shkaqe familjare etj. apo "për t'i shpërngulur serbët dhe malazezët"?!

Në kuadër "të okupimit të territorit" B. K. ndalet posaçërisht te pasuria e paluajtshme e serbëve, e cila, sipas tij, tjetërsohet nga

<sup>7</sup> D. Bogdanović, *Knjiga o Kosovu*, SANU, Beograd 1986, f. 242.



shqiptarët. Ai thekson: "Më së shumti shitblerje kishte në vitet e 60-ta (f. 168) dhe "...shitjet e para të tokës e të shtëpive në vendbanim janë paguar sipas çmimeve enorme në mënyrë që pronarët të nxiteshin për t'i shitur, ndërsa më vonë, kur në vendbanim mbetej një numër i vogël i ekonomive shtëpiake serbe, çmimi zbritej shumë. Bashkëkombësit e mi theksojnë se në blerjen e tokës nuk ka pasur konkurrencë të rëndomtë midis blerësve" (f. 171), që sipas tij do të thotë se blerja e pasurive të serbëve ka qenë e organizuar! Asnjë nga këto konstatime nuk mund të qëndrojë: çmimi i objekteve të paluajtshme në Kosovë gjithmonë është rritur kur ka pasur ofertë më të vogël, ndërsa konkurrenca në hapësirën e ngushtë jetësore të Kosovës në rrethana e moszhvillimit material, dendësisë së madhe agrare dhe grumbullimit të tepricave agrare dhe në ofertën e vogël të pasurisë së paluajtshme gjithnjë ka qenë më e lartë. B. K. nënvizon "...se shqiptarët ua blejnë tokën dhe shtëpitë serbe, ngase ata janë më të pasur" (f. 169), kuse nuk përmend se shqiptarët pasurinë e tyre e krijojnë me mund të madh nga puna në botën e jashtme, shumica duke i mbajtur madje edhe nga dy punë.

Shpërngulja e serbëve nga Kosova, shitblerja e tokave dhe marrëdhëniet e pazgjidhura pronësore-juridike në Kosovë janë të lidhura ngushtë me reformën agrare dhe kolonizimin e Kosovës midis Dy Luftërave Botërore. Nuk është e vërtetë se kolonizimi i Kosovës është bërë vetëm "për t'u siguruar riintegrimi i këtyre viseve në shtetin e ri" (f. 76), siç thekson B. Kërstiqi, duke iu referuar librit të babait të tij Gjorgje Kërstiqit. Kolonizimi dhe reforma agrare kishin për qëllim jo zgjidhjen e çështjes sociale-ekonomike të serbëve kolonë dhe autoktonë në Kosovë dhe në viset jugore të Jugosllavisë së atëhershme, por shkatërrimin e tërësisë kompakte hapësinore të shqiptarëve dhe krijimin e territorit etnikisht të pastër serb në rajonet e banuara nga shqiptarët përmes shpërnguljes masive të shqiptarëve në Turqi dhe Shqipëri. Për këtë qëllim ishin angazhuar qarqet sunduese, kulturore e shkencore serbe dhe veçanërisht ideologët e krijimit të hapësirave të pastra etnike, si Çubrilloviqi, Andriqi, Moleviqi, çetnikët e Drazha Mihajloviqit etj. Edhe Gjorgje Kërstiqi ishte njëri ndër ideologët e reformës agrare, për çka më 1928 e kishte shkruar librin "Kolonizimi në Serbinë e Jugut".<sup>8</sup>

Gjithashtu nuk qendron konstatimi i B. K. dhe Gjorgje Kërstriqit se në Kosovë "tokë kishte me bollëk sa që askund nuk janë prekur

<sup>8</sup> Đ. Krstić, *Kolonizacija u Južnoj Srbiji*, Bosanska pošta, Sarajevo 1928.

interesat e vendasve" (f. 74). M. Obradoviçi në librin "Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu" (1918-1941), të botuar më 1981, thekson se pas vitit 1923, pasi që u studiuan mirë rrethanat dhe u nxorën dekretligje të reja mbi kolonizimin dhe "për të krijuar komplekse kolonizuese edhe atje ku nuk kishte tokë të lirë, të komunës apo të shtetit, pushteti angazhohej t'u merrte sa më shumë tokë të bukës shqiptarëve. Atëherë shumë familje shqiptare mbetën pa asnjë pëllëmbë tokë ose iu la vetëm toka rreth shtëpive".<sup>9</sup> Për shqyrtimin e reformës agrare dhe kolonizimin në Kosovë midis Dy Luftërave Botërore B. K. nuk e ka shfrytëzuar e as në bibliografi nuk e ka librin e M. Obradoviçit, i cili deri më sot është studimi më komplet e më objektiv për këto probleme, sikundër që nuk i merr as hartat e M. Roux-it<sup>10</sup> (të cilin e citon shpesh në libër) për shtrirjen gjeografike të kolonëve serbomalazezë në Kosovë midis dy luftërave, të përpiluara në mbështetje të të dhënave nga hulumtimet anketuese të M. Obradoviçit (ff. 235-348).

Në Kosovë "ekziston edhe çështja e pazgjidhur e tokës kishtare", ndërsa "me reformën agrare të vitit 1946 Kishës Orotokse Serbe u janë marrë 1.282 ha" dhe se në Kosovë "në Mbretërinë e Jugosllavisë fondi i tokës kishtare ishte prej 1.500 deri në 1.800 ha" (f. 180), thekson B. K. Do ta ketë të njohur B. K. se shfytëzues të reformës agrare, pos kolonëve, komunarëve, optantëve, çetnikëve, vullnetarëve, organeve të besueshme të reformës agrare ishin edhe kishat ortodokse dhe manastiret, ushtria e gjandarmëria, institucionet arsimore, kulturore, ekonomike etj. Sipas Obradoviçit kishave dhe manastireve në Kosovë midis Dy Luftërave Botërore u janë ndarë 264 ha tokë.<sup>11</sup>

+ + +

Libri i B. K. "Kosova midis të drejtës historike dhe të drejtës etnike", ndonëse i shkruar me një fjalor të zgjedhur, ton të matur, pa ofendime e mitizime të tepruara, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë lidhet me diskursin mbi dimensionin demografik të çështjes së Kosovës, të hapur në kuadër të fushatës kundër Kosovës dhe shqiptarëve pas vitit 1981, që zhvillohej jo me qëllim të zgjidhjes së drejtë të problemit kosovaro-shqiptar, por për shkak të frikës nga

<sup>9</sup> M. Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, Institut za istoriju Kosova, Priština 1981, f. 231.

<sup>10</sup> M. Roux, *Les Albanais en Yougoslavie*, Edition de la maison des sciences de l'homme, Paris 1992 (harta 31 dhe harta 32, ff. 197-198).

<sup>11</sup> M. Obradović, *Po aty*, fq. 217.

faktori demografik shqiptar. Me përfundimet që nxirren dhe porosinë që jepen në këtë libër madje shkohet edhe shumë më larg se synimet e disa projekteve të deritashme. B. K. në reagimin e tij, të cilin nuk e konsideron "si përgjigje ndaj autorëve të kritikave",<sup>12</sup> por "si kontribut rubrikës Dosja" të revistës "Koha", edhe njëherë e shfrytëzon rastin t'i përsërisë tezat dhe qasjet kryesore nga libri i tij, të cilat edhe ishin objekt i diskutimeve dhe kontestimeve tona me shifra dhe fakte. Ky lloj reagimi i B. K. pa dyshim mund të merret edhe si obligim ndaj qarqeve dhe institucioneve që qëndrojnë pas këtij projekti, e që janë institucionet shtetërore të Serbisë.

Sikurse edhe autorët e shumë pamfleteve dhe librave, B. K. do ta shqetësojë individualiteti i Kosovës, shtrirja territorialisht kompakte, vëllimi dhe perspektiva demografike e shqiptarëve. Me konstatimin se serbët "rreth vitit 2051 do të pushonin të përbënin popullsinë shumicë në Republikën e Serbisë", që B. K. e thekson edhe në reagimin e fundit, dalin sheshazi tezat mbi shqiptarofobinë dhe kinse rrezikimin e prosperitetit shtetëror, kombëtar dhe demografik të Serbisë dhe serbëve. Prandaj ai angazhohet për gjetjen e formulës së pajtimit midis "të drejtës historike serbe" mbi bazë të monumenteve kulturo-historike dhe "të drejtës etnike shqiptare" mbi bazë të dominimit në strukturën e popullsisë dhe për pengimin e "albanizmit të Kosovës! "Pajtimi i të drejtës historike dhe të drejtës etnike nuk mund të arrihet derisa ekziston Krahina", thotë B. K. Për realizmin e interesit serb dhe vënien nën sovranitetin e Serbisë, sipas tij, duhet "thyer" plotësisht dominimin numerik dhe reprodutiv të shqiptarëve përmes rikomponimit territorial të Kosovës, krijimit të autonomisë diferenciale dhe rrjedhimisht ndarjes së Kosovës.

Kërstiçi me kërkesën për ridefinimin territorial nuk është origjinal, sepse me tezën e ndarjes shumë më herët ka dalë Dobrica Qosiqi, e cila në versione të ndryshme përmendet që nga fundi i viteve të 60-ta të shek. XX. Sa ishte kryetar i të ashtuquajturës Republikë Federative e Jugosllavisë, idenë për ndarjen e Kosovës në proporcion 60:40% në favor të serbëve si zgjidhje definitive të problemit të Kosovës, përkatësisht të çështjes shqiptaro-serbe Qosiqi ia paraqiti në fillim të vitit 2003 edhe bashkëkryetarëve të Konferencës së Gjenevës

<sup>12</sup> Pas vështrimit tonë në revistën "Koha" nr. 32 të dt. 19. 10. 1994 të cilën më vonë pjesërisht e botoi edhe gazeta "Borba", pasoi reagimi i B. Kërstiçit në "Koha" nr. 45 të dt. 25. 1. 1995 dhe më vonë në "Naša borba" të dt. 26. 4. 1995. Kjo pjesë e tekstit paraqet përgjigjen tonë në reagimin e B. Kërstiçit dhe botohet në "Koha" nr. 47/47 të dt. 8. 2. 1995 dhe në "Naša borba" të dt. 11. 5. 1995.

- Vensit dhe Ovenit në selinë e OKB-së në Gjenevë, të cilin ata pa diskutim e hodhën poshtë. Pas tij me tezën për ndarjen e Kosovës doli nënkryetari i Këshillit të partisë "Nova demokratija" (si satelite e partisë në pushtet të Millosheviqit) dr. Millovan Radovanović, drejtor i Institutit Gjeografik "Jovan Cvijik" të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve,<sup>13</sup> që është edhe recensent i këtij libri të Kërstiqit. Para tyre, pas zgjedhjeve të para në Serbi (1990) ekzistonte propozimprojekti i Qeverisë së Serbisë për copëtimin territorial-politik dhe administrativ të Kosovës, ndërsa inkuadrimi i një pjese të mirë të territorit të Kosovës në njësinë zgjedhore të Leskovcit dhe Plani më i ri hapësinor i Serbisë për Kosovën po kështu janë në funksion të rikoponimit territorial të Kosovës.

Kur bën fjalë për "ekspansionin demografik të shqiptarëve" dhe "okupimin etnik të territoreve", që është pjesa qendrore e librit të tij, njëra nga tezat që ngre B. K. është se pas viteve të 60-ta shqiptarët shënojnë rritje të shpejtë demografike, ndërsa serbët rënie dhe se kjo lëvizje e kundërt, sipas tij, vlerësohet si "dukuri jashtë rregullësive të lëvizjes së popullsisë në Krahinë". Shkaktari kryesor i sjelljes së kundërt të lëvizjes demografike të këtyre dy bashkësive nacionale, sipas B. K., janë tërësia etniko-demografike dhe autonomia e Kosovës me elemente të shtetësisë. Për të mos përsëritur argumentimin tonë nga vështrimi i mëparshëm, të cilin B. K. nuk ka mundur me asgjë ta kontestojë, porosisim autorin dhe bashkëpunëtorët e tij që t'i vështrojnë dhe studiojnë ndryshimet demografike në kuadër të procesit të transicionit demografik, raportet shoqërore dhe klimën politike pas vitit 1966, humbjen e privilegjeve të serbëve dhe malazetëve dhe mostolerimin e barazisë me shqiptarët, keqberjet e aparatit shtetëror gjatë kohës së Rankoviqit ndaj shqiptarëve, ardhjet e shqiptarëve nga viset e tjera në Kosovë për arsye të shkollimit e shkaqet e tjera, gjendjen ekonomike në Kosovë dhe në Serbi, motivet familjare e individuale (martesat, shkollimi), kthyerjen e kolonistëve të valës së parë të kolonizimit të Kosovës midis Dy Luftërave Botërore, pastaj të valës së dytë të kolonizimit pas Luftës II Botërore në vatrën prej nga kanë ardhur dhe ku i kanë pronat dhe farefisin, migrimet e të gjitha nacionaliteteve drejt "amave" të tyre kombëtare etj.

Teza tjetër e B. K., që drejtpërdrejt lidhet me të parën, është homogjenizimi i vendbanimeve në pikëpamje kombëtare, ku autori

<sup>13</sup> Shih" "Nova geografija za nove odnose: dr Milovan Radovanović o prekomponovanju Kosova", *Borba*, Beograd, 14.05.1993.

shpreh shqetësimin se në Kosovë, sipas regjistrimit të vitit 1981, prej 1.445 vendbanimeve “894 janë të pastra shqiptare”, ndërsa në vitin 1961, sipas tij, situata ishte krejtësisht ndryshe. Përkujtojmë se nga tabela që vetë autori e jep në Shtojcën II (ff. 269-285) në vitin 1961 në Kosovë 427 vendbanime ishin të banuara me shqiptarë prej 99-100% dhe 115 prej 96-98%. Në këtë vit 542 vendbanime banoheshin me serbë dhe malazezë prej 0,1-1,0%. Për arsye të përmendura dhe për shkak të ndjenjës së pakicës së serbëve dhe malazezëve, shqiptarët dhe autonomia e Kosovës më së paku janë fajtorë. Fajin për këtë duhet kërkuar në politikën e kolonizimit dhe në aspiratat hegjemoniste serbe. Qindra vendbanime të përziera, ku serbët merrnin pjesë prej 1-25%, para vitit 1961 dhe veçanërisht para reformës agrare dhe kolonizimit në periudhën 1918-1941, kur erdhën së paku 65.000 veta të kombësisë serbo-malazeze dhe u ndërrua përbërja etnike e qindra vendbanimeve, duke përfshirë shumë fshatra në kufi me Shqipërinë -, ishin të banuara ekskluzivisht me shqiptarë. Mbi bazë të padrejtësive që u janë bërë shqiptarëve dikur kërkohet që t’u bëhen padrejtësi të tjera sot – deri te transferi i dhunshëm i popullsisë së tyre, që nuk mund të quhet ndryshe pos ndërmarrje gjenocidale.

Rikomponimi territorial i Kosovës dhe ndarja e saj, ashtu siç e propozonte B. K.,<sup>14</sup> nuk ka lidhje me tendencat e një regjionalizmi të ri evropian dhe integrimet ballkanike e më gjerë, por është thjesht një aspiratë shtetomadhe e hegjemoniste serbe që mund të shpiejë drejt asaj që ndodhi në BeH. Kosova në kohën kur shkruante B. K. ishte çështje e dekolonizimit dhe e pavarësisë në bazë të së drejtës për vetëvendosje. Vetëvendosja për Kosovën dhe shqiptarët nënkupton jo vetëm realizimin e aspiratave të tyre të kahmotshme politike, por edhe ekzistencën e tyre fizike.

Dhuna që ushtrojnë pushtetet dhe regjimet me qëllim të nënshtimit dhe shtypjes së popujve në sferën nacionale, politike, sociale dhe emancipuese kurrë nuk mund të triumfojë. Nuk është treguar e qëndrueshme dhe afatgjate as politika e regjimeve hegjemoniste, që populli i tij përmes parlamenteve dhe strukturave të tjera pushtetore të vendosë për fatin e një populli tjetër, çfarë bëri Serbia dhe serbët për një kohë të gjatë ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, duke përdorur dhunën dhe terrorin derisa nuk u mposhtën nga

<sup>14</sup> Një ndarje të tillë të Kosovës faktikisht sot po e kërkojnë Presidenti Hashim Thaçi, Kryeministri Edi Rama dhe i pari i Serbisë Aleksanda Vuçiq (Shih më hollësisht: H. Islami - A. Ejupi, “Korrigjimi” i kufirit dhe ‘bashkimi’ i Luginës së Preshevës me Kosovën”, *Studime shoqërore*, nr. 5, ASHAK, 2019, ff. 7-44).

reaksioni i brendshëm i armatosur (UÇK) dhe ndërhyrja e fuqishme e faktorit euroatlantik në krye me NATO-n dhe SHBA-në.

Shqiptarët e Kosovës reagojnë në forma të ndryshme si një akt vetëmbrojtjeje. Kështu bënë shumë popuj në botë në shek. 20 në përpjekjet e tyre për çlirim dhe dekolonizim, ndër të cilët edhe shqiptarët në Serbi të Jugut dhe në Maqedoni në vitet 2000-2001. Shqiptarët më se 10 vjet, në kohën e Millosheviqit, duke u udhëhequr nga parimet e proklamuar të bashkësisë ndërkombëtare se të gjitha problemet duhet zgjidhur me rrugë demokratike dhe bisedime, ndoqën *rrugën paqësore në zgjidhjen e çështjes së Kosovës*. Mirëpo derisa shqiptarët nuk e kapën pushkën për t'iu kundërvënë forcave serbe, policore, ushtarake dhe paramilitare, kundërshtimi me rrugë paqësore nuk mundësoi shporrjen e forcave serbe nga Kosova dhe rrëzimin e regjimit të Millosheviqit. Regjimi i Millosheviqit as që ndërroi gjë nga sjellja e tij represive dhe brutale ndaj shqiptarëve. *Shembulli i Serbisë dhe i Maqedonisë dëshmuar se dhunës pushtetore e shtetërore duhej përgjigjur me dhunë*, në mënyrë që bashkësia ndërkombëtare të ndërhyjë në forma të ndryshme: ushtarake, ekonomike, politike apo diplomatike.

Problemi më i theksuar në vendet ku shqiptarët jetojnë është rezultat i çështjes së pazgjidhur shqiptare. Konflikti i armatosur midis shqiptarëve (UÇPMB-ja) për mënjanimin e dhunës dhe realizimin e të drejtave të tyre njerëzore e nacionale dhe forcave policore e ushtarake serbe në Serbi të Jugut përfundoi me një marrëveshje tepër të brishtë. Serbia nuk po i realizon obligimet e marra; “e arritura” më e madhe është instalimi i punkteve policore dhe ushtarake pothuajse në të gjitha vendbanimet ku jetojnë shqiptarët. Aktualisht sikur problemi më i madh është Maqedonia. Shqiptarët kërkojnë të jenë të barabartë me maqedonasit: popull konstitutiv, të kenë vendet e tyre në armatë dhe polici, gjuha shqipe të jetë e barabartë në jetën publike, me Universitet të financuar nga shteti etj. Shqiptarët e njohën Maqedoninë si shtet të tyre dhe partitë e tyre politike participojnë në Qeveri dhe në Parlament. Edhe pse është arritur marrëveshja, pala maqedonase bën obstrukcione nga më të ndryshmet për zbatimin e saj. Nëse pushteti maqedon vazhdon me politikën e vjetër (represioni, arrestimet arbitrare, mohimi i të drejtave njerëzore, kombëtare dhe konstitutive etj.), ka bazë supozimi se konflikti mund të përtëritet, ndërsa pasojat do të jenë shumë të mëdha për gjithë rajonin. Edhe këtu kjo çështje do të varet nga fakti se sa janë të vendosur amerikanët në realizimin e marrëveshjes së nënshkruar midis palëve në konflikt. Copëtimi etniko-

territorial i Maqedonisë është varianti më i keq i mundshëm për shqiptarët, sepse, përveç humbjeve të tjera, humben edhe qytetet me numër të konsiderueshëm të shqiptarëve, çfarë janë Shkupi dhe Kumanova.

Në fund duhet theksuar se ky autor e shkroi këtë libër me kaq gjakftohtësi, pa mitizime të tepruara dhe pezhorativizma ndaj shqiptarëve, që është një përjashtim në publicistikën dhe shkencën serbe. Mirëpo nuk është libër me porosi humaniste dhe i angazhuar për ruajtjen e stabilitetit dhe paqes në Ballkan, siç pretendon autori. Përkundrazi, me konkludimet që i nxjerr nuk ka publikim me porosi më tragjike për Kosovën dhe shqiptarët, por edhe për serbët dhe Ballkanin. Në të gjitha aspektet, historiko-gjeografike, etniko-demografike dhe juridiko-politike, Kosova është një dhe e pandashme. Si mundësi për pajtimin e "të drejtës historike" dhe "të drejtës etnike" dhe realizimin e tyre e zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe të çështjes shqiptaro-serbe autori propozon ndarjen e Kosovës, variantin më katastrofal të mundshëm, i cili, po u realizua, sjell vetëm konflikte, ndërmarrje gjenocidiale dhe rrjedhimisht gjakderdhje masive. Ndarja, sipas B. K. do ta shndërronte Kosovën në një territor prej rreth 11.000 km katrorë dhe me rreth 2.200.000 banorë, sa kishte në një hapësirë prej 4.600 km katrorë, ku do të jetonin rreth 850.000 banorë. Ku dhe si do të jetonin rreth 1.300.000 shqiptarë, duke i përfshirë këtu edhe ata të Preshevës, Bujanocit e Medvegjës dhe shqiptarët në Mal të Zi?!

Shpresë Mulliqi

CHARLES LUDWIG, *THE QUEEN OF THE REFORMATION (MBRETËRESHA E REFORMACIONIT, BOTUAR NGA OPERATION MOBILISATION GREATER EUROPE*

Reforma e shekullit XVI shënoi një kthesë të madhe në besimin e krishterë, mirëpo fillimisht nuk e ndryshoi pozitën dhe rolin tradicional të grave në familje dhe shoqëri. Gratë vazhdonin të shiheshin si shtëpiake, detyra e të cilave ishte mirëmbajtja e shtëpisë, mbështetja e burrit dhe edukimi i fëmijëve.

Sidoqoftë, reforma edhe pse jo menjëherë, shënoi hapat e parë në mundësimin e arsimimit të gruas. Dhe ishin Martin Luteri (Martin Luther), Xhon Kalvini (John Calvin) dhe disa reformatorë të tjerë protestantë që i ndriçuan mendjet e besimtarëve për rëndësinë e reformimit edhe karshi pozitës së grave të cilat filluan të trajtohen gjithnjë e më shumë si të barabarta. Meqenëse ka pak të dhëna mbi jetën e grave të zakonshme në këtë periudhë, sidomos nga shek. XVI, në këtë studim jemi përpjekur ta shpalojmë jetën dhe veprimtarinë e Katarina fon Bora - Luter (Katharina fon Bora - Luther), bashkëshortes së reformatorit të madh Martin Luterit dhe njëres nga mbështetëset dhe përqafueset më aktive dhe më të pasionuara të reformës dhe ndryshimeve, sidomos në martesë, në edukim por edhe në përfshirjen e gruas në zhvillimin e ekonomisë familjare. Këtë vështrim e kemi bërë duke e analizuar librin “Mbretëresha e Reformacionit” të Çarls Ludvig të botuar për herë të parë në gjuhën shqipe, me ç’rast është përdorur edhe literatura shtesë.

Nëpërmjet këtij studimi, gjithnjë duke u bazuar në literaturën në dispozicion, ne i kemi shpërfaqur disa nga vështrimet e të tjerëve mbi martesën mes Martin Luterit dhe Katarina fon Boras, një martesë e cila, ndonëse zgjoi shumë debate, megjithatë rezultoi të jetë shumë e suksesshme dhe e rëndësishme për kohën. Gjithashtu këtu shpaloset edhe roli i Katarinës si mbështetëse e Martin Luterit në punën e tij si pastor, profesor dhe udhëheqës i madh i Reformacionit Protestant.



## HYRJJE

Gjatë historisë së njerëzimit gratë, në të shumtën e rasteve, janë parë vetëm në rolin e nënës dhe amvise. Edhe në ditët e sotme kjo situatë nuk ka ndryshuar gjithaq, sepse gratë, në shumë shoqëri dhe nga shumë bashkësi fetare vazhdojnë të konsiderohen më pak të vlefshme se burrat, të fitojnë më pak se burrat dhe të gëzojnë më pak privilegje se burrat. Vazhdojnë të jenë të pakta gratë të cilat mbajnë pozita udhëheqëse si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat dhe kjo qasje është veçanërisht e shprehur në bashkësitë fetare. Dhe kjo pozitë e gruas rrënjët e saj i ka thellë në besim, në kulturë, në aspekte të ndryshme historike, sociologjike dhe politike të formimit dhe zhvillimit të shoqërive gjatë historisë, ngase për shekuj të tërë gruaja konsiderohej si krijesë e klasës dhe rangut të dytë.

Ta analizosh pozitën e gruas në Evropën e shekullit të gjashtëmbëdhjetë, kur kishte shumë probleme sociale dhe jo më pak ekonomike që çuan në krijimin e një klime të pakënaqësisë ishte akoma më e vështirë, sepse shtypja e vazhdueshme dhe denigrimi kishte nxitur pakënaqësi dhe të pakënaqurit, siç do ta shohim edhe në rastin e motrave të rendit Cistercian<sup>1</sup>, shpejt ose vonë do të fillojnë ta shpërfaqin pakënaqësinë e tyre, pra dëshirën për të ndryshuar. Andaj edhe lëvizjet e të pakënaqurve, dijetarëve dhe avangardëve shtuan aspiratat për ndryshim në çdo fushë të jetës gjë që çoi në reforma edhe brenda kishës. Ngase vetëm pakica ishte e pasur, si dhe ishin fisnikët ata që e përfaqësonin institucionin e kishës, ndërsa shtresa e mesme, fermerët e të tjerët mbanin gjallë këtë shtresë të të pasurve dhe kishën. Evropa ishte e bashkuar rreth fesë dhe kontrollit të Papës. Ishte e bashkuar rreth gjuhës dhe shkrimit latin dhe sistemit arsimor të zhvilluar nga Kisha në të cilin sistem gruaja ishte e përjetshme ose në rastin më të mirë ishte në shërbim të burrave.

Duke nënvizuar kritikën e Rosalinda Shaw (Shaw, R. 1995) për fenë si një kategori *sui generis* nga këndvështrimi e gjinisë, kërkimi

<sup>1</sup> Një cistercian është anëtar i Urdhrit Cistercian (/ sɪstɜːtʃən /, [1] shkurtuar si OCist ose SOCist (Latinisht: (Sacer) Ordo Cisterciensis. Urdhri i cistercitëve të respektimit të rreptë (i njohur edhe si "Trappistë") është një urdhër fetar religjioz romak katolik, i përbërë nga manastiret e murgjve dhe manastiret e murgeshave. Ata janë pjesë e familjes më të madhe cisterciane e cila daton që nga 1098. Cistercianët ndjekin edhe Rregullin e Shën Benediktit dhe kështu janë edhe pjesë e familjes benediktine. <https://presmarymethuen.org/sq/dictionary/what-are-the-main-differences-between-the-different-catholic-monastic-orders/>

ynë empirik në radhë të parë ka për qëllim ta shpalosë rolin tradicional të gruas në shoqëri, me theks të veçantë në shoqërinë e shekullit të gjashtëmbëdhjetë, si dhe ta dekonstruojmë rolin e gruas në komunitetet fetare duke e analizuar jetën e Katarina fon Bora, të ashtuquajturës *Mbretëreshë të Reformacionit*.<sup>2</sup> Dekonstruimin e kemi bërë duke u mbështetur në argumentin e Rosalind Shaw i cili thotë se *homo religiosus*, si përfaqësues i një kolektivi fetar, përgjithësisht është "i padiferencuar sipas gjinisë, racës, klasës ose moshës dhe nuk përcaktohet qartë si mashkulli" (1995, fq. 67). Shi për këtë nëpërmjet Katarina fon Boras e kemi studiuar një ndërtim të veçantë kulturor të gjinisë në funksion të fesë si një parametër kryesor, i cili përcakton se kush e bën dhe kush nuk mban kapacitetin ontologjik të qasjes në pozita të kontrollit dhe vazhdimit të traditës dhe strukturës së saj shoqërore.

### ROLI I GRUAS SIPAS KISHËS

Pozita e gruas dhe roli i saj në shoqëritë e hershme, të bartura deri në ditët e sotme, janë determinuar nga roli i Evës, gruas biblike e cila ka luajtur një rol të madh në Krishterim dhe kryesisht ka të bëjë me mëkatin e saj. Ajo mëkatoi dhe e tundoj edhe Adamin ta ndiqte atë, gjë që e shtyu Zotin ta sakrifikonte në kryq Jezusin, që konsiderohet të jetë Biri i Zotit.<sup>3</sup> Me fjalë të tjera, një grua duke vepruar vetë shkaktoi rënien e njerëzisë.<sup>4</sup> Shi për këtë edhe bijat e saj janë mëkatarë si ajo dhe duhen të trajtohen si të tilla. Një tonë të tillë dhe shumë të ashpër do ta gjeni edhe nga Shën Pali në Dhiatën e Re. Pozita e gruas dhe mundësitë e grave për ta përzgjedhur mënyrën e jetesës në fillim të shekullit të gjashtëmbëdhjetë ishin të kufizuara, ndërsa të jetuarit si një grua e vetme e pavarur thjesht nuk ishte një opsion i mundshëm. Sipas kishës, për mëkatin që kishte bërë gruaja, mëkatarja e cila e mishëronte Evën, duhej t'i nënshtrohej burrit, sepse vetëm ai do t'ia mundësonte pastrimin e shpirtit dhe trupit, faljen e mëkatit. Andaj gratë nga nënshtrimi i prindërve kaluan në atë të

<sup>2</sup> Këtë nofkë e kemi hasur në librin e Çarls Ludvigut (Charles Ludwig) *Mbretëresha e reformacionit*, botuar në vitin 1986.

<sup>3</sup> Kleinhans, K.(2015); *Women and the Reformation: Then & Now*; në Ueb faqen e Living Lutheran <https://www.livinglutheran.org/2015/09/women-reformation-now/>

<sup>4</sup> Ruter, Rozmari R. (1987); *Krishterimi*, në Arvind Sharma, *Women in World Religions*, Albany: State University of New York Press, fq. 209.

burrave dhe, më pas, nëse i mbijetonin bashkëshortit të tyre, i nënshtroheshin djalit më të madh.<sup>5</sup> Për shekuj me radhë kisha kishte mësuar se qëllimet kryesore të ekzistencës së gruas ishin që t'i shërbente burrit dhe të siguronte riprodhimin nëpërmjet martesës. Shi për këtë ia vlen të theksohet se ishin reformatorët Martin Luteri dhe Gjon Kalvini të cilët nxitën një kuptim të ri të martesës, duke e cilësuar atë si shoqërim i dy të dashurve që janë besnik ndaj njërit-tjetrit<sup>6</sup>, duke e vlerësuar njëkohësisht edhe statusin e gruas si bashkëshorte dhe nënë.

Për më tepër, vajzat kishin të drejtë arsimimi dhe mund të lexonin dhe shkruanin vetëm nëse do të vendoseshin në manastiret e grave, ambiente këto ku jetohej në një komunitet të grave të moshave dhe prejardhjeve të ndryshme, ambiente në të cilat ishte vendosur edhe Katarina fon Bora qysh në moshën dhjetëvjeçare, pas vdekjes së të ëmës dhe rimartesës së të atit. Shi për këtë, mbyllja e manastireve të grave nga ana e reformatorëve sikur e zhbëri edhe mundësinë e vetme që kishin disa vajza për të marrë një edukim, i cili i përgatiste që në një të ardhme ta udhëheqin ekonominë familjare.<sup>7</sup>

Megjithatë, sipas Katrina Klajnhans, reformatorët promovuan arsimin për të gjithë djemtë dhe vajzat, gjë që ishte e habitshme për kohën. Arsimi ishte në dispozicion vetëm për djemtë me status më të lartë shoqërorë ose ekonomik. Sipas Klajnhans, Martin Luteri inkurajoi komunitetet për të krijuar dhe mbështetur shkollat dhe u kërkoi prindërve t'i dërgonin fëmijët e tyre - djemtë dhe vajzat - në shkollë në vend që t'i mbanin në shtëpi për të punuar. Por edukimi për vajzat ishte shumë më pak i gjerë sesa për djemtë. Vajzat ndoqën shkollën më pak orë në ditë sesa djemtë dhe për pak vite, me aftësi të orientuara drejt leximit të Biblës, me qëllim përgatitjen e tyre për të udhëhequr një familje dhe për t'ua mësuar besimin fëmijëve të tyre.

Disa përparime për gratë në reformimin e shekullit të gjashtëmbëdhjetë megjithatë janë evidente, ndonëse të pakta, sepse shumica e grave të pastorëve ishin të shkolluara. Njëra prej tyre ishte edhe Katarina fon Bora, e cila u martua me reformatorin e mirënjohur Martin Luterin dhe që vendosi standardin e më shumë roleve që i janë dhënë gruas së një pastori. Ajo konsiderohej një model i përsosur për

<sup>5</sup> Kleinans, K.(2015); Women and the Reformation: Then & Now;

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Po aty.

ato gra që, ashtu si ajo vetë, ishin martuar me një klerikë, por edhe për gratë tjera familjet e të cilave kishin përqafuar Reformacionin.

### KATARINA FON BORA

Sipas librit “Mbretëresha e Reformacionit” të Çarls Ludvigut, historia e jetës së Katarina fon Boras është jo shumë më ndryshe se ajo e vajzave të rangut të saj shoqëror. E lindur në një familje fisnikësh jo shumë të pasur, ajo fillimisht është dërguar për të jetuar në një manastir benediktian në Brehna kur ishte shumë e re, mes pesë dhe gjashtë vjet.<sup>8</sup> Në këtë manastir ajo mësoj shkrimin dhe leximin, gjë që ishte një e arritur e madhe për gruan e asaj periudhe si dhe morri mësimet e para të gjuhës latine, gjë që do ta ndihmonte në leximin e Biblës. Për një familje fisnike dërgimi i vajzave në një manastir ishte i zakonshëm. Ishte një "marrëveshje familjare" e praktikuar gjeneratë pas gjenerate në familjet fisnike gjermane. Në këtë manastir Katarina mori mësimet e para, mirëpo më pas babai i saj e largon nga aty dhe e dërgon në manastirin Cistercianë Marienthrön në Nimpsh (Nimbschen), e vendosur menjëherë në jug të Grimma-s, në rrethin e Lajpcigut (Leipzig), ku në pozitën e kryemurgeshës ishte halla e saj Margaret fon Bora. Ajo e kaloi pjesën më të madhe të jetës së saj të hershme e izoluar në këtë manastir në Nimbschen ku mësoi të lexonte, të shkruante, të fliste latinisht dhe të këndonte. Edhe pse Katarina me siguri nuk ka punuar në fusha, megjithatë besohet se gjatë kohës sa ka jetuar në këtë manastir ajo i mori mësimet e para mbi menaxhimin e një ndërmarrjeje bujqësore në shkallë të gjerë, gjë që doli të jetë e dobishme për të dhe familjen e saj në vitet e mëvonshme.<sup>9</sup> Është e mundur që ajo gjithashtu mësoi të bëjë bilancin e librave, të menaxhojë një fermë dhe të kujdeset për të sëmuret pas mureve të manastirit. Në këtë manastir i dërguan bijat e tyre për të jetuar atë që ata mendonin se ishte më e shenjta e të gjitha jetëve edhe shumë familje fisnike. Të shumta ishin ato të cilat ishin sjellë aty nga prindërit e tyre. Ishin të shumta motrat që kishin kaluar jetën e tyre të pendesës dhe vetëmohimit brenda këtyre mureve, e akoma më shumë të atyre që u penduan për përzgjedhjen e tyre. Ndonëse ditët e tyre të

<sup>8</sup> [http://www.pbs.org/empires/martinluther/char\\_wife.html](http://www.pbs.org/empires/martinluther/char_wife.html)

<sup>9</sup> Treu, Martin; Katharina von Bora, the Woman at Luther's Side; Lutheran Quarterly Vol. XII (1999).

<http://www.lutheranquarterly.com/uploads/7/4/0/1/7401289/timelinetreu.pdf>

gjata ishin të mbushura me vepra të bamirësisë dhe me aktivitete ditore, jeta ishte e rëndë dhe me plot sakrifica. Këtë mundoheshin ta kompenzonin nëpërmjet leximit të librave, të cilët pas shpikjes së shtypshkronjës së Gutenbergut filluan të arrijnë te të gjitha shtresat.

Kështu, në mesin e librave të cilat u sollën në manastir ishte pamfleti i Martin Luterit, i cili ia trazoi zemrën Katerinës dhe motrave tjera dhe ua lëkundti bindjen se mbyllja në një manastir është e vetmja mënyrë për ta shpërfaqur besimin dhe vetëmohimin. *Traktati i Luterit mbi manastiret*<sup>10</sup> bëri që shumë nga ato t'i hapin sytë. Ishte ky një zbulim tjetër për to, sepse deri atëherë ato kishin jetuar me bindjen se një jetë brenda mureve të shenjta të manastirit ishte më e këndshme dhe më e shenjtë në sytë e Perëndisë, ndonëse Luteri, ideatori i 95 tezave, thoshte se një jetë në një manastir nuk është një jetë e vërtetë e krishterë; se jeta e tyre nuk është më e pastër, as më e mirë, as më e shenjtë se ajo e njerëzve të zakonshëm; se jeta e një ndjekësi të vërtetë është vetëm izolim, jo një arratisje nga tundimet, por që ta mbajë nën vete, t'i përballojë ato. Dhe sidomos pamfleti i Luterit mbi martesën, ku shkruante “sepse fjala e Perëndisë që ju ka krijuar dhe ka thënë: ‘shtohuni dhe shumëzohuni’ banon dhe sundon brenda jush dhe mbi të gjitha është urdhëresë e Perëndisë<sup>11</sup>, bëri që murgeshat e Nimpshit të kaplohen nga idetë e reja mbi të cilat edhe vendosën të vepronin. Dhe sa më shumë lexonin, aq më i thellë dhe më i ngrohtë bëhej entuziazmi i tyre për Martin Luterin, fjalët e tij dhe vargun biblik: “*i drejti duhet të jetojë me besim*” (Rom.1:7).<sup>12</sup>

Mirëpo ajo që bën shumë përshtypje është fakti se familjet (prindërit, vëllezërit dhe motrat) e motrave nuk ishin të gatshëm që t'u dilnin në ndihmë bijave të tyre, ndonëse sipas Ludvigut, tri nga murgeshat iu bashkuan familjeve dhe se njëri nga baballarët e falënderon Leonard Kopin duke i thënë: “Ti je një Mojsi i dytë” nga gëzimi për takimin e serishëm me të bijën.

Luteri, me ndihmën e Leonard Kopes nga Torgau dhe Wolfgang Tomitzsch e mundësoi ikjen e tyre nga manastiri, ndërsa shumë shënime thonë se nëntë murgeshat<sup>13</sup> u takuan në qelinë e Katarina fon

<sup>10</sup> Ludvig, Ch. (1986, 2007); Mbretëresha e Reformacionit; botuar nga Operation Mobilisation Greater Europe for the Albanian Edition;

<sup>11</sup> “Vepra e Luterit” vëllimi 45, fq. 18

<sup>12</sup> Sipas Charls Ludvig (2007) ky varg shpesh u përdor nga Katerina gjatë përpjekjeve të saj për ta nxjerrë nga depresioni bashkëshortin e saj Martin Luterin.

<sup>13</sup> Nëntë murgeshat, të cilat me guxim i hoqën lidhjet e panatyrshme të kishës

Boras, ku edhe e planifikuan shpëtimin.<sup>14</sup> Që të gjitha u vendosën nëpër shtëpitë e personave të cilët me mirësi i pranuan ato,<sup>15</sup> ndërkohë që u njohën me djem me të cilët edhe u martuan. Pavarësia e ish-motrave në përzgjedhjen e së ardhmes së tyre, zhvillimi i mendimit dhe liria e vullnetit dhe e veprimit ia vlen që të përmenden dhe t'i atribuohen Martin Luterit, sepse rezultoi me krijimin e një karakteri të fortë dhe njëkohësisht janë shenjë e parë e mbështetjes së gruas në vendimmarrje sidomos në ato raste kur bëhet fjalë për të ardhmen e tyre.

## KATARINA FON BORA DHE MARTESA ME MARTIN LUTERIN

Se jeta e gruas në shekullin XVI të nuk ishte e lehtë shihet edhe nëpërmjet biografisë së Katarina fon Boras. Jeta jashtë një rendi kur të gjitha vendoseshin nga të tjerët ishte një sfidë për Katarinën. Autorët e shumtë, ndër të cilën edhe Çarls Ludvig, tregojnë për vuajtjet e gruas për ta siguruar ekzistencën. Dhe derisa i bënim kërkimet tona, ne as edhe një herë të vetme nuk e kemi larguar nga mendja se duhet të shohim gratë e shtresave të mesme dhe të ulëta, nga ato që kafshatën e gojës e siguronin nëpërmjet punëve të shtëpisë, por edhe në fushë. Katarina fon Bora e ballafaquar me këto probleme e dinte se duhej të martohej që t'ia lehtësonte jetën vetes.

Në librin “Mbretëresha e Reformacionit” të Çarls Ludvigut e gjejmë se, duke refuzuar një numër ofertash Katarina i propozon Martin Luterit që të martohet me të, gjë të cilën Martin Luteri e bëri, përkundër rezistencës dhe kritikave si nga armiqtë, ashtu edhe nga miqtë e tij. Gjatë martesës ajo solli në jetë tre djem dhe tri vajza<sup>16</sup>.

---

romake dhe me gëzim hasën çdo sprovë që do të hapte rruga për një jetë të vërtetë në Krishtin - duke gjetur të vërtetën që i bën njerëzit të lirë - ishin Magdalena Staupitz, Elizabeth Kanitz, Eva Gross, Eva dhe Margaret Schonfeld, Laneta Golis, Margaret dhe Catherine Zeschau dhe Catherine von Bora.

<sup>14</sup> Kelleman, B. (2010); *Women of the Reformation, Part 3: Katherine von Bora Luther: Living the Truth in Love*; për më shumë shih ueb faqen: <http://www.rpmministries.org/2010/09/women-of-the-reformation-part-3-katherine-von-bora-luther-living-the-truth-in-love/>

<sup>15</sup> [http://lutheranreformation.org/wp-content/uploads/2016/04/ref500-vonBora\\_Handout.pdf](http://lutheranreformation.org/wp-content/uploads/2016/04/ref500-vonBora_Handout.pdf)

<sup>16</sup> Më 7 qershor 1526 lindi Johannes (Hans) djali i tyre i parë. Elisabeth, vajza e tyre e parë u lind më 15 dhjetor 1527, por vdiq pas 8 muajsh. Vajza e tyre e dytë Magdalena lindi në 14 maj 1529 dhe vdiq në moshën 12 vjeç. Në 1531, 1533 dhe 1534 lindën djemtë e tyre Martin dhe Paul dhe vajza Margarethe. Të gjithë pasardhësit e gjallë të Martin Luterit vijnë nga linja e Margaretes. Vdekja e

Ndonëse një martesë pa dashuri (si shumë martesë tjera të cilat lidheshin në atë kohë, por edhe sot), më pas, sipas Martin Luterit, Katarina do të bëhej e pazëvendësueshme për të dhe se nuk do ta shkëmbente Katin e tij “as për Francën dhe as për Venedikun”<sup>17</sup>. Në fakt Luteri do të thoshte për Katarinën: “Po ta humbisja Katin tim nuk do të merrja një grua tjetër, edhe sikur të më ofrohej një mbretëreshë”<sup>18</sup>.

Katarina ka bërë që Martin Luteri ta ndryshojë rrënjësisht opinionin që kishte për gratë dhe rolin e tyre në familje. Shi për këtë atë e shohim si pjesëmarrëse dhe kontribuuese në të gjitha bisedat e Martin Luterit me elitat intelektuale të kohës, duke sfiduar kështu mentalitetin e kohës. Nga dokumentet dhe shënimet e pakta, përfshirë këtu edhe letrat e Martin Luterit drejtuar Katarinës<sup>19</sup> del se ai nuk kishte asnjë sekret përpara saj dhe se opinionin e saj e vlerësonte shumë. Për më tepër, sipas miqve të tij të kohës, Martin Luteri besonte se lëvizja e Reformacionit nuk do të kish qenë e tillë pa kontributin e Katarina fon Boras. Për vlerat e pamohueshme dhe ndikimin e saj në jetën e Martin Luterit tregon fakti se shumë nga miqtë e tij mendonin se “disa nga idetë e Luterit ishin në të vërtetë ide të Katarinës”.<sup>20</sup> Ky është mbase komplimenti më i madh që i jepet Katarinës, respektivisht një gruajë e cila shënoi një kthesë të madhe në shoqërinë e asaj kohe falë vetëbesimit të madh, vullnetit për punë dhe ndryshimeve, një gruajë të fortë dhe të pavarur, virtyte këto që ishin të pazakonta për gratë e asaj kohe.

## KATARINA FON BORA GRUA, NËNË DHE EKONOMISTE

Në shekullin XVI nga një grua pritej të ishte shoqëruese e burrit të saj dhe mbështetëse në hije e tij. Gjatë kësaj periudhe del se nga gratë pritej që t’iu binden burrave, gjë që i kufizonte veprimet e tyre. Sipas Martin Treut, një historian në Shoqërinë Luther në Wittenberg

---

Magdalenës përmbysi çiftin e martuar në një krizë të thellë.

<sup>17</sup> [http://lutheranreformation.org/wp-content/uploads/2016/04/ref500-vonBora\\_Handout.pdf](http://lutheranreformation.org/wp-content/uploads/2016/04/ref500-vonBora_Handout.pdf)

<sup>18</sup> Kelleman, B. (2010); *Women of the Reformation*, Part 3;

<sup>19</sup> Smith, J. (1999). Katharina von Bora through Five Centuries: A Historiography. *The Sixteenth Century Journal*, 30(3), 745-774. doi:10.2307/2544815

<sup>20</sup> Curry, Andrew (2017); *How a Runaway Nun Helped an Outlaw Monk Change the World*, botuar në National Geographic.

<https://www.nationalgeographic.com/news/2017/10/martin-luther-wife-protestant-reformation-500/>

dhe autor i një biografie të fon Boras, gratë në atë kohë shiheshin si pjesë e familjes, shoqërisë, por zëri i tyre nuk dëgjohej. Mirëpo kishte disa gra gjatë Reformës të cilat nuk ishin aq të kufizuar sa gratë e tjera dhe Katarina fon Bora, e cila u martua me reformatorin e mirënjohur Martin Luterin, vendosi standardin e më shumë roleve që i janë dhënë gruas së një pastori. Ajo konsiderohej gjithashtu një model i përsosur për ato gra që, ashtu si ajo vetë, ishin martuar me një klerikë.

Në librin e tij “Mbretëresha e Reformacionit”, Charls Ludvig thotë se Martin Luteri gjatë bisedës me një student në dhomën e tij të studimit, kur flet për *Letrën e Palit drejtuar Galatasve*, thotë se është një nga librat e tij të preferuar dhe se një pasus në kapitullin e dytë i kujton gruan e tij, Keti fon Bora. Ndërsa pasusi sipas Ludvigut thoshte me sa vijon:

*“Mos të lodhemi kurrë duke bërë mirë; me të vërtetë, sepse nëse nuk do të lodhemi, patjetër që në kohën e duhur do të korrim.”*

Ky pasus tregon se sa e palodhshme ishte Katarina fon Bora. Dhe ajo që mbillte Katarina nuk ishte vetëm dashuria për Martin Luterin dhe fëmijët e tyre, frytet e së cilës i gëzonte çdo ditë, por edhe menaxhimi i ekonomisë familjare, sepse i shoqi një dorëlëshuar, por një njeri bujarë, i cili i bënte strehë qindra njerëzve edhe në kohën e krizave të mëdha, si në kohën e shfaqjes së murtajes, nuk donte t’ia dinte se sa kishin. Kështu, Katarinën, e cila njih parimet e tregtisë, e shohim si një grua që merret me prodhimin, shpërndarjen dhe konsumimin e mallrave dhe shërbimeve të biznesit familjar, që përbëhej nga bujtina dhe fabrika e birrës, si dhe si një grua që njëkohësisht merret me kopshtari, bujqësi e me rritjen e bagëtive dhe vetitë shëruese të barishteve nga mund të prodhohen ilaçe. Këto aftësi të saj përmenden edhe nga vetë Martin Luteri i cili, sipas dr. Bob Kellemanit, e vlerësoi shkathhtësinë dhe kreativitetin e saj, duke thënë se "gruaja ime është predikuese, prodhuese e birrës, kopshtare",<sup>21</sup> e në raste i referohej edhe si "mjeshtër Keti, luteriane, doktoreshë dhe priftëreshë e Uitenbergut (Wittenberg) që drejton një ekip, një fermë dhe kullotat përreth dhe . . . në mes të gjitha këtyre punëve e lexon Biblën".<sup>22</sup> Njëkohësisht atë e shohim edhe si person kyç në jetën e të

<sup>21</sup> Kelleman, B. (2010); *Women of the Reformation*, Part 3;

<sup>22</sup> [http://www.rpmministries.org/2010/09/women-of-the-reformation-part-3-katherine-von-bora-luther-living-the-truth-in-love/!](http://www.rpmministries.org/2010/09/women-of-the-reformation-part-3-katherine-von-bora-luther-living-the-truth-in-love/)



shoqit, sepse ajo e inkurajonte që të vazhdonte me punën edhe në momentet më të rënda. Angazhimi i saj bëri që manastiri që Princ Frederiku ia kishte dhuruar Martin Luterit të shndërrohej në një biznes fitimprurës dhe në një shtëpi të përshtatshme në të cilën Martin Luteri mund t'i organizonte takimet e rëndësishme, bisedat, diskutimet të cilat ishin të një rëndësie të veçantë,<sup>23</sup> dhe idetë që dolën në to janë dokumentuar dhe mund të gjenden në vëllimin e titulluar “3000 biseda në tryezën e Martin Luterit” atëherë kur kalonte momente të vështira shpirtërore, kur depresioni kishte kapluar mendjen e tij të ndritur, kur humbën fëmijët dhe prindërit. Sipas djalit tyre Palit, më vonë një mjek, ajo ishte si gjysmë doktori, sepse pa përkushtimin e saj Martin Luteri nuk do ta kishte mbijetuar depresionin e tij, të cilin ai e interpretonte si tundime satanike.<sup>24</sup>

## PËRMBYLLJE

Përkundër mungesës së dokumenteve të cilat në mënyrë specifike e sheshojnë rolin dhe kontributin e Katarina fon Boras gjatë periudhës së reformacionit, në librin “Mbretëresha e reformacionit” të Çarls Ludvig e gjejmë se, megjithatë, informatat e pakta e kanë portretizuar atë si një grua të fuqishme e cila jetoi dhe veproi krah për krah me Martin Luterin në një shoqëri e cila mbizotërohej nga meshkujt. Me këto vërejtje përfundimtare mbi jetën dhe veprimtarinë e Katarina fon Bora – Luterit në këtë studim kemi paraqitur një pjesë të jetës së gruas e cila la shenja të pashlyeshme në një epokë shumë të ndritshme për Protestantizmin dhe Reformacionin, një epokë me shumë sfida dhe rreziqe politike, fetare dhe shëndetësore. Me këtë rast kategoritë e tilla si 'gruaja' ose 'feja', jemi munduar që t'i ilustrojmë përtej një trajtimi klasik që mbart qasja, sepse në këtë punim jo vetëm që kemi shpalosur këto dy kategori, por jemi përpjekur të dekonstruojmë rolin e gruas në shekullin XVI nëpërmjet jetës së Katarina fon Boras në favor të ruajtjes së origjinalitetit të burimeve të cilave ju kemi referuar. Sepse në një farë mënyre, edhe pse jo plotësisht, reformimi protestant u kishte hapur dyert e çlirimit grave, që nga largimi nga jeta e kufizuar si murgësja drejt marrjes së roleve

<sup>23</sup> Luther, Martin (1483-1546); Table Talk; William Hazlitt, Esq. (19??-) (Translator) Publisher: Grand Rapids, MI: Christian Classics Ethereal Library; <https://holybooks.com/table-talk-by-martin-luther/>

<sup>24</sup> Kelleman, B. (2010); Women of the Reformation, Part 3.

të gjithanshme, për të cilat Katarina fon Bora është një shembull unik, sepse jeta e saj u kthye në një paradigmë për gratë që të zgjerojnë identitetet e tyre individuale dhe të pavarura në kontekstin e pabarazisë dhe padrejtësisë ndaj grave që mbizotëronte në mesjetë.

Andaj metodologjikisht ideja e paraqitjes së grave si agjendë aktive fetare, politike dhe ekonomike, si simbole të përfaqimit të protestantizmit dhe mbështetjes së reformacionit nëpërmjet një diskursi fetar besojmë se u tregua i dobishëm.

#### LITERATURA:

- [1] Kelleman, B. (2010); Women of the Reformation, Part 3: Katherine von Bora Luther: Living the Truth in Love; për më shumë shih ueb faqen: <http://www.rpmministries.org/2010/09/women-of-the-reformation-part-3-katherine-von-bora-luther-living-the-truth-in-love/>
- [2] Kleinhans, K.(2015); Women and the Reformation: Then & Now; në Ueb faqen e Living Lutheran <https://www.livinglutheran.org/2015/09/women-reformation-now/>
- [3] Ludvig, Ch. (1986, 2007); Mbretëresha e reformacionit; botuar nga Operation Mobilisation Greater Europe for the Albanian Edition.
- [4] Luther, Martin (1483-1546); Table Talk; William Hazlitt, Esq. (19??-) (Translator) Publisher: Grand Rapids, MI: Christian Classics Ethereal Library; <https://holybooks.com/table-talk-by-martin-luther>.
- [5] Magee, P.M. (1995, 2000.), Disputing the Sacred: Some Theoretical Approaches to Gender and Religion, in: Religion and Gender, (ed.) Ursula King, Blackwell, Oxford & Cambridge USA, 101–120.
- [6] O'Connor, J. (1995, 2000), The Epistemological Significance of Feminist Research, in Religion, in: Religion and Gender, (ed.) Ursula King, Blackwell, Oxford & Cambridge USA, 45-63.
- [7] Shaw, R. (1995). 'Feminist anthropology and the gendering of religious studies', in U. King (ed.), *Religion and gender*, 65–76. Oxford: Blackwell.
- [8] Smith, J. (1999). Katharina von Bora through Five Centuries: A Historiography. *The Sixteenth Century Journal*, 30(3), 745-774. doi:10.2307/2544815.
- [9] Treu, Martin; Katharina von Bora, the Woman at Luther's Side; *Lutheran Quarterly* Vol. XII (1999). <http://www.lutheranquarterly.com/uploads/7/4/0/1/7401289/timelinetreu.pdf>



Jean-Pierre MARCOS\*

PARATHËNIE PËR LIBRIN E MUHAMEDIN  
KULLASHIT *FOUCAULT ET LEFORT : REGARDS  
CROISÉS SUR LA MODERNITÉ (FOUCAULT DHE  
LEFORT: SHIKIME TË KRYQËZUARA MBI  
MODERNITETIN)*, L'HARMATTAN, PARIS, 2020.

Shikuar nga disa aspekte ambicja e punës së Muhamedin Kullashit në këtë libër është që të ripërtërijë vlerën filozofike të veprës së të menduarit të Claude Lefort-it. Vepër kjo fati teorik i së cilës ka pësuar për shkak të kritikave që ai u drejtonte intelektualëve dhe filozofëve nga e majta se kanë shfaqur një «verbëri të theksuar» në fushën e filozofisë politike. Verbëri e qëllimshme e cila shprehej në refuzimin e tyre që të bëjnë çështje në saje të një analize diferenciale, specificitetin e fenomenit totalitar dhe rrjedhimisht të identifikojnë veçantinë e demokracisë si regjim i modernitetit.

Mirëpo ky hulumtim nuk ka për qëllim të bëjë një apologji të argumentuar të filozofit Claude Lefort. Muhamedin Kullashi zhvillon këtu një hapësirë të të menduarit ku nuk pranohet një receptim shumë i drejtpërdrejtë i sintaksës së nëntitullit të librit të tij. Ndryshe nga alternativa e thjeshtëzuar, nga konfrontimi i drejtpërdrejt, që ka të bëjë me cilësimin tematik të modernitetit tonë politik (si, fjala vjen, prezantimin shumë të qartë të autorit të konfrontimit midis Habermas-it dhe Foucault-së) - «Zbulimi i disiplinave *apo* zbulimi i demokracisë» pra ose Foucault-ja *ose* Lefort-i, autori me subtilitet dhe saktësi, që mbështeten në një njohuri të thellë të temave që i trajton, nuk përgjigjet asnjëherë në terma të lidhjes Foucault *dhe* Lefort, e as në terma të klerarkisë. Ç'është e vërteta, një logjikë e kryqëzimit e organizon zhvillimin e përgjithshëm të veprës, mirëpo ajo shoqërohet me një parim të artikulimit preciz të linjave argumentuese dhe shpesh paralele, ku çdonjëri prej filozofëve që trajtohet vëhet në sprovë të mendimit të tjetrit në atë mënyrë që paraqiten sa divergjencat e pozicioneve të tyre, po aq edhe pikat e konvergencave të disa

---

\* Jean-Pierre Marcos është filozof dhe psikanalist. Ligjëron në Universitetin Parisi 8.

analizave të tyre. Megjithatë, ndonëse linjat prehen dhe përputhen në disa pika të planit imanent të shtjellimit dhe të zhvendosjes së të menduarit që analizohet, ato nuk ngatërrohen asnjëherë.

Me një rigorozitet të madh, fjala vjen, autori na tërheq vërejtjen që të evitojmë ngatërrimin e përdorimit të rëndomtë të emrave dhe përcaktimit të të kuptuarit dhe shtrirjes së koncepteve. Kësisoj, interpretimi të cilin e propozon Foucault në seminarin e Collège de France *Pushteti psikiatrik* mbi përmbysjen e mbretit Georges III, «i cili e humbi kokën nga çmendia», ka për qëllim të vë në pah se pas pushtetit të sovranit vjen një «pushtet anonim, i shumfishtë, i zbehtë, pa ngjyra» Kur pushteti pushon të identifikohet substancialisht me mbretin që e ushtron atë, ai shndërrohet në një «makineri» të cilën askush nuk mund të pretendojë më se e zotëron. Atëherë kjo tezë na kujton idenë e «pushtetit si vend i zbrazët», pushtet i papërvetësueshëm i demokracisë moderne, sipas Lefort; ajo nuk mund të na autorizojë t'i ngatërrojmë të dy doktrinën nga pikëpamja e analizës së tyre të çështjes së pushtetit.

Nga pikëtakimet midis dy autorëve figuron edhe interpretimi i ndryshëm që ata i bëjnë Kantorowicz-it dhe teorisë së dy trupave të mbretit, si dhe Shakespear-it dhe Machiavel-it. Ne kuptojmë kështu se në ç'mënyrë dhe me cilin qëllim Lefort e Foucault i kanë lexuar këta autorë dhe admirojmë shtjellimin e këtyre interpretimeve nga autori i cili nxjerr në shesh logjikën, principin dhe synimet e koncepcioneve të tyre. Të filozofosh për Muhamedin Kullashin don të thotë të lexosh dhe të rilexosh koncepcionet e autorëve të mëdhenj për të vënë në pah mënyrën se si ata nxjerrin në shesh gjetet e përvetësimit të momenteve që shpjegojnë ndërtimin e filozofisë së tyre.

## FIGURA E MOHIMIT

Mjaft shpesh autori zë në gojë figurën e mohimit, më shumë se atë të injorimit: *mohimi* i ndarjes midis shtetit dhe shoqërisë civile të Marx-i, *mohimi* totalitar i ndarjeve konstitutive dhe të pareduktueshme të tërë shoqërisë, anë e prapme e besimit në një shoqëri të bashkuar homogjene dhe transparente ndaj vetes, *mohimi* i veçantisë së totalitarizmit, i ekzistimit të gulagut, mohimi i parimit të të drejtave të njeriut në totalitarizëm, mohimi apo mosnjohja e origjinalitetit të ngjarjeve që prodhuan regjimin demokratik modern dhe karakteristikat e tij themelore si shpleksja e pushtetit, çtrupëzimi i

shoqërisë, vendi i zbrazët dhe i papërvetësueshëm i pushtetit, shpërbërja e kriterëve të sigurisë, papërcaktueshmërisë, mënyra e ndarjes thelbësisht konfliktuale e definimit të legjitimites dhe jolegjitimites pa e promovuar një garant absolut apo transcendent dhe duke e lënë të hapur debatin.

Nëse dallimi midis demokracisë moderne dhe totalitarizmit nuk mendohet ndryshe veçse si një dallim i shkallës, por jo i natyrës, do të thotë i esencës, nëse dënohet «demokracia totalitare» që frymëzohet nga analizat e Tocquevill-it (Tokvil), kjo na shpie te një «absurditet», siç thekson Lefort-i.

Në regjimin demokratik shteti tutor apo shteti i mirëqenies ose edhe shteti-providencë nuk buron nga një logjikë qeveritare e partisë unike, parimi i së cilës ka të bëjë me heqjen e lirive politike dhe qytetare, midis tjerash ajo e shprehjes publike të mendimit. Siç e përkujton dhe siç e demonstroi me mjeshtri autori, Lefort-i vazhdimisht ka përsëritur se «dispozitivi demokratik pengon që të bashkohen në një organ drejtues instanca e pushtetit, ajo e ligjit dhe ajo e njohjes».

#### VAZHDIMËSIA DHE UNIFORMIZIMI - DISKONTINUITETI DHE SPECIFICITETI

Lefort kishte vënë në pah në një debat të vazhdueshëm me Tocqueville-in – sa i takon çështjes së lindjes së formës moderne të demokracisë – se veçantia e demokracisë në raport ndaj sistemit monarkik në Regjiminin e moçëm (*Ancien Régime*), cilësonte gjithherë në mënyrë të ndërsjellë parimin demokratik dhe veçantitë e tij, karakterizim ky i domosdoshëm, ngase rëndësia e tij ndikonte që të vëhet në dukje gjithnjë e më mirë specificiteti i regjimit demokratik me veçoritë e tij. Lidhur me këtë, veprimi i tij na mbron nga rreziku i «tretjes së dallimeve» midis një shteti totalitar dhe një shteti demokratik». Pra, nuk mund të ngatërrohen kurrsesi regjimi i kondensimit të pushtetit, dijes dhe ligjit dhe një regjimi që mban dallimin midis këtyre instancave të ndryshme apo këtyre rendeve të ndryshme. Thënë me gjuhën e Pascal-it, i cili e definonte kështu në kohën e tij tiraninë: «Tirania ka të bëjë me dëshirën për sundimin universal dhe jasht rendit të tij. Dhoma të ndryshme, mendje të forta, të bukura, të mira, besimtare, secila prej të cilave sundon në hapësirën e vet, jo gjetiu, megjithëse ndonjëherë ata takohen. Dhe i forti e i

bukuri grinden marrëzisht se cili do të jetë zotëriu i tjetrit, sepse sundimi i tyre i takon llojeve të ndryshme. Ata nuk merren vesh. Gabimi qëndron aty se ata duan të sundojnë gjithkund. Askush nuk mund ta arrijë këtë qëllim, madje as forca. Ajo nuk ka ndikim te mbretëria e dijetarëve. Ajo zotëron vetëm aksionet e jashtme».

Ndaj këtij risku na kishte ekspozuar Foucault duke përfshirë së pari brenda «një shoqërie të normalizimit», fjala vjen në tekstin «Magjia dhe çmendia» (1976) Hungarinë totalitare dhe Ameriken: «sërisht - shkruan autori -, analiza e Foucault-së shpërbën specificitetet e dy shoqërive brenda këtij rrjeti normalizues», risk ky megjithatë i matur, ngase vitin e ardhshëm në një bisedë me Ranciëre, Foucault konteston peshën uniformizuese të kësaj analize të funksionimit të regjimeve politike demokratike dhe atyre totalitare, duke shpjeguar se «Gulagu nuk është një pyetje e cila mund t'u bëhet në mënyrë uniforme cilëso shoqërie». Nëse pyetja për gulagun duhet t'i shtrohet, në mënyrë specifike, çdonjerës nga shoqëritë socialiste, kjo u bë ngase Foucault, duke realizuar një zhvendosje brenda mendimit të tij arriti më në fund ta bëjë çështje «shpërbërjen universalizuese» të problemit të Gulagut në «formën e përgjithshme të qeverisjes» ose në formën e çdo teknologjie të pushtetit disiplinor. Libri *Lindja e biopolitikës* (1979) do të organizojë kësodore «kritikën inflacioniste të shtetit», duke përkujtuar se «Shteti providencë [...] nuk e ka as të njëjtën formë [...] e as të njëjtën rrënjë të shtetit totalitar» nacist, fashist apo stalinist. Shteti totalitar nuk buron nga një zhvillim immanent, i brendshëm dhe konstant i shtetit dhe cilësohet me një alteritet të thellë, i cili tani e tutje quhet «qeverisje e partisë».

Ky alteritet, kjo risi, do të thotë se tërësia e ngjarjeve dhe faktorëve që kanë prodhuar regjimin totalitar - një cilësi karakteristike e të cilave është urrejtja e demokracisë - do të bëhet objekt i filozofisë politike të Lefortit për aq sa ai gjithherë vuri në dukje origjinalitetin e regjimit demokratik modern.

Duke kritikuar interpretimet reduksioniste të doktrinave të shqyrtuara, autori tregon dhe dëshmon se Leforti nuk ka shkruar një vepër që bën apologjinë e demokracisë liberale. Lidhur me këtë do të mund të përmendej, në anën tjetër, vëmendja e Foucault-së për argumentin klasik marksist. Në fakt në atë masë sa demokracia moderne ishte e cilësuar thelbësisht, sipas Foucault-së, me terma të zbulimit dhe zgjerimit të pakufizuar të pushtetit të disiplinave, atëherë parimi politik i legalitetit të tij nuk është pra zbulimi i lirive apo njohja e të drejtave të njeriut; këto mbesin jo vetëm formale, por edhe

ideologjike dhe madje në atë masë sa afirmimi i mirëfilltë i barazisë së të drejtave sikur maskon gjithherë mosbarazinë e kushteve sociale dhe ekonomike.

Mirëpo kur Lefort zhvillon kritikën e kritikës marksiste të të drejtave të njeriut vetëm në aspektin e formalitetit të tyre abstrakt, ai e bënë këtë me qëllim që të ftojë çdonjerin, gjithherë sërish, që të pranojnë lindjen simbolike, transformimin rrënjësisht të ri të raportit në kuptimin e demokracisë moderne thellësia historike e së cilës ende nuk është shpalosur tërësisht. Lefort megjithatë i jap të drejtë Marx-it në atë masë sa ai kurrë nuk e ka mohuar se afirmimit teorik të lirive qytetare i kundërvihen në praktikë «mbrojtja e interesave të sunduesve», të cilën vetëm «lufta e gjatë e masave të mobilizuara» i kundërvihet padrejtësisë së eksploatimit ekonomik në kërkesat dhe «pushtimin e të drejtave të tyre».

Ne, pra, nuk duhet kurrë në emër të legjitimitetit të një kritike të përdorimit ideologjik të një formaliteti juridik abstrakt të injorojmë specificitetin e ushtrimit të pushtetit demokratik.

Autori vë në pah meritën e Foucault-së për vetëkritikën e disa qëndrimeve të tij. Në ligjëratën në Collège de France të 18 janarit 1978, Foucault deklaroi se kishte gabuar kur kishte theksuar në *Të mbikëqyrësh dhe të ndëshkosh* se shekulli XVIII i kishte ngarkuar të gjitha liritë me një «teknikë disiplinore». Mirëpo kjo kritikë nuk e kishte shpër Foucault-në, sipas autorit, te një ndryshim i rëndësishëm, ngase ai vazhdon ta shikojë lirinë thjesht si një korrelativ i vendosjes së dispozitivave të sigurisë», liri kjo tashmë e kufizuar në dimensionin e zhvendosjes: «liria e qarkullimit të gjërave dhe sendeve», ku nuk ka vend madje as për ndonjë liri të shprehjes.

Mësimi që na ofron Muhamedin Kullashi është i kthjellët. Krahas të gjitha të metave që ka, vepra e Lefortit dëshmon megjithatë se demokracia mbetet për të gjithë të shtypurit në regjimet totalitare në atë masë sa ajo ruan vlerën e lirive politike dhe individuale, një horizont të pamohueshëm të legjitimitetit, veçantinë e të cilit nuk mund ta mohojmë me arsyetimin se ajo mbetet e papërsosur apo se ajo ka aspekte të konsiderueshme të normalizimit që i takojnë teknologjisë disiplinore, e cila vepron duke udhëzuar më shumë se sa që ndalon. Duke theksuar tiparet e veçanta që definojnë regjimin demokratik në raport ndaj regjimit totalitar, Lefort mbështet mëvetësinë e një alteriteti reciprok të mënyrave të ushtrimit të pushtetit.



Na mbetet megjithatë t'i bëjmë vërejtje rregullisht demokracisë, se ajo nuk i mban premtimet e veta sa herë që lë anash perspektivën e zvogëlimit të pabarazive sociale dhe ekonomike, që heq dorë nga ambicja për t'i dhënë një efektivitet formës së domosdoshme të ligjit në fushat e arsimit, drejtësisë, informimit, shëndetsësisë. Sipas perspektivave të ndryshme dhe me një gramatikë të veçantë, Foucault dhe Lefort themeluan kësodore, përtej analizës së realitetit politik modern dhe demokratik, parimin prodhues të një rezistence dhe zhvillimin e kritikës teorike e praktike të kushteve të lirisë.

Rreze Kryeziu Breznica

## MUZIKA ARTISTIKE NË KOSOVË: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI LITERATURËN EKZISTUESE

Gjatë viteve 2012-2016 vedosa përfundimisht të përfshihem në hulumtime të hollësishme mbi muzikën artistike në Kosovë, fillet dhe zhvillimin e saj kontinuitiv. Kjo periudhë u pasua duke ndjekur të gjitha koncertet e jetës jo aq të pasur muzikore në vendin tonë, për të takuar muzikantë dhe kompozitorë, për të vazhduar me biseda të gjata, intervista të shkurta me muzikantë në festivale, koncerte dhe gjithashtu në Fakultetin e Muzikës në Prishtinë, për të marrë përshtypjet nga bisedat e zakonshme, por të mbushura me informacion, për të hulumtuar dhe dëgjuar vazhdimisht vepra të muzikës profesionale. Këto kanë qenë hapat më të rëndësishëm dhe cilësorë që kam ndjekur për t'i dhënë këtij hulumtimi formën e tij fillestare. Jo të gjithë kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të ndihmuar dhe mbështetur me informacion dhe më shpesh kjo jo gatishmëri më ka bindur mua si autor për mungesën e të dhënave dhe ruajtjen e tyre, mungesë kjo ndaj së cilës kam ndjerë një "vuajtje" individuale.

Hulumtimi aktual muzikologjik (p.sh. historik, shoqëror) në Kosovë nuk përqendrohet në arsyet e shfaqjes dhe zhvillimit të muzikës artistike, përkundrazi përqendrimi është vendosur në zhvillimin dhe menaxhimin e saj të mëtejshëm përmes krijimit të kushteve të përshtatshme nga buxheti deri te sallat koncertale. E kur jemi te literatura, dikush mund të konkludojë lirisht që botimi i librave muzikorë, përfshirë botimet dhe publikimet muzikologjike në Kosovë, kanë dëshmuar performim të dobët në këtë aspekt. Vetëm pak njerëz kanë vlerësuar një hulumtim të tillë dhe kanë arritur në përfundimin se ishin rrethanat e vështira sociale dhe pa dyshim ekonomike që ndikuan negativisht në prezantimin e vonë të muzikës artistike në Kosovë.

Fondi i një literature muzikore në Kosovë mund të kishte filluar me Shoqatën e Kompozitorëve të Kosovës gjatë periudhës 1975-80, ku ekzistuan rrethana më të mira në Kosovë, por për fat të keq asnjë studim muzikologjik nuk u realizua gjatë periudhës së lartpërmendur. Për shkak të rrethanave të vështira politike që filluan gjatë viteve 1980 në Kosovë, sektori i botimeve në kuadër të Shoqatës së Kompozitorëve, që ishte institucioni qendror për botime të tilla, u detyrua që më pas të ndalonte veprimtarinë e saj.

Në mënyrë të ngjashme gazetaria, kritika muzikore dhe hulumtimi muzikologjik nuk kanë ndjekur sa duhet opusin e muzikës artistike dhe aktivitetet tjera të jetës muzikore në Kosovë. Një nga arsytet është mungesa e muzikologëve, pasi Fakulteti i Arteve i Kosovës - Departamenti i Muzikës në Prishtinë (Kosovë), sot ende nuk posedon Departamentin e Muzikologjisë. Në një mjedis si yni ekziston një nevojë e jashtëzakonshme për shkrime muzikore e sidomos me një përparësi të lartë botimi, por njëkohësisht është një mjedis i frikshëm për ata që marrin guximin të angazhohen në këtë fushë, dhe kështu hapësira për një zhvillim të shpejtë të saj ka qenë e kufizuar. Unë konsideroj se mënyra më e lehtë për të shprehur një opinion në këtë rast edhe për muzikën artistike do të ishte media e shkruar, megjithëse kjo nuk mund të ndodhë edhe për një periudhë në vendin tonë. Mediat në Kosovë ndajnë hapësirë shumë të kufizuar dhe nuk parapëlqejnë të thelloheni në analiza, sepse ashtu si në shumë raste ku u ndesha me reagime të tilla edhe unë si muzikologe, theksohej se artikuj të tillë nuk shiten. Në raport me zhvillimin e teknologjisë, rrjetet sociale kanë mbetur shpëtimi i vetëm i momentit për të shprehurit lirshëm.

Sidoqoftë, përqendrimi im u kthye tek ata që, megjithëse në numër të vogël, kanë dhënë një kontribut të madh në literaturën muzikore në Kosovë, ndër ta Engjëll Berisha (1934-2015), ndoshta muzikologu më eminent në Kosovë deri më tani, i cili la një numër të botimeve dhe ato më domethënëse do të përmenden më poshtë. Këto botime ndikuan në promovimin e muzikës artistike të Kosovës përmes pikëpamjeve, kritikave dhe kanë adresuar problemet e këtij zhanri në Kosovë përmes analizave të opusit krijues të kompozitorëve vendorë.

Berisha i ka dhënë rëndësi të veçantë kurrikulave arsimore në shkollat joprofesionale dhe ato profesionale të muzikës dhe kjo mund të theksohet në këto botime: *Studime dhe shkrime për muzikën*, 2004, i cili përfshin artikuj të përmbledhur, recensione që u botuan në revista të ndryshme vendëse, por edhe prezantimin e portreteve të kompozitorëve vendorë dhe evropianë/botërorë. Pothuajse të gjitha institucionet muzikore kanë gjetur shërbim nga ky botim, i cili në parim mbetet vetëm një përmbledhje mbi momentet e caktuara të muzikës artistike në vend e më gjerë.

Një botim tjetër qendror i tij është *Zhvillimi i stileve në veprat e kompozitorëve shqiptarëve të Kosovës*, 1997, ku Berisha trajton aspektin stilistik të opusit krijues të kompozitorëve kosovarë, nga format e vogla deri në ato të mëdha skenike. Ky botim ka pasur një

ndikim të madh në muzikologjinë kosovare, sepse përveç përfaqësimit të vlerave të muzikës artistike, autori dha një analizë kritike mbi opusin krijues muzikor shqiptar.

Sidoqoftë, pjesë e veprimtarive të tilla është edhe kompozitori dhe akademiku Zeqirja Ballata (1941- ), një kompozitor që ka botuar artikuj në revista të ndryshme (“Rilindja”, “Bujku”, “Bota e re” etj.) dhe gjithashtu ka botuar librin *Gjurmët e muzës*, 1987 në të cilin autori shtron problematika të përgjithshme të muzikës artistike, por me një fokus të veçantë në muzikën artistike në Kosovë. Për më tepër, kompozitori Rafet Rudi (1949-) botoi një libër me titull *Sprova estetike*, 2002, ku përveç diskutimit për problemet karakteristike të zhvillimit të muzikës artistike në Kosovë dhe jashtë saj, ai adoptoi qasje analitike ndaj muzikës evropiane të shekullit të 20-të, pra karakteristikat themelore të muzikës avangarde, që tani në Evropë kishte gjetur shtrirjen e popullaritetit të saj.

Një nga ata që konsiderohet produktiv në këtë fushë është Rexhep Munishi (1936-), etnomuzikolog, i cili përveç botimeve për folklorin muzikor shqiptar, ka trajtuar edhe tema të ndryshme bazuar në aktivitetet e muzikës artistike në vend. *Identiteti muzikor*, 2001, është një nga botimet e Munishit, i cili adreson të gjitha problemet që përshekuan muzikën në Kosovë, veçanërisht në periudhën pas luftës (1999), në të cilën, siç argumenton Munishi, as edhe një element i vetëm i muzikës artistike nuk mbeti "në vendin e duhur", e gjitha për shkak të muzikës komerciale e cila zuri dhe mban ende një vend të veçantë në Kosovë.

Se sa na duhen botime të tilla në Kosovë tregohet qartë përmes secilës parathënie të pak botimeve të këtij lloji në vend. Deri në ditët e sotme ka vetëm tetë botime të librave muzikorë teorikë profesionalë që përmbajnë fakte historike dhe me të cilët mund të shërbehemi.

Një rëndësi e veçantë bie në *Fjalorin enciklopedik muzikor*, fjalori i parë dhe i vetëm në gjuhën shqipe që u botua në vitin 2014. *Fjalori enciklopedik muzikor* është shkruar nga dirigjenti e pedagogu Bajar Berisha (1951-). Ky fjalor përmban terma muzikorë, të njohur dhe më pak të njohur për ne. Autori është përpjekur të përfshijë sa më shumë fjalë nga terminologjia shkencore muzikore. Ashtu si në fjalorët e standardizuar, termat në fjalor vendosen sipas rendit alfabetik dhe përbëhet nga 440 faqe. Ky fjalor ishte aq i nevojshëm dhe po aq i rëndësishëm; ai do të jetë në shërbim të muzikantëve, sidomos atyre profesionistë, duke e ditur që muzika artistike në Kosovë ka dhe vazhdon të ketë mungesë të madhe terminologjike,

veçanërisht kur bëhet fjalë për përkthimin e termave të muzikës në gjuhën shqipe. Nuk do të mund të mos përmend edhe kompozitorin Akil Koci (1936-) i cili ka realizuar një numër botimesh, por si rezultat i pamundësisë për posedimin e tyre (shpesh për arsye të panjohura) nuk do të mund edhe të flisnim më gjërësisht. Megjithatë *Vibracione të shpirtit shqiptar*, 2008, është nga të vetmet botime të cilat i kam afër dhe ku autori paraqet portrete kompozitorësh vendorë e gjithashtu edhe prek problematika shpesh personale me komunitetin artistik.

Në kontekstin e veprimtarisë së dobët botuese në vend, forma tjetër e shprehjes së opinionit publik, vlerësimeve, promovimeve në fushën e muzikës artistike ishin prezantimet publike, konferencat, debatet përmes bisedave mbi muzikologjinë profesionale, tribunat muzikologjike (të organizuara posaçërisht në kuadër të festivaleve të muzikës artistike në Kosovë), që numerikisht nuk ishin të shumta, por realizuan misionin e tyre në avancimin e muzikës sonë dhe jetës kulturore në përgjithësi. Një lloj i debateve të tilla u organizuan dhe u ofruan nga festivale të ndryshme muzikore si ReMusica (2001), DamFestival (2006), përmes punëtorive të vogla, tryezave të rumbullakëta që vazhdojnë traditën e tyre edhe në ditët e sotme (2020) Por sot numri i diskutimeve të tilla ka rënë ndjeshëm, duke zbehur edhe më shumë këtë formë të promovimit të shkëmbimit të mendimit profesional në këtë fushë.

Sot aktivitete të tilla janë të pakta. Sidoqoftë, edhe ato pak botime të përmendura më parë që kanë mbetur janë të vlefshme për t'u kualifikuar si shumë të rëndësishme për publicistët e muzikës. Kosova ose me saktë fondi i muzikës artistike në vend posedon një numër të vogël të botimeve të këtij lloji dhe kjo është arsyeja pse edhe sot mbetet gjysmë bosh. Fokusi themelor i këtyre studimeve është përfaqësimi i kompozitorëve duke analizuar historikun e jetës dhe përgatitjes së tyre profesionale, por edhe aspektin formal e stilistik të opusit të tyre krijues, promovimin e institucioneve dhe performuesve të saj, të cilët së bashku me kompozitorët paraqesin faktorët thelbësorë mbi dëshminë e ekzistencës së muzikës profesionale në vend.

Të gjitha këto botime të përmendura paraqesin analiza të cilat përfshijnë periudhën 1945-1975 dhe rallë atë të mëvoshme. Për më tepër, ne kemi një hendek të madh përsa i përket identifikimit të ngjarjeve kulturore historike në vend, kështu që artikujt informues mund të gjenden vetëm në gazetatat ditore. Është shumë e vështirë të identifikohen elementë të tjerë, faktorë të kësaj periudhe, përveç

dokumentacionit të mbetur nga botimet që i referohen muzikologut Engjëll Berisha. Lufta e fundit (1999) shkatërroi çdo dokument që mund të ndihmojë sot për prova të tilla. Por ajo që vlen të përmendet është se individët që e kanë përjetuar këtë periudhë dhe që fatmirësisht jetojnë sot më dhanë një ndihmë të madhe në lidhje me zgjerimin e fakteve të nisura nga botimet e Berishës.

Sidoqoftë, botimet e lartpërmendura kanë shërbyer jashtëzakonisht shumë si pika orientimi dhe do të citohen shumë. Fatkeqësisht, ne mund të gjejmë pak material dokumentues mbi fillet e muzikës artistike në Kosovë, më shpesh gjejmë artikuj të zhvillimit të muzikës artistike në botë, mbi stilet krijuese të kompozitorëve evropianë dhe më gjerë, të gjitha këto në gjuhën shqipe e nga autorë shqiptarë.

STUDIME SHOQËRORE

7

2020

*Botues:*

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

*Lektor:*

Shfqet Riza

*Redaktor teknik:*

ASHAK

*Realizimi kompjuterik:*

ASHAK

*Madhësia:* 25 tabakë shtypi

*Tirazhi:* 200 copë

*Formati:* 16x24 cm

*Shtypi:*

Focus Print

Shkup